



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHQËTIT

SIGURIMI DHE SHKENCËTARËT

**ROLI I SHKENCËS NË ZHVILLIMIN E SHOQËRISË
GJATË VITEVE TË PARA TË VENDOSJES
SË REGJIMIT KOMUNIST (1945-1954)**


(Studimet e plota)

Kundera Popullit e Shtetit

SIGURIMI DHE SHKENCËTARËT

**ROLI I SHKENCËS NË ZHVILLIMIN E SHOQËRISË
GJATË VITEVE TË PARA TË VENDOSJES
SË REGJIMIT KOMUNIST (1945-1954)**

(Studimet e plota)



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Përgatiti për botim: Ornela Arapi

Redaktore gjuhësore: Kadia Dedja

Përpunimi grafik
& kopertina: Grid Cartels, Arsenina Bushi

FALËNDERIME:

STUDIUES

Prof. As. Dr. Sonila Boçi, Dr. Ledia Dushku, Dr. Andi Pinari, Dr. Enriketa Pandelejmoni (Papa), Prof. Ass. Dr. Albert Nikolla, Joana Doda, Indrit Qehajaj, Doris Pasha, Enxhi Beka, Kristi Kolçe

FAMILJARË

Brikena Çabej, Lluka Qafoku, Leonidha Pepo, Etleva Domi, Ina Kasimati, Plator Kalakula, Mirela Kamsi, Tatjana dhe Marin Haxhimihali

AIDSSH

Ardita Repishti, koordinatorë e publikimeve, Marenglen Kasmi, drejtues i projektit, Skënder Vrioni, Ardiana Topi, Selami Zalli, Anton Dukagjini, Irma Bataj, Bianka Hada, Aldi Dedndreaj, Mirela Lame, Adela Toporja dhe i gjithë ekipi mbështetës.

© Copyright: Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Shtypur nga shtypshkronja “Onufri”

ISBN: 978-9928-354-04-4

Tiranë, 2021

Përmbajtje

Parathënie / 4

Sabiha Kasimati / 8

Eqrem Çabej / 28

Gjovalin Gjadri / 48

Arshi Pipa / 63

Aleks Buda / 77

Kolë Kamsi / 93

Petraç Qafoku / 111

Petraç Peppo / 127

Gjergj Kokoshi / 142

PARATHËNIE

Mendjet e ndritura në tre regjime, qasje multidisiplinare e kërkimit shkencor

Përzgjedhja e datës 7 mars dhe e vendit, Akademja e Shkencave, për të ndarë me publikun historitë drithëruese të shkencës në diktaturë nuk është e rastësishme.

U desh fiks 1 vit që përthyerjet e aparatit shtypës në jetën dhe veprën e përndritur të Sabiha Kasimatit, Eqrem Çabejt, Gjovalin Gjadrit, Arshi Pipës, Aleks Budës, Kolë Kamsit, Petraq Qafokut, Gjergj Kokoshit e të tjerëve, të studioheshin me kujdesin që meritojnë këta margaritarë të mendimit tonë shkencor.

Po këtu, fiks një vit më parë, u hodhën hapa konkretë të bashkëpunimit frytdhënës me Perform, një projekt fisnik zviceran që synonte nxitjen e kërkimit shkencor në Shqipëri.

Me largpamësi dhe vizion u konkludua se kërkimi ynë shkencor nuk mund të humbasë shansin e të kuptuarit çfarë nuk dimë nga historia interesante dhe e pasur e zhvillimit të mendimit intelektual e shkencor në Shqipërinë e re, të para gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Pra:

Kush ishin këta hulumtues?

Në cilin kuadër institucional punuan?

Cila ishte agjenda e këtij kërkimi?

Çfarë vepre lanë pas?

Si u trajtuan ata në tre regjime?

Si reagojnë mendjet e ndritura dhe të kultivuara gjatë luftës dhe në diktaturë?

Ndërkohë që për këto figura është folur gjithë këto vite, sidomos në forumet e ish-të përndjekurve dhe ato të historianëve, në përgjithësi janë trajtuar vetëm si viktima të sistemit. Në mënyrë të reduktuar. Duke lënë jashtë kontributin e tyre themelues në mendimin intelektual e shkencor shqiptar.

Komuniteti i hulumtuesve në institucionet akademike është i painformuar për historinë e bashkësisë së cilës i përkiste dhe të institucioneve kërkimore në të shkuarën.

Ky komunitet do të mbetet skeptik ndaj tregimeve të së shkuarës nëse në këtë narrativë të re që po ndërtohet, nuk aplikohet rigoroziteti i po atij standardi me të cilin ata punojnë çdo ditë në kërkimet e tyre dhe nëse ata nuk përfshihen në këto procese rishqyrtimi.

Prandaj u punua për një qasje multidisiplinare, pra një platformë përfshirjeje e studiuësve të çdo disipline, në qasjen për të mbështetur aksionin për të rishikuar çfarë ndodhi me shkencën dikur.

Mendje të freskëta dhe moderne të ekipit bashkëpunues, përfshirë rigorozitetin shkencor dhe dashamirësinë e një vendi mik dhe politikisht neutral si Zvicra, ekspertiza e kujdesshme e prof. Sonila Boçit, bashkë me përkushtimin maksimal të AIDSSH-së, si institucion për transparencë të Sigurimit, bënë të mundur përcaktimin e një agjende të kërkimit në këtë fushë.

Dhjetë studiuës me përvojë, dhe të rinj, të përgjedhur në mënyrë rigoroze, nën udhëheqjen e profesoreshë Boçit, realizuan fazën e parë të kësaj agjende. Punimet e tyre të shkëlqyera tashmë janë publikuar në një platformë interaktive digjitale të këtyre figurave të shquara nën diktaturë, www.dosjet.gov.al, si dhe versioni i divulguar nga Fatmira Nikolli, në dy gjuhë, anglisht dhe shqip.

Në AIDSSH vlerësojmë kontributin e secilit.

Në punën tonë për qasje në trashëgiminë e Sigurimit dhe diktaturës, në përgjithësi, jemi përcaktuar si platformë shërbimesh për studiuës, me qëllim rishqyrtimin e historisë dhe edukimit për demokraci.

Konkretisht, mundohemi që punën tonë me arhivin, përcaktimin e metadatave dhe përpunimin e materialeve arkivore, ta bëjmë duke i dhënë përparësi mbështetjes së kësaj agjende të studimit shkencor, të cilën e kemi konsultuar dhe bashkërenduar me organizma akademike dhe të memories.

Një kuadër konceptual të punës sonë e kemi ndërtuar në formë matricore.

Një dimension lidhet me *tematikën*, nën okelion *Kur Sigurimi merrej me...* dhe e fillojmë me shkencën. Duke vazhduar me sportin, muzikën, pikturën, letërsinë, politikën, besimin fetar, fëmijët, gratë, kulakët, të kamurit, e kështu me radhë..., ku ilustrohen fatet e individëve, me fakte, dokumente, qoftë nga arkivi i AIDSSH-së, qoftë nga arkivat e tjera, përfshirë ato familjare.

Dimensioni tjetër lidhet me *gjeografinë e ngjarjeve*. E kemi quajtur *Dialogu Lokal për Diktaturën*. U fillua me Tepelenën dhe Konispolin, për të vazhduar me Shkodrën dhe Përmetin. Kjo na lejon të ndërtojmë partneritet të mirë me bashkësitë dhe pushtetin vendor, duke u dhënë konkretësi dhe kontekst ngjarjeve: nga një anë rezistencës ndaj shtypjes, po ashtu edhe ngjarjeve të hidhura të individëve dhe të familjeve.

Këto fusha tashmë po lëvrohen në arkivin tonë, duke u identifikuar, deklasifikuar, digjitalizuar e anonimizuar. Ato presin punë të mirëfilltë shkencore dhe dokumentuese.

Metodologjia e punës është përcaktuar. Ky është një hap i rëndësishëm themelues dhe arritje e madhe, që mbështet procesin e rishqyrtimit të historisë dhe tregimit të saj.

Gentiana Sula
Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi
Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

**Fjala e mbajtur në prezantimin e studimeve, botimit dhe platformës www.dosjet.gov.al të projektit "Roli i shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954)"*



Studimet

Dr. Ledia Dushku dhe Doris Pasha

Regjimi komunist dhe studiuesi: rasti i biologes Sabiha Kasimati

Hyrje

Artikulli *Regjimi komunist dhe studiuesi: rasti i biologes Sabiha Kasimati* ka si qëllim të paraqesë aspekte thelbësore të veprimitarisë së Sabiha Kasimatit si intelektuale dhe studiuese, të vendosura në kontekstin historik të kohës. Analiza në radhë të parë synon t'i japë përgjigje pyetjes se kush ishte dhe çfarë përfaqësonte Sabiha Kasimati para vendosjes së regjimit komunist, për të kuptuar në vijim sjelljen e regjimit karshi saj. Paraqitja në disa këndvështrime e personazhit ndihmon lexuesin të kuptojë deri në çfarë mase sjellja e regjimit ndaj intelektualit kushtëzohej nga veprimtaria shkencore, tiparet e profilit psikologjik apo marrëdhënia me drejtuesit e lartë komunistë, në rastin e Sabiha Kasimatit me vetë Enver Hoxhën.

Materiali është konceptuar në një qasje kronologjike, ndërkohë që aspektet problemore bëhen pjesë e kronologjisë përkatëse. Burimet kryesore arkivore të shfrytëzuara në përpilimin e profilit të Sabiha Kasimatit janë: dokumentet e Arkivit Qendror të Republikës së Shqipërisë, pjesë e fondeve të Ministrisë së Arsimit, Liceut Kombëtar të Korçës, Institutit Mbretëror të Studimeve Shqiptare, fondeve të Partisë (Strukturat dhe Organet Udhëheqëse), Kryeministrisë; dokumentet e dosjes së hetuesisë së të akuzuarve për bombë në Legatën Sovjetike dhe ato të dosjes formulare të Eqrem Çabejt, konsultuar pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH). Të vlefshme për këtë punim kanë qenë materialet e revistës së Institutit të Studimeve/ Institutit i Shkencave; literatura mbi totalitarizmin, mbi komunizmin në Shqipëri dhe vendosjen e bombës në Legatën Sovjetike.



Kundera Popullit e Shtetit

LETËR-RRESHTIMI

Unë Kapiten i I-re Fadil Kapisyzi (5)

qënë se i quajturi Sabiha Kasimati i babës Abdurrëmanit

i Arifit nga Surqija bashkë me hajnës Tirane

Vojo Kushi nga Bari-katave Ar. 99

profesion N.Punas në shënjë

porë së veçanta që pasojnë

Dokumentacioni i munguar i Sigurimit të Shtetit për Sabiha Kasimatin nuk ka dyshim se do ta kishte pasuruar profilin në fjalë. Njëkohësisht, një qasje më favorizuese për studiuesin e legjislacionit për konsultimin e arkivit të AIDSSH-së do të shërbente për të realizuar plotësisht atë që në gjuhën shkencore njihet si kërkim i tërthortë, në saje të të cilit do të zbuloheshin të dhëna plotësuese për Kasimatin nga dosjet e personazheve të survejuara, pjesë e rrethit të saj shoqëror. Realizimi i plotë i këtij kërkimi do të shërbente për të kuptuar më gjerë dhe më thellë anën e errët të regjimit komunist në marrëdhënie me individin/studiuesin në përgjithësi dhe S. Kasimatin në veçanti.

Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri dhe sjellja ndaj elitës

Pas Kongresit të Përmetit të majit 1944 rruga drejt pushtetit për Partinë Komuniste të Shqipërisë (PKSH) dukej se ishte jo fort e largët. Rezistenca kundër pushtuesve dhe pas nëntorit të vitit 1944 fitorja ndaj tyre, u dhanë komunistëve kredite jo të pakta popullariteti, duke lehtësuar kështu ngritjen e tyre në pushtet.¹ Pavarësisht kësaj, komunistët shqiptarë nuk ndiheshin fort të sigurt në rrugën e tyre si të vetëm drejt legjitimitit të pushtetit.




E ardhur nga një familje e mirë, njohëse e disa gjuhëve të huaja, mes të cilave fliste rrjedhshëm frëngjishten, vajza e vetme e shkollës ishte e çlirët, çapkëne, e zgjuar dhe me rezultate të larta në mësim.

¹ Sonila Boçi, "Zgjedhjet e 2 dhjetorit", *Studime Historike*, nr. 1-2/2008, Tiranë: 2009, f. 81.

* Në kontekstin e kohës, me termin "intelektualë të pasqaruar" nënkuptohej ajo kategori intelektualësh që nuk kishin mbështetur rezistencën gjatë Luftës së Dytë Botërore, Partinë Komuniste Shqiptare dhe në përgjithësi nuk kishin afilacion me të majtën komuniste.

Më 17 tetor 1945 u zhvillua Plenumi IV i Komitetit Qendror të PKSH-së, i cili analizoi situatën e brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë. Enver Hoxha në referatin e tij *Mbi situatën e brendshme dhe të jashtme* theksonte se “reaksioni jonë [opozita kundër PKSH-së] nuk i kishte rrënjët në ujë”. Sipas tij, situata ndërkombëtare kishte nxitur “reaksionin” për t’u organizuar dhe për të krijuar një lëvizje opozitare. Ai konsideronte si opozitarë të mundshëm popullsinë e Veriut të Shqipërisë, e cila ishte tërësisht nën influencën e krerëve fisnorë; elementët e pakënaqur nga reformat e ndërmarra nga Qeveria Provizore Demokratike; klerin katolik;

“shtresat e intelektualëve të pasqaruar* dhe që kanë qenë ose janë në pozitat e armikut, ose në indiferencë, shtresat e tregtarëve të mëdhenj që i kanë goditur tatimet e fitimeve të jashtëzakonshme, spekulatorët e përhershëm, shtresat e bejlerëve dhe të agallarëve që i ka prekur ligji i Reformës Agrare dhe rreth këtyre me siguri mund të grumbullohen në rast se ne s’punojmë drejt dhe nuk zbatojmë si duhet vijën e Frontit, të gjithë ata elementë indiferentë të papërzier me politikë dhe që nuk arrijnë të kuptojnë si duhet manovrën e reaksionit dhe përpjekjet tona në këtë situatë të vështirë”.²



Dokumentet e përndjekjes dhe dënimit të Sabihës / AIDSSH

² Sonila Boçi, Hamit Kaba, “Deputetët opozitarë përballë ndërtimit të ‘shtetit të diktaturës së proletariatit’”, Studime Historike, nr. 3-4/2017, Tiranë: 2018, f. 205-206.

Në të tillë situatë, u ndoq një politikë e ashpër dhe represive ndaj atyre që konsideroheshin rivalë prej komunistëve. Krijimi i Gjykatës Speciale për krimet e luftës, ku u arrestuan dhe u vranë shumë kundërshtarë, lufta ndaj komuniteteve fetare, masat drastike ndaj shtresave të pasura dhe ashpërsimi në tërësi i luftës së klasave, ishin politika që regjimi kishte vendosur t'i ndiqte për të siguruar me çdo kusht pushtetin e komunistëve.

Ndërkohë, deklarimi i ndërkombëtarëve në Jaltë për të njohur vetëm ato autoritete “në të cilat të përfaqësohen gjithë elementët demokratë të popullsisë [dhe] që ndërmjet zgjedhjeve të lira duhet sa më shpejt të formojnë qeveri që i përgjigjen vullnetit të popullit”³, si dhe frika nga “armiku fqinj jugor”,⁴ ndikuan që E. Hoxha të shkonte në zgjedhje, të cilat do t'i zhvillonte duke kontrolluar çdo mjet informacioni dhe propagandë.

Studiuesi Afrim Krasniqi shprehet se: “Në rrethanat ku ndodhej vendi, me kundërshtarë politikë të detyruar të emigrojnë, me politikanë kritikë të arrestuar apo të internuar, me pronarë të shpronësuar, me komunitete fetare të sulmuara ashpër dhe me një makinë të fuqishme propagandë, regjimi vendosi të zhvillojë zgjedhjet..., i sigurt se as teorikisht nuk kishte më shanse për refuzimin e tij.”⁵

Zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese u zhvilluan më 2 dhjetor 1945 dhe pa ndonjë surprizë, ato u fituan nga Fronti Demokratik.⁶ Nëpërmjet tyre, Hoxha kreu lëvizjen përfundimtare që i duhej atij dhe

PKSH-së për të krijuar legjitimitetin ndërkombëtar dhe për të marrë pushtetin përfundimisht. Marrja e pushtetit “de jure” nga komunistët dhe zhdukja e opozitës e ktheu PKSH-në në parti të vetme politike në Shqipëri. Shpallja e vendit Republikë Popullore, miratimi i Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë më 14 mars 1946 dhe njohja që i dhanë zgjedhjet qeverisë së Hoxhës, legalizuan vendosjen e pushtetit të PKSH-së, ndo-nëse ajo vazhdonte të fshihej nën hijen e Frontit Demokratik.

10 vitet që do të vinin më pas do të ishin vitet ku regjimi do të kërkonte të konsolidohej dhe si të tilla, do të shoqërohej me një propagandë dhe terror totalitar. Ndërtimi i shtetit të diktaturës bazohej në dhunë sistematike, nëpërmjet së cilës shumë njerëz janë masakruar, vrarë e internuar. Terrori, shprehet studiuesja e totalitarizmit, Hannah Arendt, bëhet total atëherë kur ai përveç opozitës fillon dhe shtyp shoqërinë, pjesë e së cilës janë edhe intelektualët.⁷ Krijimi i një shoqërie homogjene është një ndër aspektet kryesore të totalitarizmit që nëpërmjet propagandës nuk tenton vetëm të ndikojë dhe të ndryshojë jetën e individit, por futet edhe në familje, në intimitetin e tij, duke shkatërruar çdo aspekt të individualitetit njerëzor.

Si pjesë e pandashme e ideologjisë totalitare, terrori dhe dhuna nuk u nënshtrohen rregullave të arsyes së zakonshme, shprehet studiuesja tjetër e totalitarizmit, Cantall Millon Desol. Ato realizohen përmes një aparati policor të bindur deri në verbëri dhe të mirëdisiplinuar, i cili nuk mjaftohet vetëm me dënimin e të akuzuarit, por duhet ta bëjë atë të

³ Artur Conte, *Jalta dhe ndarja e Botës* (Tiranë: Albinform, 1994), f. 189.

⁴ Për më shumë në lidhje me “rrezikun e fqinjit jugor” shih: Sonila Boçi, *Minoritetet midis identitetit dhe integritetit (1939-1949)*, Qendra e Studimeve Albanologjike (Tiranë: Kristalina-KH, 2012), f. 146-167.

⁵ Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008* (Tiranë: EMAL, 2009), f. 190.

⁶ Për një trajtim shterues për zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 shih: S. Boçi, *Zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945...*, f. 81-103.

⁷ Hannah Arendt, *Origjinat e totalitarizmit* (Prishtinë: Dijsa, 2002), f. 589.



Sabihaja në Itali me të afërmit në vitet '30 / arkiva familjare

Në raportet e bashkëpunëtorve të Sigurimit, ajo shfaqej kritike ndaj reformave të qeverisë, politikave të ndjekura, varfërisë dhe e shprehte hapur pakënaqësinë ndaj pushtetit, medias së kontrolluar prej tij madje dhe fjalimeve të mbajtura nga një njeri i pushtetshëm si gjeneral Mehmet Shehu mbi moralin e të rinjve

pranojë gabimet. Nuk ekziston parti tjetër përveç partisë-shtet dhe çdo kundërshtim apo mendim kundër linjës ideologjike të partisë dënohet rëndë. Krahas etjes për pushtet, terrori ushtrohet edhe nga tendenca për të krijuar “njeriun e ri” që duhet të jetë i denjë për shoqërinë komuniste, e konsideruar si e përsosur.⁸ Në këtë kuadër, moment i rëndësishëm konsiderohej puna me elitën.

Për regjimin komunist në Shqipëri, në fazën e parë të tij, përqendrimi i vëmendjes në procesin e formësimit të një elite të re intelektuale, e perceptuar e tillë jo për shkak të moshës, por brumosjes ideologjike, konsiderohej moment i rëndësishëm. Kjo elitë në një të ardhme të afërt do ta ndihmonte atë në vendosjen e paqes së brendshme dhe në rezultat final do të kryente ndërtimin e socializmit. Krahas pjesës rishtare, që do të shkollohej në Bashkimin Sovjetik dhe vendet e Demokracive Popullore, elita e re nënkuptonte edhe reformimin e elitës së vjetër dhe edukimin e saj me idetë e marksizëm-leninizmit. Elita e vjetër, e arsimuar në Perëndim, me parime dhe ideologji të ndryshme nga ajo komuniste, që nuk ishte dakord me formën e regjimit që po vendosej, konsiderohej nga Enver Hoxha dhe drejtuesit më në zë komunistë shqiptarë si rrezik potencial. Si e tillë, ajo duhej “reformuar” që të bashkëpunonte me regjimin, në të kundërt konsiderohej e rrezikshme dhe duhej “eliminuar”.⁹ Mënyra se si regjimi komunist u soll ndaj biologes Sabiha Kasimati përfaqëson një model sjelljeje tepër të ashpër të shtetit karshi studiuesit, në

⁸ Chantal Millon Delsol, *Idetë politike në shekullin XX* (Tiranë: Onufri, 2006), f. 53.

⁹ Rast ekstrem në sjelljen e regjimit me elitën ishte ekzekutimi i inxhinierëve të Maliqit në vitin 1946, për të vijuar më tej me ekzekutimin e një grupi deputetësh të Kuvendit Popullor në vitin 1947. Shih: Sonila Boçi për inxhinierët e Maliqit në: <http://old.shqiptarja.com/news.php?IDNotizia=454639>, parë më 30 korrik 2018; S. Boçi, H. Kaba, “Deputetët opozitarë përballë ndërtimit të “shtetit të diktaturës së proletariatit”..., f. 205-226.

përpjekje për të eliminuar atë që për të konsiderohej kundërshtar politik dhe “armik i pushtetit popullor” me rrezikshmëri të lartë.

Kush ishte Sabiha Kasimati dhe çfarë përfaqësonte ajo

Sabiha Kasimati u lind në Edirne (Turqi e sotme), më 15 shtator të vitit 1912. Në vitin 1927 familja u vendos në Korçë.¹⁰ Kasimati vinte nga një familje intelektuale, ku i ati Abdurrahmani ishte doktor i njohur për kohën. Petro Luarasi, i cili është një nga të paktët që e kanë studiuar figurën e S. Kasimatit, e përshkruan kështu rrethin e saj familjar: “Ajo u mëkua, u rrit dhe u edukua si shqiptare e kulluar në vatrën e një familjeje të madhe në numër dhe vlera, me farefis të gjerë dhe lidhje të thella, me kontribute atdhetare, kulturore e shkencore..., u mëkua me dashuri për atdheun e të parëve të saj libohovitë, diturinë dhe vlerat universale.”¹¹

Shkollimi në Liceun Kombëtar të Korçës (1928-1931) ishte një moment i rëndësishëm në formësimin e Sabiha Kasimatit. Do të ishte Liceu ai që, krahas familjes, do të ndikonte jo vetëm në formimin profesional, por edhe në mbrytjen e karakterit të saj. Kjo nuk ishte e rastësishme, sepse Liceu kishte një trupë mësimore të përbërë nga pedagogë të kualifikuar shqiptarë dhe francezë, një program mësimor ku nxënësit, përveçse njohurive shkencore, merrnin njohuri për edukatën morale

si pjesë shumë e rëndësishme e jetës njerëzore, ndiqnin aktivitetet kulturore duke frekuentuar kinematë e qytetit, kishin lirinë e mendimit dhe formoheshin si qytetarë perëndimorë.¹²

Si liceiste, Sabiha Kasimati ra në sy për zgjuarsinë, vullnetin, natyrën e saj çapkëne e të çlirët dhe rezultatet e larta në mësimet.¹³ Por kjo ishte

Kam qenë kundra pushtetit popullor sepse nuk përputhet me ideologjinë time. Unë nuk kam qenë kurrë e mendimit, që me akte revolucionare të arrihet në komunizëm, jam lidhur me një grup shokësh të cilët edhe ata kanë qenë armiq të Partisë Komuniste.

¹⁰ Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vëllimi i dytë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Tiranë: Kristalina-KH, 2008), f. 1130 (zëri i Sabiha Kasimatit).

¹¹ Petro Luarasi, “105-vjetori i lindjes: Sabiha Kasimati, nderim dhe brengë”, në: <https://www.voal.ch/105-vjetori-lindjes-sabiha-kasimati-nderim-dhe-brengje-nga-petro-luarasi/>, klikuar më 20.07.2018.

¹² Koli Xoxe, *Liceu Kombëtar i Korçës* (Tiranë: Shtëpia botuese “Lumo Skëndo”, 1997), f. 57.

¹³ Sabiha Kasimati do të renditej e dyta në klasë për rezultatet e saj. Në provimet e vitit të fundit ajo vlerësohej me 269.4 pikë, nga 352 pikët maksimale, me shënimin “As Bien”. Shih: Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), fondi (më tej: f.) Liceu i Korçës, viti (më tej: v.) 1931, dosja (më tej: d.) 561, fl. 4. Listë e notave të Sabiha Kasimatit, sezoni i qershorit 1931.

njëra anë e së kaluarës së saj që lidhej me Liceun, ana tjetër kishte të bënte me rrethin e njohjes aty. Ekziston mundësia që pikërisht në Lice, Kasimati të ishte njohur me Enver Hoxhën, i cili studionte aty.

Pas përfundimit të Liceut, Kasimati do të punësohej në Shkollën Amerikane të Kavajës (1932-1933), për t'u rikthyer sërish në Lice, më 3 tetor 1933, tashmë si mësuese në klasat e ulëta të tij. Por qëndrimi në Korçë zgjati vetëm 2 muaj, pasi ajo u detyrua që për



Sabihaja në Itali me të afërmit / arkiva familjare



arsye shëndetësore të jepte dorëheqjen. Ministria e Arsimit e pranoi dorëheqjen dhe e transferoi në Institutin Femëror “Nana Mbretneshë” si mësuese të gjuhës frënge¹⁴.

Këto do të ishin eksperiencat e para të punës së Sabiha Kasimatit, derisa të niste studimet në Itali në vitin 1936, me bursë të plotë nga shteti shqiptar, e përgjysmuar që prej shkurtit 1937.¹⁵ Ajo studioi për biologji në Fakultetin e Shkencave të Biologjisë në Universitetin Mbretëror të Torinos dhe u diplomua në qershor të vitit 1940. Teza e diplomës mbante titullin *Fauna Ittica d’acqua dolce dell Albania (Fauna iktologjike e ujërave të ëmbla të Shqipërisë)*.¹⁶

Gjatë kohës si studente në Torino S. Kasimati nënshkroi një kërkesë drejtuar Ministrisë shqiptare të Arsimit, me anën e së cilës disa studentë shqiptarë kërkuan dhënien e provimeve edhe në sezonin e vjeshtës. Në kushtet e problemeve me gjuhën italiane, lëndët e vështira dhe mungesën e teksteve, sezoni i verës konsiderohej prej tyre i pamjaftueshëm për të kryer plotësisht detyrimet shkollore.¹⁷ Nënshkrimi i kërkesës tregon edhe një anë të karakterit të vajzës së Kasimatëve, guxi-

min për të kërkuar të drejtat e saj. Kjo e bën atë, përveçse të zgjuar dhe inteligjente, edhe një njeri të vendosur për të ngritur zërin, për të reaguar kundrejt asaj që ajo e konsideronte si padrejtësi.

Pasi u kthye nga Italia, Sabiha Kasimati më 13 nëntor 1940 doli fituese në konkursin e shpallur për postin e ndihmëssekretares në personelin e administratës arsimore. Pasi kaloi periudhën e provës, ajo u emërua ndihmëssekretare në grupin A (grada XI) të personelit të administratës arsimore dhe më 24 korrik 1941 filloi punë. Statusi i saj ndryshoi shpejt, kur më 17 nëntor të vitit 1941 u bë pjesë e trupës mësimore të Shkollës Normale Femërore “Nana e Skanderbeut”¹⁸ (ish-Instituti “Nana Mbretneshë”), si mësuese e shkencave, kimisë dhe higjienës. Arsyet shëndetësore e detyruan në maj të 1943-it të largohej nga mësimdhënia dhe të shtrohej në spital në Itali. Sabihaja ishte shëndetligë dhe vuante nga tuberkulozi. Ajo u nxor “në prituni” për një vit deri në maj të 1944-ës. Pavarësisht se nuk ishte pjesë aktive në procesin mësimor, gjatë periudhës së “pritunies” ajo mori rrogë të plotë, e cila tashmë ishte 200 franga në muaj, pasi kishte kaluar në gradë X të grupit A.¹⁹ Mospërmirësimi i gjendjes shëndetësore

¹⁴AQSH, f. Kryeministria, v. 1933, d. IV-338, fl 221. Përgjigje drejtuar Ministrisë së Arsimit nga Kryeministria ku pëlqehet emërimi i Sabiha Kasimatit në Liceun e Korçës; Po aty, d. 338/1, v. 1933, fl 461. Përgjigje drejtuar Liceut të Korçës nga Ministria e Arsimit ku pranohet dorëheqja e S. Kasimatit për arsye shëndetësore; Po aty, f. 803, d. I-218, fl. 68. Jetëshkrim i Sabiha Kasimatit.

¹⁵Fill pasi Kasimati ishte nisur për studime në Itali, Ministria e Punëve të Brendshme kërkoi “hetime të imëta” nga prefektura e Korçës mbi gjendjen ekonomike të saj dhe të familjes. Në përgjigje u raportua se Sabiha Kasimati nuk kishte pasuri në emrin e saj. Babai dhe një vëlla ishin mjekë, kurse vëllai i dytë ishte inxhinier. Nisur nga sa më sipër, më 6 shkurt 1937 Këshilli i Ministrave vendosi t’ia përgjysmonte bursën, sepse familja e saj rezultonte në gjendje “për me kontribue në shpenzimet e nevojshme” për shkollimin e saj. AQSH, f. Ministria e Punëve të Brendshme, v. 1937, d. 147, fl. 12, 56; Po aty, v. 1937, d. 250/1, fl. 382. Ministria e Arsimit për legatën shqiptare në Romë, shkurt 1937.

¹⁶Teza e diplomës iu bë publike opinionit shqiptar dhe familjes Kasimati nga ambasada italiane në Shqipëri, më 15 shtator 2017. Në ceremoninë përkujtimore “Sabiha Kasimati: figura, vepra, përndjekja dhe diktatura”, organizuar nga AIDSSH-ja, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe ambasadën italiane në Tiranë, ambasadori italian i dhuroi familjes dhe AIDSSH-së tezën e diplomës së Sabiha Kasimatit.

¹⁷AQSH, f. Ministria e Arsimit, v. 1937, d. 250/1, fl. 405-406. Kërkesë drejtuar Ministrisë së Arsimit nga studentët bursistë në Universitetin e Torinos për kryerjen e provimeve në sezonin e vjeshtës, 6 prill 1937.

¹⁸Po aty, f. Ministria e Arsimit, v. 1941, d. 207, fl. 261-262. Dekreti i emërimit të Sabiha Kasimatit si profesoreshë në Shkollën Normale Femërore “Nana e Skanderbeut”, 17 nëntor 1941.

¹⁹AQSH, f. Ministria e Arsimit, v. 1944, d. IV-117/3, fl 96. Dekret ministror për nxjerrjen në pritmëri të Sabiha Kasimatit, 20 korrik 1944.

ndikoi që Kasimatit t'i zgjatej pritshmëria deri më 1 maj të 1945-ës. Gjatë kësaj kohe, ajo do të gëzonte jo më një pagë të plotë mujore, por gjysmën e saj.²⁰ Nuk mund të lihet pa u përmendur fakti që ekziston një vendim gjatë kohës që Sabiha Kasimati ishte në kurim në Itali, që e gradoi atë nga profesoreshë e klasit IV në profesoreshë të klasit II, grupi A, me pagë mujore 260 franga.²¹

Nga sa më sipër, kuptojmë që Sabiha Kasimati ka qëndruar 2 vjet në pritshmëri dhe vitin e parë është paguar me pagë të plotë, ndërkohë që vitin e dytë është rritur në gradë pa qenë mësuese aktive në Institutin Femëror “Nana e Skanderbeut” dhe është paguar me gjysmë page. Kjo na bën të mendojmë që në këtë periudhë ajo gëzonte një status të privilegjuar.

Fillesat në rrugën e shkencës

Marrëdhëniet e Sabiha Kasimatit me institucionet shkencore në Shqipëri nisën në janar të vitit 1943. Gjatë kohës që punonte si mësuese në Institutin “Nana e Skanderbeut” ajo pati një bashkëbisedim me Ernest Koliqin, kryetar i Institutit Mbretnuer të Studimeve Shqiptare, themeluar si Institut i Studimeve Shqiptare në prill të vitit 1940. Marrëdhënia e saj me Koliqin i kishte fillesat më herët, në periudhën e shkollimit në Itali, kur, sikurse vetë Kasimati shprehej: “Shkëlqesa e Juaj më përkrahu, si Titullar

i Arsimit që ishi.”²² Menjëherë pas bashkëbisedimit, ajo i dërgoi një letër/raport kryetarit të Institutit, prej nga ku kuptojmë edhe arsyen e takimit.

S. Kasimati i paraqiti Ernest Koliqit një projekt mirëfilli shkencor, nëpërmjet të cilit ajo kërkonte që pranë Institutit Mbretnuer të Studimeve Shqiptare të formohej “një koleksion zoologjik, tue filluar nga Dega e Iktiologjisë”, fushë për të cilën kishte studiuar në Itali vitin e dytë të studimeve dhe kishte mbrojtur temën e diplomës; të përgatitej “një erbario mbasi flora shqiptare, siç dihet, ka provuar interesimin më të gjallë të botanistëve më të çuar, sidomos gjerman dhe t’Europës përgjithësisht”; të grumbulloheshin “në bashkëpunim të ngushtë dhe me Drejtorinë e Minjereve pranë Ministrisë s’Ekonomisë, llojet e ndryshme të mineraleve dhe të fosileve që gjinden në shtresat e tokës në Shqipëri”.²³ Për suksesin e projektit nevojitej krijimi i një biblioteke të posaçme me vepra shkencore, bibliografinë e së cilës ajo e kishte përgatitur tashmë. Krahas bibliotekës, Kasimati propozonte edhe ngritjen e një laboratorit studimesh mikroskopike që do të mundësonte kërkime shkencore relative. “Të gjitha këto, - evidentonte S. Kasimati, - përveç interesit shkencor do të kishin edhe një randësi të lartë nga pikëpamja gjuhësore, mbasi do t’arrihesh të mbli-dheshin, të seleksionoheshin dhe të caktoheshin njëherë e mirë në rast se nuk ekzistojnë emrat dhe termat teknike shqipe, gjë që do të pasuronte mjaft gjuhën t’onë kombëtare”.²⁴

²⁰ Po aty, fl. 98. Dekret ministror për mënyrën e pagesës së Sabiha Kasimatit, 20 korrik 1944.

²¹ AQSH, f. Ministria e Arsimit, v. 1944, d. IV-117/3, fl. 100. Vendim i Ministrisë së Arsimit për gradimin e Sabiha Kasimatit si profesoreshë e klasit II, 22 korrik 1944.

²² Po aty, f. Instituti Mbretëror i Studimeve Shqiptare, v. 1943, d. 23. fl 1. Letër/raport i Sabiha Kasimatit drejtuar Ernest Koliqit, kryetar i Institutit Mbretnuer të Studimeve Shqiptare, 12 kallnor/janar 1943.

²³ Po aty.

²⁴ Po aty.

Në projektin e mësipërm dukshëm vihet re mënyra shkencore dhe akademike e formulimit të tij. Ndonëse në fillimet e karrierës së saj si studiuese, propozimet e S. Kasimatit flasin për një intuitë dhe vizion shkencor, çka e bënte të ardhmen e saj akademike tejet premtuese. Instituti Mbretnuer i Studimeve Shqiptare në mbledhjen e 18 shkurtit 1943, në mbështetje të projektit të Kasimatit vendosi të krijojë pranë tij një muze të shkencave, për përgatitjen e të cilit ngarkoi pikërisht atë. Që prej 22 shkurtit, Sabiha Kasimati do të gëzonte statusin e punonjëses me kontratë pranë Institutit, me një shpërblym mujor prej 200 frangash. Gjithashtu, ajo do të kujdesej për të përgatitur një përshkrim të materialeve të nevojshme dhe të librave për bibliotekën e posaçme.²⁵

Përfundimi i studimeve në Itali në një degë të veçantë siç ishte iktiologjia, përgatitja e një projekti të mirëfilltë shkencor dhe përgjegjësia e ngarkuar nga Instituti Mbretnuer i Studimeve Shqiptare për ndërtimin e Muzeut të Shkencave, tregon se Sabiha Kasimati kishte hyrë tashmë në radhën e studiuesve premtues.

Regjimi komunist dhe sjellja ndaj Sabiha Kasimatit

Sabiha Kasimati vijoi t'i përkushtohet kërkimit shkencor edhe në vitet e para të regjimit komunist, veprimtari që në analizë të fundit do të kushtëzojë

marrëdhëniet e regjimit me të. Dokumentacioni arkivor na bën me dije se Sabiha Kasimati ka qenë pjesëmarrëse në mbledhjen e datës 13 prill 1946 të Institutit të Studimeve Shqiptare,²⁶ krahas figurave me zë të botës akademike shqiptare, si: Kostaq Cipo, Mark Ndoja, Selahudin Toto, Eqrem Çabej, Aleks Buda, Gjergj Komnino, Gjergj Ashta, Jonus Tafilaj, Hasan Ceka dhe Nikolla Lako. Mbledhja e kryesuar nga ministri i Arsimit, Sejfulla Malëshova, bëri një analizë të veprimtarisë së kryer gjatë vitit 1945, prezantoi planin e ri të punës dhe paraqiti ekipin e ri që do të drejtonte Institutin e Studimeve.²⁷ Sipas procesverbalit të mbledhjes, nga viti 1945 deri më 1946 Sabiha Kasimati së bashku me Gjergj Komninon kishte punuar në grupin e drejtuar nga Eqrem Çabej, për përgatitjen e skedave të gjuhës shqipe për terminologjinë e shkencave të natyrës, një ide të cilën ajo e kishte pasur që dy vite më herët, në projektin paraqitur Ernest Koliqit.

Më 28 janar 1947 Këshilli i Ministrave me vendimin numër 16 vendosi "riorganizimin e Institutit të Studimeve Shqiptare në një ent autonom të lidhur drejtpërsëdrejti me Këshillin Ministror".²⁸ Instituti që do të funksiononte me një rregullore të përkohshme, do të kishte në përbërje të tij "njerëz të shquar të artit dhe të shkencës, do të merrej me problemet aktuale të vendit në kuadër gjithmonë të zhvillimit ekonomik dhe kulturor duke shfrytëzuar pasuritë natyrore dhe fuqinë prodhuese të vendit. Tri seksionet më të mëdha të Institutit do të ishin

²⁵ Po aty, fl. 3. Shkresë dërguar S. Kasimatit nga Instituti Mbretnuer i Studimeve ku ajo ngarkohet për përgatitjen e Muzeut të Shkencave me një shpërblym mujor prej 200 frangash, 24 shkurt 1943.

²⁶ Për një informacion të detajuar në lidhje me veprimtarinë e Institutit të Studimeve Shqiptare, i riorganizuar në gusht të vitit 1942 si Instituti Mbretnuer i Studimeve Shqiptare dhe në prill të 1944-ës si Instituti Shqiptar për Studime e Arte, shih: Zyhdi Dervishi, *Fillime vizionare në kohë të traumatizuar*, Sociologji Shkencë 1 (Tiranë: EMAL, 2019).

²⁷ AQSH, f. Instituti Mbretëror i Studimeve Shqiptare, v. 1942, d. 22, fl. 146-147. Mbledhja e Përgjithshme për Riorganizimin e Institutit, 13 prill 1946.

²⁸ Po aty, f. Këshilli i Ministrave, v. 1947, d. 7, fl. 1. Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 16, dt. 28 janar 1947.

gjuhësi e literaturë, shkenca të natyrës dhe pjesa e tretë do t'i përkiste historisë, sociologjisë dhe ekonomisë”.²⁹ Në themel të punës së tij do të ishte ideologjia marksiste-leniniste, do të përdoreshin planet e punës, ndërkohë që modeli sovjetik do të ishte “filli i kuq” që do të përvijonte ndërtimin e shkencës në Shqipëri.³⁰

Manol Konomi, kryetar i parë i Institutit, në mbledhjen inauguruese shprehej: “Ne duhet të marrim nga Bashkimi Sovjetik shkencën dhe teknikën. Duhet të studiojmë literaturën dhe artin e tij. Shkenca e re juridike do të na shërbejë në ngritjen e sistemit tonë ligjor. Eksperiencia e Bashkimit Sovjetik do të jetë një ndihmë e madhe në zhvillimin e ekonomisë sonë dhe në organizimin e Shtetit tonë të ri.”³¹

Ndërsa vetë Enver Hoxha në vitin 1950 theksonte: “Për të përmbushur detyrat e mëdha që na vë përpara ndërtimi i socializmit në vëndin tonë, shëmbëllën na e jep shkenca sovjetike, shkenca e pararojës. Sipas kësaj shëmbëlle së madhe ne Ju premtojmë se do të dalim nga izolimi dhe kufizimi në të cilin donin ta mbanin punën shkencore regjimet e së kaluarës, do t'i lëftojmë me vendosmëri dhe do t'i flakim tej mbeturinat e ideologjive kallpe borgjeze, do të përvehtësojmë sa më mirë të vetmen metodë shkencore, marksizmin-leninizmin dhe do të pajisemi me rezultatet e shkencës sovjetike.”³²

Po cila ishte marrëdhënia e Sabiha Kasimatit me këtë institut, që tashmë me përjashtim të emrit të pjesshëm, në drejtim nuk kishte gjë të përba-shkët me Institutin e Studimeve Shqiptare të periudhës së Luftës së Dytë Botërore. Nga dokumentacioni i konsultuar është e vështirë të zbulosh marrëdhënien e Kasimatit më Institutin e Studimeve përgjatë vitit 1947. Ndërkohë që në qershor të 1948-ës mbledhja e Asamblesë së Institutit të Studimeve, krahas ndryshimit të emrit në Institut të Shkencave, propozoi dhe miratoi anëtarë dhe bashkëpunëtorë të rinj, në radhët e të cilëve ishte edhe Sabiha Kasimati.³³

Në Shqipërinë komuniste studimi i shkencave natyrore do të merrte rëndësi të veçantë, si të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimin ekonomik të vendit. Profesor Sotir Angjeli, shef i seksionit të Shkencave të Natyrës, në referatin e mbajtur në inaugurimin e Institutit të Shkencave, krahas problemit të ujit, të pyjeve, e konsideroi të rëndësishëm edhe studimin e peshkut dhe të peshkimit në Shqipëri.³⁴ Kështu, Sabiha Kasimati, e vetmja e specializuar në iktiologji, do të ishte femra e parë studiuuese që do të merrej me studimin e peshkut dhe peshkimit. Ajo do të botonte në Buletinin e Shkencave, nr. 2-3, 1948, një artikull shkencor mbi këtë aspekt, që çuditshëm nuk u pasqyrua në përmbajtjen e lëndës së revistës.³⁵

²⁹ Buletini i Institutit të Studimeve, viti I, Tiranë: qershor 1947, nr. 1, f. 7. Rregullore e përkohshme për Institutin e Studimeve.

³⁰ Po aty, f. 23-24. Fjala inauguruese e Manol Konomit, kryetar i Institutit të Studimeve, mbajtur n'Asamblenë e Përgjithëshme t'Institutit, më 28 prill 1947; Buletini i Institutit të Shkencave, viti IV, nr. 1-2, Tiranë: 1950, f. 136. Fjala e Tuk Jakovës, nënkryeministër i Republikës Popullore të Shqipërisë në mbledhjen e Seksionit II të Asamblesë së Institutit të Shkencave, 17-18 mars 1950.

³¹ Po aty, f. 23-24. Fjala inauguruese e Manol Konomit, kryetar i Institutit të Studimeve, mbajtur n'Asamblenë e Përgjithëshme t'Institutit, më 28 prill 1947.

³² Buletini i Institutit të Studimeve, viti IV, nr. 1-2, Tiranë: 1950, f. 188. Mbledhja e seksionit III të Asamblesë së Institutit të Shkencave.

³³ AQSH, f. Këshilli i Ministrave, d. 8-2, v. 1948, fl. 22-29. Mbledhja e Asamblesë së Institutit të Studimeve, 21-23 qershor 1948.

³⁴ Buletini i Institutit të Studimeve, nr. 1, viti I, Tiranë: qershor 1947, f. 42. Referati i profesor Sotir Angjelit.

³⁵ Sabiha Kasimati, “Probleme të peshkut dhe të peshkimit në vëndin tonë”, Buletini i Institutit të Studimeve, nr. 2-3, viti II, Tiranë: 1948, f. 18-32.

Artikulli merre në shqyrtim pasuritë kombëtare ujore të Shqipërisë, duke theksuar faunën iktiologjike shumë të pasur në sasi dhe në cilësi. Rëndësi u kushtohej faktorëve të larmishëm natyrorë, duke analizuar ndikimin që ata kishin pasur në shumë-llojshmërinë e peshqve në ujërat shqiptare. Këtë larmi studiuësja Kasimati e përshkruante në terma shkencorë dhe e vinte theksin në cilësinë e lartë të peshkut në ujërat e ëmbla të bregdetit shqiptar.

Artikulli trajtonte edhe problemet e peshkimit, madje guximshëm evidentonte problemet e shumta me të cilat përballëj ai, që nga mjetet primitive të përdorura nga peshkatarët, mungesën dhe përdorimin e kufizuar të barkave të peshkimit, mungesën e mjeteve dhe pajisjeve për konservimin e peshkut të gjallë, mungesën e mjeteve të transportit, pa anashkuar edhe traditën e munguar të peshkimit dhe të një ligji të posaçëm për të. Prodhimi i peshkut ishte një tjetër aspekt i rëndësishëm i trajtuar në artikull, pasi në bazë të raporteve të teknikëve dhe studiuësve të huaj kapaciteti i ujërave të brendshme në Shqipëri rezultonte shumë më i madh nga sa ishte prodhimi i momentit.

Stудиuesja Kasimati shfaqej kritike ndaj situatës në të cilën gjendej peshkimi në Shqipëri, por pa u mjaftuar vetëm me konstatime. Ajo kërkonte që përmes fakteve të identifikonte problemet dhe t'u jepte zgjidhje atyre, zgjidhje që sipas saj do të kontribuonin në mosvarfërimin më tej të ujërave shqiptare dhe në shfrytëzimin e gjithë pasurisë iktike të vendit.

³⁶ Po aty.

³⁷ Sipas parashikimit të punës së Institutit të Shkencave, gjatë vitit 1950 Sabiha Kasimati duhej të kryente ekspedita në orizoret e Beratit, në liqenin (kënetën) e Maliqit dhe të Belshit, në liqenin e Shkodrës dhe të Butrintit, si dhe në grykat e lumenjve Shkumbin e Seman. Shih: Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (më tej: AIDSSH), Materiale Shtesë për Sabiha Kasimatin. Projektplani i punës së Institutit të Shkencave, janar 1950.

³⁸ AQSH, f. Këshilli i Ministrave, v. 1948, d. 802, fl. 40 dhe 60. Plani i Punës së Sesionit të Shkencave të Natyrës për vitin 1948.

³⁹ Po aty. Për botimin e monografisë ishte planifikuar 38.400 lekë shpenzime shtypi dhe 8.000 lekë klishe, në total 46.400 lekë.

Pishikultura (degë e iktiologjisë) dhe organizimi i peshkimit në baza racionale dhe moderne, duke ruajtur sigurisht pasurinë iktiologjike të vendit; organizimi më i mirë i peshkimit, duke përdorur mjetet moderne e ligjet ndërkombëtare, ishin zgjidhjet që ajo propozonte.³⁶ Kjo e bënte Kasimatin një studiuese mendjehapur, në një regjim që diktonte gjithçka. Artikulli, që tregonte rritjen profesionale të S. Kasimatit, ishte bazuar në kërkime shkencore të realizuara përmes ekspeditave dhe kërkimeve periodike. Si një studiuese e arsimuar në Perëndim, referencat e saj ishin po ashtu të tilla, duke mos pasur asgjë të përbashkët me ideologjinë marksiste-leniniste dhe referencat e shkencës sovjetike.

Artikulli do t'i paraprinte një bashkëpunimi të mëtejshëm me Institutin e Shkencave, ku krahas përgatitjes së monografisë *Peshqit e Shqipërisë*, ajo do të ishte pjesëmarrëse në ekspeditat e ndryshme kërkimore,³⁷ si dhe në përgatitjet për Muzeun e Shkencave. Për herë të parë, informacionin për monografinë *Peshqit e Shqipërisë* e gjejmë në planin e punës së Institutit të Shkencave për vitin 1948. Aty ishte parashikuar që “broshura *Peshqit e Shqipërisë* (rreth 100 faqe, 1200 kopje), punuar prej zj. Kasimatit”, të botohej në shtator.³⁸ Ishte planifikuar edhe sasia e parave që do të shpenzohej për botimin e studimit.³⁹ Duke u nisur nga koha e shkurtër për botimin e broshurës, priremi të mendojmë se botimi do të ishte në vija të përgjithshme puna e tezës së diplomës së Sabiha Kasimatit.

Nga hulumtimet e kryera rezulton se broshura nuk doli nga botimi atë vit, ndërkohë që puna kërkimore në repartin e zoologjisë ku bënte pjesë edhe Sabihaja përgjatë vitit 1949 vijoi me hulumtime edhe në ujërat e kripura. Instituti i Shkencave raporton në buletinin e vitit 1949 se ekipi i zoologjisë ka mbledhur material iktologjik të "Liqenit të Shkodrës, të Bunës dhe të Drinit, në ujrat e Rrethit të Shkodrës; ka mbledhur materjal të njëjtë të ujrave të kripura dhe të bregdetit të Shëngjinit. Njëkohësisht ekipi ka bërë vrejje natyre shkencore mbi zhvillimin e kulturës së peshqve, mbi llojet dhe vlerën ekonomike të këtyre".⁴⁰ E gjitha kjo na bën të mendojmë se botimi i broshurës është shtyrë, mbase për mungesë buxheti, dhe Kasimati ka vazhduar punën kërkimore për ta pasuruar studimin e saj edhe me ujërat e kripura. Shtyrja e botimit vërtetohet lehtësisht pasi në Buletinin e Institutit të Shkencave, nr.1-2, viti 1950, bëhet me dije se "në këtë vit janë dhënë për në shtyp studimet origjinale *Ortografia e gjuhës shqipe* kolektive dhe *Peshqit e Shqipërisë* e S. Kasimati.⁴¹ Informacioni në lidhje me sa më sipër është më i plotë në projektplanin e punës së Institutit të Shkencave për vitin 1950, në të cilin ishte parashikuar që të botohej: "Një vepër mbi 'Peshqit e Shqipërisë', hartuar nga S. Kasimati. Vepra me 100 e ca faqe tekst dhe 50 e ca figura, do të vihet në shtyp në tremujorin e parë dhe do të dalë në tremujorin e dytë në 3.500 ekzemplarë."⁴²

Studimi *Peshqit e Shqipërisë* ka parë dritën e botimit, ashtu sikurse ishte parashikuar, në vitin

1950, pasi në raportin e bashkëpunëtorit të Sigurimit të Shtetit me pseudonimin "Prurësja", datë 27 prill 1950, tregohet se Sabiha Kasimati në bisedë të lirë me të ishte shprehur:

"...Tash kemi shpënë në shtypshkronjë një broshurë për t'u botuar; është vepra ime, pjesën më të madhe më ka ndihmuar dhe Çabeu [bëhet fjalë për Eqrem Çabejn]. Sot këtë broshurë vajta dhe e mora nga shtypshkronja. Ju thashë atyre se e kërkon Komisioni i Kontrollit..."⁴³.

Fatkeqësisht për momentin ne nuk zotërojmë asnjë informacion mbi fatin e mëtejshëm të tij. Çuditshëm, nuk ka gjurmë as në Bibliotekën Kombëtare, ku nuk gjendet asnjë skedë që të vërtetojë ekzistencën e tij, madje as gjurmë në inventarin e regjistrimit të librave të kohës.

Studiuesi Leka Ndoja hedh hipotezën se puna e Sabiha Kasimatit është përvetësuar pas pushkatimit të saj në shkurt të vitit 1951 dhe është botuar në vitin 1958, me të njëjtin titull, nën autorësinë e studiuesit rus Anatolij Poljakov dhe të shqiptarëve Ndoc Filipi dhe Ndoc Rakaj.⁴⁴ Është e vështirë për ne që ta pohojmë një gjë të tillë, në kushtet kur mungon një analizë krahasuese shkencore midis librit *Peshqit e Shqipërisë* të Sabiha Kasimatit dhe atij të botuar nën emrat e autorëve të lartpërmendur. Për sa kohë nuk disponojmë broshurën e botuar në vitin 1950, kjo analizë krahasuese nuk mund të jetë shteruese. Megjithatë, studiuesit e fushës mund

⁴⁰ Buletini i Institutit të Shkencave, nr. 2, Tiranë: 1949, f. 108. Ekspeditat e Muzeut të Shkencave të Natyrës.

⁴¹ Buletini i Institutit të Shkencave, nr. 1-2, Tiranë: 1950, f. 192. Aktiviteti Shkencor i Institutit të Shkencave.

⁴² AIDSSH, Materiale Shtesë për Sabiha Kasimatit. Projektplanin e punës së Institutit të Shkencave, janar 1950. Shih edhe Leka Ndoja, *Tjetërsimi i veprës intelektuale gjatë komunizmit në Shqipëri (1944-1990)* (Tiranë: West Print, 2013), f. 9.

⁴³ AIDSSH, Dosja Hetimore e Eqrem Çabejt, fl. 24 (26). Raport i bashkëpunëtorit të Sigurimit të Shtetit me pseudonimin "Prurësja" në lidhje me Sabiha Kasimatit dhe Eqrem Çabejn, 27 prill 1950.

⁴⁴ L. Ndoja, *Tjetërsimi i veprës intelektuale gjatë komunizmit në Shqipëri...*, f. 16-17.

krahasojnë librin e botuar në vitin 1958 me temën e diplomës dhe artikullin e 1948-ës, punë të cilat Kasimati pa dyshim që do t'i kishte bazike në hartimin e studimit *Peshqit e Shqipërisë*. Petro Luarasi ka bërë një hap, ka përkthyer temën e saj të diplomës, në qendër të së cilës janë tipologjitë e ndryshme të peshqve, përkatësisht analiza e 7 familjeve të tyre; përshkrimi gjeografik i mjediseve iktiologjike, si dhe përshkrimi i shkurtër i industrisë së peshkimit në Shqipëri.⁴⁵ Ndërkohë, studiuesi i zoologjisë, profesor Ferdinand Bego, ka bërë recensën shkencore, duke e vlerësuar tezën e saj si një “punim të shkëlqyer diplome, i shkruar me një gjuhë të pasur dhe korrektesë shkencore, në të cilën ajo demonstroi njohuri të thelluara mbi shkencën e iktiologjisë dhe të mjediseve me ujëra të ëmbla të vendit tonë”.⁴⁶

Mbetet e vështirë që nga dokumentacioni i momentit të arrish në një përfundim shterues në lidhje me përvetësimin e punës shkencore të Sabiha Kasimatit. Gjithsesi, nuk mund të mohohet fakti se në lidhje me këtë çështje ka dyshime të arsyeshme, të cilat të çojnë të mendosh se një përvetësim i tillë mund të ketë ndodhur, aq më tepër që studiuesit sovjetikë ishin ulur këmbëkryq në Shqipëri. Në një regjim totalitar, kush konsiderohej “armik” dhe dënohej si i tillë, nuk meritonte asgjë. Familja i internohej, emri i zhdukej, vepra i përvetësohej dhe ai/ajo dergjej në harresë. Siç thotë edhe Machiavelli te libri i tij *Princi*: “Kur është e nevojshme të dëmtohet një njeri, ai duhet të dëmtohet rëndë, në mënyrë që askush të mos druhet më prej hakmarrjes së tij.”⁴⁷

Krahas punës intelektuale, *aspekti i dytë* që kushtëzoi marrëdhënien e regjimit komunist me Sabiha Kasimatin ishte natyra e çlirët në marrëdhënie me njerëzit, liria për të shprehur hapur mendimin, si dhe për të kundërshtuar politikat ekonomike, kulturore që regjimi komunist po ndiqte në Shqipëri. Për këtë arsye, ajo duhet të jetë vënë në survejim që herët nga Sigurimi i Shtetit, duke u konsideruar “armike të pushtetit popullor”. Deri më sot të dhëna të drejtpërdrejta për kohën dhe nivelin e survejimit nuk kemi, përderisa nuk ekziston një dosje personale formulare në fondin e Arkivit të Sigurimit të Shtetit. Sipas ish-drejtorit të Arkivit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, studiuesit Kastriot Dervishi, dosjet personale formulare të Sigurimit të Shtetit për të gjithë ata që u ekzekutuan më 22 shkurt 1951, nën akuzën e bombës në Legatën Sovjetike, pjesë e të cilëve është edhe Kasimati, janë eliminuar.

Megjithatë, disa informacione në lidhje me Sabiha Kasimatin kemi mundur t'i gjejmë nëpër-mjet kërkimit të tërthortë, duke konsultuar dosjen formulare të Eqrem Çabejt, studiues në Institutin e Shkencave. Aty kupton se Kasimati i shprehte hapur pakënaqësitë e saj ndaj regjimit. Në raportin e bashkëpunëtorit të Sigurimit me pseudonimin “Prurësja”, më 27 prill 1950, bëhet me dije se S. Kasimati kishte thënë: “Është interesante të kesh gjithë numurat e gazetave që përmbajnë diskutimet sesa raportin e Komandantit. Kush e humb kohën kot, kurse në diskutime mund të gjesh gjëra interesante.” Kritikuese shfaqej ajo

⁴⁵ Petro Luarasi, “105-vjetori i lindjes – Sabiha Kasimati, nderim dhe brengë” në: <https://www.voal.ch/105-vjetori-lindjes-sabiha-kasimati-nderim-dhe-brengje-nga-petro-luarasi/>, parë më 20 korrik 2018.

⁴⁶ Ferdinand Bego, “Vlerësimi i veprës shkencore të studiueses Sabiha Kasimati”. Fjalë e mbajtur në ceremoninë përkujtimore “Sabiha Kasimati: figura, vepra, përndjekja dhe diktatura”, organizuar nga AIDSSH në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe ambasadën italiane në Tiranë, më 15 shtator 2017.

⁴⁷ Niccolò Machiavelli, *Princi* (Tiranë: Shtëpia Botuese Enciklopedike, 1992), f. 12.

edhe në lidhje me diskutimin që “kish bërë Gjeneral Leitnant Mehmet Shehu për grupin e të rinjve, duke i akuzuar si të dobët nga morali”. Në raport tregohet se Kasimati kishte shprehur pakënaqësi për politikat e ndjekura nga drejtuesit komunistë në lidhje me kuadrin: “Udhëheqësit tanë kur duanë të venë ndonjë tjetër në Komitetin Qëndror që e kanë më të besimit, heqin ndonji që e kanë pasur, por që ju ka humbur besimi. I venë ca akuza të kota, që në qoftë se ay i ka zbatuar, prapë me urdhërin e tyre i ka zbatuar.”⁴⁸

Në raportin e datës 22 shtator 1950, sërish të bashkëpunëtorit “Prurësja”, evidentohet se Kasimati “takohet me kaptera dhe gra të cilat kanë burrat kriminelë me damkë”. Madje, ajo shprehte pakënaqësi në lidhje me situatën ekonomike dhe varfërinë në vend, që konstatohet në thëniet e saj: “Shtypi dhe radjo thonë se amerikanët i ushqejnë t’arratisunit me mish kali, por ky i këtyre kutive këtej ç’a është vallë? Se neve nuk i kemi as këto. Rallë na bie t’i kemi, edhe këto me ndërmjetësinë e miqvet tonë.”⁴⁹

Ndërkohë, në raportin për Institutin e Shkencave të datës 3 shtator 1950 që Misto Treska, përgjegjës i Seksionit të Kulturës dhe Arteve në Drejtorinë e Agit-Propit në Komitetin Qendror të PPSH-së, ia dërgonte Bedri Spahiut, e konsideronte Sabiha Kasimatin së bashku me Eqrem Çabejn “njerëz që as politikisht as ideologjikisht nuk kanë asgjë të përbashkët me ne, madje as që mund të edukohen apo korrigjohen”.⁵⁰

⁴⁸ AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 24 (26). Relacion i bashkëpunëtorit me pseudonimin “Prurësja” për Sigurimin e Shtetit, 27 prill 1950.

⁴⁹ Po aty, fl. 25 (27), Relacion i bashkëpunëtorit me pseudonimin “Prurësja” për Sigurimin e Shtetit, 5 tetor 1950.

⁵⁰ AQSH, f. Këshilli i Ministrave, d. 1881, v. 1950, fl. 13. Shënime të Misto Treskës mbi raportet e shokëve Dh. Shuteriqi dhe M. Ndoja, si dhe K. Paparisto e A. Xhuvani, dërguar Bedri Spahiut, sekretar i KQ të PPSH, 3 shtator 1950.

⁵¹ Kastriot Dervishi, *Terrori komunist i vitit 1951* (Tiranë: ISKK, 2017), f. 161.

⁵² AQSH, f. 14, Strukturat, v. 1951, d.1. Diskutim i datës 20 shkurt 1951 në Plenumin XIX të PPSH-së. Shih edhe: Uran Butka, *Bomba në Legatën Sovjetike* (Tiranë: Instituti i Studimeve Historike “Lumo Skëndo”, 2018); K. Dervishi, *Terrori komunist...*

⁵³ K. Dervishi, *Terrori komunist...*, f. 162.

Fundi tragjik i biologes Kasimati

Momenti më kulmor në marrëdhënien e regjimit komunist me Sabiha Kasimatin është arrestimi dhe ekzekutimi i saj, së bashku me 21 persona të tjerë, shumica tregtarë, nëpunës të shtetit, të akuzuar për sulmin ndaj Legatës Sovjetike.⁵¹ Vendosja e “bombës” në Legatën Sovjetike më 19 shkurt të vitit 1951 do të konsiderohej si sulm terrorist ndaj regjimit dhe do të përdorej si pretekst për fillimin e një spastrimi ndaj “armiqve të popullit”. Në Plenumin e Byrosë Politike, më 20 shkurt 1951, Mehmet Shehu deklaroi: “Duhet të merren masa të jashtëzakonshme, pa marrë parasysh ligjet në fuqi. Një masë të tillë ne e kemi marrë edhe kur u vra Bardhok Biba, d.m.th kemi pushkatuar edhe jashtë ligjeve në fuqi. Ne duhet terrorit t’i përgjigjemi me terror dhe këtë mund ta bëjmë me plot ndërgjegje dhe me gjakftohtësi. Ne i kemi përgatitur listat e arrestimeve dhe po të jeni ju dakort veprojmë që sonte.”⁵²

Menjëherë nisën arrestimet. Studiuesi Kastriot Dervishi pas konsultimit të dokumenteve në Arkivin e Ministrisë së Brendshme ka arritur në përfundimin se proceset janë mbyllur me të shpejtë, pa u bërë hetim real. Po sipas tij, regjimi e komunistët vuanin nga kompleksi i inferioritetit, kishin frikë nga njerëzit e arsimuar dhe të shkolluar dhe çdo veprimtari të tyre e interpretonin si “veprimtari armiqësor”.⁵³

Ndërsa studiuesi Uran Butka në lidhje me sa më sipër shprehet:

“Ky ishte dhe motivimi politik i kupolës komuniste për masakrën me pretekstin e ‘bombës’ në Legatën Sovjetike. Të arrestojmë 100 ose 150 veta dhe të pushkatojmë nja 10 ose 15 prej tyre pa marrë parasysh ligjet në fuqi. Pra, ishin vetë partia, vetë pushteti politik, që shkelnin ligjet dhe kryenin një krim shtetëror, një terrorizëm shtetëror, një gjenocid me përmasa të mëdha për motive politike e pushtetore”.⁵⁴

Sabiha Kasimati u arrestua më 20 shkurt 1951 dhe u pushkatua një javë më pas. Emri i saj, çuditshëm, ishte vendosur në listën e sektorit të dytë të Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit, ku përfshiheshin “ballistët, legalistët dhe pronarët”.⁵⁵ Ajo akuzohej se ishte kundër regjimit dhe se mbante lidhje me elementë armiq. Sipas dosjes hetimore: “Gjatë okupacionit ka pasur marrëdhënie me elementë fashistë, shqiptarë e italianë. Ajo mban qëndrim armiqësor ndaj pushtetit, flet kundër reformave dhe mban kontakte me elementë armiq... Ajo akuzohet gjithashtu se ka pasur kontakt me deputetin anglez Lester Hutchiston. Gjithashtu, ka mbajtur kontakte me njerëz të misionit anglez si V. Robinson dhe anëtarin e misionit të UNRRA-s J. S. Payne me të cilin ka pasur lidhje të ngushta. Ajo akuzohet si armike e betuar e pushtetit të sotëm. Ka urrejtje karshi tij dhe sidomos karshi komunistëve, kritikon moralin komunist etj.”⁵⁶

⁵⁴ U. Butka, *Bomba në Legatën Sovjetike...*, f. 34.

⁵⁵ K. Dervishi, *Terrori komunist...*, f. 111.

⁵⁶ AIDSSH, Dosja e hetuesisë së Sabiha Kasimatit, fl. 17. Listë e personave të arrestuar, seksioni II. Shih edhe: U. Butka, *Bomba në Legatën Sovjetike...*, f. 47.

⁵⁷ AIDSSH, Dosja e Hetuesisë së Sabiha Kasimatit, fl. 9, procesverbal, dt. 27.02.1951. Shih edhe: U. Butka, *Bomba në Legatën Sovjetike...*, f. 84; K. Dervishi, *Terrori komunist i vitit 1951...*, f. 151.

⁵⁸ AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 57. Shënim me stilograf poshtë raportit për Sigurimin e Shtetit të bashkëpunëtorit me pseudonimin “Dhëlpërija”, 24 dhjetor 1953. Shënimi është bërë nga një punonjës i Sigurimit të Shtetit dhe mban datën 30 dhjetor 1953, përmbajtja e të cilit është si më poshtë: “Instituti i Shkencave është objekt ku janë grumbulluar njerëz me interes për organet e Sigurimit. Për këtë objekt të interesohet vetë kryetari i degës III.”

Sipas procesverbalit të mbajtur nga Gjykata Ushtarake, pretendohet se Kasimati u është përgjigjur akuzave si vijon: “Akuzën e pranoj pjesërisht. Kam qenë kundra pushtetit popullor, sepse nuk përputhet me ideologjinë time. Unë nuk kam qenë kurrë e mendimit që me akte revolucionare të arrihet në komunizëm, jam lidhur me një grup shokësh të cilët edhe ata kanë qenë armiq të Partisë Komuniste. Ndër shokët e grupit tim ka pasur edhe njerëz që mendonin se duhet të hidheshin në aksione kundër pushtetit. Unë vetë nuk kam kryer ndonjë atentat dhe as që kam marrë pjesë në ndonjë mbledhje, ku është marrë vendim për akte terroriste. Ka bërë vaki që të kem folur se një luftë e re është e paevitueshme dhe se kjo është në interes të popullit shqiptar. Gjë tjetër s’kam për të thënë.”⁵⁷

Që procesi ka qenë i manipuluar del edhe nga dëshmia e pretenduar se është dhënë nga Kasimati, pjesë e dosjes formulare të Eqrem Çabejt. Ajo është e ndryshme nga dëshmia që gjendet në dosjen hetimore të Sabiha Kasimatit dhe të ekzekutuarve të tjerë të shkurtit 1951, duke implikuar emra konkretë të kolegëve të saj në Institutin e Shkencave. Me sa duket, Sigurimi i Shtetit, i cili e konsideronte “Institutin e Shkencave objekt ku janë grumbulluar njerëz me shumë interes...”,⁵⁸ kishte përshtatur më vonë në kohë dëshminë e

saj.⁵⁹ Sipas dëshmisë: “Nga elementat që janë kundërshtarë të pushtetit të sotëm dhe që presin ndryshimin e situatës janë: Eqrem Çabej, Injac Ndoja, Rrok Zojzi, Zef Boriçi, Stiliano Gaxho, Andromaqi Gjorgji [Gjergji] e Sotir Papparisto, të gjithë me punë në Institutin e Shkencave. Me të cilët në raste të ndryshme kam folur duke kritikuar reformat e pushtetit si Reformën Agrare, goditjen e tregëtarëve, politikën e jashtme që ndjek shteti, kemi komentuar lajmet e radiove të huaja mbi jetën e vendeve perëndimore dhe mbi ndryshimin e situatës. Për këto gjëra konkretisht kam biseduar në hotel Dajti me Petro Fundon dhe Eqrem Çabejn, në zyrë me Sotir Pappariston, në muze me Injac Ndojin, Zef Boriçin e Steljano Goxhon. Në shtëpinë e Rrok Zojzit me Eqrem Çabejn, Petro Fundon, Sandër Saraçin e Rrokun. Në zyrë dhe në shtëpinë time me Gjergj Gecon dhe Andrimaqi Gjorgjin.”⁶⁰

Studiues të ndryshëm hedhin idenë se këto procesverbale janë shkruar nga vetë anëtarët e Partisë, pasi koha në të cilën ndodhi e gjithë ngjarja ishte shumë e shkurtër. Uran Butka, duke u mbështetur në dëshminë e prokurorit të Përgjithshëm Siri Çarçani, më 17 nëntor 1993, ku pohohet

se “Gjykata e Lartë ushtarake nuk ka zhvilluar gjyq fare ndaj të pandehurve”, si dhe në shqyrtimin e procesverbalit ku mungojnë firmat e trupit gjykues, arrin në përfundimin se jo vetëm që nuk është bërë ndonjë gjyq, por janë fabrikuar e falsifikuar procesverbalet nga Gjykata e Lartë Ushtarake, pas ekzekutimit pa gjyq të 22 personave të pafajshëm.⁶¹ Për ekzekutimin e tyre sistemi komunist u mjaftua me një dekret të hartuar me urgjencë më 26 shkurt 1951, ku mes të tjerash thuhej se gjyqi bëhej pa pjesëmarrjen e palëve dhe se kundërshtimi i vendimit nuk lejohej.⁶²

Vrasja e Sabiha Kasimatit, së vetmes femër në grupin e të pushkatuarve, menjëherë pas rënies së regjimit komunist, ka ngjallur debate dhe diskutime të ndryshme në opinionin publik shqiptar. Ka prej tyre që pohojnë se ajo është pushkatuar, sepse në një takim me Enver Hoxhën apo letër të shkruar për të ka kritikuar mënyrën se si Hoxha po qeveriste vendin. Në fjalën e mbajtur në ceremoninë përkujtimore *Sabiha Kasimati: figura, vepër, përndjekja dhe diktatura*, arkivistja Gentiana Sinojmeri kumton: “Me aq sa e njohim historinë diktatoriale të komunizmit ndoshta ka qënë e

⁵⁹ Dëshmia e pretenduar e Sabiha Kasimatit është bërë pjesë e Dosjes Formulare të Eqrem Çabejt, më 20 tetor 1954. AIDSSH, dosja formulare e Eqrem Çabejt, fl. 51, Relacion mbi këqyrjen e procesit të Sabiha Kasimatit, dt. 20 tetor 1954. Punëtori operativ Llazar Karafili shkruan: “Më datë 10 shtator 1954 mora në studim shtojc procesin e Sabiha Kasimatit, e proceduar më 26 shkurt 1951 nga Kap. I, Koli Shuke dhe Tog. Laze Dano, e akuzuar si agjente e huaj dhe për veprimtarinë e saj në dëm të Pushtetit Popullor është ekzekutuar. Në procesin e saj midis të tjerave implikon dhe një seri elementësh që janë në përpunim nga ana tonë për të cilët deponon...” (vijon deponimi i parashtruar më lart).

⁶⁰ AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 51. Relacion mbi këqyrjen e procesit të Sabiha Kasimatit, 20 tetor 1954.

⁶¹ U. Butka, *Bombë në Legatën Sovjetike...*, f. 95.

40 vjet pas ekzekutimit, më 10 gusht 1991, një vendim i Gjykatës së Lartë i shpalli të pafajshëm të 22 të ekzekutuarit, duke shënuar fillimin e procesit të rehabilitimit të tyre. Më 10 qershor 1993 presidenti i Republikës Sali Berisha u dha atyre medaljen “Për veprimtari patriotike”. Ndërsa më 25 shkurt 2011 presidenti i Republikës Bamir Topi i jep grupit të 22 intelektualëve dhe qytetarëve që u pushkatuan pa gjyq nga regjimi komunist më 26 shkurt 1951 urdhrin “Nderi i Kombit” me motivacionin: “Në shenjë respekti dhe mirënjohjeje të thellë për qëndresën e pashembullt dhe papajtueshmërinë e palëkundur me idetë e regjimit komunist, të cilët shteti diktatorial i dënoi me vdekje për shkak të bindjeve dhe orientimit të tyre demokratik.” Ndërkohë në tetor 2018 AIDSSH përuroi këndin e kujtesës së biologes Sabiha Kasimati në Muzeun e Shkencave të Natyrës, i cili tanimë mban edhe emrin e saj. Shih: U. Butka, *Bombë në Legatën Sovjetike...*, f. 129-232.

⁶² AQSH, f. Presidiumi i Kuvendit Popullor, d. 27, v. 1951, fl. 5. Dekret mbi ndjekjen dhe shikimin e veprimtarisë s'organizatave terroriste dhe t'akteve terroriste kundër punonjësve të Pushtetit Popullor dhe të organizytave politike e shoqërore të Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, më 26 shkurt 1951.

vetmja grua që shfaq si një shuplakë profecinë e saj duke i thënë Enver Hoxhës: ‘Ti po vret të gjithë intelektualët! Me çfarë ke ndërmend ta ndërtosh Shqipërinë me këpucarët dhe teneqexhinjtë?’⁶³

Ne kemi bërë kërkimet e nevojshme në dosjet e klasifikuara të Arkivit Qendror të Republikës së Shqipërisë dhe në materialet e dosjes së hetuesisë së të akuzuarve për bombë në Legatën Sovjetike, por nuk kemi gjetur një letër të Sabiha Kasimatit për Enver Hoxhën. Ndërkohë, familjarë të saj, në intervistat e dhëna në shtypin e përditshëm, pohojnë se emri i Sabihës në listat e personave që do të pushkatoheshin ishte vendosur nga vetë Enver Hoxha, “pasi ai i ekzekutoi të gjithë ata që e njihnin dhe Sabihaja ishte një prej tyre”, duke qenë bashkënxënës në Liceun e Korçës. Sipas Viktor Kasimatit, nipit të Sabihës: “Ajo kishte një guxim të jashtëzakonshëm për t’i thënë hapur mendimet dhe se e njihje mirë kapacitetin intelektual të Enver Hoxhës, por edhe natyrën e tij prej Don Zhuani dhe njeriu pa moral e vlera. Ajo filloi të fliste hapur për Enver Hoxhën duke e akuzuar si faktorin kryesor për goditjet që po merrte elita shqiptare.”⁶⁴

Pa mohuar këtu marrëdhënien personale të diktatorit me Sabiha Kasimatit, arsytet e ekzekutimit të saj mbartin të ngërthyer një sërë fajtorësh që lidhen sa me tiparet e profilit njerëzor të Kasimatit, punën që ajo bënte, po aq edhe me modelin e emancipimit që regjimi komunist donte t’i injektonte femrës shqiptare. Fakti se Sabiha Kasimati kishte

një karakter të guximshëm për të shprehur atë që mendonte, natyrë të çlirët e mendje të hapur, evidentohet qartë edhe në relacionet e përgjimit të përgatitur për Sigurimin e Shtetit. Në një prej tyre, realizuar në vitin 1954, bashkëpunëtori me pseudonimin “Prurësja” e tregon hapur arsyen e sjelljes ekstreme të regjimit ndaj saj: “Lëre mos e pyet, nuk e bënte zap gojën ajo!”⁶⁵

Përfundime

Sabiha Kasimati për kohën në të cilën jetoi ishte një femër e shkolluar dhe e emancipuar, e pavarur si në mendime ashtu edhe në mënyrën e organizimit të jetës personale. Ajo ishte kthyer nga Italia me një bagazh të konsoliduar të dijeve shkencore, të cilat do të kontribuonin për një Shqipëri më të mirë dhe më të zhvilluar, aspak totalitare dhe marksist-leniniste, ashtu sikurse komunistët kishin vendosur. Kasimati zotëronte tipare të dukshme të një studiueseje të re, skrupuloze dhe vizionare. Puna për Muzeun e Shkencave dhe monografinë *Peshqit e Shqipërisë* pa dyshim ishin hapa të rëndësishëm jo vetëm në konsolidimin e saj profesional, por edhe domosdoshmëri për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë së vogël e të prapambetur.

Me karakterin dhe përgatitjen intelektuale që zotëronte, rrethin e gjerë shoqëror me intelektualë shqiptarë dhe personalitete të huaja, Sabiha Kasimati e sfidonte dukshëm regjimin dhe mentalitetin e kohës. Ajo guxoi të fliste hapur dhe të artikulonte

⁶³ Gentiana Sinojmeri, “Instituti i Studimeve Shqiptare dhe fati i shkencëtarëve shqiptarë”. Fjalë e mbajtur në ceremoninë përkujtimore *Sabiha Kasimati: figura, vepra, përndjekja dhe diktatura*, organizuar nga AIDSSH në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe ambasadën italiane në Tiranë, më 15 shtator 2017.

⁶⁴ “Si e vrau Enver Hoxha, shoqen e klasës”, <https://telegafi.com/si-e-vrau-enver-hoxha-shoqen-e-klases/>, parë më 20 korrik 2018.

⁶⁵ AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 39. Relacion i bashkëpunëtorit me pseudonimin “Prurësja” për Sigurimin e Shtetit, 1 mars 1954.

pakënaqësitë që kishte ndaj regjimit, ndonëse disa prej miqve të saj kishin pasur një fund tragjik, siç ishte rasti i Selahudin Totos, i pushkatuar nga regjimi komunist me Grupin e Deputetëve. Pushkatimi dhe vrasja e dhunshme e S. Kasimatit ishte projektuar nga regjimi në kuadër të eliminimit të kundërshtarëve të tij politikë.

Heqja nga jeta publike dhe intelektuale e grave të tilla të shkolluara si S. Kasimati apo Musine Kokalari eliminonte gjithashtu edhe një tjetër model të emancipimit të femrës shqiptare. Gruaja e emancipuar që regjimi propagandonte duhej të ishte revolucionare dhe e brumosur me ideologjinë marksiste-leniniste. Si një proces kryesisht i imponuar nga lart, emancipimi i femrës shqiptare, më

shumë sesa emancipimin real dhe ndërgjegjësimin për të drejtat dhe vlerat që ajo mbartte, synonte sigurimin e një fuqie të konsiderueshme punëtore dhe subjekti prodhues. Në një shoqëri mashkullore dhe të paemancipuar ky model e vendosi gruan në një barrë të dyfishtë. Ajo do të duhej të punonte dhe të arrinte normat e punës, ndërsa kur të kthehej në shtëpi do të duhej të përmbushte rolin e nënës, të bashkëshortes, të zonjës së shtëpisë, pa pasur kohë dhe mundësi për të menduar për veten. Ky emancipim në realitet ishte nënshtrim dhe mosngritje zëri ndaj padrejtësive që i bëheshin. Regjimi nëpërmjet sjelljes karshi Sabiha Kasimatit u kishte dhënë tashmë mesazhin se si përfundonin gratë mendjehapura, të guximshme dhe sfiduese ndaj autoritetit mashkullor dhe atij shtetëror.

Dr. Ledia Dushku

“Armik i pushtetit popullor” që shkencërisht “punon për ne”: shteti komunist dhe studiuesi Eqrem Çabej (1944-1954)

Hyrje

Marrëdhëniet e regjimeve totalitare me intelektualin janë bërë shpesh objekt diskutimesh në rrethet e studiuesve. Duket sikur ky raport përvijohet në dy kahe të kundërta, ku intelektualin duhet të zgjedhë midis të qenit “njeri i oborrit” ose “disident”, pa pasur rrugë të mesme. Por në diktaturat komuniste ekziston koncepti i “artit të të mbijetuarit”, i cili nuk është gjë tjetër veçse një kombinim i nënshtrimit të kalkulluar, kritikës së vetëkontrolluar, mbajtjes taktike të një profili të ulur dhe përdorimit me inteligjencë e pa zhurmë të mundësive që mund të të krijohen.¹ Në këtë mënyrë pranimi i kontratës sociale të regjimit komunist jo gjithmonë e bën intelektualin “njeri të oborrit”.

Artikulli “*Armik i pushtetit popullor*” që shkencërisht “*punon për ne*”: shteti komunist dhe studiu-esi Eqrem Çabej (1944-1954) fokusohet në marrëdhëniet e regjimit komunist me gjuhëtarin Eqrem Çabej, duke synuar t’i japë përgjigje pyetjes: Si mundi një intelektual i edukuar në Perëndim, i konsideruar “armik i pushtetit popullor”, të mbijetonte dhe më tej të vlerësohej në një regjim ku indoktrinimi marksist-leninist ishte në themel të gjithçkaje?

Nga pikëpamja metodike, artikulli është konceptuar në një qasje kronologjike-tematike. Analiza ka si pikënisje formimin e hershëm intelektual të studiuesit Çabej, për të kuptuar në vijim sjelljen e regjimit komunist ndaj tij.

¹ Andrei Plesu, “Intellectual life under dictatorship”, *Representation*, No. 49. *Special Issue: Identifying histories: Eastern Europe before and after 1989*, Winter, 1995, University of California Press: 1995, p. 64. <https://www.jstor.org/stable/2928749>, klikuar më 20 tetor 2020.

INSTITUTU I HISTORIS
STUDITUM I HISTORIS
protokoll Nr. 118/42



Titane 27.11.42

Ju llogon, me merrni
peshon, ku kemi marrjen
me shqisun nga liria e mi-
-larëve të Jugosllavisë së
meve Jugosllavisë. Ajo qe
kërkoi për të se ç'është
këtyrë fqinjëve synuar
Fulvio Corrocciani, të cili
me vërtetë ka qenë një
personalisht, qe të njëjtat
ndit si arsimi, si neptë
racës shqiptare.

Qune merrni me atë qe
të parrukuara merrsiore, ju



Prezantimi në disa këndvështrime i personazhit, gërshetuar me ekspozenë e tipareve që fitoi “shkenca” dhe “punonjësi i mendjes” në Shqipërinë e viteve 1945-1954, janë në funksion të zbulimit të sjelljes së regjimit ndaj tipologjisë së intelektualit, të përfaqësuar nga E. Çabej; për të kuptuar se deri në çfarë mase qëndrimi i shtetit kushtëzohej nga

është përqendruar kryesisht në dokumentacionin arkivor. Janë qëmtnuar me imtësi dokumentet e Arkivit Qendror të Republikës së Shqipërisë, pjesë e fondeve të Ministrisë së Arsimit, Institutit Mbretëror të Studimeve Shqiptare, fondeve të Partisë së Punës (Strukturat dhe Organet Udhëheqëse) dhe Kryeministrisë. Mbështetje metodologjike mjaft të rëndë-



**Që prej fillimit, qeveria
komuniste e etiketoi
Çabejn si një element të
rrezikshëm që është
ideologjikisht dhe
politikisht problematik**

marrëdhënia e intelektualit me Sigurimin e Shtetit, nga tiparet e profilit të tij psikologjik, veprimtarisë shkencore, qëndrimit të partisë-shtet dhe vetë Enver Hoxhës.


Deri më tani është shkruar shumë në lidhje me veprimtarinë shkencore të profesor Eqrem Çabejt, por studimet në lidhje me marrëdhënien e regjimit me të janë të mangëta. Në këtë optikë, kërkimi

sishme përbëjnë hulumtimet në dosjen formulare të Sigurimit të Shtetit për E. Çabejn, kon-sultuar pranë AIDSSH-së. Me anën e tyre është analizuar dinamika e vëzhgimit, spiunimit, impaktin që këto kanë pasur në jetën dhe veprimtarinë e Eqrem Çabejt. Një qasje më favorizuese ndaj studiuesit e legjislacionit për konsultimin e arkivit të AIDSSH-së do të shërbente për të realizuar plotësisht atë që në

gjuhën shkencore njihet si kërkim i tërthortë, në saje të të cilët do të zbuloheshin të dhëna plotësuese për E. Çabejn nga dosjet e personazheve të survejuara, pjesë e rrethit të tij familjar e shoqëror. Realizimi i plotë i këtij kërkimi do ta pasuronte profilin e përgatitur dhe do të shërbente për të kuptuar më gjerë dhe më thellë anën e errët të regjimit komunist në marrëdhënie me individin/ studiuesin në përgjithësi

Kush ishte dhe çfarë përfaqësonte Eqrem Çabej

Eqrem Çabej u lind më 6 gusht 1908 në Eskishehir, qytet në afërsi të Ankarasë (Turqi). Sipas së bijës, Brikena Çabejt, 6 muaj pas lindjes së tij familja u vendos në Gjirokastrë, por “babait nuk i pëlqente të thoshte që kishte lindur andej.



Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike

Fjala e Enver Hoxhës 24/02/1954

27/09/1942

dhe E. Çabejn në veçanti. Duke synuar trajtimin e marrëdhënies së studiuesit me regjimin komunist në shumë plane u konsiderua e rëndësishme edhe historia orale, e përcjellë në saje të kujtimeve të së bijës së profesorit, Brikena Çabejt, e cila u tregua tejet bashkëpunuese.

Në dëftesat e shkollës vendlindja është Eskishehir, por në çdo biografi ai quante, edhe psikologjikisht besoj, Gjirokastrën si vendlindjen e tij. Kurrë nuk e shkroi që kam lindur në Eskishehir”.² I ati, Hyseni, me profesion gjyqtar, kishte lënë gjurmë në formimin e të birit, duke i dhënë një edukatë, sikurse

² Brikena Çabej, *Takimet e tim eti me Enver Hoxhën*, në <http://gazeta-shqip.com/lajme/2017/03/08/brikena-cabej-takimet-e-tim-eti-me-en-ver-hoxhen/>, klikuar më 13 qershor 2018.

vetë Çabej shprehej, “me drejtim nga ndershmeria qytetare dhe nga dashurija për vendin”.³ Shkollën fillore dhe qytetëse djaloshi i Çabejve e përfundoi në Gjirokastrë.⁴ Pasi fitoi një bursë nga shteti shqiptar, më 1920 vijoi shkollimin në Austri, fillimisht në St. Polten, më tej në Graz dhe maturën në Klagenfurt. Studimet e larta i përfundoi po në Austri, përkatësisht 3 semestra në Universitetin e

njohur të kohës, si dhe në histori të Ballkanit. Gjatë gjithë periudhës së shkollimit Çabej tregoi vullnet e këmbëngulje dhe u dallua si i ri që premtonte mjaft. Formësimi me tiparet solide të shkencëtarit merr pikënisje në këtë periudhë.

Profesor Jokli, duke çmuar talentin e tij, e mbajti afër. Marrëdhënia mes tyre ndikoi në mbujtjen e Çabejt me dashurinë për kërkimin shkencor



Çabej dhe gruaja e tij, Shyhreti / arkiva e familjes

Në 1948, Çabej qëndroi në kontakt me 62 persona, në 1953, numri zbriti në 17. Dhe në 1956 ai takoi vetëm 2 persona jashtë rrethit të tij të ngushtë familjar

Grazit dhe 5 semestra në Universitetin e Vjenës, duke u specializuar në linguistikë të përgjithshme e indoeuropiane dhe në albanistikë, në klasat e profesor Nobert Jokli-t, një nga albanologët më të

dhe shërbeu si shtysë për vijimin e studimeve të thelluara për gjuhën shqipe, tashmë me tezën e doktoraturës *Italoalbanische Studien (Studime italo-shqiptare)*. Disertacioni u mbrojt më 7 tetor

³ Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (më tej: AIDSSH), Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 12.

⁴ Për një informacion të plotë në lidhje me biografinë e Eqrem Çabejt shih: Shaban Demiraj, *Eqrem Çabej. Një jetë kushtuar shkencës* (Tiranë: 8 Nëntori, 1990); *Eqrem Çabej, personalitet i shquar i shkencës dhe i kulturës shqiptare* (në 90-vjetorin e lindjes), Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, sesioni shkencor i albanologjisë, *Studime shqiptare 9* (Tiranë: Botimet Çabej MÇM, 1998); *Eqrem Çabej dhe vendi i tij në shkencat albanologjike*, Aktet e konferencës shkencore në 100-vjetorin e lindjes së Eqrem Çabejt, organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (Tiranë: Kristalina KH, 2009).

1933 dhe Eqrem Çabejt iu dha diploma për gradën Doktor nga Universiteti i Vjenës, me rezultatin Shkëlqyer. Për sa më sipër, autoritetet drejtuese të universitetit i propozuan të qëndronte aty, si asistent pranë Joklit. Por Çabejt e refuzoi propozimin, u kthye në Shqipëri, duke përmbytur kështu angazhimin që kishte marrë më 19 gusht 1927 karshi shtetit shqiptar, me të cilin “detyrohej që, mbasi të ketë kryer mësimet, t’i shërbejë Shtetit për 7 vjet në çdo vend që dërgohet ose t’i kthejë të hollat e marruna si bursë”.⁵

Me t’u kthyer në Shqipëri, E. Çabejt punoi si profesor i letërsisë dhe gjuhës shqipe, fillimisht në Gjimnazin Shtetëror të Shkodrës dhe më pas në Normalen e Elbasanit, Gjimnazin Shtetëror të Gjirokastrës dhe Liceun e Tiranës. Njëkohësisht, ai mbajti edhe poste administrative, si atë të nëndrejtorit të konviktit “Malet tona” në Shkodër dhe shefit të seksionit të arsimit të mesëm në Ministrinë e Arsimit. Sipas relacionit të drejtorisë së Gjimnazit të Shkodrës, profesori i letërsisë shqipe shfaqte prirje liberale në marrëdhënie me nxënësit dhe respektonte mendimin e tyre. Vendosja e një marrëdhënieje besimi konsiderohej e rëndësishme dhe në këtë aspekt gënjeshtër nuk përtypej lehtë prej tij. Ndonëse drejtorja e gjimnazit konstatonte se për shkak të moshës së re i mungonte shpirti i sakrificës, evidentonte faktin se Çabejt “përmban në vedit elementë përmirësimi dhe bindjeje”.

Ai spikaste për korrektësinë, përgatitjen profesionale dhe ndjenjat kombëtare: “Asht shumë i zoti dhe përpiqet gjithnjë tue studjue, me dalë kurdoherë faqe bardhë. Nuk ka mungue në shkollë. Ka ndjenja të mira kombësije.”⁶

Sakaq, vrullshëm nisi edhe konsolidimi i Eqrem Çabejt si studiues i letërsisë e gjuhës shqipe nga njëra anë dhe folklorit nga ana tjetër. Spikasin botimet e një sërë artikujve të *Hylli i Dritës* dhe në revista të ndryshme ndërkombëtare, pa anashkaluar edhe librin *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, me pjesë të zgjedhura për shkollat e mesme, botuar nga Ministria e Arsimit në vitin 1936.⁷ Kjo veprimtari e klasifikonte Çabejn si një nga intelektualët dhe edukatorët më në zë në Shqipërinë e fundviteve '30.

Lufta e Dytë Botërore e gjeti E. Çabejn drejtor të Liceut të Tiranës, post që nuk e mbajti gjatë. Arsyen e zbulon raporti i datës 27 korrik 1940 i Federatës së Fashios së Tiranës në të cilin Çabejt konsiderohej “i vetmi person përgjegjës për veprimet e këqija të kryera nga studentët e Liceut në demonstratat e njohura të 28 nëntorit 1939. Deri më sot nuk ka treguar asnjë shenjë afrimi me politikën fashiste. Prandaj duhet konsideruar i rrezikshëm dhe duhen marrë masa për ta shkarkuar nga detyra që kryen në këtë moment”.⁸ Në janar të vitit 1942⁹ ai u dërgua “si gjysmë internimi”¹⁰ në Itali, ku qëndroi

⁵ Eqrem Çabejt kishte marrë bursë nga shteti shqiptar për një periudhë 13-vjeçare (1 tetor 1920 deri 31 dhjetor 1933), në vlerën e 23.550 frangave. Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), fondi (më tej: f.) Ministria e Arsimit, dosja (më tej: d.) 524, viti (më tej: v.) 1935, fl. 1. Shkresë e ministrit të Arsimit për Ministrinë e Financave, Tiranë, 29 janar 1935.

⁶ Po aty, f. Ministria e Arsimit, d. 33, v. 1934, fl. 100-106. Raport i drejtorisë së Gjimnazit Shtetëror të Shkodrës për Ministrinë e Arsimit, Shkodër, 12 gusht 1934.

⁷ Shih: Jup Kastrati, “Bibliografi për Eqrem Çabejn”, *Studime Filologjike*, nr. 3, Tiranë: 1981, f. 219-254.

⁸ AQSH, f. Partia Fashiste, d. 138, v. 1940, fl. 15-20. Raport i Federatës së Fashios së Tiranës dërguar Drejtorisë Qendrore të Partisë Fashiste Shqiptare, Tiranë, 29 korrik 1940; Sh. Demiraj, *Eqrem Çabejt...*, f. 12-13.

⁹ Po aty, f. Ministria e Arsimit, d. 780, v. 1942, fl. 1. Njoftim i Ministrisë së Arsimit dërguar prefekturës së Tiranës, Tiranë, 9 janar 1942.

¹⁰ Kështu e konsideron E. Çabejt periudhën e qëndrimit në Itali. Shih: AIDSSH, Dosja Formulare e E. Çabejt, fl. 12.

i mbikëqyrur deri në qershor të vitit 1944, duke punuar për Atlantit (Atlasit) Gjuhësor Shqip¹¹ në Akademinë e Shkencave në Romë.

Ndërkohë, në vlerësim të punës së tij shkencore, Eqrem Çabej që prej prillit të 1940-ës ishte anëtari më i ri në moshë “i rendshëm” [i rregullt] dhe pjesë e Këshillit Drejtues të Institutit të Studimeve Shqiptare, i riorganizuar në gusht të vitit 1942 si Instituti Mbretënor i Studimeve Shqiptare dhe në prill të 1944-ës si Instituti Shqiptar për Studime e Arte.¹² Në mbledhjen e dytë të Këshillit Drejtues, më 14 prill 1940, kur u diskutua përgatitja e shpejtë e një përmbledhjeje për gjendjen e studimeve të realizuara nga autorë shqiptarë dhe të vendeve të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët, Eqrem Çabej u caktua një nga dy redaktorët e pjesës së gjuhës shqipe, së bashku me studiuesin italian Carlo Tagliavini.¹³

Por marrëdhënia e tij me institutin nuk rezultoi lineare. Ajo pësoi thyerje në vitin 1942, kohë kur u bë riorganizimi i komisioneve dhe nënkomisioneve të punës. Krahas emërimit në Nënkomisionin e Gjuhësisë, Terminologjisë, Folklorit, Çabej u caktua

anëtar edhe në Nënkomisionin e Fjalorit, pjesë e të cilit ishte edhe atë Fulvio Cordignano.¹⁴ Më 27 shtator 1942 ai i dërgoi një letër të shkurtër, por të guximshme, kryetarit të Institutit, Ernest Koliqit, me anën e së cilës kërkoi “të më shlyeni nga lista e anëtarëve të Institutit të Studimeve Shqiptare”, se “si mis [anëtar] i këtij Instituti figuron atë Fulvio Cordignano, të cilin unë vërtet as nuk e njoh personalisht, veçse njihet botërisht si armik i rreptë i racës shqiptare”.¹⁵ Dorëheqja nuk u pranua, nën arsyetimin “se emnimi i tij asht i përjetshëm simbas Statutit”.¹⁶

Në kohën e qëndrimit në Romë, fillimisht autoritetet italiane më 1942 dhe më pas ato gjermane më 1943, i propozuan postin e ministrit të Arsimit në qeverinë e Tiranës. Në të dyja rastet përgjigjja ishte refuzuese. Vetë Çabej është shprehur se “i kam hedhur poshtë dy propozimet për bashkëpunim me të huajt, si gjë që nuk pajtohej me nderin tim shqiptar dhe me të mirën e vendit dhe të popullit tim”.¹⁷ Pa e shmangur një arsye të tillë, mendoj se kishte edhe dy arsye që ndikuan në përgjigjen refuzuese. Arsyeja e parë lidhet me faktin se Çabej nuk e konsideronte të rëndësishëm angazhimin në

¹¹ Në raportin e fillimvitit 1943 që profesor Francesco Ercole, drejtori i Qendrës së Studimeve për Shqipërinë, pranë Akademisë Mbretërore të Italisë, i dërgoi Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë, ndër të tjera, bëhej me dije edhe ecuria e punës për përgatitjen e Atlantit Gjuhësor Shqip. “Pas një studimi paraprak të gjerë e të durimshëm si nga pikëpamja teknike e përgjithshme ashtu edhe nga pikëpamja gjuhësore dhe etnografike shqiptare”, Eqrem Çabej kishte përgatitur kuestionarin (pyetësorin). Në vijim do të niste mbledhja e lëndës gjuhësore. Pyetësori u botua në vitin 1943 në Itali në gjuhën shqipe dhe italisht. Sociologu Zyhdë Dervishi e konsideron atë si të parën anketë në studimet sociolinguistike dhe përgjithësisht në studimet sociale të shoqërisë shqiptare. Shih: Zyhdë Dervishi, *Fillime vizionare në kohë të traumatizuar*, Sociologji Shkencë 1 (Tiranë: EMAL, 2019), f. 318.

¹² AQSH, f. Instituti i Studimeve Shqiptare, d. 10, v. 1940, fl. 1-3. Dekret i Mëkëmbësit të Madhërisë së Tij, Viktor Emanuelit III, 10 gusht 1942; po aty, d. 19, v. 1942, fl. 11, Instituti Mbretënor i Studimeve Shqiptare për anëtarët e Këshillit të Institutit, Tiranë, më 28 shtator 1942; po aty, fl. 13. Letër e Kryetarit të Institutit Mbretëror të Studimeve Shqiptare, Tiranë, më 9 tetor 1942; po aty, d. 1, v. 1944, fl. 4. Kryesija e Këshillit të Naltë për Institutin Shqiptar për Studime e Arte, Tiranë, 22 prill 1944. Për një informacion të detajuar në lidhje me veprimtarinë e Institutit shih: Z. Dervishi, *Fillime vizionare në kohë të traumatizuar...*

¹³ Z. Dervishi, *Fillime vizionare në kohë të traumatizuar...*, f. 306.

¹⁴ AQSH, f. Instituti i Studimeve Shqiptare, d. 19, v. 1942, fl. 13-18. Letër e kryetarit të Institutit Mbretëror të Studimeve Shqiptare, Tiranë, më 9 tetor 1942.

¹⁵ Po aty, f. Instituti i Studimeve Shqiptare, d. 1, v. 1942, fl. 16. Letër e Eqrem Çabejt dërguar Institutit Mbretënor të Studimeve Shqiptare, 27 shtator 1942.

¹⁶ Po aty, fl. 17. Kryetari i Institutit, Ernest Koliqi, për kryeministrin, Tiranë, 5 tetor 1942.

¹⁷ Sh. Demiraj, *Eqrem Çabej...*, f. 13.

politikë. Në telegramin që përfaqësia diplomatike gjermane në Romë i dërgon Ministrisë së Punëve të Jashtme, evidentohet se Çabej e kishte refuzuar postin e ministrit të Arsimit nën arsyetimin se “nuk e ndien veten të zot për postin e ministrit dhe nuk dëshiron gjithashtu të angazhohet politikisht”.¹⁸ Krahas kulturës së marrë në familje për t'i qëndruar larg politikës, në mbujtjen e tij duhet të ketë ndikuar edhe fakti se në periudhën e Ahmet Zogut nëpunësit dhe arsimtarët e kishin të ndaluar me ligj përfshirjen në veprimtari politike. Arsyeja e dytë që duhet ta ketë çuar Çabejn në refuzimin e postit të propozuar tanimë nga gjermanët, mendoj se lidhet me fundin tragjik që gjermanët i dhanë profesorit të tij të dashur, Nobert Jokli, i cili u vra prej tyre, ndërkohë që zhdukën edhe bibliotekën e tij personale. Ky mendim përforcohet edhe nga Brikena Çabej, e cila me bindje thotë se i ati “nuk mund të pranonte të bëhej ministër i gjermanëve, që i patën vranë babanë shpirtëror, Joklin”.¹⁹

Lajmi për vrasjen e të vëllait, Selahudin, me detyrë nënprefekt i Tropojës, ishte, sipas familjarëve, arsyeja e kthimit në Shqipëri të Çabejt. Me të mbërritur, në korrik 1944, ai filloi punë provizore në Ministrinë e Arsimit, në Komisionin e Teksteve Shkollore (Inspektoria Eprore). Ndërkohë, Çabej vijoi të përmbushte angazhimin e tij në Institutin e Studimeve Shqiptare dhe të Artit, duke marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit të Gjuhës e të Letërsisë.

¹⁸ Buletini Arkivor Ushtarak, Përmbledhje dokumentesh nga Fondi i Komandës Gjermane 1940-1944, nr. 1-2/2017, Ministria e Mbrojtjes. Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, Tiranë: 2017, f. 153-154. Përfaqësia diplomatike në Romë, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Romë, 8 dhjetor 1943.

¹⁹ Intervistë e Brikena Çabejt dhënë L. Dushkut, qershor 2018.

²⁰ AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 12. Biografi e Eqrem Çabejt.

²¹ AQSH, f. Instituti Mbretëror i Studimeve Shqiptare, d. 22, v. 1942, fl. 146-147. Mbledhja e Përgjithshme për Riorganizimin e Institutit, 13 prill 1946.

²² Buletini i Institutit të Studimeve, viti I, nr. 1, qershor 1947, f. 14. Fjala inauguruese e Manol Konomit, kryetar i Institutit të Studimeve, mbajtur n'Asamblenë e Përgjithshme të Institutit më 28.4.1947.

Kjo marrëdhënie vazhdoi deri në maj të vitit 1945, kur Qeveria e Përkohshme Demokratike mori në dorë drejtimin e Institutit të Studimeve dhe vendosi si përgjegjës të tij Selahudin Toton. Tanimë Çabej u emërua nëpunës teknik²⁰ dhe përgjatë viteve 1945-1946 drejtoi punën e grupit për përgatitjen e skedave të gjuhës shqipe, për terminologjinë e shkencave të natyrës, pjesë e të cilit ishin Sabiha Kasimati dhe Gjergj Komnino.²¹

Tipare të shkencës dhe “punonjësit të mendjes” në vitet e para të Shqipërisë komuniste

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjes së regjimit komunist Shqipëria hyri në një fazë të re të zhvillimit politik, shoqëror dhe ekonomik. Struktura shtetërore dhe shoqëria shqiptare do të duhej të zhvilloheshin mbi baza krejt të reja, të cilat nuk kishin asnjë pikë takimi me atë çka kishte ndodhur në Shqipëri më herët.

Përrjashtim nga e tëra nuk do të bënte as fusha studimore dhe “punonjësit e mendjes”. Që në mbledhjen e dytë të Frontit Demokratik, më 7 tetor 1946, Enver Hoxha i konsideroi çështjet e arsimit, kulturës dhe shkencës problemet më me rëndësi të Frontit dhe të Shtetit.²² Tashmë në atë që në terminologjinë e kohës konsiderohej si “Shqipëri e Re”, rrugën e së cilës e kishte shenjuar Lufta Nacio-

nalçirimtare, zhvillimi i arsimit, kulturës dhe shkencës do të merrte tipare thellësisht të ndryshme nga më parë. Ato diktoheshin nga modeli i ri që shteti dhe shoqëria shqiptare do të duhej të ndiqnin. Sa i përket kulturës/ shkencës, Hoxha shprehej se, në përgjithësi, duhej të zhvillohej në baza shkencore, të pastrohej nga “të gjitha ideo-logjitë reaksionare që gjenden në kundërshtim flagrant me principet e mëdha që dualën nga Lëvizja Nacional-Çlirimtare”.²³ Në të kundërt, ajo konsiderohej “antihistorike, anti-njerëzore, shërbë-tore e ulët dhe armë e poshtë në duart e klikave reaksionare”.²⁴

Sikurse edhe në fusha të tjera, modeli mbi të cilin do të ngrihej shkenca shqiptare ishte ai sovjetik, i konsideruar si pararojë. Shkenca shqiptare, sikurse ajo sovjetike, duhej të kishte në themel një botëkuptim unik: materializmin dialektik që përbënte bazën filozofike të doktrinës së Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit. Ajo duhej të ishte “në shërbim të masave punonjëse” dhe e mburjtur me frymë partie. Në funksion të kësaj fryme, ngjyresa politike që kultura/shkenca duhej të merrte ishte komponenti bazë i saj. Shkenca nuk mund të mos kishte përmbajtje ideologjike dhe për këtë, sikurse shprehej Manol Konomi, kryetar i Institutit të Studimeve, studiuiesit nuk duhej të kishin as më të voglin dyshim.²⁵

Tiparet e mësipërme ishin përcaktuese edhe për veçoritë që duhej të kishte studiuiesi dhe puna e tij. Së pari, “punonjësit e mendjes” duhej të njih-

nin realitetin e ri shoqëror dhe të ndërprinin çdo lidhje “të pashkëputur me botën e vjetër” dhe “shkencën borgjeze”. Metoda e punës së tyre do të duhej të ishte ajo marksiste-leniniste, pa të cilën nuk mund të përfitonte nga shkenca dhe kultura e popujve të Bashkimit Sovjetik.²⁶ Përvetësimi i kësaj metode ishte i lidhur me njohjen e “botëkuptimit të ri” të materializmit filozofik dhe dialektik. Njerëzit e shkencës duhej të dilnin nga sferat e idealizmit ku i kishin shtyrë “regjime reaksionare të së kaluarës” dhe të zbrisnin në sferën e realitetit. Ata duhej të ishin të lidhur me popullin/ masat e gjera. Tashmë liria për studiuiesin (për)kufizohej vetëm tek e drejta e njohjes së aspiratave, nevojave dhe problemeve të popullit, duke u shmangur hapur liria e mendimit dhe e gjykimit.²⁷

Gjithë sa më sipër do të ishin edhe linjat mbi të cilat do të duhej të zhvillohej puna në Institutin e Studimeve, i krijuar rishtazi nga qeveria e Enver Hoxhës, më 28 janar 1947,²⁸ me emër të ndryshuar në Institut të Shkencave një vit më pas. Një ndër 23 anëtarët e Institutit ishte edhe Eqrem Çabej. Tashmë qëndrimet ndaj Institutit Mbretnor të Studimeve Shqiptare dhe veprimtarisë së tij do të fillojnë të bëhen më të politizuara dhe më mohuese. Përpjekjet për ta stigmatizuar këtë institut si një organizëm i krijuar nga pushtuesit fashistë italianë në shërbim të politikës së tyre për italianizimin e shoqërisë shqiptare, sa vijnë e përforcohen.²⁹

²³ Enver Hoxha, *Për shkencën*, vëll. 1 (Tiranë: 8 Nëntori, 1985), f. 12.

²⁴ Buletini i Institutit të Studimeve, viti I, nr. 1, qershor 1947, f. 3. Me rastin e së parës Asamble të Përgjithshme t’Institutit të Studimeve.

²⁵ Po aty, f. 11. Fjala inauguruese e Manol Konomit, kryetar i Institutit të Studimeve, mbajtur n’Asambleshë e Përgjithshme t’Institutit, më 28.4.1947.

²⁶ Buletini i Institutit të Shkencave, viti IV, nr. 1-2, 1950, f. 136. Fjala e Tuk Jakovës, nënkryeministër i Republikës Popullore të Shqipërisë, në mbledhjen e Seksionit II të Asamblesë së Institutit të Shkencave, 17-18 mars 1950.

²⁷ Buletini i Institutit të Studimeve, viti I, nr. 1, qershor 1947, f. 11. Fjala inauguruese e Manol Konomit, kryetar i Institutit të Studimeve, mbajtur n’Asambleshë e Përgjithshme t’Institutit, më 28.4.1947.

²⁸ AQSH, f. Këshilli i Ministrave (490), V. 1947, D. 7, fl. 1. Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 16, dt. 28 janar 1947.

²⁹ Z. Dervishi, *Fillime vizionare në kohë të traumatizuar...*, f. 547-549.

Shteti komunist dhe studiuesi Eqrem Çabej

10 vitet e para pas vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri do të ishin të vështira për shqiptarët dhe intelektualët në veçanti. Regjimi do të kërkonte të konsolidohej dhe si rrjedhojë, do të zhvillonte një propagandë dhe terror totalitar. Sikurse edhe në regjimet e tjera totalitare, terrori do të realizohej përmes një aparati policor të bindur deri në verbëri dhe të mirëdisiplinuar. Nuk ekzistonte parti tjetër përveç partisë-shtet dhe çdo kundërshtim apo mendim kundër linjës ideologjike të partisë dënohej rëndë.³⁰ Krahas etjes për pushtet, terrori ushtrohej edhe nga tendenca për të krijuar “njeriun e ri” që duhej të ishte i denjë për shoqërinë komuniste, e konsideruar si e përsosur.³¹ Në këtë kuadër, rëndësi mori puna me elitën/ intelektualin.

Përqendrimi i vëmendjes në procesin e formësimit të një elite të re, e konsideruar e tillë jo për shkak të moshës, por ideologjisë, mori rëndësi të posaçme edhe për komunistët në Shqipëri. Elita e re, krahas pjesës që do të krijohet rishtazi dhe do të shkollohej në Bashkimin Sovjetik dhe vendet e demokracive popullore, nënkuptonte reformimin e elitës/ kuadrove të vjetër dhe brumosjen me idetë e marksizëm-leninizmit. Në terminologjinë e kohës, “kuadro të vjetër” konsideroheshin ata që kishin studiuar në shkollat e Perëndimit, të cilët nga pikëpamja kulturore ishin nën influencën e asaj

shkollë dhe nën zotërimin e “ideologjisë borgjeze”. Ata ishin pa parti dhe si të tillë, kishin probleme ideopolitike. Elita e vjetër që nuk dakordësohej me formën e regjimit që po vendosej, konsiderohej nga Enver Hoxha dhe drejtuesit më në zë komunistë shqiptarë si rrezik potencial. Si e tillë, ajo duhej “reformuar” që të bashkëpunonte me regjimin, në të kundërt konsiderohej tepër e rrezikshme dhe duhej marginalizuar.³²

Nga sa më sipër, marrëdhënia midis shtetit komunist dhe studiuesit Eqrem Çabej u kushtëzua nga disa aspekte:

Aspekti i parë kishte të bënte me të kaluarën jetësore, me theks te shkollimi në Perëndim, prejardhja familjare, rrethi shoqëror dhe veçanërisht vitet e Luftës së Dytë Botërore.

Për këtë, marrëdhënia midis shtetit dhe E. Çabejt kaloi nëpërmjet sitës së Sigurimit të Shtetit. Informacioni i parë, që mbërrin në trajtën e një shënimi në Drejtorinë e Sigurimit të Shtetit në lidhje me Çabejn, i përket Sektorit të Pushtetit, më 29 shtator 1946, sipas të cilit: “Eqrem Çabej në kohën e fashizmit ishte dërguar në Itali nga Ministria e Ekonomisë për të ndjekur disa studime. Mbas kapitullimit të Italisë ky ka pasur marrëdhënie të mira me gjermanët se këta e emëruan ministër, mirëpo ky nuk pranoi sepse u këshillua nga shokët e internuar. Ky u kujdesua dhe asht elementi kryesor që bëri të vijnë në Shqipëri Stefo Grabocka me

³⁰ Hannah Arendt, *Origjinat e totalitarizmave* (Prishtinë: Dija, 2002), f. 589.

³¹ Chantal Millon Delsol, *Idetë politike në shekullin XX* (Tiranë: Onufri, 2006), f. 53.

³² Rast ekstrem në sjelljen e regjimit me elitën ishte ekzekutimi i inxhinierëve të Maliqit në vitin 1946, për të vijuar më tej me ekzekutimin e një grupi deputetësh të Kuvendit Popullor në vitin 1947 dhe grupin e ekzekutuar në kuadrin e bombës në legatën sovjetike, pjesë e të cilëve ishte edhe Sabiha Kasimati. Shih: “Sonila Boçi për inxhinierët e Maliqit”, në: <http://old.shqiptarja.com/news.php?IDNotizia=454639>; Sonila Boçi, Hamit Kaba, “Deputetët opozitarë përballë ndërtimit të ‘shtetit të diktaturës së proletariati’”, *Studime Historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2017, f. 205-226; Kastriot Dervishi, *Terrori komunist 1951* (Tiranë: ISKK, 2017); Uran Butka, *Bomba në Legatën Sovjetike*, Instituti i Studimeve Historike “Lumo Skëndo”, Tiranë: 2018.

shokë. Na lë të dyshohet se ky ka qenë besnik te gjermanët sa të lirojë dhe të dërgojë në Shqipëri 30-40 shqiptarë të internuar prej italianëve dhe kaq jugosllavë. Dyshohet mbi qëndrimin e tij.”³³ Shënimi me gjasë ishte përpiluar nga Mehmet Shehu, në atë kohë shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Kombëtare, e më pas ministër i Brendshëm, prej nga ku varej Drejtoria e Sigurimit të Shtetit. Në dosjen formulare të Çabejt, të dhënat për implikimin e tij në procesin e riadhesimit të dhjetëra shqiptarëve, gjenden në materialin pa datë, që mban titullin *Pjesë nga relacioni pa firmë i gjeneral M. Shehut*.³⁴

Nuk do të ishin të çuditshme lidhjet e afërta të Eqrem Çabejt me kulturën gjermane, që vinin për shkak të shkollimit në Vjenë. Dokumentacioni arkivor i konsultuar deri më tani dëshmon për kontakte sporadike të Çabejt me autoritetet gjermane në Romë.³⁵ Telegrami i konsullit Gumpert i gjendur në Arkivin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë evidenton një përçapje/ lutje të Eqrem Çabejt për riadhesimin e shqiptarëve të internuar prej pushtuesve italianë në kampe të ndryshme të Italisë Veriore dhe të Mesme.³⁶ Në lidhje me rastin në fjalë, në librin *Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)* Petro Marko tregon se Stefo Grabocka dhe Mina Uçi e kishin këshilluar që të takonte Eqrem

Çabejn. Ky i fundit duhej “të mundahej dhe t’i siguronte një shkresë nga ambasada gjermane në Romë për të shkuar e për të mbledhur shqiptarët e burgosur e të internuar”.³⁷ Çabej ia kishte dalë të siguronte shkresën e kërkuar dhe Petro Marko u autorizua “nga ambasada gjermane e Romës të udhëtojë nëpër Itali për të mbledhur të burgosurit dhe të internuarit shqiptarë që t’i sjellë në Romë, se këndeja ata do të riadhesohen. Autoritetet ushtarake të Rajhut janë të lutura të mos e pengojnë për të kryer misionin e tij”.³⁸

Brikena Çabej, sërish duke iu referuar një bisede të saj me P. Markon, dëshmon se i ati kishte kontaktuar dhe ndërhyrë nëpërmjet një shoku klase të periudhës së shkollimit në Vjenë, i cili ishte mobilizuar nga gjermanët dhe mbante një post të lartë në strukturat pushtuese gjermane në Romë. Takimi mes dy bashkëstudentëve kishte ndodhur rastësisht në një kafene të Romës. “Në atë takim, ai shok i hershëm i kishte treguar se kishte mjaft gjëra në dorë e i kishte shfaqur gatishmërinë për ta ndihmuar në rast nevojë. Ndihma që Çabej i kërkoi shokut të vjetër në dimrin e vitit 1943 ishte pikërisht riadhesimi i 23 bashkëpatriotëve të tij. Më tej, Petro Marko ka shkuar bashkë me Çabejn për të paraqitur këtë kërkesë [pranë autoriteteve përkatëse]”.³⁹

³³ AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 31. Përmbledhje materiali për Eqrem Çabejn, pa datë.

³⁴ Po aty, fl. 70. Pjesë nga relacioni pa firmë i gjeneral M. Shehut, pa datë.

³⁵ Politisches Archiv/ Auswärtiges Amt Rom (Quirinal) (më tej: PA/AA, POIII - Berlin), Band 129. Telegram i konsullit Schiep për ambasadën gjermane në Romë, Tiranë, 11 dhjetor 1942; Telegram i ambasadës gjermane në Romë për konsullin Schiep në Tiranë, Romë, 17 dhjetor 1942 (përkthyer nga Edmond Malaj); Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (më tej: AQFA), fondi (më tej: f): Dokumentet e Komandës Gjermane, d. 33, v. 1943, fl. 50. Telegram sekret i punonjësit të ambasadës gjermane në Romë, Gumpert, për komandën gjermane, Romë, 26 tetor 1943 (përkthyer nga Edmond Malaj).

³⁶ AQFA, f. Dokumentet e Komandës Gjermane, v. d. 33, 1943, fl. 50. Telegram sekret i punonjësit të ambasadës gjermane në Romë, Gumpert, për komandën gjermane, Romë, 26 tetor 1943.

³⁷ Petro Marko, *Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)* (Tiranë: OMSCA, 2000), f. 398-399.

³⁸ Po aty, f. 399.

³⁹ *Intervistë e Brikena Çabejt dhënë L. Dushkut*, qershor 2018.

Pavarësisht se ndërhyrja e Eqrem Çabejt rezultoi e suksesshme, kjo nuk përlligj ndonjë lidhje të afërt politike të tij me gjermanët. Deri më tani as dokumentacioni gjerman dhe literatura e konsultuar nuk japin indikacione për një gjë të tillë.⁴⁰

Në vijim, informacioni i Sigurimit të Shtetit për të kaluarën e Eqrem Çabejt vjen e plotësohet dhe zgjerohet. Në materialin e përgatitur nga seksioni i Tiranës, më datë 9 janar 1948, krahas fakteve që kanë të bëjnë me studimet e kryera në Austri, njihjen e disa gjuhëve të huaja, prejardhjen nga “shtresa të pasura”, jetën në “rrethe borgjeze”, përbërjen e rrethit shoqëror nga “elementë kundërshtarë të pushtetit”, siç ishin Selahudin Toto, Gjergj Ashta, Vedat Kokona, Sabiha Kasimati, pjesë e studiuesve të Institutit të Studimeve, theksi vihet tek e kaluara e Çabejt në vitet e Luftës së Dytë Botërore. Ky aspekt shkëputet nga konteksti, interpretohet dhe manipulohet në frymën e kohës, çka bënte që në tërësi informacioni të ishte i paplotë, larg së vërtetës. Sipas relacionit: “Okupacionin fashist e ka pritur mirë, duke e përhapur dhe deklaruar si mik të popullit tonë, ka punuar me mish e me shpirt për fashizmin dhe ka përkrahur njerëzit e tij. Për këtë u dërgua në Itali për studime, ku qëndroi deri në kapitullimin e Italisë. Mbas kapitullimit Eqremi u caktua ministër i Arsimit, me gjithë se akoma nuk ishte kthyer nga Italia. Gjatë okupacionit nazist u kthye në Shqipëri dhe filloi të bashkëpunojë me ta duke mbrojtur politikën e tyre.”⁴¹

⁴⁰ *Dokumente të institucioneve gjermane për historinë shqiptare, 1941-1944*, përgatiti për botim Hakif Bajrami (Prishtinë: Vatra, 1998); Buletini Arkivor Ushtarak, Përmbledhje dokumentesh nga Fondi i Komandës Gjermane 1940-1944..., nr. 1-2/2017; Marenglen Kasmi, *Pushtimi gjerman i Shqipërisë 1943-1944. Me këndvështrim në dritën e dokumenteve gjermane* (Tiranë: Botimet Filara, 2013); Bernd J. Fischer, *Shqipëria gjatë Luftës, 1939-1945* (Tiranë: Çabej MÇM, 2000).

⁴¹ AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 25. Shkresë e Seksionit të Tiranës drejtuar Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit, 9 janar 1948.

* Vëllai i Eqrem Çabejt, Selahudini, ka qenë nënprefekt në Tropojë.

⁴² Po aty, fl. 28. Relacioni i bashkëpunëtorit me pseudonimin “Prurësja” për Sigurimin e Shtetit, 11 tetor 1950.

Pavarësisht sa më sipër, ende në informacionet që i vinin Sigurimit të Shtetit emrit të Eqrem Çabejt nuk i ishte bashkëngjitur togfjalëshi “armik i pushtetit popullor”. Për herë të parë, ky togfjalësh përdoret në relacionin e datës 11 tetor 1950 të bashkëpunëtorit të Sigurimit të Shtetit me pseudonimin “Prurësja”, por duke u specifikuar se nuk kishte “ndonjë aktivitet të zgjeruar antipushtet”. Etiketimi “armik i pushtetit popullor” ishte rrjedhojë e së kaluarës së tij, me fokus vitet e Luftës së Dytë Botërore. Informacioni tashmë pasurohej me dy të dhëna të reja: Çabejt “ka të arratisur burrin e motrës eksponent i Ballit” dhe “prej partizanëve kur ende nuk ishte çliruar vendi i është vlarë një vëlla, ka qenë prefekt në Kosovë”. Një vend i posaçëm i kushtohej marrëdhënies së Eqrem Çabejt me Sabiha Kasimatin, kjo për faktin se “Prurësja” ishte personi i ngarkuar nga Sigurimi i Shtetit për të mbikëqyrur këtë të fundit. Marrëdhënia midis tyre konsiderohej si “miqësi e ngushtë”, “më shumë me karakter politiko-kulturor”, midis të cilëve “bisedohet rreth kulturës, shkencës dhe veprave... të shkrimtarëve me kulturë borgjeze. Kultura marksiste për ta konsiderohet si hiçgjë, veprat e Leninit jo si kryevepra, por si ngjarje të rastit.”⁴²

Marrëdhënia e Sigurimit të Shtetit me studiuesin Çabejt mori përmasa të tjera në vitin 1952, atëherë kur regjimi duhej të bindej për nivelin e rrezikshmërisë, duke e pasur plotësisht nën vëzhgim veprimtarinë e tij. Në tetor të atij viti, niveli i

survejimit të “elementit kundërshtar Eqrem Çabej” nga niveli IIB⁴³ do të kategorizohej në nivelin më të lartë, atë IIA. Të dyja raportet e kategorizimit arrinin në përfundimin se Çabej kryente “aktivitet antipopullor, kundra atdheut dhe popullit”.⁴⁴ Raporti i kategorizimit në nivelin IIA paraqitet më i plotë në informacion, duke synuar të përligjë ndryshimin në një kategorizim më të lartë. Theksi vihej te shkollimi në Vjenë, prej nga rridhnin tendencat naziste, që konsideroheshin të barasvlershme me ato antipushtet. Këto tendenca ishin përforcuar në vitet e Luftës së Dytë Botërore, kur ai kishte qëndruar në Itali, si “përfaqësues i Ernest Koliqit”, kohë kur i ishin propozuar postet e ministrit të Arsimit. Në përputhje me frymën dhe orientimin e udhëheqjes komuniste, qëndrimi i të përmendurit gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte përcaktues edhe për qëndrimin e tij në të ardhmen. Sipas raportit, Çabej për shkak të së kaluarës së tij ishte “i predispozuar për të qenë armiku i klasës, që edhe sot vazhdon të veprojë, sepse ky qysh mbas çlirimit dhe sot vazhdimisht asht parë të shoqnohet me elementa të dyshimtë të tipit të tij...”.⁴⁵ Krahas emrit të biologes Sabiha Kasimati, tashmë e ekzekutuar në kuadrin e bombës në Legatën Sovjetike, për të cilën spekulohet se ishte Çabej ai që kishte bërë punë armiqësore, rrethi shoqëror plotësohej me Shyrete Turkeshin, e përjashtuar nga Partia, survejuar në nivel IIA, e cila më vonë do të ishte edhe bashkëshortja e tij; etnologun Rrok Zojzi, që

konsiderohej “fashist me damkë”, survejuar në IIB; ish-ministrin e Arsimit, kolegun e tij në Institutin e Shkencave, Sejfulla Malëshova, “tradhtar i partisë”, survejuar në IIA. Por, për ta kaluar nga kategoria IIB në atë IIA nuk kishte mjaftuar as “gjithë ky aktivitet”, as fakti se Çabej “asht një element mjaft inteligjent edhe me një kulturë të gjerë dhe eksponent i dorës së parë për reaksionin”. Ishte dashur “një shënim qi ka vënë titullari i këtij dikasteri, gjeneral Leitnant Mehmet Shehu për t’u vënë në përpunim aktiv”, shënim ky që evidentohet nga nëntogeri Taip Rada si i rëndësishëm për ta kaluar rastin e Çabejt nga kategoria IIB në IIA.⁴⁶

Vendosja në kategorinë IIA u shoqërua me hartimin e planeve të detajuara të “masave operative agjenturore”. Nga tetori i 1952-shit deri në qershor të 1955-s u hartuan shtatë plane masash dhe një plan special në korrik të 1954-ës. Plani i parë e vinte theksin te përdorimi i agjenturës dhe bashkëpunëtorëve ekzistues të Sigurimit të Shtetit, “por nëse të tillë nuk gjendeshin, atëherë të studiojmë gjetjen e një kandidati për rekrutim dhe ta rekrutojmë”. Menjëherë u aktivizua një rrjet i tërë bashkëpunëtorësh, ku në vitet e para spikatin pseudonimet “Prurësja”, “Drojtja”, “Edija”, “Dhelpërija”, “Çajupja”, “Taraboshi”. Puna e tyre ishte të informonin në detaje mbi çdo aspekt të veprimtarisë së Eqrem Çabejt, karakterin që ai kishte, veprimtarinë shkencore, rrethin e njerëzve me të cilët shoqërohej, interesimin ose jo për

⁴³ Raporti i kategorizimit në nivelin IIB të survejimit të Eqrem Çabejt nuk ka të shënuar datë. Vënia në nivelin e survejimit IIB ka ndodhur midis viteve 1948-1952.

⁴⁴ AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 6. Raport propozimi për survejim në nivelin IIB për Eqrem Çabejn, data mungon; po aty, fl. 16. Raport kategorizimi në IIA për Eqrem Çabejn, 6 tetor 1952.

⁴⁵ Po aty, fl. 16. Raport kategorizimi në IIA për Eqrem Çabejn, 6 tetor 1952.

⁴⁶ Po aty.

politikë, bisedat që zhvillonte, jo vetëm në Institutin e Shkencave apo Bibliotekën Kombëtare, por edhe shtëpi apo kudo ku ai shkonte, në Tiranë apo jashtë saj. Ndërkohë, filloi puna për të gjetur informacion nga procesverbalet e të akuzuarve të tjerë, prej nga ku duhej të nxirrej informacion që implikonte studiuesin Çabej. Qëllimi ishte që të përligjej “veprimtaria armiqësore agjenturore” e Eqrem Çabejt. Për shkak se nuk u siguroa informacioni që pritej, më 10 prill 1953 u përgatit plani i dytë i masave, ku u shtua mbikëqyrja e korrespondencës, brenda dhe jashtë Shqipërisë, si dhe kontrolli i hyrjeve e daljeve në shtëpinë ku ai banonte. Por, pavarësisht planeve të njëpasnjëshme, dëshirës dhe vullnetit të Sigurimit të Shtetit për të zbuluar “veprimtarinë armiqësore dhe agjenturore” të Eqrem Çabejt, objektivat mbetën të parealizuara. Si rezultat, në tetor të 1958-ës niveli i survejimit u ul nga kategoria IIA në atë IIB. Intensiteti i survejimit ra dhe në vitin 1963 dosja formulare do të arkivohet, por jo përgjithmonë.

Aspekti i dytë që kushtëzoi marrëdhënien e shtetit komunist me studiuesin Çabej ishte profili psikologjik dhe karakteri njerëzor. Natyra dhe karakteri i Eqrem Çabejt u vendos në fokus të punës së bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit, për të kuptuar shkallën e rrezikshmërisë së tij. Në përgjithësi relacionet, ku spikasin ato të bashkëpunëtorit me pseudonimin “Edija”, student i Çabejt dhe prej vitit 1952 koleg me të, e përshkruajnë profesorin si njeri me “kulturë borgjeze”, mjaft

i zgjuar e inteligjent, por dinak. Edhe në kohën e Zogut, “kur vendi i zakonshëm për shumicën e profesorëve ishte kafeneja, ky studionte, nuk është njeri i bixhozit”. Shfaqte ego të madhe, e çmonte shumë veten, prekej shpejt në sedër, por manifestonte gjithmonë maturi dhe seriozitet. Sa i përket asaj që në terminologjinë e kohës konsiderohej “anë politiko-shoqërore”, evidentohej mbajtja gjithnjë e me konsekuencë i bindjes së “një nacionalisti borgjes të vendosur”.⁴⁷

Në përputhje me pritshmërinë e kohës, në fokus të relacioneve të bashkëpunëtorëve vendosej marrëdhënia e Çabejt me politikën. Në përgjithësi, aty evidentohej drejt e kaluara jopolitike dhe e tashmja indiferente/shpërfillëse karshi politikës. Bashkëpunëtori me pseudonimin “Edija” e gjente me vend të tregonte mendimin e Çabejt se: “Ka disa njerëz të mëdhenj që qëndrojnë mbi politikën, nuk interesohen, s’e përfillin fare politikën.” “E tha me pasion këtë, - theksonte “Edija”, - aq sa më dha të kuptoj se edhe ai ishte i bindur se një qëndrim i tillë ishte i përshtatshëm për njerëzit e mëdhenj, prandaj ai mbante...”.⁴⁸ Më tej, Çabej konsiderohej mendjemadh, që nuk pajtohej me luftën e klasave dhe çështjet shkencore i shihte të ndara nga politika, duke sfiduar kështu ideologjinë e kohës.

Nga sa më sipër, përshkrimi i karakterit të Eqrem Çabejt përgjithësisht nuk e përligjte profilin e “armikut të pushtetit popullor” me rrezikshmëri të lartë. Ndonëse relacionet e bashkëpunëtorëve

⁴⁷ AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 25. Shkresa e seksionit të Tiranës për Drejtorinë e Sigurimit të Shtetit, 9 janar 1948; po aty, fl. 28. Relacion i bashkëpunëtorit me pseudonimin “Prurësja” për Eqrem Çabejn, 11 tetor 1950; po aty, fl. 29. Raport i bashkëpunëtorit me pseudonimin “Edija” për Sigurimin e Shtetit, 29 shtator 1952; po aty, fl. 60-61. Raport i bashkëpunëtorit me pseudonimin “Edija” për Sigurimin e Shtetit, 22 prill 1955.

⁴⁸ Po aty, fl. 60. Raport i bashkëpunëtorit me pseudonimin “Edija” për Sigurimin e Shtetit, 22 prill 1955.

evidentojnë natyrën e tij tejet të rezervuar, prirem të mendoj se ky ishte një aspekt jo plotësisht i lindur i karakterit të Çabejt, por i krijuar nën ndikimin e rrethanave të kohës, si një masë mbrojtëse kundër ashpërsisë së regjimit dhe ndjenjës së rrethimit nga spiunë të kudogjendur. Duke konsultuar dosjen formulare, dukshëm të bie në sy se rrethi i personave me të cilët E. Çabej kontaktonte zvogëlohet ndjeshëm, veçanërisht që prej vitit 1952, kohë kur ai u vendos në survejim. Kështu, nëse në vitin 1948 Çabej kishte kontaktuar 62 persona, në vitin 1953 numri kishte shkuar në 17, ndërsa në 1956-ën gjatë 5 ditëve të survejimit ai kishte takuar jashtë familjes së ngushtë, vetëm 2 persona, njëri prej të cilëve ishte i vjehri.⁴⁹

Po si qëndron profili veshur me ideologjinë e kohës, përballë profilin e bijës për atin. Brikena Çabej e përshkruan kështu të atin: “Njeri i matur e i përmbajtur, me një edukatë të pabesueshme në komunikimin me të gjithë, që nga një fëmijë i vogël deri te plaku më i respektueshëm. E kam parë shumë rrallë të humbiste durimin dhe të nervozohet. Zakonisht, kur ndodhte kjo, ikte nga dhoma. Nuk shante njeri dhe i shmangte konfliktet sa të mundej. Besoj se bënte atë që thotë populli: ‘Mishi të piqet dhe helli të mos digjet.’ Kishte një ndershmëri proverbiale dhe një karakter vërtet për ta pasur zili. I ndihmonte shumë të tjerët, nuk bënte asgjë me bujë. Kishte parime, të cilat nuk i shkelte kurrë. E dinte fort mirë se ku ishte dërrasa e kalbur dhe i qëndronte larg. Mendohej t’u nguliste njerëzve përreth mendime e ide pa dhënë

këshilla, por duke dhënë shembullin e tij; ishte një shprehje që përmendej shpesh në shtëpinë tonë, ai e përmendte shumë shpesh: ‘Fjalët të mësojnë, shembujt të tërheqin.’ Nuk ankohej kurrë, megjithëse nuk ka bërë jetë të lehtë. Presioni i regjimit e bëri modest. Për gjërat që i dhembnin nuk fliste. Në qoftë se kishte një thelb në karakterin dhe në qenien e tij, ishte atdhedashuria dhe patriotizmi. Sa i përket politikës, e ndiqte me interes, por vetë shmangte plotësisht që të merrej me të.”⁵⁰

Aspekti i tretë që ravijëzoi marrëdhënien e shtetit komunist me studiuesin Çabej ishte raporti që Partia dhe Enver Hoxha krijoi me Institutin e Shkencave në përgjithësi dhe atë vetë në veçanti. Kjo marrëdhënie u kushtëzua nga vëmendja që mori nga njëra anë përgatitja e “kuadrove të rinj” dhe rolit që do të luanin studiuesit me përvojë dhe nga ana tjetër, procesi i reformimit të “kuadrove të vjetër”.

Duke nisur nga fillimviti 1950, kohë kur Sekretariati i Komitetit Qendror (KQ) të PPSH-së dhe personalisht vetë Enver Hoxha mori plotësisht në dorë Institutin e Shkencave, lidhja formale e organeve të Partisë edhe me institucionin e vetëm shkencor në Shqipëri përbënte shqetësim për udhëheqjen. Për Enver Hoxhën ngritja e Institutit të Shkencave ishte pa dyshim një sukses, por Partia nuk kishte krijuar një pikëpamje të drejtë për punën aty, “duke e konfunduar atë me kuadrin e vjetër që është atje”.⁵¹ Instituti, vijonte ai, “nuk është parë me sy të mirë, puna e tij është nënvlerësuar..., duke qenë atje kuadro të vjetra është humbur

⁴⁹Po aty, fl. 34. Personat me të cilët është shoqëruar E. Çabej gjatë vitit 1948 dhe 1953; po aty, fl. 69. Përmbledhje e materialit të survejimit 5-ditor që iu bë E. Çabejt, 4 maj 1956.

⁵⁰ *Intervistë e Brikena Çabejt dhënë L. Dushkut*, qershor 2018.

⁵¹ AQSH, f. 14/Organet Udhëheqëse (OU), d. 80, v. 1950, fl. 25 (5). Protokoll i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, 30 mars 1950. Fjala e Enver Hoxhës.

besimi në punën e Institutit ngaqë ata janë më të shumtë dhe pse ka vetëm dy tre anëtarë partije atje”. Në këtë kuadër, E. Hoxha konsideronte të rëndësishme marrjen e dy masave: së pari, “duhet të kemi kujdes se Instituti nuk është atje për të vënë kuadrot e vjetra, por ata që janë atje ne duhet të përpiqemi dhe t’i bëjmë që të punojnë”; së dyti “duhet të kujdesohemi që të përgatisim kuadro të tjera”, për të cilët duhej të përdorej edhe përvoja e eksperiencës e “kuadrove të vjetër”.

Që prej asaj mbledhjeje, puna në Institutin e Shkencave do të vendosej në lupën e Partisë, madje personalisht Hoxha do të merrte në dorë raportet dhe planet e punës aty. Sakaq, ai u shpreh: “Se ne na duhet të dimë mirë se cilat janë kuadrot që punojnë mirë atje dhe kjo, jo vetëm me emrat dhe biografitë e tyre, por edhe me kapacitetin e tyre.” Si shembull, u mor prej tij vetë Eqrem Çabej: “Ne e dimë ... se çfarë elementi është Eqrem Çabeu, por duhet të përpiqemi që ta bëjmë të punojë. Këto kuadro KQ duhet t’i marrë dhe t’i studiojë mirë dhe këtë do të mund ta bëjë, po të dijë mirë se çfarë bëhet atje.”⁵²

Tashmë, periodikisht thujse çdo dy vjet kur në organet udhëheqëse do të diskutohej puna e Institutit të Shkencave, Enver Hoxha do të përmendte emrin e studiuesit Çabej. Ai do të ishte kështu përfaqësues i asaj kategorie të elitës së vjetër, të paparti, që nuk bënte përpjekje për të përqaftuar ideologjinë marksiste-leniniste, puna e të cilit në kushtet e mungesës së studiuesve të

rinj të përgatitur në Bashkimin Sovjetik dhe vendet e Demokracive Popullore do të konsiderohej e rëndësishme për Partinë dhe regjimin komunist.

Që prej sjelljes tejte të ashpër të shtetit me një pjesë të elitës së vjetër, eliminuar midis viteve 1946-1951, dhe spastrimit të administratës nga “elementët armiq”, në mbështetje të vendimit të Sekretariatit të KQ të PPSH-së, të 14 shkurtit 1951,⁵³ vihet re një zbutje e marrëdhënies së partisë/ shtetit me “intelektualët e vjetër”, të konsideruar armiq.

Shqetësim për udhëheqjen komuniste përbënte fakti “i shkëputjes së urave” me ta. Për sa kohë veprimtaria intelektuale e kësaj kategorie konsiderohej e rëndësishme, puna e Partisë “me intelektualët armiq” duhej të merrte vlerë. Lënia pas dore konsiderohej si “lëshim në vijë”, ndërkohë që theksi vihej te fakti se “armiku nga ana e tij punon”. Në këtë frymë kërkohej që intelektualët, anëtarë partie, të kishin më durim dhe të luftonin sektarizmin ndaj elitës së vjetër, madje të mos nënvleftësonin kapacitetet e tyre. Elita e re nuk duhej të trembej nga marrëdhënia me të vjetrit, sepse ata ishin “të armatosur me marksizëm-leninizmin dhe me shkencën e kulturën e përparuar sovjetike” e si të tillë “janë në mënyrë më absolute superiorë nga intelektualët e shkollës së vjetër dhe me ideologji të huaj”.⁵⁴

Kjo qasje e re, në dukje më e zbutur, në punën e Partisë me “intelektualët e vjetër”, u përforcua edhe

⁵² Po aty, fl. 25 (6).

⁵³ AQSH, f. 14/OU, d. 80, v. 1950, fl. 11. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH “Mbi spastrimin e Aparatit Shtetëror nga elementët armiq”, 14 shkurt 1951.

⁵⁴ Po aty, f. 14/Strukturat, d. 704, v. 1951, fl. 1-6. Puna me intelektualin, 13 korrik 1951.

nga Enver Hoxha: “Të kenë një frymë shoqërore që t’i ndihmojmë për të shkuar përpara... Por kjo nuk arrihet në mënyrë policeske, me dhunë, me përplasje grushtesh në bango, me kufizim me mbyjtje të diskutimeve, me metoda imponimi e të tjera të kësaj natyre. Kjo do të thotë: ja ky është intelektual me të metat e tija dhe me të mirat e tija, xhvishe nga të metat, ndihmoje për këtë dhe bjere në rrugë.”⁵⁵

Gjithë sa më sipër u reflektua edhe në qëndrimin ndaj Eqrem Çabejt. Në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, të datës 25 janar 1952, që shqyrtoi punën e Institutit të Shkencave, u shmang diskutimi për “kuadrot e vjetër”. Madje, pyetjes së Mehmet Shehut: Çabeu e të tjerë duhet të mbeten atje? Enver Hoxha nuk i dha përgjigje,⁵⁶ duke nënkuptuar që ndaj tyre nuk kishte ashpërsim qëndrimi. Në këtë aspekt, Hoxha kishte anashkaluar edhe raportin e Misto Treskës, përgjegjës i seksionit të kulturës dhe arteve në Drejtorinë e Agit-Propit në KQ të PPSH-së, në të cilin Çabej konsiderohej njeri që as politikisht as ideologjikisht nuk ishte me komunistët dhe ç’ishte më keq, as që mund të edukohej e të korrigjohej.⁵⁷

Qëndrimi karshi tij do të ndryshonte në vitin 1954, kohë kur numri i “kuadrove të rinj” të përgatitur në BS dhe vendet e tjera të Lindjes ishte rritur, duke zvogëluar raportin e kësaj kategorie me atë të “kuadrove të vjetër” në Institutin e Shkencave. Situata e re do të vihej në dukje nga vetë Enver Hoxha në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH-së,

më 24 shkurt 1954. Sipas tij: “Ne kemi me qindra kuadro të mësuara me teori e me shkencë të lartë të pararojës.” Tashmë kishte ardhur momenti që t’i jepej fund praktikës së deriatëhershme, kur “nuk kishim kuadro të larta, kur ata ishin të pakta, numëroheshin me gisht pra ahëre kjo punë për ne ishte e vështirë”. Qëndrimi i Enver Hoxhës në lidhje me intelektualët e vjetër, të konsideruar armiq, do të ishte i ashpër: “T’i japim fund një herë e mirë me ata elementë të vjetër që nuk kanë asnjë lidhje me shkencën tonë të re dhe me pushtetin tonë, por që bile janë edhe armiq dhe gjoja mbahen atje pse janë të mësuar dhe të ditur. Diturija e njerëzve si Sejfulla Malëshova, Eqrem Çabej, etj., ...nuk na vlen për në Institut, i cili ka qëllime të mëdha. Ne duhet t’i japim kompetenta institutit, që ata njerëz të mos i mbajë më se, mjaft i kemi mbajtur dhe në ato duar ne nuk mund të japim sekretet shkencore tonat. Prandaj duhet t’i pastrojmë ata njerëz... Institutit i Shkencave... nuk mund të mbajë në gjirin e vet njerëz që qëndrojnë atje sepse janë gjoja pleq, të pjekur ose të ditur, kur në një kohë ata janë armiq të pushtetit tonë popullor, të shkencës së re dhe të socializmit...”⁵⁸

Por marrëdhënia e Partisë me studiuesin Çabej do të marrë një tjetër qasje, duke nisur nga viti 1955. Në mbledhjen e Byrosë Politike, më 3 mars 1955, kur u diskutua përbërja e re e Institutit të Shkencave, në ndryshim nga një vit më parë, entuziazmi i Enver Hoxhës për rritjen e numrit të studiuesve të Institutit të Shkencave kishte rënë. “Nuk mund të japim 40 veta”, - konstatonte ai,

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Po aty, f. 14/OU, d. 28, v. 1952, fl. 135. Protokoll i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 25 janar 1952. Fjala e Enver Hoxhës.

⁵⁷ Po aty, f. Këshilli i Ministrave, d. 1881, v. 1950, fl. 12-14. Letër e Misto Treskës për Bedri Spahiun, 3 shtator 1950.

⁵⁸ Po aty, f. 14/OU, d. 9, v. 1954, fl. 47-49. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, 24 shkurt 1954. Fjala e Enver Hoxhës.

ashtu sikurse ishin nevojat atje.⁵⁹ Por mbledhja rezervoi një surprizë në lidhje me qëndrimin karshi Eqrem Çabejt, emri i të cilit ishte propozuar nga Instituti i Shkencave që të hiqej nga përbërja e tij. Për të mos hedhur poshtë atë që vetë Enver Hoxha kishte thënë për Çabejn një vit më parë, fjalën në lidhje me të e mori një tjetër pjesëtar i familjes, Nexhmije Hoxha, drejtoresha e sektorit të agjitacionit e propagandës në KQ të PPSH-së. Ajo u shpreh: “Për Eqerem Çabejin, po të nisemi nga ana politike mund të hiqet, por unë them se ai nuk duhet të hiqet, duke marrë parasysh se ai sot [shkencërisht] punon për neve, prandaj kjo të shikohet.”⁶⁰ Fjala e saj do të vuloste gjithçka dhe Çabej do të vijonte të punonte në Institutin e Shkencave.

Puna studimore ishte kështu **aspekti i katërt** që kushtëzoi marrëdhëniet e shtetit me studiuesin Çabej. Nisur nga veçoritë e “punonjësit të mendjes”, qasja e shtetit me të mban parasysh: fushën e kërkimit dhe cilësinë e punës shkencore, aspekt ky që në analizë të fundit ndikoi pozitivisht në marrëdhënien e shtetit me studiuesin Çabej; metodologjinë e punës, që në rastin e Çabejt rezultoi sfiduese në marrëdhënien e tij me shtetin. Pavarësisht përpjekjeve për imponimin e ideologjisë marksiste në punën e tij studimore, Çabej vijoi të shkruante duke u mbështetur në “ideologjinë borgjeze” dhe “shkollën idealiste gjermane”.⁶¹ Ky aspekt i dytë, në analizë të fundit, ndonëse ndiko-

nte negativisht në marrëdhënien e shtetit me studiuesin, në rastin e Çabejt u tolerua për shkak të punës së tij të domosdoshme dhe cilësore.

Në promemorian *Mbi krijimin e një fakulteti universitar katërvjeçar për studimin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Tiranë*, hartuar nga një grup studiuesish dhe paraqitur, më 17 gusht 1947, qeverisë shqiptare nga Dhimitër Shuteriqi, mungesa e specialistëve në fushën e shkencave shoqërore ishte kryefjalë. Fakti se studimet gjuhësore brenda vendit kishin qenë mjaft të kufizuara, se në to ishin angazhuar pak persona, që më së shumti ishin ata që kishin pasur fatin të qëndronin afër ndonjë albanologu, evidentoheshin si arsytet e një situatë të tillë. Eqrem Çabej ishte një prej tyre, që në promemorie konsiderohej “kuadroja më i afirmuar nga pikëpamja shkencore gjuhësore”.⁶² I barasvlershëm me të qëndronte Kostaq Cipo, e pas tyre vinte Aleksandër Xhuvani, i vlerësuar për kulturën e gjerë shkencore dhe gjuhësore.

Sakaq, ministri i Arsimit, Sejfulla Malëshova, kishte vendosur piketat e punës në Institutin e Studimeve/Shkencave. Fjalori i Gjuhës Shqipe, Historia e Literatyrës dhe Gramatika e Gjuhës Shqipe ishin fushat në të cilat do të përqendrohej puna në sektorin e gjuhësisë dhe letërsisë.⁶³ Tri ekipe studiuesish nisën nga puna, pjesë e të cilëve ishte edhe Eqrem Çabej. Fillimisht, ai punoi me Cipon dhe Xhuvanin për Ortografinë dhe Fjalorin e Gjuhës Shqipe, punë që

⁵⁹ Po aty, f. 14/OU, d. 9, v. 1955, fl. 221. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, 3 mars 1955. Fjala e Enver Hoxhës.

⁶⁰ Po aty, fl. 222. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, 3 mars 1955. Fjala e Nexhmije Hoxhës.

⁶¹ AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 23. Andrea Varfi për Eqrem Çabejn, 21 janar 1948; po aty, fl. 55. Raport i bashkëpunëtorit me pseudonimin “Dhelpërija” për Sigurimin e Shtetit, 24 dhjetor 1953.

⁶² AQSH, f. Ministria e Arsimit, d. 33, v. 1947, fl. 1-11. Promemorie “Mbi krijimin e një fakulteti universitar katërvjeçar për studimin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Tiranë”, 17 gusht 1947.

⁶³ Po aty, f. Instituti Mbretëror i Studimeve Shqiptare, d. 22, v. 1942, fl. 146-147. Mbledhja e Përgjithshme për Riorganizimin e Institutit, 13 prill 1946.

në vazhdimësi u vlerësua si shkencore e kujdeshme dhe e kualifikuar⁶⁴ dhe që prej 1950-ës u angazhua në Historinë e Letërsisë Shqipe. Puna për këtë të fundit e vendosi në marrëdhënie të drejtpërdrejtë me drejtuesin e projektit, Dhimitër Shuteriqin, i anëtarësuar herët në parti, në atë kohë kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve.

Puna për hartimin e Historisë së Letërsisë Shqipe u fillua në shkurt të vitit 1950, por ajo nuk eci me ritmet e parashikuara.⁶⁵ Për këtë, Dh. Shuteriqi bëri me faj Institutin e Shkencave, që i kishte dhënë përparësi përgatitjes së Atlasit Gjuhësor të Shqipërisë, duke anashkaluar punën e transkriptimit të veprave të shkrimtarëve të vjetër, si Buzuku e Budi, e konsideruar si e domosdoshme për Historinë e Letërsisë Shqipe. Në letrën që Shuteriqi dhe Mark Ndoja i dërguan kryetarit të Institutit të Shkencave, Manol Konomi, bënin me dije se Eqrem Çabej ishte “i vetëmi njeri ndër ne që është interesuar gjer më sot për “Atlasin e Shqipërisë”...”, që ngurronte të merrte përsipër të punonte me autorët e vjetër të letërsisë shqipe. Puna për hartimin e Atlasit konsiderohej nga dyshja Shuteriqi-Ndoja si “utopike” dhe ngurrimi “për studimin e autorëve të vjetër shqiptarë e të letërsisë arbëreshe, është i dëmshëm jo vetëm sepse pengon për hartimin e Historisë së Letërsisë Shqipe, por së shpejti do të influenconte edhe për çështje të tjera me rëndësi...”. Me ton urdhërues, Shuteriqi-Ndoja kërkonin që Çabej, Cipo e Xhuvani,

“shkencëtarët më me eksperiencë për punë të gjuhës”, të merreshin menjëherë me “studimin e transkriptimit e autorëve më me rëndësi, e pa u lejuar që tjetërkush të bëjë studimin e tjetërkush transkriptimit”.⁶⁶

Prej këtej e ka zanafillën puna e Çabejt për transliterimin dhe transkribimin e *Mesharit* të Gjon Buzukut, libri më i vjetër në gjuhën shqipe i zbuluar deri më sot. Puna me Mesharin, e konsideruar nga specialistët e fushës “si punë murgu”, filloi në verë të vitit 1950 dhe përfundoi në vitin 1958. Ajo rezultoi e gjatë, tejet e vështirë, por cilësore dhe skrupuloze.⁶⁷ Në vitin 1955, kur Nexhmije Hoxha foli për punën e Çabejt, profesori ishte duke punuar pikërisht me *Mesharin* e Buzukut. Në këtë mënyrë, *Meshari* jo vetëm evidentoi domosdoshmërinë e punës së Çabejt, por në njëfarë mënyre u bë edhe shpëtimtari i tij.⁶⁸

Ndërkohë, puna e profesorit të rezervuar e fjalëpakë i ishte bërë prezent Udhëheqjes edhe nga raportet e bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit. Spikasin këtu raportet e bashkëpunëtorit me pseudonimin “Edija”, në të cilat Çabej përsikruhej si studiuesi “që punon me leksin [leksikon] e teksteve të vjetra të gjuhës shqipe, të cilët i njeh mirë, punën e të cilit seksioni i gjuhësisë e shfrytëzon mirë; njeri që punon shumë..., që njeh gjithë anën teorike të shqipërisë, çfarë është thënë mbi të nga linguistët e mëdhenj”, i vetmi studiues i çmuar

⁶⁴ Po aty, f. 14/OU, d. 80, v. 1950, fl. 4. Relacion mbi aktivitetin e Institutit të Shkencave, shkurt 1950.

⁶⁵ Puna nuk eci me ritmet e parashikuara deri në janar 1952, kohë kur Byroja Politike e KQ të PPSH-së vendosi përparësi të punës në Institutin e Shkencave, punën për Historinë e Letërsisë Shqipe. AQSH, f. 14/OU, d. 28, v. 1952, fl. 24-27. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH-së mbi orientimin e punës shkencore dhe strukturën e Institutit të Shkencave, 25 janar 1952.

⁶⁶ Po aty, f. Këshilli i Ministrave, d. 1881, v. 1950, fl. 5-10. Letër e Dhimitër Shuteriqit dhe Mark Ndojës për Manol Konomi, 18 gusht 1950.

⁶⁷ Merita Sauku-Bruci, “Botimet kritike filologjike – misioni i papërmbytur i albanologjisë”, kumtesë mbajtur në Seminarin Albanologjik Ndërkombëtar të Ohrit, shtator 2007; Sh. Demiraj, *Eqrem Çabej...*, f. 115-126.

⁶⁸ Për punën e bërë me *Mesharin* e Gjon Buzukut, Eqrem Çabej u vlerësua në vitin 1962 me Çmimin e Republikës të Klasit I. Pak më herët, më 1957, ai ishte vlerësuar me Urdhrin e Punës të Klasit II.

nga A. Xhuvani, “që nuk e nxjerr kurrë punën nga dora kur s’ka përfunduar si duhet”.⁶⁹ Përshkrime të tilla, pa anashkaluar këtu qëndrimin e Udhëheqjes karshi Çabejt, do ta detyronin kapitenin Nuri Çakërrin që në maj 1955, në dosjen formulare të Çabejt, të vendoste shënimin: “Vlera e Çabejt në pikëpamje të Historis Linguistikës është e madhe. Sot që neve na mungojnë të tillë kuadro, unë jam dakort... që duke vlerësuar punën e tija, pa u kursyer ... të punohet për heqjen e botëkuptimit reaksionar ... kur është rasti për ndonjë delegacion shkencor në Demokracit Popullore ... ta dërgojmë gjithnjë me qëllim afirmimi.”⁷⁰

Përfundime

Periudha 10-vjeçare (1944-1954) rezulton të jetë më e vështira për studiuesin Eqrem Çabej, si në aspektin njerëzor dhe profesional. Ai rezistoi këto vite duke përdorur me mjeshtëri punën si “artin e të mbijetuarit”, pa qenë as intelektual i “njeri i oborrit” as intelektual i “disident”. Shteti komunist ndoqi ndaj tij politikën e *dorës së hekurt*, duke e survejuar, duke e mbyllur në vetvete dhe duke e ndrydhur thuajse në çdo aspekt të veprimtarisë së tij. Duke nisur prej 1955-s, marrëdhënia e shtetit me të, gradualisht, filloi e mori trajtat e politikës së *dorashkës së kadifenjtë*, që nuk ishte gjë tjetër veçse një formë shumë e hollë dhune dhe manipulimi, me synim nënshtrimin përmes shtrëngimit dhe përkëdheljes

njëkohësisht.⁷¹ Në rastin konkret, “përkëdhelja” fillon e bëhet e dukshme që prej vitit 1957, kur Eqrem Çabej u vlerësua me Urdhrin e Punës të Klasit II, për të vijuar me disa çmime të para të Republikës dhe dhënien e titullit “Mësues i Popullit”. Sakaq, prej vitit 1961 Çabej do të ishte pjesë e diskursit publik të Enver Hoxhës, duke u konsideruar si “mik i vjetër” dhe “profesor me rezultate të shkëlqyera”.⁷² Në vijim, nga gushti i 1963-shit, me ulje e ngritje të herëpashershme, ai u bë pjesë e delegacioneve të studiuesve shqiptarë jashtë Shqipërisë. Regjimi kishte nisur kështu të projektonte përdorimin e punës së pashoq të profesorit të gjuhës,⁷³ si pasqyrë të tij në arenën ndërkombëtare.

Ndërkohë, larg syve të publikut zhvillohej ana tjetër e *dorës së hekurt* të totalitarizmit shqiptar. Ajo mban emrin *Dosja Formulare, numër 2383*, që ekzistoi si e tillë deri pesë muaj pas ndarjes nga jeta të profesor Çabejt. Në brendinë e 205 fletëve të saj zbulon “tjetrin” e Çabejt studiues, atë të Çabejt “armik i pushtetit popullor”, që nuk e përqafoi marksizëm-leninizmin, me një vëllë të vranë nga komunistët dhe kunatin eksponent të Ballit Kombëtar, arratisur në Amerikë. Këto dy aspekte të fundit, pjesë e historisë së tij familjare në vitet e Luftës së Dytë Botërore, gjatë gjithë jetës ishin kambanat e alarmit, çekanët mbi kokë, për ta frikësuar dhe për ta bindur njëkohësisht, duke dashur t’i kujtonin se për regjimin ai ishte “i dashuri armik”.

⁶⁹ AIDSSH, *Dosja Formulare e Eqrem Çabejt*, fl. 29. Raport i bashkëpunëtorit me pseudonimin “Edija” për Sigurimin e Shtetit, 29 shtator 1952; po aty, fl. 60. Raport i bashkëpunëtorit me pseudonimin “Edija” për Sigurimin e Shtetit, 22 prill 1955.

⁷⁰ Po aty, fl. 61. Shënim me shkrim dore i kapitenit Nuri Çakërrin, 12 maj 1955.

⁷¹ Hannah Arendt, *Mbi dhunën* (Tiranë: Pika pa sipërfaqe, 2015), f. 58.

⁷² “Nga fjala e shokut Enver Hoxha në mbledhjen e gjerë me shkrimtarë dhe artistë, mbajtur më 11 korrik 1961”, *Nëntori*, nr. 8, Tiranë: 1961, f. 10; Enver Hoxha, *Vepra, Vëllimi 23* (janar-tetor 1962), Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH (Tiranë: 8 Nëntori, 1977), f. 522. Fjala e Enver Hoxhës në takimin me përfaqësuesit e inteligjencës së kryeqytetit, 25 tetor 1962.

⁷³ Një informacion të plotë dhe të detajuar për veprimtarinë shkencore të profesor Eqrem Çabejt gjendet në bibliografinë e përgatitur nga Jup Kastrati dhe Begzad Baliu. Shih: J. Kastrati, “Bibliografia e punimeve të prof. Eqrem Çabejt...”, f. 219-256; Begzad Baliu, *Çabej: Bibliografi e studimit të veprës së Çabejt në Kosovë, 1952-2002* (Prishtinë: Focus, 2006).

Gjovalin Gjadri

Prof. Ass. Dr. Albert P. Nikolla

Joana Doda – Studente e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë

Vështrim antropologjik mbi persekutimin e shkencëtarëve përgjatë viteve 1945-1955 – rasti i inxhinier Gjovalin Gjadrit, i vëzhguari i komunizmit

*Te kultura sovjetike njerëzit tanë të rinj
do të gjejnë, të pastruar nga çdo mbeturinë,
nga çdo falsitet i shkencës borgjeze,
pasurinë e madhe kolosale
të të gjithë shkencës botërore.
E. Hoxha*

Metodologjia

Rasti i marrë në shqyrtim i nënshtrohet një metodologjie kërkimore shumëplanëshe, gjë që na e dikton vetë personaliteti i inxhinier Gjovalin Gjadrit. Pas studimeve në Austri, inxhinier Gjadri pati një përvojë pune pesëvjeçare në Bashkimin Sovjetik. Nisur edhe nga kjo e dhënë, do të vërejmë disa dinamika antropologjike të marrëdhënieve midis shkencës “socialiste” dhe asaj “kapitaliste”. Ndikimi i përvojës studimore austriake, puna në BS dhe më vonë në Shqipëri, na shtojnë të

shohim me vëmendje dinamikat kulturore të sjelljes së inxhinier Gjadrit ndaj çështjes së shpërblimit të punës, nën këndvështrimin e antropologjisë ekonomike. Në këtë optikë do të qasen dokumentet arkivore të PPSH mbi çështje të shërbimit dhe do të bëhet një krahasim mes qasjes së Leninit në BS mbi këtë çështje dhe debatet e inxhinier Gjadrit rreth të njëjtit argument. Kjo për faktin se regjimi komunist shqiptar, në vitet të cilave u referohet studimi, merr për bazë kryesisht metodat sovjetike të përfshirjes së intelektualëve në ndërtimin e socializmit.



REPUBBLICA POLONIA E INDIENSA

SECRETARIA

SECRETARIA

SECRETARIA

Dosa Formulare

SECRETARIA

SECRETARIA

SECRETARIA

SECRETARIA

SECRETARIA

SECRETARIA

Mbështetje metodologjike mjaft të rëndësishme përbëjnë hulumtimet arkivore mbi vëzhgimin që i bëhet inxhinier Gjadrit si një “armik potencial” i regjimit. Në këtë pjesë të studimit do të analizohet nga pikëpamja antropologjike dinamika e vëzhgimit, spiunimit, dozës kulturore të pashmangshme të thashethemeve dhe impaktit që kanë këto veprimtari mbi jetën e Gjadrit.

“aftësive teknike” të Gjadrit. Interes të thellë antropologjik për studimin tonë përbën ndeshja e shpeshtë në arkiva e termit “përdorim” për t’iu referuar personave. Sipas nesh, kjo është dëshmi e qartë e reduktimit të qenies njerëzore në mjet, në objekt, gjë që i hap rrugën edhe kulturalisht një persekutimi që rregullohet deri me ligj nga regjimi.



Gjovalin Gjadri dhe gruaja e tij (1935)

Gjovalin Gjadri gjatë të '50ve

Tashmë komunizmi ka triumfuar dhe po instalon regjimin e tij. Në Qeverinë Shqiptare, Gjadri sheh se si vendimet merreshin nën ndikimin e komunistëve jugosllavë.


Së fundi, në pjesën që vijon, e cila është edhe pjesa kryesore e studimit, do të ndiqet metodologjia e antropologjisë historike, nëpërmjet së cilës analizohen dokumentet arkivore nën dritën e elementeve të pranishme kulturore që na japin mbështetjen e duhur për t’u thelluar në analizë. Në këtë optikë do të shikohet sjellja e regjimit ndaj

Për vetë natyrën antropologjike të studimit, një pjesë e analizës do t’i kushtohet edhe një libri të Gjadrit botuar në vitin 1942 në gjuhën gjermane, *Letra grues seme të vdekun*. Përgjatë gjithë analizës studimore, rasti i inxhinier Gjadrit do të analizohet duke dëshmuar nëpërmjet historisë së tij elementet e ngjashme ose të përbashkëta që

pati regjimi komunist në dhunën që përdori ndaj intelektualëve dhe shkencëtarëve shqiptarë me modelin sovjetik si pikë referimi.

Hyrje

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri u vendos një regjim i bazuar në diktaturën



Raport i Sigurimit (1949)

e proletarietit. Modeli i qeverisjes i mbështetur nga PKSH¹ do të ishte ai socialist, duke ndjekur atë sovjetik. Në dritën e persekutimeve të panumërta dhe të forta, mund të thuhet se Shqipëria u kthye në një burg të madh.

¹ Partia Komuniste e Shqipërisë.

² E. Hoxha, *Vepra 8* (Tiranë: Naim Frashëri, 1971), f. 182.

Ngjitja në pushtet e komunistëve shqiptarë qëndron akoma e mbështjellë me një mister dhe do të duhen akoma shumë studime që të nxjerrin në pah peshën tragjike të periudhës historike që shkon nga fundi i luftës deri në vitin 1991. Elita mbizotëruese në Partinë Komuniste Shqiptare që përgatitur dhe imponuar nga komunistët jugosllavë. Kjo elitë përbëhej nga njerëz jo shumë të përgatitur kulturalisht apo shkencërisht, por të etur për pushtet, mbi të gjitha të pamëshirshëm ndaj gjithkujt: të gatshëm të vrisnin këdo dhe në çdo moment që të mund të mbanin pushtetin. Në këtë klimë politike kulturore diktatori mbështeti fort luftën e klasave sipas modelit sovjetik. Klima e krijuar ishte vërtet mospranuese për ata që nuk ishin të bindur ndaj pushtetit. Një pohim i diktatorit e krijon një ide të qartë mbi atë situatë:

Ju lani fytyrën kur ktheheni nga puna dhe spastroheni. Ja, kështu është edhe me kritikën e autokritikën bolshevike, ajo spastron të metat dhe gabimet te njerëzit. Ju s'rroni dot në një dhomë me pluhur dhe me ndyrësira, por merrni fshesën dhe i fshini këto. Ja, kështu bën edhe kritika e autokritika bolshevike; ajo spastron njerëzit, spastron Partinë tonë, spastron pushtetin dhe vendin tonë nga "... pleshtat, spekuluesit, nga tartabiqet..." - siç i quan Lenini njerëzit e këqij që futen kontrabandë në radhët tona. Partia ju thotë juve t'i bëni sytë katër kudo.²

Lufta e klasave dhe persekutimi komunist veprroi në të gjitha shtresat e shoqërisë. Ajo që shumë e ashpër sidomos kundrejt intelektualëve e shkencëtarëve që ishin shkolluar në vendet perëndimore. Për intelektualët Enver Hoxha do

“Zhvëshja e drejtave, më kujton përsëri kohët e hershme kur kam kenë student në Austri, ku kam ndie një mungesë, kam hekë një vuajtje që nuk e kam ditë se çka është kanë, por që tash e di se ka kenë vuajtja e mungesës të Atdheut, që e kam kërkue gjithmonë dhe nuk e kam gjetë kurr, sa këtu në Shqipëri

të shprehej: “Duhet me i shkundë intelektualët nga ideologjia borgjeze dhe me i armatosë me ideologjinë marksiste-leniniste.”³

Regjimi komunist intelektualët që mund të mendonin ndryshe nga dogmat zyrtare i shikonte si kërcënim për ngritjen dhe konsolidimin e pushtetit. Kjo bëri që mbi pjesën më të madhe të intelektualëve të kohës, që me ardhjen në pushtet të komunizmit, të vërshonin akuzat për sabotatorë, arrestimet, internimet, torturat dhe pushkatimet. Por edhe kundrejt atyre intelektualëve të cilët mundën të vazhdojnë të ushtrojnë profesionin presioni nuk ishte i paktë. Kundrejt tyre kishte vëzhgim të vazhdueshëm për aq kohë sa inteligjenca shihej si kërcënim për pushtetin.

³E. Hoxha, *Vepra 15* (Tiranë: Naim Frashëri, 1971), fq. 284.

⁴E. Hoxha, *Vepra 7* (Tiranë: Naim Frashëri, 1973), fq. 94.

Porositë e Enver Hoxhës ishin gjithmonë për brumosjen e çdo njeriu me ideologjinë marksiste-leniniste, veçanërisht njerëzit e shkencës. Për këtë shërbente edhe një nga drejtoritë më të rëndësishme të pushtetit siç ishte Drejtorja e Agjitacionit dhe Propagandës:

*Ju, shokët e Drejtorisë së Agjitacionit e të Propagandës të Komitetit Qendror, nuk keni të bëni as me rroba ose me maqina as me materiale të tjera e as me kuadro që i duhen institutit; ju të interesohehi që të zbatohet vija e Partisë në Institutin e Shkencave.*⁴

Vëmendja e regjimit kundrejt intelektualëve të ardhur nga përvoja studimore perëndimore mbësh-

tetej në bindjen e pushtetit komunist se shkenca ka karakter thellësisht ideologjik e moral. Pra, kemi “shkencë socialiste” të mirë dhe “shkencë kapitaliste” të keqe. Kjo bindje ideologjike tipike e elitave komuniste vinte nga arsytimi se morali dhe shkenca janë shumë të ndërlidhura mes tyre, për rrjedhojë një shkencë e mirë edukon një moral të mirë dhe anasjelltas. “Shkenca socialiste” identifikohet me ideologjinë marksiste-leniniste dhe kjo e fundit, sipas ideologëve marksistë, ishte në gjendje t’i jepte zgjidhje çdo problemi shkencor. Aq intensiv bëhej identifikimi i shkencës me ideologjinë, sa që edhe socializmi quhej “socializëm shkencor”.

*Marksizëm-leninizmi është shkenca e ligjeve të zhvillimit të natyrës dhe të shoqërisë, shkenca e revolucionit të masave të shtypura e të shfrytëzuara, shkenca e fitores së socializmit, shkenca e ndërtimit të shoqërisë komuniste. Prandaj Partia jonë, si një parti marksiste-leniniste, që në ditët e para të organizimit, i ka kushtuar një kujdes të veçantë edukimit ideologjik të anëtarëve të saj.*⁵

Përkundër, shkenca “kapitaliste”⁶ nuk ka këtë karakter kaq të theksuar ideologjik dhe nuk kërkon përmbysje formacionesh ekonomik-shoqërore me dhunë. Ka edhe ajo shpeshherë dogmat dhe “mëkatet” e saj, por nuk pretendon të jetë “shkenca e pushtetit totalitar”. Edhe në versionet e saj më agresive, si në rastin e themelimit të rrymës së pozitivizmit nga A. Comte, prapëseprapë ajo paraqitet si alternativë, jo si dhunë.

⁵E. Hoxha, *Vepra 17*, (Tiranë: Naim Frashëri, 1973), f. 288.

⁶E përdorim këtë term vetëm në mënyrë konvencionale, për krahasimin me shkencën “socialiste”.

⁷AIDSSH, Dosja Gjovalin Gjadri, fl. 6.

⁸AQSH, f. 800, Komisioni i Lartë i Atestimit, v. 1971, d. 330, f. 51.

⁹Vendim KM, nr. 313, datë 8.7.1999, Për shpalljen e Urës së Matit monument kulture.

Inxhinier Gjovalin Gjadri, i vëzhguari i komunizmit

Nëpërmjet këtij studimi kërkojmë të sjellim në dritë historinë e vëzhgimit dhe të persekutimit të inxhinier Gjovalin Gjadrit. Inxhinier Gjadri lindi më 2 korrik të vitit 1899, në Shkodër. Ishte i biri i një familjeje të thjeshtë. I ati Andrea Gjadri, tregtar, vdiq kur Gjovalini ishte në moshë të njomë dhe e ëma Tereze Deda e rriti e vetme. Nga viti 1905 deri më 1913 Gjadri ndjek Kolegjin Saverjan në Shkodër. Në vitin 1914, me bursë austriake, vazhdon shko-llën e mesme në Krema dhe më 1925 arrin të diplomohet për inxhinieri civile në Universitetin e Vjenës, diplomë që mban numrin e protokollit 141.⁷ Njohuritë e tij shkencore mbi inxhinierinë e ndërtimit plotësohen akoma më tej edhe me zotë-rimin e katër gjuhëve të huaja, si: gjermanisht, italisht, rusisht dhe frëngjisht.⁸ Pas përfundimit të studimeve në vitin 1925 rikthehet në Shqipëri, ku emërohet inxhinier në dispozicion të Ministrisë së Punëve Botore.

Moment i rëndësishëm në debutimin e tij si inxhinier, nga ku do të fillonte edhe konsolidimi i figurës së tij në botën e inxhinierisë, do të ishte pozicioni inxhinier kontrollues në Urën e Matit, për llogari të firmës italiane *Mezzarana*, në vitin 1926. Kjo urë është shpallur monument kulture.⁹

Nga viti 1927 deri më 1932 ka punuar si inxhinier projektues në Institutin e Projektimit të Urave “Mostovoi Byro” në Bashkimin Sovjetik. Për shkak

të komplikacioneve shëndetësore nga klima e ashpër, ai rikthehet në Tiranë. Edhe mbi këtë fakt, siç do ta shohim më poshtë, lindin përherë dyshime nga Sigurimi i Shtetit për veprimtari agjenturore austriake në Bashkimin Sovjetik. Me rikthimin e tij vazhdon puna e pandalshme profesionale, për gati 50 vjet, me vepra të projektuara që mbajnë emrin e tij. Deri në çlirimin e Shqipërisë inxhinier Gjadri punoi si inxhinier projektues e zbatues në Ministrinë Botore. Mbas çlirimit ka punuar në Ministrinë e Ndërtimit dhe në Institutin Shtetëror të Projektimit si projektues e drejtues në sektorin e urave dhe statikën e konstruksioneve të ndërtimit.¹⁰

Në një autobiografi të tij në dosjen pranë AIDSSH, në vitin 1945, përveç të dhënave mbi punën e tij, Gjadri e ndien të nevojshme të tregojë që ishte i pastër si figurë: “Në kohën e okupacionit Italian nuk jam shkruar në *Partin Fashiste*, as në kohën e okupacionit Gjerman nuk kam bashkëpunuar me Gjermanin.”¹¹ Ky fakt e siguron që të mos pësojë fatin e atyre që u dënuan si bashkëpunëtorë dhe të vazhdojë i qetë punën e tij. Sigurisht, gjithë kjo përkujdesje për pastërtinë e figurës së tij lidhet me dyshimet e tij mbi persekutimin e mundshëm që mund ta godasë, ashtu siç ka ndodhur me shumë kolegë të tij.

Inxhinier Gjadri mban Urdhrin e Punës të Klasit të Parë, të marrë me dekret të Kuvendit Popullor nr. 28, viti 1945, në akordim theksohet: “Ndonse shëndet lig, Gjadri u hodh pa rezerva në ndërtimin

e krejt urave të mëdha. Punoi pa rreshtur dhe me dinamizmin që kërkonte koha. Vuri krejt zotësin e tij teknike në shërbim të popullit.”¹²

Arritjet e tij shkencore e profesionale janë me të vërtetë mbresëlënëse. Për të përmendur vetëm një pjesë prej tyre, mund të themi se në fushën e projekteve në fondin e Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit ruhen projekte të mbi 75 veprave inxhinierike të tij të ndërtuara në rajone të ndryshme të Shqipërisë, midis të cilave spikasin: Ura e Lanës (në bulevardin e madh të Tiranës, 1932), Ura e Bunës (Shkodër, 1934), Ura e Zaranikës (Elbasan, 1934), Ura e Gjanicës (qyteti i Fierit, 1940), Ura e Mbrostarit (Fier, 1945), Ura e Mezghoranit (Tepelenë, 1947), Ura e Rrogozhinës (1948), Ura e Bahçallëkut (Shkodër, 1949), Ura e Mokrës mbi Shkumbin (Pogradec, 1951), Kullë e lartë uji për lokomotivat (Durrës, 1951), Ura e re e Mifolit mbi Vjosë (Vlorë, 1952), Centrali i Rubikut (1952), Urë tip pasarelë mbi Vjosë (Memaliaj, 1953), Oxhak i lartë në Rubik (1954), Ura mbi Dunavec (Maliq, 1957) e shumë e shumë vepra të tjera, kryesisht nga infrastruktura e transportit, si dhe objekte industriale.¹³ Të gjitha këto arritje bëjnë që inxhinier Gjadri të renditet ndër figurat më të shquara të shkencës shqiptare dhe që në vitin 1947 të anëtarësohet në Asamblenë e Përgjithshme të Institutit të Studimeve, që mund të cilësohet si gur themeltar i institucioneve shkencore në vend. Në Asamble bënë pjesë 23 intelektualë, ndër ta përmendim: Sejfulla Malëshova, Spiro Koleka, Aleksandër Xhuvani, Aleks Buda, Petraq Peppo, Eqrem Çabej, Petro Fundo dhe Gjovalin Gjadri.¹⁴

¹⁰ AQSH, f. 800, v. 1971, d. 330, fl. 50.

¹¹ AIDSSH, fq. 6.

¹² AQSH, f. 489, Presidiumit të Kuvendit Popullor, v. 1945, d. 102. Dosje për dhënie dekoratash e urdhrash të ndryshëm.

¹³ Niko Pojani, “Gjovalin Gjadri, inxhinieri i urave të *para shqiptare*”, në: *Gazeta Shqiptare*, nr. 6211, 16 dhjetor 2013, fq. 16.

¹⁴ “Problemi i adjezionit në lëvizjen e trenit hekurudhor”, në: Buletin i Institutit të Studimeve, v. I, nr. 1 (Tiranë: Botim i Institutit të Studimeve, 1949).

Ndërkohë, në fushën e studimeve teknike-shkencore vlejnë për t'u përmendur: *Artikull mbi Urën e Lanës*, botuar në Bauteknik, 1935; *Probleme urash në Shqipëri*, botuar në materialet përmbledhëse të Kongresit të Berlinit, 1936; *Problemi i adjezionit në lëvizjen e trenit hekurudhor*, botuar në Buletin e Institutit të Shkencave, 1949; *Tre artikuj mbi teorinë e plasticitetit*, botuar në Buletin e Institutit të Shkencave, 1950; *Referat mbi llogaritjen e harkut të inkastruar*, mbajtur në një nga seksionet shkencore të organizuara për nder të 20-vjetorit të çlirimit të atdheut, botuar nga dega e botimeve të Universitetit të Tiranë, 1964.¹⁵

Për sa u përket botimeve shkencore, një peshë të rëndësishme zë libri *Shkenca e konstruksioneve*, volumi I, “Rezistenca e materialeve”, Tiranë, 1965, i përbërë nga 550 faqe. Prof. Gjadri e kishte konceptuar veprën e tij *Shkenca e konstruksioneve* në tri vëllime dhe në vëllimin II trajtoheshin teoritë e shtypjes së tokës dhe trau vertikal, instruktuar në tokë. U dorëzua pjesërisht në universitet, ndonëse pa recensë, edhe vëllimi III mbi analizën statike të strukturave tip hark.¹⁶ Përfundimi i punës u pamundësua për shkak të vdekjes së tij në vitin 1974.

Për librin *Shkenca e konstruksioneve*, në vitin 1952, Gjadri i shkruan nënkryeministrit, inxhinier Spiro Kolekës, një promemorie, ku shpjegon angazhimin që ka ndërmarrë për të shkruar librin për Institutin e Shkencave dhe thekson që, për shkak të shëndetit të tij të dobët, i nevojiten 3 orë në ditë liri veprimi, brenda orarit zyrtar, gjithashtu kërkon që t'i

pakësohen çështjet formale dhe administrative që të mund të përfundojë librin. Ajo që bie në sy në këtë letër është guximi i tij për të kërkuar mbështetje prej drejtuesve të lartë të regjimit për punën shkencore: “Nuk qëndron çështja mbas mendimit t'em te mekaniteti i permanencës ma pak a ma shumë në zyrë, por te trajtimi akademik. Në këtë pikëpamje kam informata se, në Bashkimin Sovjetik, ata që merren me shkrime librash, shkruajnë vetëm libra dhe nuk merren me asnjë punë tjetër.”¹⁷

Edhe nga vështrimi i imët i dosjes së Gjadrit vihet re një marrëdhënie e ftohtë me regjimin. Për Gjadrin, regjimi është një punëdhënës dhe ai nuk shfaq asnjë lloj pasioni politik pro regjimit apo kundër tij. Për këtë arsye, do të akuzohet edhe për “indiferentizëm”. Pra, edhe dinamikat e “përplasjeve”, sado të vogla, kanë të bëjnë thujse me një marrëdhënie punëdhënës-punëmarrës. Regjimi ka nevojë për aftësitë e tij tekniko-profesionale, Gjadri ka nevojë për një punë që t'i sigurojë sa më shumë të ardhura dhe t'i njihen meritat profesionale.

Njohja dhe vlerësimet nga ana e autoriteteve shkencore të kohës për veprën e Gjadrit dëshmojnë se regjimi ishte i kënaqur me punën e tij. Asnjë vlerësim nuk ishte i mundur pa pëlqimin e autoriteteve të regjimit. Pas botimit të librit nuk kanë munguar vlerësimet për punën e tij të madhe. Në një recension publik botuar në shtypin e kohës në shtator 1966, duke komentuar vëllimin I të veprës së prof. Gj. Gjadrit, një inxhinier tjetër i fushës së konstruksioneve të ndërtimit, Haxhi Dauti, shprehet:

¹⁵ AQSH, f. 800, v. 1971, d. 330, fq. 52.

¹⁶ Po aty, fl. 53.

¹⁷ AQSH, f. 499, Ministria e Ndërtimit, v. 1952, v. 744.

*Libri i inxhinier Gjadrit është shkruar me dinjitet teknik dhe karakterizohet nga një nivel i lartë teorik, si nga pikëpamja e thellësisë së argumentimit, ashtu dhe nga ajo e rrobës matematike... Lënda e trajtuar në të është mjaft e gjerë dhe aktuale... Libri ka rëndësi të madhe të dyfishtë, për inxhinierët dhe studentët e Inxhinierisë...*¹⁸

Në vitin 1972, në mbështetje për dhënien e titullit Profesor, ka një recensë të shkruar nga docent Andrea Papastefani, ku ia vlen të theksojmë fjalët e tij mbi veprën e Gjadrit:

*Libri “Shkenca e konstruksioneve” është libri i parë në këtë lëmë të shkencave, që shkruhet në gjuhën amtare. Ai meriton vëmendje të veçantë për një trajtim të problemit të rezistencës së materialeve si nga ana teknike ashtu edhe teorike.*¹⁹

Gjithashtu, mbi veprimtarinë e tij shkencore ka recensë edhe nga doc. Vasil Pistoli. Ndër të tjera, theksohet që autoriteti i tij është i mirënjohur edhe nga shumë personalitete të huaja të fushës së ndërtimit. Siç përshkruan rastin e diskutimit të bërë ndërmjet disa inxhinierëve shqiptarë që vajtën për këmbim eksperience në Itali me profesorin Carlo Cesteli Guidi, me autoritet ndërkombëtar i cili, sipas V. Pistolit, kishte për Gjadrin respektin e një kuadri shkencor të shquar.²⁰

Gjadri prej vitit 1957 ushtronte aktivitetin shkencor pedagogjik në Universitetin Shtetëror të Tiranës, duke qenë nga kuadrot e parë në fushë të ndërtimit qysh me krijimin e Institutit të Shkencave.

Moment i rëndësishëm për Gjadrin ishte vendimi i shumëpritur dhe deri diku i vonuar mbi dhënien e titullit Profesor. Këshilli shkencor i fakultetit të inxhinierisë në mbledhjen e datës 6 dhjetor 1972 vendosi me 24 vota pro nga 25 votues t'i akordojë titullin shkencor Profesor.²¹

Dinamikat e përndjekjes së inxhinier Gjovalin Gjadrit

Pavarësisht punës së tij të madhe në rindërtimin e vendit, ai është mbajtur vazhdimisht nën kontrollin e Sigurimit, me pretekstin se inxhinier Gjadri mund të dëmtonte pushtetin. Në dosjen e tij pranë AIDSSH, figura e Gjadrit trajtohet herë si figurë e pastër dhe herë të tjera ngrihen hije dyshimi. Në një nga përshkrimet e figurës së tij në një raport të shkruar më 1949 që fillon me fjalët “për kategorizimin e aktivitetit kundërshtar të Gjovalin Gjadrit”, shikohet tendenca e qartë për të hedhur hije dyshimi mbi figurën e tij. Aty theksohet: “Gjovalin Gjadri është njeri i privilegjuar.” Raporti vijon me informatat mbi arsimimin e tij në Vjenë, punësimin e tij në ministri pas kthimit në Shqipëri, më pas përmendin punësimin e tij si inxhinier në Moskë më 1927 dhe kthimin më 1932 nga Bashkimi Sovjetik. Për periudhën e punës në BS raporti vazhdon hedh hije dyshimi mbi arsyet e kthimit: “Gjatë kohës që ka qëndruar në Moskë dhe largimi i tij nga Bashkimi Sovjetik nuk dihet përse, meqenëse ky ka kryer universitetin në Austri, dyshohet të jetë kenë agjent i kontrollit austro-german.”²²

¹⁸ Niko Pojani, “Gjovalin Gjadri, inxhinieri i urave të para shqiptare”, në: *Gazeta Shqiptare*, nr. 6211, 16 dhjetor 2013.

¹⁹ AQSH, f. 800, v. 1971, d. 330, fl. 57.

²⁰ Po aty, fl. 55.

²¹ Po aty, fl. 62.

²² AIDSSH, fl. 8.

Në punën e Sigurimit të Shtetit shumëçka ishte nën shenjën e dyshimeve për agjenturë të huaj, sidomos për ata që kishin studiuar jashtë shtetit. Problemi bëhej më dramatik atëherë kur në përndjekjen e personave Sigurimi mbështetej vetëm te dyshimet dhe hipotezat, jo në verifikimin e tyre. Vëzhgimi kryhej në mënyra nga më të ndryshmet dhe fryma e vëzhgimit ishte krijuar nga nevoja e pushtetit për të pasur nën kontroll çdo person që mund të krijonte ndonjë problem ndaj tij. Fakti që pushteti kishte ngritur një sistem kontrolli të jashtëzakonshëm që nga ushtria, policia, Sigurimi i Shtetit, me një rrjet spiunësh në çdo skaj të vendit, kontrolli punëtor, organizatat e masave, kolektivët e punës së çdo ndërmarrjeje, na bën të mendojmë se regjimi ishte e bindur se nuk kishte krijuar një “njeri të ri” të bindur, por gjithçka ishte një përpjekje e mirëmenduar për të mbajtur pushtetin nëpërmjet frikësimit të popullit.

Në vijim, dosja përmban aludime mbi vënien e interesit vetjak mbi atë të përgjithshëm nga ana e Gjadrit, cilësi kjo e papranueshme për moralin komunist. Në citimin e mëposhtëm spiunimi përpiket të nxjerrë në pah dy veti “negative” të Gjadrit: vënia e interesit vetjak mbi atë të përgjithshëm dhe indiferentizmin.

Gjatë regjimit të Zogut ky ashtë bërë njeri i privilegjuar, simpatizonte regjimin dhe punonte për të deri në okupacion. Ky ka qenë i lidhur ngushtë me degën e sektorit ku punonte si inxhinier. Gjatë okupacionit i ka shërbyer fashizmit më së miri, njeri që ka shikuar gjithmonë lekun dhe interesin e tij personal, ka simpatizuar okupacionin Italian-Gjerman dhe

organizatat trathtare të Ballit e të Legalitetit, ka folur në favor të tyre duke popullarizuar ata dhe luftën N.CL. nuk e ka shikuar me sy të mirë. Nuk ka treguar ndonjë aktivitet kundërshtar mbasi ka qëndruar indiferent.²³

Gjadri nuk mund të konsiderohet as “njeri i ri” as person i besueshëm i regjimit, pasi ai “ka shikuar gjithmonë lekun dhe interesin personal”. Kjo çështje ka një peshë të madhe antropologjike, pasi na sjell në vëmendje dinamikën e antropologjisë ekonomike në marrëdhënien e regjimeve me shkencëtarët. Në vitet e para të regjimit komunist në BS, ku Gjadri ka punuar për 5 vjet, ka një qasje kryesisht negative të pushtetit kundër kërkesës që kanë shkencëtarët e intelektualët për paga të larta. Lenini ishte kundërshtar i madh i pagave të larta:

Është e padiskutueshme që pagat e larta kanë një influencë të madhe korruptimi mbi pushtetin tonë bolshevik! Por shpejtësia e zhvillimit të Revolucionit tonë ka bërë që të detyrohemi të na bashkohen disa aventurierë intelektualë që kërkonin paga të larta duke bërë që të shpërdorohej paraja publike e masave punonjëse. Masave u duhet shpjeguar se të paguarit e intelektualëve me paga të larta është joparimore, por e kemi bërë nga nevoja ekstreme.²⁴

Edhe regjimi shqiptar kërkonte t'i përmbahej kësaj linje. Interesi vetjak ka qenë demonizuar përgjatë gjithë kohës së pushtetit socialist. Madje, edhe arti ishte vënë në funksion të luftës ndaj interesit vetjak. Veprat artistike duhej ta dënonin çdo tendencë të vënies së interesit vetjak mbi atë të përgjithshëm.

²³ AIDSSH, fl. 8.

²⁴ A. Moscato, *INTELLETTUALI E POTERE IN URSS (1917-1956)*. Ed. MILELLA-LECCE, 1986, fq. 79.

Veprat më të mira të kësaj periudhe edukuan njerëzit me mendime dhe dëshira të reja, ato brumosën në ndërgjegjen e tyre qëndrimin socialist ndaj punës dhe pronës së përbashkët, frymën e kolektivizmit dhe vënien e interesave të përgjithshme mbi interesat e ngushta vetjake, i edukuan ata me besnikërinë e pakufishme ndaj socializmit dhe me frymën e urrejtjes ndaj shoqërisë me klasa dhe moralit të saj.²⁵

Duke parë pjesën e dosjes së Gjadrit, ku shkruhet për debatet mbi pagën, vërehet një fakt interesant: ministrat i kanë premtuar rritje page, por nuk e kanë mbajtur fjalën:

Në plenumin e datës 20 korrik 1949, me rëndësi ka qënë diskutimi i Gjovalin Gjadrit që kërkon rritjen e rrogës së tij. Të cilën vjet ja kanë premtuar ministrat por akoma s'ka ndryshuar. Ai thekson që është e padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin e punës i cili përcakton si të doktorave dhe të nënpunësve. Ndërkohë që doktorët marrin 8000-9000 leke.²⁶

Duke kërkuar mbi rrogat e inxhinier Gjadrit në kohën kur ishte drejtor në Drejtorinë e Rrugëve dhe Urave, nga arkivi zbuluam se rroga kapte shifrën 1850 lekë. Rroga bazë ishte 1600 lekë dhe 200 lekë i përfitonte për kualifikimin që zotëronte në këtë kohë, kishte gradën III; po ashtu merrte edhe 50 lekë shpërblime.²⁷

Gjadri është jashtë klimës sociale, kulturore dhe shpirtërore në të cilën është rritur, është shkolluar, ka punuar. Çdo gjë në vitet e para të regjimit i duket

aq e zymtë dhe e papërballueshme, saqë kërkon në rrugë zyrtare të largohet nga Shqipëria. Kërkesa që ai i bën pushtetit për largim nga Shqipëria vihet në dosjen e tij nën titullin "Material kompromentues":

Shveshja e drejtave, më kujton përsëri kohët e hershme kur kam kenë student në Austri, ku kam ndie një mungesë, kam hekë një vuajtje që nuk e kam ditë se çka është kanë, por që tash e di se ka kenë vuajtja e mungesës të Atdheut, që e kam kërkuar gjithmonë dhe nuk e kam gjetë kurr, sa këtu në Shqipëri ...por në degradimin tem kam bindjen me të drejtat dhe pretendimet e mija këtu në Shqipëri, janë pa të realizueshme... dëshiroj ta le këtë Shqipëri .Unë kam një nanë dhe një motër në Austri, që vujn ekonomikisht simbas lajmeve që kam marr... I lutem ministris më me shkarkue nga çdo detyrë dhe me ndërmjetësu ku duhet për lëshimin e pashaportës që mund të shkoj në Austri.²⁸

Ky është kulmi i dëshpërimit për një person që e do atdheun e tij, por që e sheh veten të huaj me këtë pushtet. Këtë mënyrë të shprehuri me nota të forta emocionale do ta gjejmë edhe poshtë në vijim të artikullit kur të shikojmë librin e tij *Letra grues seme të vdekun*. Gjadri është një shpirt i lirë, rregullat e diktaturës i rrinë mjaft ngushtë dhe nuk ka dëshirë të qëndrojë më në atdheun e tij.

Edhe indiferentizmi nuk është parë me sy të mirë nga regjimi, pasi ai kërkonte me ngulm që çdo person, për më tepër intelektualët, të përfshihe-shin në luftë kundër pushtuesit. Kujtojmë në këtë kontekst edhe kritikën e opinionit shoqëror në

²⁵ *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, ASH e RPS të Shqipërisë, IGJL, Tiranë, 1978, fq. 193.

²⁶ AIDSSH, f. 16.

²⁷ AQSH, f. 899, v. 1947, d. 323/I, f. 213.

²⁸ AIDSSH, fl. 21-23.

socializëm ku kjo mendësi e të qëndruarit i paangazhuar dhe pasiv në jetën shoqërore dhe politike kategorizohej si “indiferentizëm”.

Pasiviteti dhe indiferenca janë fenomene të huaja jo vetëm për komunistët, por për çdo qytetar të ndershëm të shoqërisë sonë socialiste ... si mund të rrijë indiferent një komunist, madje dhe një qytetar, kur ... sheh që ndokush nuk respekton disiplinën proletare, kur ndokush nuk sillet sipas normave të moralit të shoqërisë sonë socialiste në punë, në shoqëri dhe në familje? Shoku Enver Hoxha nënvizon se indiferentët “janë më të rrezikshëm edhe se vetë fajtorët, sepse indiferentët dëmtojnë zhvillimin e opinionit shoqëror”.²⁹

Të klasifikohesh si indiferent, ishte një hap drejt konsiderimit si armik i regjimit. Gjithë analiza e dosjes së Gjadrit dhe arkivat e tjerë të konsultuar na shtyjnë të pohojmë se Gjadri është konsideruar përherë si armik, por për arsye të nevojës së madhe që regjimi kishte për njohuritë e tij ai është mbajtur vazhdimisht nën vëzhgim. Në fakt, në dosje kemi gjetur edhe kategorizimin e tij si element armik në kategorinë 2B, i cila është treguese për intensitetin e vëzhgimit nga Sigurimi i Shtetit element kundërshtar.

Dramatik ka qenë përgjatë regjimit komunist mënyra e dënimit me karakter kolektiv. Pra, nëse dikush kryente një “krim” apo shprehte kundërshti kundër regjimit, ai nuk ishte i vetmi që do të paguante pasojat, bashkë me të vuanin edhe të afërmit e tij. Kjo është arsyeja pse në raportet e gjetura në arkiv flitet për njerëzit e tij të afërt.

Vëzhgimi i inxhinierit bëhet edhe më i qartë në disa fletë pranë dosjes së AIDSSH që mbajnë titullin *Përmbledhje informative të ndryshme të Gjovalin Gjadrit*. Këto fletë nisin gjithmonë në krye me fjalët “Vdekje Fashizmit – Liri Popullit”. Kemi mbi 30 informata që në njëfarë mënyre janë spiunime të ndryshme mbi çdo veprim të Gjadrit nga individë me pseudonim. Këto spiunime i kemi të datave të ndryshme, nga viti 1946 deri më 1954. Ndjekja e personaliteteve të shkencës, artit apo politikës ka qenë një shenjë dalluese e regjimit komunist shqiptar. Ky fakt buronte nga mosbesimi që mbretëronte midis drejtuesve politikë. Mosbesim ndaj intelektualëve, mosbesim ndaj njëri-tjetrit, frikë nga njëri-tjetri. Në diktaturë, regjimi nuk kishte besim te bindja e njerëzve dhe për këtë qëllim organizonte një kontroll të vazhdueshëm përndjekës kundër të gjithëve, sidomos ndaj atyre që mund të paraqisnin rrezik për pushtetin.

Një element që ne e konsideruam me rëndësi të veçantë antropologjike gjatë analizës së dosjeve ishte përdorimi i fjalës “thuhet” gjatë denoncimeve dhe spiunimeve të ndryshme. Kjo fjalë, duke qenë evazive, lë shkas për thashetheme, pasi nuk përcaktohet qartë se kush është burimi i informacionit. Kjo ka të bëjë edhe me një qëndrim të dyfishtë të pushtetit ndaj problemit të thashe-themeve: nga njëra anë, zyrtarisht regjimi i dënon thashethemet dhe personat që merren me to, nga ana tjetër regjimi i nxit thashethemet “kur ato janë në të mirën e pushtetit”.³⁰ Te dosja e Gjadrit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit gjejmë shpesh informacione me shprehjet “thuhet” dhe me autorësi “anonim”:

²⁹ “Në luftë kundër ndikimeve borgjeze-revizioniste”, në: *Rruga e Partisë*, n. 3, 1973, fq. 12.

³⁰ A. Nikolla, *Njeriu i ri shqiptar. Ndërmjet moralit komunist dhe krizës së tranzicionit* (Tiranë: Onufri, 2012), f. 99.

Në politikë thuhet se qëndrimi i tij politik nuk është i mirë, por ka shfaqur urrejtje kundra formës në [...]. Thuhet se në vitin 1948 nuk e ka realizuar planin dhe nuk është goditur përpara kolektivit. Thuhet të ketë kushërinj të tij në burg, por kur është pyetur me rastin e verifikimit të kundërshtarëve ka deklaruar se jo. Del se nuk bën përpjekje për të përfituar nga eksperiencia sovjetike, por përdor literaturën gjermane.³¹ (nënvizimi ynë)

Kjo mënyrë e marrjes së informacionit ka mbështetur një dhunë të pashoqe kundrejt mjaft personave të pafajshëm të cilët nuk kishin as mundësi të mbroheshin përballe akuzave “thuhet” me autorësi anonime. Përballë pyetjes që mund të drejtonin të akuzuarit rreth autorëve të formulimit të akuzave, punonjësit e Sigurimit kishin gati formulën: Partia, ajo di gjithçka!

Nga një informatë tjetër ku komentohen veprimet e Gjadrit në punë, vërejmë se si pushteti shfrytëzon shpesh edhe konfliktet midis kolegëve në mënyrë që ata të mund të akuzojnë njëri-tjetrin.

I. Lufi dhe Gjovalin Gjadri nuk shkojnë mirë, për arsye se Lufi i dorëzon punë Gjadrit për të bërë që i takon sektorit të tij dhe i thotë që në këtë datë duhet të jetë gati. Këtu Gjadri acarohet dhe grindet me Lufin. Me 15.03.1948. Nga seksioni III.³²

Marrëdhëniet ndërnyerëzore e ndërprofesionale në komunizëm ishin pre e një frike të ndërsjellë dhe të paditjes a denoncimit të mendimeve, që dikush mund të shprehte hapur në mirëbesim a në një bisedë miqësore. Shpeshherë, grindjet mes

personave mund të shfrytëzoheshin nga regjimi për qëllimet e tij persekutuese për të vënë kundër njëri-tjetrit personalitetet e fushave të ndryshme.

Tipik në arsyetimin e regjimit ka qenë dyzimi në gjykimin ndaj intelektualëve dhe shkencëtarëve: janë të aftë, por nuk janë politikisht të mirë. Regjimi kërkonte një dedikim total të personit ndaj pushtetit, dedikim profesional, politik e moral. Jashtë regjimit nuk ka asgjë që mund të jetë më e rëndësishme se vetë regjimi, për pasojë çdokush që nuk ka këtë dedikim total mund të jetë i dëmshëm për regjimin.

Prandaj ky element është një inxhinier i zoti, por është anormal dhe politikisht nuk pajtohet me politikën popullore. 1948 (pseudonim).³³

Një element i rëndësishëm antropologjik që ka të bëjë me punën e spiunëve lidhet edhe me detyrimin që kishin këta të fundit për të dhënë llogari ndaj eprorëve dhe shpesh edhe e teprojnë me zellin e tyre duke përshkruar detaje që përdoren për të krijuar një ide se personi i vrojtuar është vërtet i rrezikshëm, edhe kur nuk ka asnjë fakt për të vërtetuar akuzën.

Sipas një bisedimi që pata me Ing. Myzefer Dragotin në lidhje me Ing. Gjadrin, pasi më foli për zgjuarësinë e tij, më tha se një ditë ishte duke biseduar me Gjadrin rreth një projekti të punuar nga Ing. Lutfi Strazimiri tha: Ah, interesant dhe puna e ketij personi, vall çfarë krimi ka bërë ky person? Ing. Dragoti nuk ju përgjigj. Më pas vazhdon: Nga shikimi i veprimtarisë së përgjithshme të tij del se është menefregist në punë dhe si rrjedhim

³¹ AIDSSH, fl. 21-23.

³² Po aty, fl. 14.

³³ Po aty, fl. 24.

puna e tij del me vonesë, e pa studiuar mirë dhe pa asnjë bazë të sistemit sovjetik. *Megjithëse nuk kemi fakte konkrete në duar, si opinion unë e them me siguri se është një fashist i fëlliqur mbasi megjithëse shpërblehet rreth 10.800 Lek në muaj është i pakënaqur për shpërblimin që merr. Në një mbledhje ose diskutim politik si informacion politik etj., nuk i pret mirë dhe këto i shpreh me fjalë indirekte. Më 17.01.1951.* (Informatë nën pseudonim).³⁴ (nënvizimi ynë)

Kjo ishte në mënyrë të përmbledhur klima ku punoi dhe jetoi për 28 vjet inxhinier Gjadri, veprat e të cilit kanë lënë një dëshmi të jashtëzakonshme në sektorin e ndërtimit, të urave e rrugëve në Shqipëri. Për këtë figurë të rëndësishme të inxhinierisë shqiptare në vitin 1967 u hap edhe shkolla që mban emrin e tij “Gjovalin Gjadri” në Gjadër të Lezhës si një vlerësim për punën e tij shumëvjeçare.

Gjovalin Gjadri si shkrimtar

Gjovalin Gjadri në fushën e tij mbetet një personalitet i lartë. Përpos kësaj, dëshirojmë të përmendim edhe meritat e tij si shkrimtar. Në vitin 1941 ai humbet gruan e tij, Zejnepin, të cilën aq e deshi, sa përjetësoi dhimbjen e tij në librin *Letra grues seme të vdekun*. Libri ka në përmbajtje të tij letra të shkruara mes 3 shtatorit 1941 dhe 20 korrikut 1942. Në mes tyre ka edhe letra të shkëmbyera mes të dashuruarve, po edhe mjaft reflektime me natyrë filozofike mbi jetën, vdekjen, shoqërinë, kulturën.

Në leximin e këtyre letrave të duket sikur ke hapur ditarin e fshehtë të një të afërmi. Të fshehtën

e konfirmon edhe botimi i këtij libri, të cilin Gjovalin Gjadri e boton në gjuhë të huaj, gjermanisht, *Briefe an meine tote frau*, dhe nën pseudonimin G. Maranaj. Duket sikur do ta mbajë larg lexuesit të asaj kohe kaotike luftime. Studiuesi Ardian Ndreca, që ka përkthyer librin nga gjermanishtja, në parathënie sjell informacione të mëtejshme që plotësojnë mjaft mirë këtë libër të pazakontë në letërsinë shqiptare. Njohja me Zejnep Toptani ndodhi në vitet 1930, ajo ishte vajza e Abdi Toptanit, një prej nënshkruesve të Deklaratës së Pavarësisë. Abdi Toptani nuk mund të pranonte martesën e së bijës me një njeri që nuk i përkiste rangut të tij dhe më e rëndësishmja, një mysliman që në vitin 1920 ka qenë përfaqësues i myslimanëve sunitë në Këshillin e Lartë nuk mund të pranonte për dhëndër një katolik. Por Zejnepi largohet nga shtëpia e prindërve dhe martohet me inxhinier Gjadrin kundër dëshirës së familjes. Pas ndërtimit të familjes së tyre dhe me ardhjen në jetë të djalit Egon Gjadri, Zejnepit i shfaqet sëmundja e tuberkulozit. Pavarësisht dëshirës së madhe për të jetuar, më 15 gusht të vitit 1941 ndahet nga jeta në Romë.³⁵

Në mesin e dhimbjeve autori, duke shprehur dhimbjen për humbjen e së shoqes, përpiqet të gjejë edhe fajtorët dhe shkaktarët e kësaj humbjeje. Një herë e shikon fajin te vetja, një herë te lufta që nuk iu la mundësinë të shkonin në Vjenë për kurim, një herë te familjarët e Zejnepit, madje e shikon si një hakmarrje të historisë ndaj tyre, duke e gjetur fajin te stërgjyshërit e saj “Karl dhe Andreat”, që sipas tij i hapën zemrën dhe derën armikut turk.³⁶

Struktura antropologjike ka mjaft prani të hesh-tur në këtë libër, mbasi është e qartë se personi

³⁴ AIDSSH, fl. 18.

³⁵ Gjovalin Gjadri, *Letra grues seme të vdekun* (Tiranë: Onufri, 2017), fq. 10.

³⁶ Po aty, fq. 122.

historik nuk mund të konceptohet kurrë i ndarë prej individualitetit shprehës të subjektit. Shkruan Gjovalin Gjadri: “E di, ti don që un ta mbaj veten, që të tregohem i fortë para njerëzve, siç e lypin doket e vendit tonë, siç e kërkon edukata dhe krenija jote.” Sikur e cekëm, ka dy dimensione në këtë dhimbje, humbje, vdekje: një krejt vetjak e intim dhe një dimension shoqëror që e harron njeriu e përveçëm – njeriu i përveçëm është harruar qysh kur babai duhet të kundërshtojë martesën mes një myslimaneje dhe një të krishteri, qysh kur imponimet e rangut pengojnë bashkimin mes një djali të thjeshtë e një vajzë soji: një luftë mes fana-tizmit dhe qytetnimit.

Funksionin më të madh shprehës ky libër e ka bash në këto ndarje që ushqejnë një diskurs të pasur antropologjik, ku shenjën e barazimit e vendos veç dashuria e mbasandaj vdekja. Po vdekja nxjerr në dritë mjerimin e sjelljeve fanatike, padobinë e vogëlsive njerëzore përballë një ngjarjeje të skajshme si vdekja. Ja si ia kujton në letër Gjadri së shoqes brengën që ajo kishte për marrëdhënien vëlla-motër tashmë të krisur pikërisht për shkak të zgjedhjes së Zejnepit t’u martuar me Gjadrin:

Ti e din e dashun se përse i përket tand vëllau mue s’më ka interesue kurrë asgja, por për të qetësue ty do të jem i butë me të, edhe pse asht e vështirë mos me pasë paragjykime. Unë kisha mendime të thjeshta, të natyrshme rreth marrdhanjeve të njerëzve me njeni-tjetrin. E shihja qëndrimin e tij të vjetruem, të papajtueshëm me edukatën që kishte marrë jashtë dhe s’mund të shfajësohej me trysninë që baba yt plak mund të ushtronte mbi të.

BIBLIOGRAFIA

ARKIV

AIDSSH – Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Dosja Gjovalin Gjadri.

AQSH, fondi 489, Presidiumi i Kuvendit Popullor, dosja 102, viti 1945.

AQSH, fondi 499, Ministria e Ndërtimit, dosja 323/1, viti 1947.

AQSH, fondi 499, Ministria e Ndërtimit, dosja 744, viti 1952.

AQSH, fondi 800, Komisioni i Lartë i Atestimit, dosja 330.

LITERATURË

Enver Hoxha, *Vepra 7*, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH (Tiranë: Naim Frashëri, 1971).

Enver Hoxha, *Vepra 15* (Tiranë, Naim Frashëri, 1971).

Enver Hoxha, *Vepra 8* (Tiranë, Naim Frashëri, 1973).

Enver Hoxha, *Vepra 17* (Tiranë: Naim Frashëri, 1973).

Gjovalin Gjadri, *Letra grues seme të vdekun* (Tiranë: Onufri, 2017).

Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist, ASH e RPS të Shqipërisë, IGJL, Tiranë, 1978.

A. Moscato, *INTELLETTUALI E POTERE IN URSS* (1917-1956), Ed., MILELLA – LECCE, 1986.

A. Nikolla, *Njeriu i ri shqiptar. Ndërmjet moralit komunist dhe krizës së tranzicionit* (Tiranë: Onufri, 2012).

GAZETA

Gazeta shqiptare, nr. 6211, 16 dhjetor 2013.

REVISTA

“Në luftë kundër ndikimeve borgjeze-revizioniste”, *Rruga e Partisë*, n. 3, 1973.

Indrit Qehajaj

Arshi Pipa, profili i një studiuesi të padëshiruar

Hyrje

Ndër tiparet më themelore të modelit totalitar, sidomos atij shqiptar, mbeten dhuna e ashpër dhe eliminimi i individëve dhe grupeve që konsiderohen si kundërshtarë të regjimit. I tillë ishte edhe rasti i profesor Arshi Pipës i cili, ndonëse nuk kishte asnjë përgjegjësi penale të faktuar, u dënua dy herë, duke qëndruar për rreth 11 vjet në burgje e kampe pune. Vitet 1945-1954, që janë kufijtë kohorë të këtij prezantimi, përkojnë pikërisht me vitet e burgosjes dhe vuajtjeve të pafundme të Pipës dhe të familjes së tij. Në mënyrë kronologjike do të përpiqemi të hedhim dritë mbi këtë personazh të rëndësishëm të kulturës shqiptare, duke u përpjekur të kuptojmë më mirë njeriun dhe studiuesin, arsyet e burgosjes së tij dhe përballjen e tij me dënimin. Materialet kryesore që

janë përdorur i përkasin Fondit personal Arshi Pipa në dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, të cilat na janë vënë në dispozicion nga Autoriteti për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit. Me vlerë kanë qenë edhe disa prej librave të Pipës të shkruar para, gjatë dhe pas dënimit, duke na dhënë mes vargjeve, artikujve studimorë dhe rrëfimeve personale një pamje të plotë të njeriut, të intelektualit, të shkrimtarit dhe të studiuesit Pipa. Në librin e shkruar në burg dhe të botuar pas dënimit si *Libri i burgut* prezantohet edhe fytyra që regjimi i shfaqti Pipës, sikurse edhe shumë të tjerëve, sidomos në vitet e para të vendosjes së regjimit. Rrëfimet e tij mbi vuajtjet në burgjet e kohës, të shprehura në mënyrë mjeshtërore nga Pipa, përbëjnë një tjetër dëshmi të ashpërsisë së kohës për një pjesë të madhe të shqiptarëve. Në përmbledhjen e artikujve



të titulluar *Stalinizmi shqiptar* gjenden disa analiza historike shkencore mbi modelin totalitar shqiptar, që mund të konsiderohen edhe si ndër përpjekjet e para shkencore për të analizuar modelin totalitar shqiptar. Me vlerë për këtë prezantim është edhe një

ndërsa e ëma Hatixhja ishte nga Shkodra. I ati ishte jurist dhe kishte studiuar në Stamboll. Arshiu kishte një vëlla dhe katër motra. Mësimet e para i mori në Kolegjin e Jezuitëve në Shkodër. Te jezuitët mori bazat e kulturës klasike, greqishten e vjetër e



“Ata më kyçën mua në burg për të më bërë të vuaj. Por unë nuk mbaj asnjë qëndrim kundër tyre... në fakt, u jam sinqerisht mirënjohës”

dokumentar realizuar në fillim të viteve '90 nga Radio Televizioni Shqiptar. I xhiruar në qytetin e Shkodrës, ku edhe kaloi rininë, dokumentari përshkruan disa prej momenteve më të rëndësishme të jetës së Pipës, të rrëfyera nga vetë ai.

Formimi akademik

Arshi Pipa lindi më 28 korrik të vitit 1920 në qytetin e Shkodrës. Babi i tij Mustafai ishte nga Libohova,

latinishten dhe për pasojë, kur shkoi në Gjimnazin Shtetëror të Shkodrës, kishte baza të forta për të dalë i pari në dy gjuhët klasike, greqishten e vjetër dhe latinishten. Këto dy gjuhë e shoqëruan gjatë gjithë jetës. Përkthimet e bollshme, të lëna në dorëshkrim, e dëshmojnë më së miri këtë fakt.¹

Familja Pipa investoi shumë për formimin akademik të fëmijëve të saj, veçanërisht djemve.

¹Uran Kalakulla, *Arshi Pipa, Njeriu dhe Vepra* (Tiranë: Toena, 1999), f. 17.

Si Arshiu, ashtu edhe i vëllai i tij Myzaferi, ndoqën studimet e larta jashtë Shqipërisë. Myzaferi, që do të ishte gjithmonë modeli dhe pika e referencës për Arshiun, kreu studimet e larta për jurisprudencë në Padova të Italisë. Ndërsa Arshiu, pasi mbaroi Gjimnazin e Shkodrës në vitin 1938, u largua për të studiuar letërsi e filozofi në Universitetin e Firences në Itali. Aty do t'u përkushtohej plotësisht studimeve. Këtë gjë e vërteton më së mirë një bisedë mes Arshiut dhe shokut të tij që na e sjell si dëshmi Uran Kalakulla në librin e tij. Pasi shoku i tij Muhameti e fton të dalin në qytet për tu dëfryer, Arshiu i përgjigjet: "Muhamet, shok e mik të kam, por mos harro se na nuk kemi ardhë *këtu për ahengje e dafrungë, por për më* studjue. Dhe më parë se gjithshka asht detyra. E detyra jonë asht studimi e mbarimi i universitetit!"

Në bisedat mes autorit Uran Kalakulla dhe mikut të Arshiut, Muhametit, ky i fundit shprehet: "Më kot m'u lodhë për me tundë Arshiun prej studimit, kur ai kishte orarin për këtë punë. Nuk mbaj mend ndonjë herë që të ma ketë ba qejfin në këtë drejtim. E kur mendoj se sa kohë bjerrë kot i riu, them me vete se sa mirë e kishte ai. E shef, shok të ngushtë kemi qenë, por kush asht sot Arshi Pipa e kush jam unë! Mor mik, asgja s'arrihet pa mund e sakrificat! ... E kjo, megjithëse ai, ishte zgjedhë si duket prej fatit a Zotit me u ba ai që u ba!"²

Arshi Pipa dhe Lufta e Dytë Botërore

Pas përfundimit të studimeve, në vitin 1941 Pipa u kthye në Shqipërinë tanimë të pushtuar nga

Italia e Musolinit. Rezistenca që sapo kishte filluar të formësohej dhe reagimi i ashpër i pushtuesve italianë ndaj saj kishte prekur edhe familjen e Arshiut. Vëllai i tij Myzaferi ishte treguar aktiv në këtë rezistencë. Duke qenë student në Padova, ai kishte shfaqur kundërshtimin e tij për pushtimin e Shqipërisë nga Italia e Musolinit. Në bar-kafe *Peddrachi* mblihdeshin shpesh studentët shqiptarë. Në një nga këto takime Myzaferi kishte nxitur studentët të këndonin këngën e Thoma Nasit *Vlona, Vlona... Bjeri më ju lumtë dora*, kushtuar luftës së Vlorës. Për këtë arsye ai do të internohej në ishullin famëkeq Ventotene më 1940, ku gjendeshin edhe Safet Butka, Isuf Luzaj, Abas Ermenji, Lllazar Fundo, Fazlli Frashëri, Alteiro Spinelli, Petro Marko, Sadik Bekteshi etj., që u bënë të famshëm në jetën politike shqiptare dhe italiane.³ Edhe pse Myzaferi u shpreh hapur ndaj pushtimit italian, madje u internua për këtë gjë, kjo nuk do ta shpëtonte këtë nga regjimi që do të instalohet në Shqipërinë e pas Luftë së Dytë Botërore.

Në këto momente të vështira për familjen e tij, Arshiu zgjodhi të rrinte i tërhequr dhe të ndërtonte profilin e tij si intelektual. Deri në vitin 1942 ai punoi si mësues në Gjimnazin e Tiranës. Gjatë këtij viti nisi të përgatisë edhe tezën e tij të diplomimit dhe zgjodhi të trajtojë filozofin frëng, Henri Bergson. Në këtë temë shpreh mendimet e tij kritike ndaj filozofit frëng, duke sjellë një punim krejtësisht të tijin dhe pa ndihmën e askujt, madje as të profesorëve në Universitetin e Firences, për shkak të largësisë midis Shqipërisë dhe Italisë. Pasi u diplomua, do të bënte kërkesë pranë Ministrisë së Arsimit për

² Uran Kalakulla, *Arshi Pipa, Njeriu dhe Vepra* (Tiranë: Toena, 1999), f. 24-25.

³ <https://www.shkodradaily.com/2015/04/myzafer-pipa.html>.

t'u transferuar pranë familjes së tij në Shkodër. Në vitet 1942-1943 Pipa ishte profesor i letërsisë në Gjimnazin e Shkodrës. Nuk do të kalonte shumë kohë dhe familja Pipa do të vendosej përfundimisht në Tiranë. Arsytet e vendosjes mund të jenë të shumta dhe kjo shpjegohet me faktin se Tirana kishte marrë një zhvillim të madh arsimor, kulturor dhe urban. Si e tillë, edhe Arshiut, por edhe vëllait të tij Myzaferit, i interesonte të ishin sa më afër dijes, bibliotekave, grupeve intelektuale etj.

Në mars të vitit 1944 Arshi Pipa u bë themelues i revistës *Kritika*, që u botua në katër numra, nga marsi deri në qershor të vitit 1944. Synimi i kësaj reviste ishte nxitja e kritikës letrare në Shqipëri dhe përpjeka që lexuesit shqiptarë të njiheshin me letërsinë e huaj. Ai kishte si synim që ta shndërronte atë në një organ të mirëfilltë kritik, sidomos duke u përpjekur të përvijojë kahet e një kritike të tekstit si të tillë, gjë që është përmbushur më së miri në të gjithë numrat e revistës.⁴ Për realizimin e kësaj reviste Arshiu ishte konsultuar edhe me Aleks Budën, i cili në atë kohë ishte profesor në Gjimnazin e Tiranës dhe jepte lëndën e letërsisë. Në një letër që Arshi Pipa i dërgon Aleks Budës dhe që ruhet në Arkivin e Familjes Buda, Pipa kërkon mendime prej tij lidhur me revistën. Letra mban datën 23 mars 1944, gjë që tregon se është shkruar sapo ka dalë numri i parë i revistës. Në këtë letër Pipa i drejtohet Budës duke i kërkuar që ta vlerësonte vetë se çfarë ishte trajtuar në revistën *Kritika* dhe t'i jepte mendimet e tij. Ai vazhdon: "Gjithsesi, nuk besoj t'ia kem dalë plotësisht, por

që mendoj se numri i dytë do të jetë më i pasur dhe i ndryshëm." Nga letra kuptojmë që Pipa dhe Buda njiheshin me njërit-tjetrin, ndoshta si kolegë në mësimdhënie apo edhe si intelektualë të kohës. Nga letra rezulton se do të ketë pasur njohje dhe disa takime më përpara, ku të dy kanë biseduar në lidhje me revistën. Në letër Pipa i kërkon Budës të angazhohej më shumë duke i thënë se prej tij priste më shumë ndihmë se nga kolegët e tjerë.⁵ Nga kjo letër dëshmohet miqësia e dy intelektualëve të shquar të Shqipërisë, fatet e jetës së të cilëve do të ishin krejt të ndryshme. Vlerat e revistës *Kritika*, ndonëse me veç katër numra të botuar, janë evidentuar shpesh prej studiuesve letrarë si mjaft serioze. Nëse "historia" dhe jeta për Arshi Pipën do të kishte marrë rrugë tjetër, sot do të mund të flisnim për një kritikë letrare tepër të zhvilluar në Shqipëri.

Gjatë luftës Pipa nuk u angazhua në Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Ky fakt mund të ketë pasur arsye të ndryshme, por më thelbësorja duhet të ketë qenë kundërshtia që kishte Pipa ndaj modelit totalitar të majtë. Siç shprehet ai në intervistë: "Jam rritur në një familje që mund të konsiderohet demokratike, me urrejtje për diktaturën, e çfarëdo tipi qoftë ajo."⁶ Ai më tej tregon në këtë intervistë se kishte lexuar edhe literaturë marksiste, si Marksini, Leninin, Gramshin dhe kishte kuptuar problemet që kishte vetë doktrina dhe versionet e ndryshme të saj. Duke pasur të bënte rregullisht në leximet e tij me kolosë të filozofisë, si Spinoza e Kanti, ideologët marksistë dukeshin si të papërfillshëm. Kur filloi

⁴ <https://www.shqiperia.com/Letersia-e-perkthyer-ne-shqip-dhe-revista-Kritika-e-Arshi-Pipes.26923/>.

⁵ Arkivi i Familjes Buda, Letër drejtuar Aleks Budës nga Arshi Pipa.

⁶ <https://www.youtube.com/watch?v=mmBn3XnRcTA>, Arshi Pipa, Dokumentar nga TVSH i viteve '90.

lëvizja kundër pushtuesit, ai dhe i vëllai nuk morën pjesë në të, sepse nuk u pëlqente formati stalinist.⁷ Vëllezërit Pipa e dinin se kishte shumë modele dhe rryma të komunizmit e jo vetëm stalinizëm, si ai që po përpiqej të imponohej nga komunistët shqiptarë. Në pikëpamje doktrinare ajo që po aplikohej në Shqipëri ishte thjesht stalinizëm. Ndonëse u ishte propozuar disa herë të bëheshim pjesë të lëvizjes, vëllezërit Pipa nuk pranuan, ndonëse ishin edhe kundër fashizmit.⁸

Një fakt tjetër mbi jetën gjatë luftës është edhe përfshirja e Pipës në Institutin e Studimeve, i krijuar nga italianët. Në periudhën e pushtimit gjerman Instituti u riorganizua dhe u quajt Instituti për Studime e Arte, me zgjerimin e fushave të kërkimit e të numrit të studiuesve, tanimë vetëm shqiptarë, të ndarë në tri degë: gjuhësi, arte dhe shkencë natyrore e teknike. Në këtë institucion, veç Arshi Pipës, u përfshinë edhe intelektualë të tjerë të njohur të kohës, si: Ali Asllani, Hamdi Sulçebe, Hasan Dosti, Krist Maloki, Kristo Floqi, Ndoc Nikaj, Mid'hat Frashëri, Odhise Paskali, Spiro Konda, Vasfi Samimi, Vedat Kokona etj.⁹ Edhe ky fakt mund të ketë qenë një arsye pse nuk shihej me sy të mirë prej komunistëve.

Vendosja e regjimit komunist dhe dënimi i parë i Arshi Pipës

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri Partia Komuniste Shqiptare u kthye në të vetmen forcë politike reale. Sfida e udhëheqjes së saj ishte vendosja e kontrollit të plotë mbi të gjithë vendin dhe jetën e tij. Ata do të ndërmerrnin disa

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

⁹ <http://akad.gov.al/ash/rreth-ash/historiku>.

**Pipa betohet të gjejë
forcë për të pranuar
vdekjen e vëllait të tij
dhe shkruan një elegji
për të në burg**



Arshi Pipa me familjen e tij

Pipa profesor në universitet

hapa për të arritur qëllimet e tyre, si goditjen e kundërshtarëve potencialë të tyre, që në të vërtetë ishin shtresat e mesme dhe të larta të shoqërisë shqiptare, që ishin natyrshëm më të mirarsimuar. Nën emërtimin si bashkëpunëtorë të fashizmit dhe

armiq të popullit, atyre iu hoq e drejta të merrnin pjesë në jetën politike, iu konfiskua pasuria dhe u lanë pa asnjë lloj mbështetjeje.¹⁰ Ndër gjyqet e para më të bujshme ishin ato kundër opozitës, të njohura edhe si Gjyqi i Deputetëve, ku u goditën drejtpërsëdrejti disa përfaqësues politikë të elitës intelektuale që shpresonin dhe kërkonin vendosjen e një sistemi demokratik.

Ndonëse nuk kishte lidhje të drejtpërdrejtë me grupin e deputetëve, Pipa u bë padashur pjesë e këtij grupi, që u akuzuan si kundërshtarë të regjimit. Si një intelektual me pikëpamje demokratike, ai nuk mund ta duronte regjimin e ri që po instalohet në Shqipëri. Pipa e kishte demonstruar kundërshtimin e tij ndaj vendosjes së një regjimi diktatorial në shumë mënyra. Në librin e tij *Letërsia Bashkëkohore Shqiptare të botuar në anglisht në Nju-Jork në vitin 1991*, Arshiu shkruan për “përplasjet” me regjimin dhe shkaqet që atë e çuan në burg për herë të parë: “Diskutimi im në mbledhjen me Totozanin u bë shkak të më ulnin në detyrë, duke më transferuar në Liceun e Durrësit. Ligjërata ime për Migjenin u komentua si një akt rebelimi. Menjëherë pas kësaj në një mbledhje poetike në Shtëpinë e Kulturës në Tiranë deklamova një lirikë të përkthyer nga Fausti, *Këngën e Plebishtit*, që përmbante vargjet: ‘Dhe në çast u bë Ministër/ Dhe kishte një yll të madh.’ Totozani do të jetë tërbuar, më tha një mik. Në një mbrëmje tjetër poetike, kësaj radhe në Durrës, recitova lirikën *Bushtra*, që bën fjalë për ngordhjen e një qeni të zgjebosur. Vetëm më vonë, gjatë kohës që torturohesha në zyrat e Sigurimit,

mësova se bushtra qenkësh BS dhe këlyshët e saj Demokracitë Popullore.”¹¹

Kishte disa kohë që Arshiu e përndiqte një student i tij në Durrës, duke e pyetur vazhdimisht nëse lexonte literaturë sovjetike e nëse pëlqente Majakovskin. Arshiu i përgjigjej se nuk e pëlqente Majakovskin. “Por Stalini ka thënë që ai është poeti më i madh sovjetik”, - ia priste studenti. “Ai mund të jetë poeti më i madh, por jo sepse e thotë Stalini. Ai nuk është kritik letrar”, - i përgjigjej Arshiu.¹² Po në librin e lartpërmendur, Arshiu shkruan edhe për një ndodhi që mbase i vulosi vajtjen në burg. Gjatë një mbrëmjeje poetike në Tiranë, tek po dëgjonte pa ndonjë emocion recitimet e zakonshme plot patetizëm mbi heroizmat revolucionarë, në skenë del një djalosh që pas afro 5 minutash recitim nuk kishte arritur akoma të prekte temën e poezisë, që fliste për ndërtimin e një fabrike. Një djalosh që qëndronte në të djathtën e tij, foli me ironi: “Do ta ndërtojmë me slogane!” Pipa buzëqeshi në shenjë aprovimi. “Ngaqë vjersha ishte e mërzitshme dhe banale, atij i duhej të stërmundohej. Djaloshi vazhdonte përsëri të thumbonte dhe unë përgjigjesha. Kështu padashur u bëmë pjesë e një dialogu parodizues buzëqeshjesh dhe ironish. Në fund u përshëndetëm me njëri-tjetrin, por nuk u prezantuam. Kur po largoheshim, - vazhdon përsëri Arshiu, - një miku im më pyet: Kaq mirë njihesh me Nako Spiron?”¹³

Këto elemente që kujton Pipa, por, mbi të gjitha, qëndrimi i vëllait të tij ndaj regjimit të ri, do të ishin arsyet kryesore të arrestimit të tij. Arshi Pipa ishte

¹⁰ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-1920* (Tiranë: Albas, 2014), f. 227-228.

¹¹ Arshi Pipa, *Contemporary Albanian Literature* (New York: 1991), p. 20.

¹² Arshi Pipa, *Contemporary Albanian Literature*, p. 20.

¹³ Po aty.

27 vjeç kur për të doli një urdhër arresti. Urdhri ishte lëshuar nga Prokuroria Publike e qytetit të Durrësit. Ai akuzohej për veprimtari kundërshtuese të kryer me grupe tradhtare dhe si pasojë, urdhërohej ndalimi i tij i menjëhershëm dhe burgosja në burgun e “armiqve të popullit”.¹⁴ Pas këtij urdhri do të fillonte kalvari i vuajtjeve për Arshiun e ri. Më 1946 do të dënohej prej Gjykatës së Garnizonit të Tiranës me dy vjet burg në burgun e Durrësit për veprimtari kundër pushtetit.¹⁵ Akuzat u formuluan me shpejtësi dhe pa asnjë provë konkrete. Pra, ishte një arrestim e dënim arbitrar. Vetë autoritetet e pranojnë këtë fakt nëpërmjet dokumenteve të gjyqit. Gjatë qëndrimit në burgun e Durrësit do të fillohej të “hetohej” dhe të bëhej një pasqyrë e gjithë veprimtarisë së tij, që Arshiu do t’i kundërshtonte hapur. Në një dokument që mban datën 5 dhjetor 1947 thuhet se Arshi Pipa, i dënuar më 23 nëntor 1946 me dy vjet burg, ka marrë një dënim minimal, sepse në dosjen e tij hetimore nuk ka pasur prova dhe fakte të thelluara për të provuar veprimtarinë e tij antikombëtare. Kjo dhe për shkak se akoma nuk ishte zbuluar thellësisht organizata tradhtare-sabotore e deputetëve.¹⁶ Gjatë formulimit të dosjes

kundër tij përmendet edhe i vëllai, Myzaferi, si tradhtar dhe “armik i popullit”.¹⁷

Arshi Pipa edhe një herë përballë shtetit të diktaturës së proletariatit: dënimi i dytë

Procesi i dytë ndaj tij u zhvillua gjatë vitit 1947, ndërsa vendimi u mor më 24 dhjetor 1947. Ai, së bashku me tre të akuzuar të tjerë, që ishin Pashko Gjeçi, Hysen Ballhysa dhe Preng Kaçinari, u shpallën fajtorë, sepse kishin qenë anëtarë të organizatës social-demokratike të kryesuar nga Gjergj Kokoshi dhe Suat Asllani. Gjithashtu, ata u akuzuan se kishin një lidhje me organizatën tekniko-intelektuale, me klerikët dhe me mbeturina të organizatave tradhtare, Balli Kombëtar dhe Legaliteti. Aktiviteti i të katër të pandehurve, sipas akuzës, ishte shtrirë në të gjithë elementët e pakënaqur nga Pushteti, duke propaganduar kundër reformave të Pushtetit Popullor, duke sabotuar në sektorët e punës së tyre, si p.sh në sektorin shkollor etj., gjithashtu duke propaganduar mbi një ndërhyrje të armatosur të forcave anglo-amerikane në çështjet e brendshme të Shqipërisë

¹⁴ AIDSSH (Arkivi i Autoritetit të Dosjeve), Arshi Pipa, f. 69.

¹⁵ Po aty, f. 64.

¹⁶ AIDSSH (Arkivi i Autoritetit të Dosjeve), Arshi Pipa, f. 11.

¹⁷ Myzafer Pipa është një nga avokatët mbrojtës në Gjyqin Special, i caktuar si i tillë. Mbi qëndrimin e tij në gjyq ka pasur një histori e cila ka qarkulluar duke u shndërruar në proverbiale. “Si asht e mundem zotnij, që një trup gjykues, i cili për kryetar ka një ish-“teneqexhi” – ishte fjala për Koçi Xoxen – e për prokuror një ish-“kafexhi” – për Bedri Spahiun – të mundet sot me gjykue elitën e kulturës Shqiptare?” Sipas dëshmisë së motrës së vogël të profesor Pipës, e cila kishte konsultuar dokumentet e arkivit të MPB, ngjarja kishte ndodhur pak më ndryshe. Myzafer Pipa, si një jurist me përvojë, kishte vënë në dukje disa parregullsi në administrimin e procesit dhe këto i kishte artikulluar. Prokurori i Gjyqit Special, Bedri Spahiu, me ironi i drejtohet juristit të shkolluar në Padova, duke i thënë se ky mund të mos ishte si proceset borgjeze që ishte mësuar avokati, por kjo ishte drejtësia e popullit. Reagimi i tij ndaj padrejtësive, si dhe marrja përsipër e mbrojtjes së priftërinjve katolikë në gjyqin e së ashtuquajturës organizata e Bashkimit Shqiptar, e vunë Myzaferin në “listën e zezë” të Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit. Pas kryengritjes së dështuar të Postribës, Myzaferi u arrestua në shtator të vitit 1946 dhe u torturua pa mëshirë, duke humbur jetën në tortura. Për të mbuluar krimin, atë e hodhën nga dritaret e ndërtesës ku zhvilloheshin hetimet në Shkodër dhe vdekjen e mbuluan me tentativë ar-ratisjeje. Tre vjet më vonë, gjatë zhvillimit të gjyqit të Koçi Xoxes, i njëjti prokuror, Bedri Spahiu, do ta sillte në vëmendje vdekjen në tortura të Myzafer Pipës, këtë radhë për të provuar fajësinë e ish-kolegut të tij në krimet e kryera nga Sigurimi i Shtetit gjatë viteve 1945-1948. Arshiu e mori vesh vdekjen e të vëllait gjatë hetuesisë së tij të dytë, pra disa muaj pasi ajo kishte ndodhur. Motrat nuk kishin mundur t’ia thoshin, sepse ato e dinin shumë mirë dashurinë që ai kishte për të vëllanë, por edhe ishin të vetëdijshme për shëndetin e dobët të Arshiut. Ishte hetuesi i tij që ia kishte njoftuar vdekjen e të vëllait, duke e kërcënuar se edhe ai do të përfundonte si i vëllai nëse nuk dëshmonte për çka i kërkohej.

dhe se në këtë mënyrë, e së bashku me kriminelët e arratisur, do të rrëzonin Pushtetin Popullor.¹⁸

Formulimi i akuzës ndaj Arshi Pipës vazhdon akoma më tej, duke e akuzuar se ai kishte drejtuar revista me ideologji fashiste për të mashtruar popullin dhe për të maskuar okupacionin e fashizmit në vendin tonë. Mbas çlirimit të Shqipërisë, duke qenë profesor në Liceun e Tiranës, ishte lidhur me grupin social-demokrat dhe zhvillonte një aktivitet të gjerë në favor të kësaj organizate. Ai e vazhdon aktivitetin e tij më studentë dhe elementë të pakënaqur duke predikuar mbi demokracitë perëndimore për të treguar se në vendin tonë nuk kishte liri demokratike dhe e konsideronte pushtetin si një pushtet terrorist. Sipas akuzës, aktiviteti i tij ishte provuar plotësisht nga atribuimet që i bëri Sulo Konjari në gjyqin e Tiranës, Selim Kokalari dhe Ramazan Tabaku, nga procesverbali i tij para hetuesisë dhe nga gjithë përmbajtja e dosjes. Për ta thelluar akoma më shumë akuzën ndaj Arshi Pipës, shkruhet se: “I pandehuri ka bërë mbledhje të rregullta me Preng Kaçinarin, Stavro Frashërin, Isa Podgoricën, Simon Dedën, Hysen Mallhysën, Sabri Ticin e Rifat Dervishin, dhe se këto mbledhje janë bërë në Liceun e Qytetit.”¹⁹ Për të mbështetur akuzën e ngritur, prokuroria mbështetej te dëshmia para gjyqit e të dënuarit Sulo Konjari, i cili shprehej se: “Arshi Pipa ka bërë pjesë në grupin e social-demokratëve dhe ka qenë elementi më aktiv i këtij grupi me Isa Podgoricën, Hysen Bellhysën dhe

Skënder Çelën.”²⁰ Të njëjtat deklarime bënin edhe dy të dënuarit, Salim Kokalari dhe Skënder Çela.²¹

Arshi Pipa mbajti një qëndrim dinjitoz dhe u përpoq të mbrohej, pasi nuk i pranonte këto akuza. Madje, ai tha që as nuk ka qenë në dijeni të një organizate të tillë.²² Ai shprehej se deklaratimet e Salim Kokalarit, Sulo Konjarit e Ramazan Tabakut janë të pavërteta dhe se nuk kishte qenë pjesë e asnjë organizate. Ai vazhdon akoma më tej kur thotë që “duke qenë se pakënaqësitë e mia ndaj pushtetit popullor unë i kam shprehur dhe janë të njohura, i ka bërë ata që kanë deklaruar kundër meje të më hedhin edhe mua në faj, ashtu siç mund të kenë hedhur edhe të tjerë”.²³

Me Sulo Konjarin dhe Salim Kokalarin nuk kishte pasur ndonjë miqësi dhe as nuk i njihje. “Sulo Konjari, - thoshte ai, - mund të thotë shumë gjëra, por unë kërkoj të ballafaqohem”. Ndërsa me Hysen Podgoricën kishte njohje, kjo për faktin se të dy ishin profesorë. Në deklaratimet e tij, Arshi Pipa shprehej se me Hysen Podgoricën kishte pasur kontakte dhe biseda. Kishte biseduar për çështje letrare dhe jo për çështje politike, sepse për këtë të fundit nuk kishte kohë të merrej. Kohën e kishte vetëm për studime! Ndërsa me Hysen Bellhysën njihje, por nuk kishte kontakte miqësie. Ishte takuar disa herë, por asnjëherë nuk e kishte vizituar në shtëpi. Ndërsa Skënder Çelën nuk e njihje, por shprehej se ky i fundit mund ta kishte dëgjuar

¹⁸ AIDSSH (Arkivi i Autoritetit të Dosjeve), Arshi Pipa, f. 5-6.

¹⁹ AIDSSH (Arkivi i Autoritetit të Dosjeve), Arshi Pipa, f. 6-7.

²⁰ Po aty, f. 11.

²¹ Po aty, f. 11.

²² Po aty, f. 25.

²³ Po aty.

emrin e tij ngaqë ishte profesor.²⁴ Për sa i përket deklarimit të Hysen Bellhysës, ai e përmend Arshi Pipën, por shprehet se e njihje thjesht si person dhe se nuk ishte e vërtetë që të kishte biseduar ndonjëherë me të për Partinë Social-Demokrate.²⁵

Në një akuzë tjetër thuhej se i pandehuri Arshi Pipa mbledhte studentët në shtëpinë e tij për t'u bërë propagandë kundër pushtetit popullor, u fliste për Partinë Social-Demokrate dhe kundër udhëheqësve. Akuza faktohej nga deklaratimet e disa studentëve, si Alfred Kazanxhiu, Thomas Goxhaj dhe Sotiraq Manushi, të cilët u shprehën se Arshi Pipa u fliste për parimet e Partisë Social-Demokrate. Në deklaratën e Sotiraq Manushit thuhej se Arshi Pipa kishte folur keq edhe për pushtetin popullor, duke thënë se pushteti shqiptar është shtypës, se reformat që bënë këta po shkatërrojnë vendin dhe po varfërojnë mbarë popullin. Gjithashtu, ata që janë vendosur në krye janë njerëz të paftë.²⁶ Studenti Thomas Goxhaj shprehet se Arshi Pipa kishte folur edhe për Bashkimin Sovjetik, duke thënë se është vendi ku shkelen më shumë të drejtat e njeriut. Deklarimi i Thomas Goxhaj është i njëjtë me atë të Sotiraq Manushit, sepse edhe ky flet për varfërinë që ka kapur popullin, drejtuesit e paftë etj.²⁷ Për sa u përket deklaratimeve të studentëve, Arshi Pipa thotë: “Unë këtyre u jepja mësim privat dhe ata nuk i kanë kuptuar mirë fjalët e mia. Ata nuk kishin ndonjë simpati ndaj meje, por unë jepja mësim që të më paguanin, ndërsa ata kishin interes që të mësonin.”

²⁴ AIDSSH (Arkivi i Autoritetit të Dosjeve), Arshi Pipa, f. 13-14.

²⁵ Po aty, f. 15.

²⁶ Po aty, f. 36.

²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty, f. 38.

²⁹ Po aty, f. 65.

³⁰ Arshi Pipa, *Libri i burgut* (Tiranë: Euroindja, 1994), f. 200.

Pas seancave gjyqësore, ku u morën në pyetje shumë, duke u bazuar në të gjitha këto dëshmi, për Arshi Pipën kërkohet dënim maksimal, si një njeri që kishte qenë pjesë e grupit social-demokrat dhe që kishte propaganduar kundër pushtetit.²⁸ Kështu, më 20 dhjetor 1947 Arshi Pipa do të dënohej rishtazi nga Gjykata me 20 vjet burg dhe për të do të riniste kalvari i vuajtjeve e mundimeve. Përveç kushteve të këqija të burgut, atë e mundonte edhe sëmundja e tij për të cilën shprehet se vuan nga një inflacion në mushkëri.²⁹ Ky proces i ashpër dhe i padrejtë ndaj Pipës ishte një tregues i qartë i dhunës tipike staliniste në sistemin gjyqësor, një drejtësi e paprincipitë, pasi bazohet te nënshtrimi me anë të eliminimit, torturave e dhunës psikologjike ndaj kundërshtarëve më të ekspozuar.

Jeta në burgjet e diktaturës

Në gjyqin e parë u dënua me dy vjet burg dhe fillimisht u dërgua në burgun e Durrësit. Pas qëndrimit në burgun e Durrësit dhe dënimit të dytë, ai së bashku me një grup të burgosurish u dërguan në kampin e Vloçishtit, në korrik të vitit 1948. Pjesa më e madhe e të burgosurve aty kishin shkuar tre muaj para tij, siç shkruan Arshiu; nuk i njihje dot si ishin bërë prej urisë dhe mundimeve të mëdha.³⁰ Në kampin e Vloçishtit, Arshiu u sëmur dhe qëndroi disa kohë në spitalin e Korçës. Në atë kohë në kampin e Vloçishtit kishte rreth 1300-1600 veta, sipas periudhave që grumbulloheshin, dhe flinin

nëpër tri baraka të mbuluara me mushama që në shumë vende ishte e shpuar. Të burgosurit flinin në një krevat me tri dërrasa dhe sapo hyje brenda në barakë qelbeshe erë. Nuk kishin mundësi të laheshin dhe të pastroheshin. Uji mund të sigurohej vetëm prej disa puseve. Ndërsa ujë të pijshëm kishte fare pak në hyrje të kampit. Nëpër baraka qëndronin të gjithë bashkë, të dënuar politike dhe “ordinerë”. Rastet e vjedhjeve ishin të shumta. Shpeshherë këta ordinerë nxiteshin nga rojat të vidhnin të dënuarit politikë apo intelektualë të tjerë. Në rast se ankohehe, faji nuk u ngelej vjedhësve, por personit që ankohej. Rojat kishin një mentalitet, i cili ishte: “Politikanët janë përfaqësues të klasës kapitaliste-borgjeze, kurse ordinerët janë proletarë, dhe si të tillë kanë të drejtë të plaçkitin të parët.”³¹ Ushqimi në kamp ishte shumë i paktë dhe njerëzit ishin të uritur. Kishte raste kur të burgosurit shkonin për të punuar në distanca të largëta nga kampi dhe gjatë rrugës shikonin parcela toke të mbjella më misër ose panxhar. Ata ishin aq të uritur, saqë ndonjëri prej tyre hidhej me shpejtësi për të marrë diçka nga të mbjellat dhe nuk e lëshonte, edhe pse rojat e godisnin me shkelma ose dru kokës. Burgu ishte më i ashpër për të dënuarit politikë sesa për fshatarët. Fshatarët e thjeshtë shikoheshin më me pak përçmim. Kishte raste kur të dënuarit politikë visheshin si fshatarët e thjeshtë vetëm për t’i shpëtuar dhunës.³² Punët që të burgosurit bënin, ishin hapja e kanaleve të mëdha ku gjatësia shkonte me kilometra, gjerësia 10 m dhe lartësia 3 metra. Kur ktheheshin nga puna, ata kishin rrugë

të gjatë për të bërë. Të lodhur e të raskapitur, ata torturoheshin edhe nga rojat rrugës. U ënjtreshin këmbët nga puna e rëndë, lodhja dhe kushtet e këqija. Mungesa e çizmeve, këpucëve, ecja këmbëzbathur dhe punët e mundimshme bënë që shumë të burgosur të vdisnin para kohe në kushte çnjerëzore. Për kampi i Vloçishtit, Arshi Pipa shprehet se qe si një kamp shfarosjeje!³³

Në vitin 1949, pas Kongresit të Parë të PKSH, dënimit të Koçi Xoxes dhe orientimit krejtësisht në Bashkimin Sovjetik, Enver Hoxha bëri një amnisti ku përfitoi edhe Arshiu, sepse iu ulën 10 vjet dënim. Vitet e mbetura të dënimit ai i bëri në burgje të ndryshme.³⁴ Pas qëndrimit në kampin e Vloçishtit, Arshiu u shtrua në spitalin e burgut të Durrësit deri në janar të vitit 1950. Më vonë e dërguan në burgun e Gjirokastrës, deri në qershor të vitit 1952. Pastaj transferohet në burgun e Tiranës dhe shtrohet në spitalin e burgut përsëri. Pas disa kohësh e dërgojnë në burgun e Burrelit, deri në prill të vitit 1956, ku edhe do të mbarojë dënimin e tij.³⁵ Arshiu do të lëvizte nga një kamp në tjetrin dhe kështu nuk mundi t’i shpëtonte as burgut famëkeq të Burrelit. Në këtë burg gjetën vdekjen qindra të burgosur. Disa nga sëmundjet e disa nga torturat e mëdha, nga uria etj. Në nga problemet më të mëdha të të burgosurve në burgun e Burrelit ishte çështja e ujit. Gjatë kohës që Arshiu qëndroi në këtë burg, ai thotë se uji merrej në një pus diku mes oborrit, por që nuk kishte as grykë. Për ta vështirësuar akoma më shumë punën, të burgosurve nuk u ishte dhënë

³¹ Po aty, f. 201.

³² Po aty.

³³ Arshi Pipa, *Libri i burgut*, f. 204.

³⁴ Kalakulla, *Arshi Pipa, Njeriu dhe Vepra* (Tiranë: Toena, 1999), f. 87.

³⁵ Po aty, f. 88.

asnjë mjet lehtësues për ta nxjerrë ujin. Madje, as një kovë apo litar. Për nxjerrjen e ujit përdorëshin mjete rrethore. Për të mos mjaftuar kjo, uji i pusit ishte shumë i ndotur dhe po kthehej në sëmundje për të gjithë. Mjaft njerëz kishin gjetur vdekjen nga ky ujë i ndotur. Shpeshherë në ujin që të burgosurit nxirrnin kishte krimba.³⁶ Arshiu kishte një fizik të dobët dhe ishte i sëmurë, kështu që dalja gjallë nga kampi i Burrelit ishte veçse fat për të.

Ndër veprat më të mira të Pipës, *Libri i burgut* është një dokument autentik i vuajtjeve nëpër burgjet dhe kampet e internimit të Shqipërisë komuniste, duke e sjellë nëpërmjet vargjeve poetike. Ky libër, siç do të shprehet edhe vetë autori, u shkrua gjatë periudhës së burgimit (1946-1956), por nuk u shkrua në ndonjë bllok shënimesh apo në ndonjë fletë letre të pastër dhe pa frikën e ndokujt. Libri u nxor fizikisht nga burgu i shkruar nëpër letra cigaresh. Do të rishkruhej përsëri nëpër letra cigareje para se Arshiu të arratisesh nga atdheu së bashku me motrën e tij, Fehime Pipa. E motra do t'i qepte këto fletë nëpër rrobat e saj. Pasi të kalonin kufirin, të arratiseshin edhe nga autoritetet jugosllave gjatë periudhës shtator-nëntor 1957, ata do të arrinin në Sarajevë. Gjatë qëndrimit në Sarajevë do t'i rendisnin fletët e librit të shkruar në letër cigareje dhe më vonë do të përgatiteshin në Detroit dhe do të botoheshin në Romë në vitin 1959.³⁷ *Libri i burgut* na njez edhe me jetën e vetë autorit, rininë e tij, por gjithashtu na sjell vuajtjet dhe torturat që pësonte një grup njerëzish nga më të diturit e Shqipërisë së asaj kohe. Një grup

njerëzish që kishte mundësi të kontribuonte në zhvillimin e Shqipërisë. Është ky grup njerëzish që i ishte mohuar e drejta e të qenit njeri.

Pas daljes nga burgu më 26 prill 1956, Arshiu do të qëndronte disa kohë të shijonte jetën përtej vuajtjeve dhe terrorit të kampeve të internimit. Jashtë do ta prisnin motrat dhe e ëma. Edhe pse u duk që vuajtjet mbaruan, kjo nuk ishte e vërtetë. Për ish-të burgosurit ishte shumë e vështirë të gjejë një punë. Të vetmet punë që mund të të caktoheshin ishin ato më të rëndomtat dhe të vështirat fizike, që për Arshiun ishte shumë e vështirë. Puna që ai dinte të bënte më mirë ishte ajo e penës.

Pas shumë mundimesh, caktohet mësues në një shkollë shtatëvjeçare në Shkodër, por kjo punë nuk e kënaqte atë. Ai ishte mësuar me nxënës të një niveli më të lartë, të merrej me kritikë etj. Kështu që Pipa kërkoi të shkëputet nga puna në arsim që i ishte ofruar me pretekstin se ishte i sëmurë.³⁸ Pas zhvillimeve politike në Shqipërinë e vitit 1956, ku u forcua më shumë rruga e stalinizmit, Arshiu filloi të mendojë arratisjen. Bazuar më së shumti në dorëshkrimet e Fehime Pipës, motrës së Arshiut, të mbledhura dhe të botuara nga Uran Kalakulla në librin e tij, Arshiu vendosi të arratiset së bashku me të motrën, Fehimen, i ndihmuar nga një fshatar që kishte shtëpinë pranë kufirit. Atij iu desh ta kalonte lumin e Bunës me not, ku matanë bregut e priste e motra. Më pas arritën pranë fshatit Muriqan dhe arritën të kalonin kufirin. Pasi kaluan kufirin, ata u paraqitën pranë postës jugosllave, ku qëndruan disa kohë në hetuesi në Tivar. Pasi

³⁶ Pipa, *Libri i burgut* (Tiranë: Eurolindja, 1994), f. 207-208.

³⁷ Pipa, *Libri i burgut* (Tiranë: Eurolindja, 1994), f. 240.

³⁸ Kalakulla, *Arshi Pipa, Njeriu dhe Vepra*, f. 111.

u liruan, shkuan në Sarajevë, ku ndodhej edhe i fejuari i Fehimes me familjen e tij.³⁹ Por qëndrimin atje nuk do të ishte i gjatë dhe ai do të largohet për në Romë, ku synimi ishte Amerika. Për vajtjen në Amerikë do ta ndihmonin dy kushërinjtë e tij, duke i sjellë një garanci. Atje do të fillojë të mësojë edhe gjuhën angleze. Pas shumë peripecish, do të fillojë të ngjisë shkallët e karrierës në universitet. Atë që shteti shqiptar ia mohoi, e gjeti në një vend tjetër. Si fillim do të jepte lëndën e filozofisë dhe filozofinë e fesë së krishterë. Për sa i përket fesë, nuk kishte njohuritë e duhura. Madje, në një dokumentar të TVSH në vitet '90, Arshiu shprehet se njohuritë e tij për sa i përket fesë ishin të pakta, vetëm disa gjëra që mbante mend nga Kolegji i Jezuitëve. Arshiu u bë një pedagog mysliman që jepte filozofi të krishterë.⁴⁰

Përfundime

Arshi Pipa ishte një intelektual i rrallë dhe si i tillë, kontributi që ai dha, por edhe do të mund të jepte në arsimimin e vendit, ishte i vyer. I rritur në një familje arsim-e-kulturëdashëse, i pajisur me një arsimim solid dhe të plotë, i edukuar me parimet bazë të demokracisë, ai kishte potencialin e nevojshëm për të qenë një nga intelektualët më në zë të kohës. Përfshirja e tij në jetën intelektuale të kryeqytetit që në moshë të re dhe dëshira e tij për të kontribuar në kulturën shqiptare janë një dëshmi e qartë e aftësive të tij.

³⁹ Po aty, f. 113.

⁴⁰ <https://www.youtube.com/watch?v=mmBn3XnRcTA>.

⁴¹ Pipa, Arshi. *Stalinizmi shqiptar*, (Tiranë: IKK & Princi 2007), 40

Arshi Pipa ishte një armik *sui generis* i diktaturës dhe si i tillë, ishte në thelb antifashist i lindur. Nëse ai nuk u përfshi në lëvizjen nacionalçlirimtare të drejtuar nga PKSH, ndodhi sepse nuk e pëlqente ideologjinë komuniste që i vishej lëvizjes çlirimtare.

Burgosja e tij pas luftës, së bashku me shumë intelektualë të tjerë, ishte një humbje e madhe për vendin. Njerëz të një kalibri të tillë, të cilët nuk e pranuan sistemin që po instalohesh në Shqipëri, u dënuan ashpër duke përfunduar nëpër kampet famëkeqe, ku një pjesë e tyre gjetën edhe vdekjen. Por përsëri ishin njerëz si Arshi Pipa që, edhe pse prapa hekurave, nuk u dorëzuan. Çdokush nga ata u mundua që ta luftojë komunizmin me armën më të mirë që zotëronte. Arma më e mirë e Arshi Pipës ishte pena. Ai në fshehtësi të plotë vazhdoi të shkruajë, jo letra, por një libër të plotë si *Libri i burgut*. Me *Librin e burgut* ai na solli të gjithëve ne jo vetëm një vepër letrare, por një dokumentim të të gjithë asaj çfarë ndodhte në kampet e internimit të Shqipërisë, për mënyrën se si trajtohej elita intelektuale e vendit etj. Rasti i profesor Arshi Pipës është rasti tipik i intelektualit që, siç thotë vetë Pipa, i kanë treguar komunizmit një fytyrë të ftohtë, duke i provokuar deri në tërbim.⁴¹ Shumë prej tyre humbën jetën ose e kaluan atë burgjeve. Duke qenë se Shqipëria ishte një komb i vogël, historia e zhdukjes së tyre është një nga anët më të shëmtuara të regjimit.

BIBLIOGRAFIA

BURIME ARKIVORE

AIDSSH (Arkivi i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit).

Fondi Arshi Pipa.

Arkivi i Familjes Buda.

LITERATURA

Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000* (Tiranë: Albas, 2014).

Uran Kalakulla, *Arshi Pipa njeriu dhe vepra* (Tiranë: Toena, 1999).

Arshi Pipa, *Contemporary Albanian Literature* (New York: 1991).

Arshi Pipa, *Libri i Burgut* (Tiranë: Euroindja, 1994).

Arshi Pipa, *Stalinizmi shqiptar* (Tiranë: IKK & Princi, 2007).

BURIME NGA INTERNETI

<https://www.shkodradaily.com/2015/04/myzafer-pipa.html>.

<https://www.shqiperia.com/Letersia-e-perkthyer-ne-shqip-dhe-revista-Kritika-e-Arshi-Pipes.26923/>.

<http://www.radiandradi.com/myzafer-pipa-dhe-koha-kur-ai-jetoi-e-vdiq-nga-ahmet-bushati/>.

<http://muzeuimemories.info/tepavdekshmit/>.

<https://www.shkodradaily.com/2014/12/elegjia-vllazerore.html>.

<http://27.al/libri-burgut-dhe-nje-poezi-nga-arshi-pipa/>.

<https://www.youtube.com/watch?v=mmBn3XnRcTA>.

<http://akad.gov.al/ash/rreth-ash/historiku>.

Dr. Andi Pinari

Aleks Buda, një dietar european në totalitarizmin shqiptar

Metodologjia

Ky prezantim i shkurtër do të përpiqet të pasqyrojë veprimtarinë shkencore dhe administrative, si dhe rrethanat në të cilat u ngrit dhe veprroi personaliteti i prof. Aleks Budës. Analiza do të përqendrohet në çështjet e lidhura me marrëdhëniet e këtij studiuesi, si pjesë e elitës intelektuale në vitet 1945-1954, me modelin totalitar shqiptar. Këto vite mund të konsiderohen si vitet më të ashpra të totalitarizmit shqiptar, sepse janë vitet e para të instalimit të një modeli të ri politik dhe shtetëror, që kishte si parim luftën e klasave dhe si mjet dhunën shtetërore. Veprimtaria e tij akademike e këtyre viteve mund të ndihmojë për të kuptuar deri në çfarë mase orientimi i hulumtimeve shkencore vinte nga tradita e Rilindjes Kombëtare dhe e periudhës mes dy luftërave, imponohej nga

lart apo varej nga studiuesi. Përfshirja në karrierën administrative duke mbajtur poste shtetërore ishte një tjetër veçori që tregon për pozicionin e dyfishtë si studiues dhe zyrtar shtetëror në disa pozicione të rëndësishme. Burimet kryesore që janë shfrytëzuar, janë dokumente të AQSH, si dhe dokumente origjinale, si letra apo shënime, që na janë vënë në dispozicion me shumë dashamirësi nga zonja Tatjana Haxhimihali, e bija e prof. Budës. Me shumë vlerë për këtë punim ka qenë edhe libri *Kujtime* dhe *Kujtime 2*, ku jepen të dhëna me vlerë për jetën dhe karrierën e tij. Po ashtu me mjaft interes është edhe përmbledhja e kumtesave të konferencës *Aleks Buda, një jetë për albanologjinë*, e organizuar nga Akademia e Shkencave me rastin e 100-vjetorit të lindjes së profesorit, e zhvilluar në vitin 2010 dhe e botuar në vitin 2012. Në këtë konferencë kanë



rreth dhe e shprehur
 Albas mendoja fothuj se uje mias
 se e... nuk e di...; jam; t...
 ... me qe jam ne kete kryeqend
 ... me munde pas dera hark
 ... te gjeri dera dokumente te calat
 ... me qe te gjetel e tpe ku ve
 ... te qat per kete fillim, e mpre se me
 ... me munde t... perder, jam : shprehur
 ... te fethem ne Shqiperi po te
 ... me mpre qe te tyra

Vrina me palqen shume
 ... te munde e uje qyteti te mende dhe qat
 ... te munde te e ng' qyteti te vogel. Kite
 ... qan Kurumushite te organizuar munde
 ... e bukuri profesori me cunet, dille
 ... qatun profesor, te formidua shume
 ... te te veqente per shprehur kal
 ... Ande t... se Vrina e... d...
 ... te... te shprehur t... munde
 ... munde e tpe qan shu
 ... me lichte zbra se nga buda velle
 ... shprehur shprehur e profesore te
 ... te...

... shprehur qe
 ... munde e tpe qan
 ... d... e shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me

... shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me
 ... d... te shprehur me

... me 5 X 40

marrë pjesë dhe kanë shprehur mendimet e tyre studiues të historisë dhe bashkëpunëtorët e tij që kanë pasur njohje personale me të.

Në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të vëna në dispozicion nga Autoriteti për Informimin me Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në emrin e tij nuk rezultoi asnjë dosje personale, ndonëse përmendet në dosjet e kolegëve të tij që ishin nën mbikëqyrje. Sidoqoftë, ky punim nuk mund të jetë shterues, sidomos lidhur me të dhënat nga materialet e panjohura arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, një fushë e gjerë kërkimi që kërkon kohë dhe ndoshta në vitet në vazhdim do të ketë edhe më tepër informacione nga këto dokumente të panjohura. Materiali është konceptuar në mënyre kronologjike dhe në disa raste edhe problemore, duke dashur të përshkruajë ecurinë e një studiuesi të një niveli të lartë në vitet e vështira të pasluftës, por duke e integruar me historinë e intelektualëve gjatë diktaturës.

Formimi akademik dhe politik

Aleks Buda lindi në familje të shtresës së mesme, të shkolluar dhe të pajisur me një formim intelektual të nivelit të lartë, duke pasur parasysh nivelin e shoqërisë shqiptare të kohës. I ati, Dhimitër (Taq) Buda, ishte diplomuar në Greqi si farmacist, me këmbënguljen e babait të tij që ishte doktor i diplomuar në Itali. Pasi përfundoi studimet në Selanik, Taq Buda ngriti një farmaci në qendër të qytetit, të cilën e drejtonte me profesionalizëm. Siç dëshmohet edhe nga një artikull i vitit 1913 të një gazetari austriak të quajtur Kraus, që citohet te

Kujtimet, gjatë vizitës në qytet i ra në sy një farmaci e pajisur në mënyrë moderne me barna që vinin nga Selaniku dhe Trieste.¹ Taq Buda ishte mjaft aktiv në jetën publike të vendit, ende nën pushtimin osman, duke ndihmuar Rilindjen Kombëtare drejt finalizimit të pavarësisë së Shqipërisë. Ai ishte pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit dhe

Prof. Buda arriti të përqendrohej gjithnjë e më tepër në çështjet e shkencës duke gjetur hapësirën e tij të lirisë së brendshme në atë kohë të vështirë. Ai e ka ditur mirë cilat ishin pasojat nëse rebelohej.

ndihmoi në zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe, si kontribuues me të holla në Normalen e Elbasanit. Ishte edhe një prej pjesëmarrësve aktivë në lëvizjen kombëtare si aktivist politik dhe një prej firmëtarëve të dokumentit të shpalljes së pavarësisë në qytetin e Elbasanit më 25 nëntor, qytet i cili e shpalli i pari pavarësinë. Kjo tregon, ndër të tjera, edhe peshën e

¹ Tatjana Haxhimihali, *Aleks Buda, Kujtime* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2005), f. 31.

madhe që mbajti elita e qytetit të Elbasanit në jetën politike të vendit, elitë e cila ishte mjaft e angazhuar dhe zotëronte të gjitha aftësitë për përfaqësim dinjitoz në nivel kombëtar. Më pas ai ishte deputet në dy legjislatura të parlamentit shqiptar në vitet 1921-1924.



I lindur në vitin 1910, Aleks Buda u ndikua së tepërmi në formimin e tij patriotik qoftë nga familja, qoftë edhe nga atmosfera e viteve '20-'30, ku mbizotëronte atdhedashuria e diktuar nga kushtet specifike të shtetit të ri, kur vendit i duhej medoemos të ngrinte dhe të forconte institucionet e tij.

²Haxhimihali, *Aleks Buda, Kujtime*, f. 73.

Taq Buda i dërgon fëmijët e tij në shkollë duke ndjekur shembullin e të atit dhe duke besuar se investimi më i mirë për ta ishte vetëm shkollimi. Aleks i ndjek disa vjet shkollën në qytetin e lindjes, pastaj largohet për të vazhduar studimet në Itali dhe më pas në Grac të Austrisë. Pasi përfundon gjimnazin në Salzburg, ku edhe mëson latinishten dhe greqishten e vjetër, pjesë e rëndësishme e kurrikulës shkollore në gjimnazin klasik me nga 8 orë në javë, Aleks regjistrohet në Universitetin e Vjenës, fillimisht në degën e farmacisë, duke pasur ndikimin e të atit. Pas vetëm një semestri ndërrohet degë, duke u regjistruar në Fakultetin e Filozofisë, për të vazhduar studimet në degën e historisë dhe të letërsisë. Ky drejtim që ai mori me vullnet të plotë ishte rezultat i pasionit të tij për shkencat shoqërore, pasion që iu shtua më tepër nga niveli i lartë i profesorëve të tij, ku veçohen albanologët e shquar Karl Patsch dhe Norbert Jokl, me të cilët krijoi edhe marrëdhënie shoqërore për shkak të njohjes së thellë që ata kishin për Shqipërinë. Gjatë viteve të studimeve në Vjenë shoqërohej me studentët e tjerë shqiptarë, si Skënder Luarasi, Krist Maloki, Eqrem Çabej, Lasgush Poradeci etj. Në ato vite fillon të formohet edhe ndërgjegjja politike, duke qenë bashkëkohës i një periudhe mjaft të trazuar për historinë europiane, si kriza ekonomike botërore, revolucioni bolshevik apo ngritja e fashizmit dhe e nazizmit. Siç shprehet në kujtimet e tij, në Austri ai jetoi 18 vjet që i konsideron si vitet më vendimtare të jetës, ku njeriu formohet intelektualisht dhe zhvillohet nga ana kulturore e fillon të piqet si personalitet.² Në vitet '30-'40 Vjena ishte gjithashtu një qendër e rëndësishme e shumë patriotëve dhe intelektualëve shqiptarë, kryesisht e

diasporës antizogiste, ku më të rëndësishmit ishin Fan Noli, Sejfi Vllamasi, Azis Çami, Ali Këlcyra etj.

Ndërkohë Tirana zyrtare mbikëqyrte me kujdes të gjithë studentët shqiptarë jashtë vendit, veçanërisht ata të Vjenës, për të pasur nën kontroll diasporën antizogiste të këtij qyteti. Siç shprehet prof. Buda në kujtimet e tij, konsulli shqiptar morri informacione mbi shqiptarët e atyshëm, ndër të tjera edhe për Aleksin, i cili së bashku me të vëllanë, Mihalin, konsideroheshin si të dyshimtë, sepse shoqëroheshin me profesorin e njohur Skënder Luarasi.³ Në dokumentet e Ministrisë së Arsimit gjenden informacione të hollësishme mbi studentët shqiptarë qoftë bursistë të shtetit shqiptar, qoftë studentë shqiptarë që i përballojnë vetë shpenzimet. Një formular që plotësohej nga nëpunësit e Ministrisë dhe që firmosej nga prindi i studentit, vërtetonte statusin e studentit për autoritetet shqiptare. Aty ndodhen edhe emrat e vëllezërve Buda, qyteti ku studionin, dega përkatëse dhe ecuria e studimeve.⁴ Miqësia e ngushtë me Skënder Luarasin, të cilin e quan me krenari edhe “mësuesi im”, duket se ka qenë një nga momentet vendimtare për formimin e tij. Aq i fortë ishte ndikimi i Luarasit në rrethin e studentëve shqiptarë, sa që në një letër të shkruar e të nënshkruar prej tyre rreth 15 studentë i drejtohen Ministrisë së Arsimit në vitin 1930. Ata u kërkojnë autoriteteve që t'i rikthejnë bursën e studimit Skënder Luarasit. Kjo bursë ishte ndërprerë në vitin 1929, pasi Luarasi akuzohej pa të drejtë nga konsulli Çatin Saraçi si i përfshirë në aktivitetet politike kundër

vendit të tij. Ky fakt hidhet poshtë nga nënshkruarit e letrës, të cilët shprehen se kjo akuzë kaq e rëndë nuk qëndron, sepse karakteri i tij nuk e lejonte kurrë të punonte kundër atdheut të tij. Letra është nënshkruar nga Mihal e Aleks Buda, si dhe studentë të tjerë, mes të cilëve edhe Eqrem Çabej.⁵

Fryma e solidaritetit të krijuar mes studentëve shqiptarë të Vjenës ishte karakteristikë e atyre viteve të rinisë. Në këtë linjë dhe me pasoja të konsiderueshme ishte vizita e vitit 1938 në Vjenë e Ali Kelmendit, që ishte një nga veprimtarët e parë komunistë shqiptarë, i cili u strehua në dhomën e Aleksit për disa javë. Ky episod bëri që policia e Vjenës të ushtronte kontroll në dhomën e tij. Këto elemente nga jeta e prof. Budës tregojnë për një prirje politike drejt së majtës në vitet e studimeve, duke pasur si model social-demokracinë europiane, ndonëse kishte simpati për marksizmin për shkak të polarizimit të skajshëm që diktonte koha. Vetë Luarasi u ishte bashkuar vullnetarëve ndërkombëtarë në Luftën Civile spanjolle që prej vitit 1936.⁶

Buda diplomohet në vitin 1938 dhe fillon të merret me gjuhësi me ndihmën e albanologut të shquar Norbert Jokl, në atë kohë profesor në Universitetin e Vjenës. Me pushtimin e Austrisë nga nazistët, Jokli filloi të vuajë persekutimin dhe Buda tashmë i diplomuar kthehet në Shqipëri në vitin 1938. Me të mbërritur në atdhe merret në pyetje nga policia për lidhjet me ata që përhapnin ide bolshevike dhe me Ali Kelmendin, dhe autoritetet shqiptare e burgosin në Elbasan për 20 ditë.⁷

³Po aty, f. 201.

⁴AQSH, fondi nr. 511, dosja nr. 159, viti 1932.

⁵AQSH, fondi nr. 511, dosja nr. 97, fleta 1-2.

⁶Skënder Luarasi, *Në brigadat ndërkombëtare në Spanjë* (Tiranë: Toena, 2006), f. 13.

⁷Haxhimihali, *Aleks Buda, Kujtime*, f. 229-230.

Prof. Buda zgjodhi rrugën e mesme që ia diktoi nevoja që kishte vendi për punë kulturore dhe edukata rilindase që kishte marrë në familje. Qëndroi larg temave ideologjike dhe iu kushtua historisë së kaluar të largët

Aleks Buda si pjesëtar aktiv në rezistencën kundër pushtuesit

Pushtimi fashist i 7 prillit 1939 e gjen në Elbasan, ku merr pjesë në demonstratën spontane kundër pushtimit që u zhvillua në qytet. Në shtator 1939 fillon punë si profesor i letërsisë në Gjimnazin e Tiranës, ku gjendet i rrethuar nga një mjedis intelektual dhe nga një atmosferë mjaft e ndezur për shkak të pushtimit. Veç mësimdhënies, u përfshi edhe në shumë aktivitete me sfond politik, si shprehje e rezistencës spontane të intelektualëve shqiptarë ndaj pushtimit italian.

Si profesor i letërsisë, ai drejtoi dhe vuri në skenë pjesën teatrale *Vilhem Tel*, ku aktorët kryesorë ishin

studentët e tij. Kjo pjesë u perceptua prej tyre si një model i rezistencës ndaj pushtimit ku, veç të tjerash, gjatë shfaqjes u këndua, edhe pse nuk ishte fare pjesë e dramës, kënga patriotike *Për Mëmëdhenë*. Shfaqja u pezullua dhe prof. Buda u thirr në Ministrinë e Arsimit për të dhënë shpjegime.

Në vitin 1940 e transferojnë në Liceun e Korçës, ndonëse autoritetet nuk e lënë të qetë dhe pasi i kontrollojnë shtëpinë ku ishte vendosur në Korçë, e shoqërojnë në Tiranë drejt burgut. Atje merret në pyetje lidhur me arsyet e qëndrimit të tij kundër pushtimit dhe pjesëmarrjes së tij në manifestimin e 28 nëntorit 1939. Pas pak ditësh lirohet nga burgu pa ndonjë akuzë dhe rikthehet në Korçë. Në verën e vitit 1940 rekrutohet me forcë në ushtrinë italiane



**Burrit me ballë të gjerë, dikur
iu zbardhën flokët dhe iku.
E mbajnë mend si një njeri
që përpiquej të ndihmonte.
Ndërkohë, faktet tregojnë
për një burrë në pozicion
të dyzuar mes shkencës,
angazhimit politik dhe
problemeve familjare të
diktuar nga regjimi.**

dhe dërgohet në Itali bashkë me shumë mësues të tjerë. Kjo ishte një nga mënyrat e fashizmit për të bindur e për të nënshtruar inteligjencën shqiptare. Arrin të shpëtojë nga shërbimi ushtarak duke siguruar një raport mjekësor dhe në gushtin e vitit 1941 rikthehet në Liceun e Korçës, ku qëndron vetëm 6 muaj pasi kishte arritur të regjistrohej në Universitetin e Padovës. Aty ndjek kurse kualifikimi në gjuhësi dhe punon pranë linguistit italian Taliavini, duke studiuar linguistikën e përgjithshme ballkanike.

Në verën e vitit 1942 kthehet përfundimisht në Shqipëri, sepse gjendja e krijuar në familjen e tij nuk e lejon më të udhëtojë drejt Padovës. I vëllai, Sofokli Buda, ishte përfshirë në Lëvizjen

Nacionalçlirimtare duke qenë një nga anëtarët më aktivë të njësitit gueril të Elbasanit. Për këtë arsye atij i arrestojnë nënën, të cilën arrin ta lirojë pas pak kohësh. Rifillon punë në Gjimnazin e Tiranës dhe lidhet përfundimisht me Lëvizjen, duke u përfshirë në Këshillin Nacionalçlirimtar ilegal të Tiranës.⁸ Në shtëpinë e tij organizohen takime të këtij këshilli. Prej vjeshtës së vitit 1943 ai shkon në Elbasan, sepse ishte caktuar të merrte pjesë në Këshillin Nacionalçlirimtar të qytetit të Elbasanit. Ndonëse i angazhuar në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, gjë që do t'i jepte mundësi të angazhohej më pas edhe në poste shtetërore, ai ishte një intelektual që kishte krijuar reputacion mes studiuesve shqiptarë. Ndër

⁸ AQSH, fondi 489, dosja nr. 143

të tjera, ky bashkëpunim duket edhe në marrëdhëniet me Arshi Pipën, me të cilin ishin kolegë për një kohë në Gjimnazin e Tiranës dhe i lidhte pasioni për dijen e librin. Në një letër që Pipa i dërgon Budës në mars të vitit 1944, i kërkon të shprehë mendimet e tij lidhur me botimin e librit *Lundërtarë* të Pipës, si dhe për numrin e parë të revistës *Kritika* që ky i fundit kishte filluar të botonte. Pipa i thotë, ndër të tjera: “Është e tepërt të shtoj se bashkëpunimi yt do të jetë një ndihmë e madhe dhe se pres prej teje më tepër se prej të tjerëve.”⁹

Një tjetër letër me interes e kësaj periudhe është edhe letra që i dërgon At Zef Pllumi në vitin 1944, ku ndan mendimet e tij mbi veprën e albanologut Lambertz dhe trajton çështje që kanë të bëjnë me historinë e lashtë të Shqipërisë, sidomos në zonat e Veriut.¹⁰ Këto komunikime na flasin shumë për profilin e lartë prej studiuesi që kishte krijuar prof. Buda që në fillimet e karrierës së tij.

Sidoqoftë, formimi i tij intelektual dhe patriotik, si dhe ndikimi i familjes së tij me emër në qytet, bëri që ai të shndërrohet në një përfaqësues të rëndësishëm të intelektualëve në luftën kundër pushtuesve. Në shtator 1944 u zgjodh nënkryetar i Këshillit Nacionalçlirimtar të qarkut të Elbasanit. Në fund të vitit 1944 shkon në Kongresin e Beratit dhe thirret për të punuar në Ministrinë e Kulturës.¹¹

Në krye të Bibliotekës Kombëtare

Në vitin 1945 ai emërohet në krye të Bibliotekës Kombëtare. Këtë detyrë e kishte marrë gjatë mbledhjes së Beratit nga Sejfulla Malëshova,¹² i cili do të bëhej ministri i Shtypit, Propagandës dhe Kulturës. Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore e gjeti BKSH me një koleksion prej 15.000 vëllimesh. Fillimisht biblioteka ndodhej në një ndërtesë të vjetër dhe të amortizuar tiranase, që ishte dëmtuar edhe më tepër gjatë çlirimit të kryeqytetit. Ajo u vendos në një nga ndërtesat më të mira të asaj kohe, e cila shërben edhe sot si “aneks” i saj.¹³ Kjo ndërtesë e re ishte ndër ndërtesat më madhështore të qytetit dhe gjatë pushtimit kishte qenë selia e Luogotencës.¹⁴ Ai caktohet për të marrë në administrim librat e Mid’hat Frashërit, që ishte larguar në Itali. Koleksionet me karakter albanologjik u rritën kryesisht si rezultat i konfiskimit edhe të disa librarive dhe bibliotekave private të personaliteteve të kulturës, si Lef Nosi, Mustafa Kruja, Lazër Shantoja, Vangjel Koça dhe biblioteka e pasur e jezuitëve, që prof. Buda i quante ajka e inteligjencës së Shqipërisë.¹⁵

Në fund të vitit 1947 fondi i saj numëronte rreth 100.000 vëllime.¹⁶ Puna në bibliotekë filloi me studimin, formimin e kartotekës dhe hartimin e një bibliografie, duke e shndërruar në bërthamën e një institucioni shkencor. Prof. Buda konsultoi me

⁹ Arkivi i Familjes Buda, Letër e Arshi Pipës për Aleks Budën, dt. 23 mars 1944.

¹⁰ Arkivi i Familjes Buda, Letër e Zef Pllumit për Aleks Budën, viti 1944.

¹¹ AQSH, fondi nr. 489, dosja nr. 143.

¹² Tatjana Haxhimihali, *Aleks Buda, Kujtime 2* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2014), f. 7.

¹³ <http://www.bksh.al/Pershkrimi.html>.

¹⁴ Haxhimihali, *Aleks Buda, Kujtime 2*, f. 8.

¹⁵ Haxhimihali, *Aleks Buda, Kujtime 2*, f. 9.

¹⁶ <http://www.bksh.al/Pershkrimi.html>.

Sotir Kolean, që kishte qenë drejtori i mëparshëm i bibliotekës.¹⁷ Ndërkohë, nëpër qilarët e bibliotekës u gjet arkivi i Luogotencës italiane me materiale shumë të rëndësishme të kohës së pushtimit italian, materiale të cilat me krijimin e Institutit të Shkencave kaluan në sektorin e arkivit të seksionit të historisë, duke shërbyer si bërthamë e Arkivit të Shtetit.

Gjatë kohës që punonte me zell për Bibliotekën Kombëtare, por edhe si lektor i letërsisë për aktorët e Teatrit të sapongritur, prof. Budës i ngarkohet një detyrë e vështirë dhe e rëndësishme, që tregon edhe për vlerësimin që kishin për të si historian autoritetet e reja. Ai përzgjidhet si pjesë e delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris. Në verën e vitit 1946, së bashku me një grup pune, ishte caktuar në komisionin që do të trajtonte çështje të historisë, etnografisë dhe gjuhësisë, sido-mos në raport me pretendimet e qeverisë greke ndaj Jugut të Shqipërisë. Puna kërkonte studimin e literaturës dhe dokumenteve të pas Luftës së Parë Botërore, veçanërisht të Konferencës së Versajës të viteve 1919-1920, ku qenë trajtuar çështjet e kufijve.¹⁸ Profesor Buda, së bashku me kolegun e tij Petraç Peppo, studiuuan urgjentisht në ditët e fundit të korrikut dhe në dhjetëditëshin e parë të gushtit literaturë e dokumente për çështjen shqiptare në Konferencën e Paqes të Parisit 1919-1920, veçanërisht për kufijtë shqiptarë. Ishte koha kur qeveria greke kishte ngritur pretendime në Konferencë për kufijtë jugorë të Shqipërisë dhe për ndëshkimin e saj si shtet aleat i Boshtit fashist.¹⁹ Detyrë kryesore e delegacionit shqiptar

ishte që të hidhte poshtë me fakte dhe argumente pretendimet greke, të cilat kishin edhe mbështetjen e hapur të disa qeverive perëndimore. Këto fuqi, do të shënonte në atë kohë prof. Buda, “na kanë mohuar të drejtat tona. Qëndrimi i anglo-saksonëve nuk asht i drejtë; e njohin realitetin, megjithatë, nuk na ndihmojnë...”. Kjo vështirësi e bënte edhe më të rëndësishme detyrën e dy historianëve për t’i dhënë udhëheqjes së delegacionit argumente sa më të mbështetura e bindëse.²⁰ Sipas rrëfimeve të tij, ai u befasua kur dëgjoji në radio se do të ishte pjesë e delegacionit të kryesuar nga Enver Hoxha dhe Hysni Kapo, në përbërje të të cilit ishin edhe Behar Shtylla si diplomat, Manol Konomi si jurist, Pëllumb Dishnica si ushtarak, Misto Treska si Prokuror i Përgjithshëm, Kahreman Ylli si ministër fuqiplotë i legatës shqiptare në Francë, Dhimitër Popa si diplomat i vjetër dhe Petraç Peppo si historian. Si drejtor i Bibliotekës Kombëtare, rrëmoi e gjeti në fondet e saj gjithçka sa kishte, ndërsa Pepo shkoi në Korçë e mori nga biblioteka e qytetit gjithë dokumentet, letrat e memorandumet e Konferencës së Parisit 1919-1920 që ndodheshin aty.

Në Paris delegacioni zyrtar shqiptar qëndronte në të njëjtin hotel dhe hanin të gjithë bashkë. Ishte momenti i takimit me Enver Hoxhën, emrin e të cilit e kishte dëgjuar gjatë luftës, por nuk kishte pasur rastin ta njihnte më nga afër. Buda shprehet se në atë kohë dukej i hapur dhe bisedonte me ta në tryezë si një njeri i thjeshtë, sepse ende nuk kishte filluar kulti i individit.²¹ Më 21 gusht delegacioni

¹⁷ Haxhimihali, *Aleks Buda, Kujtime 2*, f. 13.

¹⁸ Po aty, f. 39.

¹⁹ Paskal Milo, *Aleks Buda ambasador i shkencës shqiptare*, “Gazeta Shqiptare”, 24 maj 2016.

²⁰ Po aty.

²¹ Haxhimihali, *Aleks Buda, Kujtime 2*, f. 44.

shqiptar u paraqit në Konferencë, ku u përballën me argumentet greke, sipas të cilave Shqipëria nuk mund të konsiderohej një shtet fitues i luftës, pasi kishte qenë pjesëmarrëse në sulmin italian ndaj Greqisë në vitin 1940. Pikërisht për këtë fakt duhej që t'i paguante Greqisë njëfarë dëmshpërblimi, pra tokat në Jug.

Kontributi i prof. Budës nuk ka qenë vetëm në grumbullimin e fakteve historike dhe në paraqitjen e argumenteve që zunë vend edhe në fjalimin e Enver Hoxhës para Konferencës, por edhe në hartimin e dokumenteve të tjera në mbrojtje të kufijve shqiptarë. Prof. Buda dhe kolegu i tij Pepo morën pjesë në mjaft debate të hapura që organizoheshin jashtë Konferencës dhe kundërshtuan pretendimet greke. Në shënimet që ka lënë, ai kujtonte se “dëgjuesit u kushtonin vëmendje çështjeve që ngrinin ne që i ndriçonim në një dritë të re”.²² Pjesëmarrja e Shqipërisë në Konferencën e Paqes ishte e suksesshme, sepse arriti të vërtetonte renditjen e saj përkrah vendeve antifashiste.

Aleks Buda si studiues në Institutin e Shkencave

Instituti i Shkencave ishte një nga strukturat e reja që u ngrit me ardhjen në pushtet të komunistëve. Sidoqoftë, u mor për bazë përvoja ekzistuese në

këtë drejtim, e nisur në vitin 1940 me krijimin e Institutit të Studimeve Shqiptare, ku u përfshinë studiues të njohur shqiptarë dhe italianë, të gjuhës, letërsisë dhe të artit.²³

Menjëherë pas çlirimit u ngrit Instituti i Studimeve (1946) dhe më 1948 ai u riorganizua si Instituti i Shkencave dhe u bë vatër e kërkimeve dhe veprimtarive shkencore të organizuara. Krahas punonjësve nga instituti i paraluftës që, në fakt, filluan të spastrohen pak nga pak, u përfshinë shumë punonjës të rinj dhe u rrit numri i tyre; drejtues i parë i këtij instituti ishte Selahudin Toto. Instituti përbëhej nga 3 seksione: a) i gjuhësisë e i letërsisë; b) i historisë dhe i sociologjisë; c) i shkencave natyrore dhe biologjike.²⁴ Në vendimin e qeverisë të janarit të vitit 1947 shprehet qartë edhe qëllimi i krijimit të këtij institucioni, i cili do të kontribuonte shumë në studimin dhe zgjidhjen e problemeve aktuale që lidhen ngushtë me zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të vendit.²⁵ Ky institucion do të vihej në varësinë direkte të Këshillit të Ministrave dhe në krye të institucionit u vendos një përfaqësues i rëndësishëm i qeverisë. Këtë detyrë e mbajti në fillim dr. Manol Konomi. Prof. Buda u emërua në krye të seksionit të historisë, sociologjisë dhe shkencave ekonomike.²⁶ Instituti në vitin 1947 kishte 23 anëtarë, ndër të cilët vetëm dy prej tyre kishin qenë edhe më parë pjesë e tij, Aleksandër Xhuvani dhe Eqrem Çabej.

²² Milo, *Aleks Buda ambasador i shkencës shqiptare*.

²³ Kryetar i parë i këtij instituti ishte Ernest Koliqi dhe sekretar i përgjithshëm Zef Valentini, ndërsa ndër anëtarët kishte intelektualë të shquar, si Aleksandër Xhuvani, Ekrem Vlora, Eqrem Çabej, Karl Gurakuqi, Kolë Kamsi, Lasgush Poradeci, Lazër Shantoja, Sotir Kolea, Vangjel Koça etj. Më 1942 u quajt Instituti Mbretner Shqiptar, në varësi të Kryeministrisë. Në periudhën e pushtimit gjerman Instituti u riorganizua dhe u quajt Instituti për Studime e Arte, me zgjerimin e fushave të kërkimit dhe të numrit të studiuesve, tanimë vetëm shqiptarë, të ndarë në tri degë: gjuhësi, arte dhe shkencë natyrore e teknike. Në këtë institucion u përfshinë edhe intelektualë të tjerë të njohur të kohës, si: Ali Asllani, Arshi Pipa, Hamdi Sulçebe, Hasan Dosti, Krist Maloki, Kristo Floqi, Ndoc Nikaj, Mid'hat Frashëri, Odhise Paskali, Spiro Konda, Vasfi Samimi, Vedat Kokona etj. <http://akad.gov.al/ash/rreth-ash/historiku>.

²⁴ <http://akad.gov.al/ash/rreth-ash/historiku>.

²⁵ AQSH, fondi 490, dosja nr. 7, viti 1947.

²⁶ Po aty.

Vitet formuese të regjimit komunist u karakterizuan nga mobilizimi masiv dhe represioni në një shkallë të konsiderueshme. Ishte një periudhë kur dhuna u përdor për të riformuar marrëdhëniet shoqërore. Megjithatë, një operacion i tillë i madh nuk mund të kryhej vetëm nga organet represive, por mbështetej në pranimin ose bashkëpunimin aktiv të atyre që përfitonin – ose që shpresonin të përfitonin – nga rendi i ri. Kjo ishte gjithashtu një periudhë kur u hapën mundësi për lëvizje në rangjet më të larta të shoqërisë, duke u bërë pjesë e administratës së re shtetërore, për shumë punëtorë, fshatarë dhe aktivistë.²⁷

Sjellja e modelit totalitar shqiptar në raport me njerëzit e shkencës gjatë viteve 1945-1954 është vetëm një nga elementet e shumta të marrëdhënieve të reja që krijohen mes shtetit dhe individit pas vitit 1945. Përpjekjet për kontroll total të aktivitetit publik dhe privat të studiuesve kanë karakterizuar edhe modelin shqiptar, duke krijuar profile të ndryshme që mund të grupohen në këto ndarje kryesore:

Së pari, intelektualët që iu kundërvunë hapur ishin ata që me qëndrimet e tyre reagues ndaj modelit totalitar dhe për këtë u dënuan ashpër ose u mënjanuan.

Së dyti, ishin intelektualët që qëndruan në heshtje duke mbajtur distancë nga politika dhe duke zgjedhur të fokusohen te jeta akademike.

Së treti, ishin intelektualët që u formuan më vonë dhe u vunë në shërbim të pushtetit duke qenë

mjaft aktivë. Ky grupim i tretë ka gjasa të mos jetë ende aktiv në vitet e para të funksionimi të institutit.

Si kudo në vendet totalitare, mund të themi se shteti totalitar kishte marrëdhënie të dyfishtë me studiuesit. Nga njëra anë, ata mbaheshin nën kontroll dhe iu diktoheshin tematikat që përkonin me interesat e pushtetit, ndërsa nga ana tjetër ata kishin privilegjin që të shiheshin me admirim nga pushteti si intelektualë me vlera dhe me autoritet të padiskutueshëm në publik.²⁸ Këto marrëdhënie mes shtetit dhe studiuesve zhvilloheshin në një atmosferë mjaft të ngarkuar, ku dënimet ndaj intelektualëve kundërshtarë ishin mjaft të ashpra, sepse ata konsideroheshin si më të rrezikshmit dhe si opozitarë politikë të komunistëve. Gjyqi i Deputetëve dhe dënimi i Selahudin Totos, drejtori i Institutit të Shkencave, në vitin 1945, por edhe mjaft dënime të tjera, treguan hapur natyrën e sistemit të ri politik dhe sjelljen ndaj intelektualëve kundërshtarë. Pasi eliminoi ata që i shihte si kundërshtarë, shteti totalitar kishte nevojë për të pasur një grup studiuesish me emër që ishin të shkolluar jashtë vendit, që do të punonin për të ngritur lart kulturën kombëtare. Kjo ishte edhe pika lidhëse mes atyre studiuesve që, ndonëse mbështetën luftën, nuk mund të ishin dakord me masat e ashpra represive të regjimit të ri. Interesi akademik i këtij grupit të dytë të studiuesve dhe pamundësia për të reaguar bëri që ata të qëndronin neutralë dhe të ruanin gjatë gjithë periudhës profilin e studiuesit të papërfshirë në politikë aktive. Edhe prof. Buda bën pjesë në këtë profil. Në lidhje me këtë qëndrim na vijnë në ndihmë edhe opinionet e historianëve të tjerë që

²⁷ Pavel Kolar, "Communism in Eastern Europe", *The Oxford Handbook of the History of Communism*, Ed. Stephen A. Smith, Oxford University Press, 2014, p. 208-209.

²⁸ Michael David-Fox, "Communism and Intellectuals", *The Cambridge History of Communism*, Cambridge University Press, p. 527.

e kanë vlerësuar, veç aktivitetit akademik, edhe këtë qëndrim politik thuajse neutral. Profesor Kristo Frashëri, pasi vlerëson punën e madhe të prof. Budës në hedhjen e bazave dhe ngritjen në nivele shkencore të historiografisë shqiptare, thekson se ai zgjodhi rrugën e mesme të cilën ia diktoi nevoja që kishte vendi për punë kulturore dhe edukata rilindëse që kishte marrë në familje. Ai vendosi të vazhdonte punën në fushën e kulturës duke qëndruar sa më larg temave ideologjike, hapësirë të cilën e gjeti te historia e së kaluarës së largët, që nga ilirët, te Skënderbeu dhe te Rilindja Kombëtare.²⁹

Profesor Paskal Milo mendon se prof. Buda i qëndroi larg angazhimit politik për shkak të formimit të tij perëndimor, bindjes së tij se shkenca e historia ishin fushat e tij të veprimit dhe kënaqësia e jetës. Prof. Buda i ka shërbyer Shqipërisë, historisë, shkencës e kulturës shqiptare. Nëse në momente të caktuara këto shërbime të çmuara kanë përkuar edhe me interesat e regjimit komunist ose janë shfrytëzuar prej tij, këtu nuk ka asnjë faj e përgjegjësi historiani i madh, apo shkrimtarë, shkencëtarë e artistë të tjerë të mëdhenj.³⁰

Ndërsa profesor Pëllumb Xhufi mendon se prof. Buda i shfrytëzoi marrëdhëniet e mira që kishte me regjimin për të ndikuar në promovimin e shkencave albanologjike, duke filluar nga formimi brenda dhe jashtë vendit i specialistëve të latinishtes, greqishtes së vjetër dhe osmanishtes. Instituti i Shkencave u bë një mburojë, ndoshta i vetmi vend ku mundën të punësohen apo të përfshihen në projektet shkencore

përfaqësues të atyre që konsideroheshin si “klasat e përmbysura”.³¹

Në këto vite puna kryesore që bëri sektori i sociologjisë ishte e organizuar në drejtim të kërkimeve arkeologjike, kërkimeve gjuhësore të përqendruara në etnogjenezën ilire, mesjetën, Rilindjen, pra një punë e shtrirë në një hark kohor mjaft të gjerë. Duhet thënë se niveli i kërkimit shkencor në histori u rrit, pavarësisht ideologjizimit që pësuan të gjitha shkencat, por mbi të gjitha historia. Pavarësisht kësaj, prof. Buda arriti të studionte tema që mbulonin të gjitha periudhat historike me një profesionalizëm të lartë.

Tema e tij e preferuar në ato vite ishte historia e Skënderbeut, temë e cila ishte edhe punimi i parë shkencor si historian i prof. Budës. Ky punim u prezantua në konferencën e parë për Skënderbeun të mbajtur më 17 janar 1949 me rastin e 481-vjetorit të vdekjes së heroit në sallën e Teatrit dhe materiali u botua pas 3 ditësh në shtyp. Duke qenë se regjimi i ri kishte në bazë urrejtjen ndaj bejlerëve, ata që ishin personazhe historike me këtë prejardhje shiheshin me dyshim, ku nuk shpëtonte dot as edhe heroi kombëtar, që ishte pjesë e aristokracisë feudale dhe mbante titullin “bej”. Ky qëndrim dogmatik e dëmtonte historinë kombëtare dhe prof. Buda në prezantimin e tij hodhi bazat e trajtimit të historisë së heroit kombëtar, duke e trajtuar atë në kuadrin e kohës kur jetonte dhe kontributit të jashtëzakonshëm në bashkimin e shqiptarëve në luftën kundër osmanëve. Kjo do të ishte linja bazë

²⁹ Kristo Frashëri, *Prof. Aleks Buda dhe Skënderbeu*, Arkivi i Familjes Buda.

³⁰ Milo, *Aleks Buda ambasador i shkencës shqiptare*.

³¹ Pëllumb Xhufi, “Aleks Buda dhe mjedisi kulturor e atdhetar i formimit të tij”, *Aleks Buda një jetë për albanologjinë* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2012), f. 40.

që do ta çlironte heroin kombëtar nga paragjykimet klasore.³²

Në shtatorin e vitit 1952 u zhvillua një konferencë nga Instituti i Shkencave që kishte dy tematika kryesore. Tema e parë ishte formimi i kombit shqiptar, ndërsa tema e dytë ishte fillimet e lëvizjes kombëtare shqiptare. Organizatori i konferencës ishte prof. Buda, i cili kishte arritur të vendoste në sallën e madhe të Bibliotekës Kombëtare, ku edhe mbahej konferenca, një citat të Stalinit ku thuhet: “Asnjë shkencë nuk mund të zhvillohet e të përparojë pa luftë mendimesh dhe pa liri kritike.”³³ Parulla e vendosur dukej sikur ishte një mesazh edhe për studiuesit që të diskutonin lirshëm në konferencë, por edhe për partiakët vigjilentë që të mos i kundërviheshin thënies së Stalinit.³⁴

Një çështje tjetër e diskutuar ishte maketi i historisë së Shqipërisë, diskutimi i parë i së cilës është bërë në shkurt të vitit 1952. Në këtë mbledhje prof. Buda hedh një nga parimet e rëndësishme metodike të shkrimit të historisë. Ai fillimisht këmbëngul që të krijohen skedarë sipas rendit kronologjik i cili duke u plotësuar përbën skeletin e punës. Por gjithashtu kërkon që të krijohet edhe një skedar i dytë që duhet të jetë i radhitur sipas problemeve, sepse ka materiale që nuk mund të rreshtohen në formën kronologjike, sepse përmbledhin faza të mëdha.³⁵ Kështu del në pah edhe perceptimi mjaft i gjerë dhe i saktë për historinë si një shkencë që kërkon jo vetëm trajtim kronologjik, por edhe problemor e mbi

të gjitha, në bashkëpunim të ngushtë me shkencat e tjera ndihmëse. Për çështjen e maketit të historisë së Shqipërisë ka pasur informacion edhe Sigurimi i Shtetit. Ja se ç’thuhet në një raportim nga bashkëpunëtori “Dhelpëria” për Budën: *Raport i bp “Dhelpëria” marrë nga p.operativ R. Zavalani, Tiranë, më 24.12.1953. “Në seksionin e Historisë: Aleks Buda është shefi i seksionit. Bën përpjekje për të përvetësuar Marksizëm-Leninizmin, njeh mjaft Çështjet e Historisë, po ka konfuzion në kokë. Puna kryesore e Seksionit është Historia e Shqipërisë që po përgatitet. Nga sa kemi biseduar me Aleks Budën, monografitë e ndryshme nuk janë bërë në bazë të një modeli të përbashkët dhe as që janë biseduar përpara tezat e çdo monografie (siç bëhet fjala vjen në Bashkimin Sovjetik), po cilido ka vepruar sipas mendjes së tij. Veç kësaj edhe niveli i çdo monografie nuk është i ngritur, disa janë të dobëta. Kështu që kemi përshtypjen se Historia e Shqipërisë nuk do të dalë e gjitha e një niveli dhe me boshllëqe.”*³⁶

Mjaft prej studiuesve të kohës ishin edhe deputetë të Kuvendit Popullor. Në dy legjislatura, të viteve 1950-1954 dhe 1954-1958, edhe prof. Buda ishte deputet i Kuvendit Popullor. Ai nuk ishte i vetmi nga Instituti i Shkencave që u bë deputet. Veçanërisht në qarkuan e Elbasanit spikasin disa prej emrave më të rëndësishëm të kulturës dhe dijes, si Aleksandër Xhuvani, Kolë Paparisto, Petraq Popa, Dhimitër Shuteriqi.³⁷ Sidoqoftë, pozi-

³² Kristo Frashëri, *Prof. Aleks Buda dhe Skënderbeu*, Arkivi i Familjes Buda.

³³ Kristo Frashëri, “Aleks Buda, mbi kriteret metodologjike studimore të historisë së Shqipërisë”, *Aleks Buda një jetë për albanologjinë* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2012), f. 20.

³⁴ Po aty.

³⁵ Procesverbal i mbledhjeve për historinë e Shqipërisë, dt. 14.02.1952, Arkivi i Familjes Buda.

³⁶ AIDSSH, Dosja Formulare Eqrem Çabej, fl. 56-57.

³⁷ AQSH, fondi nr. 489, dosja nr. 141, fleta 1-4.

cioni i deputetit dhe i vetë Kuvendit Popullor ishte i parëndësishëm, sepse zgjedhjet ishin formale dhe pushteti real ishte i papërfillshëm. Në biografinë e tij që ndodhet në fondet e Kuvendit në AQSH rezulton se ai ishte përfshirë në listën e deputetëve si një punëtor i palodhur në fushën e kulturës. Aty thuhet: “Me plot të drejtë populli i zonës elektorale nr. 43 të qarkut të Elbasani ka propozuar për Kuvendin Popullor kandidaturën e këtij intelektual patriot që energjitet e tija i ka vënë në shërbim të zhvillimit dhe të përparimit të kulturës sonë nacionale.”³⁸

Ai ka kontribuar edhe për filmin e madh artistik mbi heroin kombëtar Skënderbeu dhe për punën që bëri u dekorua me Urdhrin e Punës të klasit të parë. Është dekoruar gjithashtu me Urdhrin e Punës të klasit të tretë.

Ndërkohë ka edhe një varg elementesh të tjera që tregojnë vështirësitë e mëdha që iu krijuan atij dhe familjes së tij gjatë kësaj faze të parë të vendosjes së modelit totalitar. Në kohën kur po nisej në Konferencën e Paqes në vitin 1946 dy kunetërit e tij ishin arrestuar dhe ndodheshin në burg. Në letrën që prof. Buda i dërgon së shoqes Vasilikës para se të nisej për në Paris, i thotë se kishte qenë në burg dhe i kishte takuar të dy kunetërit të cilët ishin mirë, por trembeshin për ndonjë transferim në burgun e Burrelit.³⁹ Në vitin 1948 i arrestojnë vëllain e tij, Stasin, sepse si trashëgimtar i farmacisë së babait të tyre nuk kishte arritur të shlyente tatimin e jashtëzakonshëm. Tatimi i vendosur ishte jashtë çdo logjike, sepse nuk përputhej me të ardhurat e farmacisë. Siç rrëfen prof. Buda, aty do të kuptonte

se sa e fortë ishte dora e diktaturës së proletariatit. Pasi ishte dërguar që të punonte edhe në kënetën e Maliqit dhe autoritetet ishin bindur se nuk kishte mundësi të paguante, Stas Buda u lirua pas një viti e gjysmë në burg.⁴⁰

Të gjitha këto fakte tregojnë për një pozicion të dyzuar mes shkencës, angazhimit politik dhe problemeve familjare të diktuar nga regjimi i ri. Sidoqoftë, prof. Buda arriti të fokusohet gjithnjë e më tepër në çështjet e shkencës, duke gjetur hapësirën e tij të lirisë së brendshme në atë kohë të vështirë.

Përfundime

Prof. Buda ishte, mbi të gjitha, një erudit i përmasave europiane që ua kushtoi jetën studimeve dhe shkrimeve mbi albanologjinë. I edukuar në një familje patriotike në një qytet mjaft aktiv, ai u mbrujt me atdhedashuri. Jetoj dhe studioi jashtë vendit për 18 vjet. Sidomos gjatë viteve të studimeve në Austri, u orientua drejt studimeve filologjike dhe historike, duke njohur mirë latinishten dhe greqishten e vjetër. Gjatë viteve të studimeve të larta bëri shoqëri me shumë intelektualë të tjerë patriotë me prirje të majta dhe filloi të kishte prirje të majta politike e të simpatizonte marksizmin ende pa e njohur fytyrën e vërtetë të aplikimit të ideologjisë në praktikë. Sidoqoftë, ndihej shumë më tepër social-demokrat, me respekt për humanizmin dhe demokracinë parlamentare. Kthimi në atdhe mund të thuhet se e radikalizoi politikisht, sepse nga njëra anë vendi ishte i pushtuar e nga ana tjetër ai dhe familja e tij vuajtën nën regjimin e pushtimit. U burgos dy herë

³⁸ AQSH, fondi nr. 489, dosja nr. 143.

³⁹ Haxhimihali, *Aleks Buda, Kujtime 2*, f. 40.

⁴⁰ Po aty, f. 19.

dhe u dërgua forcërisht të bënte ushtrinë në Itali, ndonëse ishte profesor. Veç kësaj, edhe e ëma e tij u burgos për pak kohë si rezultat i përfshirjes së të vëllait në rezistencën antifashiste. Si pjesa më e madhe e intelektualëve shqiptarë, ai nuk mund të pajtohej me pushtimin e vendit dhe për këtë arsye krejt spontanisht u bë pjesë e lëvizjes antifashiste. Statura e tij prej intelektualit të spikatur dhe me bindje të majta bënë që të afrohet nga pushteti i ri duke u emëruar në poste të rëndësishme si nënkryetar i Këshillit Nacionalçlirimtar të Elbasanit, si drejtor i Bibliotekës Kombëtare, si anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes së Parisit, si anëtar dhe drejtues i seksionit të sociologjisë e historisë dhe ekonomisë në Institutin e Shkencave dhe më pas si deputet i Kuvendit Popullor. Të gjitha këto pozicione i arriti dhe i pranoi, sepse thellë-thellë ishte njeri i dijes dhe do të përpqej të jepte maksimumin e tij për të ndriçuar dhe për të

lartësuar historinë shqiptare. Mbi të gjitha, hodhi bazat e historiografisë shqiptare. Ndërkohë, jetonte në një sistem ku i vëllai iu burgos për pak kohë se nuk mund të paguanin tatimin e jashtëzakonshëm të vendosur pas luftës. Kunetërit e tij po ashtu u burgosën. Liria e shprehjes ishte e kufizuar dhe shumë intelektualë u burgosën e vranë. Ai e dinte mirë pasojat nëse rebelohej, ndonëse në heshtje nuk pajtohej me luftën e klasave, me mungesën e lirive, me persekutimet politike dhe me kufizimet drastike të kontakteve njerëzore, shkencore e kulturore me botën e jashtme. Kjo duket në përpjekjet që bëri për përfshirjen në institut të atyre që, ndonëse kishin njolla në biografi, u përfshinë në projekte shkencore. Për shkak të aftësive të tij si studiues, u shndërrua gradualisht në përfaqësuesin më të shquar të kërkimit shkencor në Shqipëri, ndoshta ndër të vetmin që mbante kontakte dhe takohej me kolegë të huaj në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare.

BIBLOGRAFI

AQSH

Fondi i Këshillit të Ministrave.

Fondi i Kuvendit.

Fondi i Ministrisë së Arsimit.

ARKIVI I FAMILJES BUDA

Kristo Frashëri, *Prof. Aleks Buda dhe Skënderbeu*.

Procesverbal i mbledhjeve për historinë e Shqipërisë, dt. 14.02.1952.

Letër e Arshi Pipës për Aleks Budën, dt. 23 mars 1944.

Letër e Zef Pllumit për Aleks Budën, viti 1944.

AIDSSH

Dosja Formulare Eqrem Çabej.

LIBRA

Tatjana Haxhimihali, *Aleks Buda, Kujtime* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2005).

Tatjana Haxhimihali, *Aleks Buda, Kujtime 2* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2014).

Skënder Luarasi, *Në brigadat ndërkombëtare në Spanjë* (Tiranë: Toena, 2006).

ARTIKUJ

Michael David-Fox, "Communism and Intelecutals", *The Cambridge History of Communism*, Cambridge Univeristy Press.

Kristo Frashëri, "Aleks Buda, mbi kriteret metodologjike studimore të historisë së Shqipërisë", *Aleks Buda një jetë për albanologjinë* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2012).

Paskal Milo, *Aleks Buda ambasador i shkencës shqiptare*, "Gazeta Shqiptare, 24 maj 2016.

Pavel Kolar, "Communism in Eastern Europe", *The Oxford Handbook of the History of Communism*, Ed. Stephen A.Smith, Oxford Unviersity Press, 2014.

Pëllumb Xhufi, "Aleks Buda dhe mjedisi kulturor e atdhetar i formimit të tij", *Aleks Buda, një jetë për albanologjinë* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2012).

BURIME NË INTERNET

<http://akad.gov.al/ash/rreth-ash/historiku>.

<http://www.bksh.al/Pershkrimi.html>.

Enxhi Beka

Kolë Kamsi, intelektual i kushtoi jetën arsimit dhe kërkimit shkencor

Në këtë punim do të hidhet dritë mbi Kolë Kamsin, një intelektual që i ka kushtuar jetën arsimit në Shqipëri, për të cilin pak është shkruar deri më sot. Analiza e figurës së Kolë Kamsit kryesisht do të zhvillohet përmes analizës krahasimore të burimeve arkivore dhe shkrimeve mediatike e artikujve të botuar mbi të.¹

Biografia²

I lindur më 23 shtator 1886 në Shkodër, babai i tre fëmijëve, Paolinit, Karlos dhe Terezina Kamsit, me një origjinë shoqërore prej tregtari të vogël

dhe me profesion arsimtar,³ ka dhënë kontributin e tij në fushën e arsimit dhe të kulturës kombëtare. Personalitet shkencor, folklorist, mësues dhe pedagog i gjuhës shqipe, hartues tekstesh shkollore, përkthyes, prozator, fabulist, publicist, redaktor, studiues i shquar i gjuhës shqipe dhe i traditave shoqërore. Familja Kamsi nuk është një familje pa ndikim në Shkodër. Prapa këtij mbiemri fshihet një histori e vjetër e kësaj familjeje dhe me një kontribut të rëndësishëm në aspektin kombëtar. Në fakt, mbiemri Kamsi lidhet ngushtësisht me Drishtin e Komunës së Postribës.⁴ Drishti ka qenë një ndër qendrat më të zhvilluara që në shek. XII. Kamsi është mbiemri i njëres prej dy degëve të familjes së

¹ Ky artikull është rezultat i pjesëmarrjes sime në projektin e AIDSSH, të mbështetur nga programi zviceran PERFORM. Falënderoj udhëheqësen time të projektit, prof. asoc. Enriketa Pandelejmoni (Papa), e cila më udhëzoi dhe më mbështeti me sugjerime dhe këshilla në shkrimin e këtij artikulli.

² Falënderoj znj. Mirela Kamsi Gurakuqi, mbesën e prof. Kolë Kamsit, mbi ndihmën e dhënë me ofrimin e burimeve historike dhe historive familjare për të plotësuar sa më mirë figurën e tij.

³ AQSH, fondi 803, dosja II-134, fl. 51.

⁴ "Familja Kamsi, intelektualët e djeshëm e të sotëm të Shkodrës", gazeta *Shekulli*, nr. 2926, 2010, fq. 16-17.



[Illegible handwritten text overlaid on the man's face]

[Illegible handwritten text, possibly a header or address]

21-11-1995

F. Sgherza


[Handwritten text on the neck and chest area, appearing to be a letter or note]

[Large handwritten signature or initials]

sundimtarëve të Drishtit, të Ëngjëllorëve. Familja i ka rrënjët te Dhimitër Ejlli, më pas ajo u nda në dy degë, në atë Kamsi dhe Radovani. Me pushtimin e Drishtit dhe fortesës së saj nga osmanët, Ëngjëllorët u shpërndanë. Një pjesë e tyre merr mbiemrin Kamsi duke zotëruar fshatrat mes Cukalit e Drishtit dhe kështu shpërndahen në zona të ndryshme të Shkodrës. Kështu nis rrëfimi i historisë Kamsi në një

Interesante është gjithashtu emrin që morën pas shpërbërjes së Ëngjëllorëve. Njëri prej pjesëtarëve të familjes Kamsi, i quajtur Denk Kamsi, ishte i njohur për të ecurën e tij të shpejtë dhe kështu i mbeti pseudonimi Kamci ose këmbëshpejtë.⁵

Duke i referuar sërish kësaj gazete, zbulojmë se në familjen e Karlo Kamsit ruhen me fanatizëm 16 dokumente pergamenë, origjinale, që flasin për



Kartolina dërguar revistës "Diturija"

Studim i Kolë Kamsit

“Miqhtë e kujtojnë atë si një njeri që punonte në heshtje, rregullisht dhe palodhje. Ata e kujtojnë atë si njeriun që i dedikoi jetën e tij arsimit pa pritur që të nderohej”

prej shkrimeve të gazetës *Shekulli* nga pinjolli i kësaj familjeje, Karlo Kamsi. Më tej, vijon Karlo Kamsi, në zonën e Drishtit edhe sot ruhen toponimet që lidhen me emrin e kësaj familjeje, si Guri i Kamxit (Kamsit), Shpella e Kamsit, Kullat e Kamcejve, Dheu i Kamsit.

vjetërsinë e kësaj familjeje. Jo vetëm Arkivi i Shtetit, por edhe Vatikani ka kërkuar dokumentet që flasin për vjetërsinë e familjes Kamsi. Përveç pemës familjare, rrëfen Karlo Kamsi, këto dokumente flasin edhe për ekonominë dhe zhvillimin kulturor të zonës, akte juridike të kohës etj.⁶

⁵“Kolë Kamsi, punëtor i palodhur në lëmin e arsimit e kulturës kombëtare”, gazeta 55, 2013.

⁶Po aty.

Një ndër figurat më të shquara të kësaj familjeje ishte imzot Pal Kamsi, i cili ka shërbyer si famullitar i Kishës së Zojës së Shkodrës në Tophanë dhe më 25 maj 1742 u caktua nga Papa Benedikti XIV si ipeshkëv i Shkodrës. Pal Kamsi gjatë shërbimit të tij në Tivar u bë i njohur se arriti të bënte për herë të parë regjistrimin në librin e kishës që ruhet në Arqipeshkvinë e Shkodrës. Drejtoi dioqezën e Shkodrës për 29 vjet dhe u nda nga jeta më 14 prill 1771 në kuvendin françeskan të Kastratit.⁷

Gjon Kamsi është një tjetër figurë mjaft interesante, i cili menjëherë të kujton refuzimin që i bëri Papa Klementit XII më 1739 për të qenë ipeshkëv i Shkodrës. Jeta që Gjon Kamsi preferonte të bënte ishte ajo midis njerëzve të thjeshtë. Ai u nda nga jeta në moshën 90-vjeçare dhe pasurinë e tij ua la të varfërve. Emra të tjerë ishin Kol Ndoc Kamsi, Bep Kamsi, ky i fundit ka shërbyer si përkthyes në konsullatën e Venedikut në Shkodër.

Willy Kamsi rrëfen se Gjon Kamsi, babai i tij, ishte një tjetër intelektual i familjes Kamsi. Gjon Kamsi e zhvilloi aktivitetin e tij në Bari të Italisë, ku dhe Willy Kamsi lindi. Ishte bashkëpunëtor i shtypit kombëtar brenda dhe jashtë vendit dhe anëtar i gazetarëve të huaj në Itali. Ka botuar në revistat e njohura të asaj kohe, *Posta e Shqypnisë* dhe *Bashkimi i Kombit*. Veç të tjerave, ka bashkëpunuar edhe me shumë gazeta e revista të tjera, ku ndër to dallohet bashkëpunimi 5-vjeçar me prestigjiozen *Hylli i Dritës*.⁸ Xhaxhai im Kolë Kamsi, vijon Willy Kamsi, studioi njëllonj si babai im, në fillim në Shkodër e pastaj në Itali.

⁷Po aty.

⁸“Familja Kamsi, intelektualët e djeshëm e të sotëm të Shkodrës”, gazeta *Shekulli*, nr. 2926, 2010, fq. 16-17.

⁹<https://Konica.al>.

Willy Kamsi vetë kishte punuar në bibliotekën e qytetit të Shkodrës dhe kishte disafishuar numrin e librave të fondit të bibliotekës. Kishte shërbyer si i pari ambasador fuqplotë i Shqipërisë në Vatikan.⁹ Kur ishte kthyer në Shkodër pas shërbimit të tij diplomatik, kishte përpiluar seritë bibliografike të revistave më të rëndësishme të periudhës para vendosjes së regjimit. Ai është përkushtuar mbas botimit të disa veprave të rëndësishme, siç janë 4 vëllimet e plota me bibliografi të revistave *Hylli i Dritës*, *Leka, Albania* e Konicës, *Shejzet* dhe *Shkëndija*, dhe materiale të rëndësishme historike, si *Ditari historik* i Shuk Gurakuqit, *Kujtimet* e Gjon Kamsit dhe studime të tjera me karakter historik. Willy Kamsi është marrë me histori, monumente e arkeologji, me gjuhë shqipe, kryesisht me etimologji të toponomastikës historike e fusha të tjera shkencore.

E parë në këtë këndvështrim, pema gjenealogjike e familjes Kamsi është një pemë gjenealogjike intelektuale. Duke parë këtë ecuri, natyrisht që edhe Kolë Kamsi do të ishte pjesë e kësaj rrjedhe. Ecuria e tij ishte thujse e paracaktuar, nëse do të shohim familjen në të cilën ai u rrit. Kolë Kamsi do të ishte veçse emri i radhës që do të kontribuonte gjerësisht në fushën e arsimit. Rugën drejt dijes ai e nisi në qytetin e tij të lindjes, në Shkodër. Në Shkodër mori mësimet e para, duke kryer shkollën fillore dhe atë të mesme, duke marrë kështu edhe diplomën në Shkollën Teknike Tregtare Italiane. Shkollën Normale do ta kryente në San Demetrio Corone (Itali) dhe italishtja do të ishte një ndër

gjuhët që ai do të zotëronte.¹⁰ Këtu do të qëndronte për tre vjet, ku do të mbaronte Shkollën Normale Pedagogjike më 1907. Në këtë kolegji katedra e gjuhës shqipe u themelua nga Jeronim de Rada më 1849 dhe po në këtë institucion arsimor dha mësim në gjuhën shqipe nga viti 1906 deri më 1909 profesor Aleksandër Xhuvani, si dhe studioi pas vitit 1897 patrioti, politikani dhe intelektuali i shquar shqiptar Luigj Gurakuqi. Në vitin 1907, pasi kryen studimet, në moshën 21-vjeçare, Kamsi kthehet në vendin e lindjes, me një devotshmëri dhe përkushtim për t'i shërbyer atdheut në fushën e arsimit. Po këtë vit emërohet mësues i gjuhës shqipe në qarkun e Vlorës, qark ky që në këtë periudhë trashëgonte prapambetje të theksuara në fushën e arsimit. Duke u njohur realisht me gjendjen e arsimit në qarkun Vlorë dhe Gjirokastrë, Kamsi ndërmerr hapjen e 44 shkollave elementare për t'u mësuar shqip fëmijëve të këtyre dy qarqeve. Pasi ushtron për një kohë të gjatë veprimtarinë e tij si arsimtar për 7 vjet rresht, në vitin shkollor 1915-1916 emërohet drejtor i shkollës së parë fillore për djem në prefekturën e Vlorës dhe mësues në këtë shkollë caktohen Jani Minga, Thoma Papapano dhe Halim Xhelo. Në këtë periudhë, duke qenë koshient për nivelin e ulët të arsimtarëve që jepnin mësim në shkolla, Kamsi së bashku me Jani Mingën çelën në Vlorë një kurs afatshkurtër pedagogjik, i cili synonte të ndihmonte mësuesit për përdorimin e metodave didaktike gjatë mësimit.

Kamsi, krahas drejtimit të shkollave dhe mësimit, filloi një veprimtari intensive që lidhej me hartimin e teksteve bazë për shkollën fillore ku,

¹⁰AQSH, fondi 803, dosja II-134, fq. 51.

¹¹Po aty.

përveç abetares që e titulloi *Jeta e re* (1915), 72 faqe, iu përvesh punës dhe brenda katër vjetësh hartoi tekstin *Mësime përmbi natyrën* (1917), 60 faqe, dhe në vitin 1919 botoi antologjinë me vjersha për shkollën fillore *Lulet e mendimit*, 52 faqe. Në këto vite Kolë Kamsi bëhet anëtar dhe veprimtar i klubit "Labëria" dhe shquhet si veprimtar i lëvizjes arsimore e kulturore "Lidhja e arsimtarëve" në Vlorë, lëvizje kjo e cila e ushtroi aktivitetin e saj në vitet 1907-1928. Në këto vite Kolë Kamsi arrin të vërë në skenë dramën *Vdekja e Pirros* të Mihal Gramenos. Në qarkun e Vlorës Kamsi e ushtroi veprimtarinë e tij për hapjen dhe drejtimin e shkollave shqip deri më 1920 përgjatë



Kamsi në të djathtë, me një mik të afërm

**Tri vite para se të shuhej,
mësuesi Kolë Kamsi u
dekorua me "Urdhërin e
Flamurit"**

një periudhe 13-vjeçare. Mbas mbarimit të Luftës së Parë Botërore kthehet në Shkodër.

Në vitet 1910-1920 ushtonte profesionin e mësuesit në Vlorë. Me urdhër të Ministrisë së Jashtme ai punoi si mësues i thjeshtë në shkollën italiane në Vlorë.¹² Në vitet 1912-1916 pagesa e tij në Vlorë ishte 220 fr. ari.¹³ Në vitin shkollor 1915-1916 në Vlorë çelet shkolla fillore për djem, drejtor i së cilës emërohet pikërisht Kolë Kamsi. Me urdhër të Prefekturës emërohet drejtor në shkollën shqipe të Vlorës. Në vitin 1916-1917 pagesa e tij mujore, bazuar në dokumentet arkivore, në pozicionin e drejtorit ishte 240 fr. ari.¹⁴ Stafi i mësuesve në këtë shkollë përbëhej nga emra, si: Jani Minga, Thoma Papapano, Halim Xhelo etj. Sipas dokumenteve arkivore, në vitet 1917-1920 në pozicionin e mësuesit Kolë Kamsi merr një pagë prej 220 fr. ari.¹⁵ Në vitet 1920-1926 ishte në po të njëjtën detyrë, por në Shkodër, me po të njëjtën pagesë. Ndërmjet këtyre viteve ai emërohet mësues në Shkodër me urdhër të Ministrisë së Arsimit në Shkollën Françeskane, në vitet 1920-1922. Po ashtu Kamsi është një ndër delegatët në Kongresin e Dytë Arsimor në Tiranë, kongres ky i cili zhvilloi punimet në godinën e Parlamentit të Parë Shqiptar.¹⁶

Emocionuese në mbledhjen e parë të punimeve të këtij kongresi, i cili u çel ditën e shtunë, më 22 korrik 1922, ora 10.00, ishte fjala e mbajtur nga ministri i Arsimit i asaj kohe, zotit Rexhep Mitrovica, i cili iu drejtua pjesëmarrësve: “Zotërinj të

ndershëm, ndihem shumë i gëzuar që po shoh rreth meje fuqitë më të vlefshme të arsimit, të mbledhur këtu për të rrahur çështjet që kanë rëndësi të madhe për zgjimin e popullit tonë dhe për përparimin e kulturës së tij, që mund të fitohen vetëm me anën e shkollave. Me arsim ne jo vetëm do të sigurojmë lirinë dhe pavarësinë e kombit tonë, por do të përmirësojmë edhe gjendjen e tij ekonomike e shëndetësore, dy pika jo më pak të rëndësishme se liria dhe pavarësia politike.”

Profesor Kolë Kamsi, së bashku me profesorët Kol Margjini, Thoma Papapano dhe Dhimitër Gjerga, emërohen sekretarë të këtij kongresi me votim nga pjesëmarrësit dhe profesor Karl Gurakuqi ngarkohet me shkrimin e raportit, që do shkruhej mbi bazën e procesverbaleve të mbajtura në kongres. Në këtë kongres Kolë Kamsi, së bashku me profesorët Xhuvani, Kondo, Pogoni, Beltoja, Gurakuqi, Çekaj, Minga, Bala, Gashi, Babameto dhe Papapano, zgjidhen anëtarë të komisionit prej 12 vetash, si një përfaqësi e pjesëmarrësve nga qarqet e ndryshme të vendit, të cilët do të përgatisnin reformën arsimore, programet dhe tekstet shkollore dhe do të merrnin vendimet për ecurinë e sistemit arsimor në Shqipëri. Synimi i këtij kongresi ishte që të kryhej një reformë arsimore, kurrikula e së cilës duhej të përgatiste në të ardhmen qytetarë me karakter të patundur, vullnet të hekurt, me iniciativë dhe gjykim të drejtë, që t'i shërbejnë kombit dhe për ta nxjerrë vendin nga prapambetja shekullore ku ishte zhytur.¹⁷

¹² Po aty, f. 54.

¹³ AQSH, fondi 803, fq. 50.

¹⁴ Po aty, f. 53.

¹⁵ Po aty, f. 50.

¹⁶ Gazeta *Dit e re*, Tiranë, 23 korrik 1922, fq. 22-23.

¹⁷ Mirela Kamsi Gurakuqi, Manuskript mbi fjalën e mbajtur mbi Kolë Kamsin në përvjetorin e 95-të të Gjimnazit të Shtetit.

Pikërisht në këtë moment, të mëdha dhe të vazhdueshme ishin përpjekjet e deputetit të Shkodrës nga krahu opozitar, Luigj Gurakuqit, i cili seancë pas seance shprehte nevojën e krijimit të një shkolle të mesme. Ndaj shqetësimin për nevojën emergjente të hapjes së një shkolle laike shtetërore të mesme në qytetin e Shkodrës ai e paraqiti në parlamentin shqiptar në janar të vitit 1922, në Mbledhjen X të Këshillit Kombëtar, i cili e mori fjalën menjëherë pas fjalimit të plotë të ministrit të Arsimit të asaj kohe, Rexhep Mitrovicës: “Mbi këtë pikë dua t’i heq vërejtjen zotit Ministër të Arsimit të merren masat e nevojshme për të hapurit e një shkolle të mesme laike, pse atje gjithë, i cili ka dëshirë të math për arësim. Shkollat e mesme në këtë qytet janë private dhe u përkasin besimeve fetare.”¹⁸ Kështu, Këshilli i Ministrave i Shtetit Shqiptar në vitin 1922, më datë 11 gusht merr vendimin nr. 720, “të bazuem në kërkesën e Ministrisë së Arsimit, nr. 11878, vendim me të cilin urdhnon që të hapet në Shkodër një shkollë Gjinnaz i Shtetit, për me mujtë me ndjekë aty mësimet një shumicë e studentave shqiptarë, që nuk kanë me u dergue ma jashtë e, sidomos, nxanësit e atij Qarku...”. Më 05.10.1922 Ministria e Arsimit çel Gjinnazin Shtetëror me një bazë materiale tepër modeste, në të cilin regjistrohën 20 gjinnazistët e parë dhe emërohen profesorë Kolë Kamsi (gjuhë shqipe dhe letërsi), Loro Rasha (latinishte), Kol Kraja (frëngjishte), Kol Margjini (histori-gjeografi), Ruhi Zheko (matematikë), Simon Rrota (vizatim), Demush Jakova (gjinnastikë). Pas dy muajsh emëron Drejtor të parë të këtij gjinnazi

profesor Xhevat Korça (histori-gjeografi) dhe zëvendës drejtor Luigj Shala (histori natyre).¹⁹

Me po të njëjtin urdhër të Ministrisë së Arsimit emërohet mësues në vitet 1922-1924 në Gjinnazin e Shtetit në Shkodër dhe më 1924-1925 Kamsi emërohet drejtor nga Ministria e Arsimit në Shkodër në shkollën “Teuta”. Në vitin 1925, me urdhër nga Ministria e Arsimit emërohet drejtor dhe pedagog i kursit pedagogjik që Ministria çeli në qarkun e Korçës për përgatitjen e mësuesve që do të jepnin mësim në shkollat e qytetit të këtij qarku. Arsimitarët që ndoqën këtë kurs shprehën konsideratat më të larta për ndihmesën që iu dha atyre nga profesor Kolë Kamsi me synim përmirësimin e metodologjive të reja didaktike për mësimdhënien.²⁰ Vlerësimet për aftësitë dhe vlerat e kursit të ndjekur nga profesor Kamsi i gjejmë përmes artikullit që u titullua *Kurset e pedagogjisë për mësuesit e Korçës dhe të qarqeve*, botuar në gazetën *Zëri i Korçës*: “Zoti Kamsi është drejtor dhe pedagog i kurseve dhe shquhet për një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, kështu tërheq vëmendjen e të gjithë arsimtarëve, të cilat janë të etjësuar për të mësuar methodha të ra dhe sa më lehtësuese për shkollat.”²¹ Pesë javë më vonë në *Gazeta e Korçës*, VII, 05 shtator 1925, pas përfundimit të këtij kursi, 12 arsimtarët pjesëmarrës shprehën mirënjohje ndaj përkushtimit që profesor Kamsi pati ndaj tyre përmes një artikulli. Në fund të artikullit të 12 arsimtarët pjesëmarrës kishin firmosur shkrimin në shenjë mirënjohjeje ndaj profesor Kamsit me këtë dedikim: “Për drejtorin e kursit, profesor Kamsin, i cili me aktivitet dhe energji

¹⁸ Bisedimet parlamentare, 1922, pjesa I, Tiranë, 2012, Mbledhja X e Këshillit Kombëtar, fq. 110.

¹⁹ AQSH, fondi 669, v. 1923, d. 8, fq. 5.

²⁰ Mirela Kamsi Gurakuqi, vep. cit.

²¹ *Gazeta Zëri i Korçës*, nr. 5, 1 gusht 1925.

të palodhur përdor metodën më të pëlqyeshme për zhvillimin e mësimave didaktike, prej të cilave po kemi një dobi tepër të madhe. E falënderojmë nga thellësia e zembrës dhe e përgëzojmë për këto cilësi që ka.”²² Po në këtë vit, më 1924, ishte drejtor dhe mësimdhënës në një kurs pedagogjik për mësuesit e qytetit dhe të qarkut. Nga viti 1926 deri më 1928 punoi në Institutin Tregtar në Vlorë, u emërua drejtor nga Ministria e Arsimit. Konkretisht, më 1926 ishte drejtor i Shkollës Tregtare dhe i Konviktit të Ujit të Ftohtë në Vlorë. Në këtë pozicion ai shpërblehet me një pagesë prej 300 fr. ari.²³

Përveç paraqitjes së këtyre fakteve mekanike, ajo që nuk mund të anashkaloj është pikërisht një letër e Kolë Kamsit, që mban datën 31 dhjetori 1926, në Vlorë dhe i drejtohet revistës *Diturija*, ku ai dha një kontribut të gjerë në botimin e disa shkrimeve. Tekstualisht, Kolë Kamsi shprehet kështu në letër: “Me vjetin e ri të më njehni edhe mue si pajtimtar i së përkohshmes *Diturija*, qi ka nise të botohet nën drejtim të Z. s’uej.”²⁴ Më tej në letër vihet re edhe fryma e tij perëndimore për të kontribuar me disa mendime të shkrimtarëve të huaj, kryesisht në gjuhën frënge dhe italiane: “Përnjher po ju dërgoi edhe disa mendime të zgjedhura shkrimtarësh të huej, të cilat i kam përmbledhe mbas subjektit qi kam kështu të botohen veçmas ndër numra të përkohshmes.” Më tej vijon: “Disave u kam vu para origjinalin e men të përkthimin sidomos të men-

dimeve në gjuhën frëngjishte e italishte”.²⁵ Gjatë viteve 1907-1928 ka qenë veprimtar i shquar i lëvizjes arsimore e kulturore në Vlorë dhe anëtar i shoqërisë “Lidhja e arsimitarëve” të Vlorës.

Gjatë viteve 1928-1936 punon në Gjimnazin e Shtetit në Shkodër në rolin e mësuesit me urdhër nga Ministria e Arsimit me një rrogë prej 360 fr. ari²⁶ dhe nuk shkëputet deri në vitin 1936. Gjatë viteve 1936-1939 është drejtor i Institutit Femëror “Donika Kastrioti”, në Shkollën e Mesme në Shkodër, me urdhër të Ministrisë së Arsimit, duke arritur një pagesë prej 400 fr. ari.²⁷ Gjatë viteve 1939-1940 është në Institutin “Nana e Skënderbeut” në pozicionin e drejtorit në Tiranë me një pagesë prej 400 fr. ari.²⁸ Në vitin 1940 caktohet nga Ministria e Arsimit anëtar në Komisionin Teknik të hartimit të teksteve dhe së bashku me Aleksandër Xhuvanin, Karl Gurakuqin, Ernest Koliqin dhe Eqrem Çabejn punuan intensivisht për hartimin e teksteve të gjuhës shqipe dhe antologjive të letërsisë shqiptare për shkollat shtetërore. Në vitin 1940 punon pranë Institutit të Studimeve Shqiptare themeluar nga profesor Ernest Koliqi, i cili shërbeu si drejtues i këtij institucioni me sekretar at Zef Valentinin. Ky institucion u krijua për të zhvilluar veprimtari shkencore, në të cilin u përfshinë studiues të gjuhës, letërsisë dhe artit. Anëtarë të këtij institucioni ishin intelektualë të shquar, si: Aleksandër Xhuvani, Ekrem Vlora, Eqrem Çabej, Karl Gurakuqi, Kolë

²² Mirela Kamsi Gurakuqi, vep. cit.

²³ AQSH, fondi 803, dosja II-134, fq. 50.

²⁴ AQSH, fondi 823, dosja 5, fq. 6-7.

²⁵ Po aty.

²⁶ AQSH, fondi 803, fq. 50.

²⁷ Po aty, f. 50.

²⁸ Po aty, f. 50.

Kamsi, Lasgush Poradeci, Lazër Shantoja, Sotir Kolea, Vangjel Korça etj. Më 1942 ky institucion u quajt Instituti Mbretnuer Shqiptar dhe varej direkt nga Kryeministria.²⁹

Po nga Ministria e Arsimit në vitet 1942-1945 emërohet në Gjmnazin e Shtetit në Shkodër. Në vitin 1944 Instituti i Studimeve u riorganizua dhe u quajt Instituti për Studime e Arte. Kamsi punon pranë këtij institucioni për zgjerimin e fushave të kërkimit e të numrit të studiuesve shqiptarë, tashmë të ndarë në tri degë: gjuhësi, arte dhe shkencë natyrore e teknike. Në këtë institucion u përfshinë edhe intelektualë të tjerë të njohur të kohës, si: Ali Asllani, Arshi Pipa, Hamdi Sulçebe, Hasan Dosti, Krist Maloki, Kristo Floqi, Ndoc Nikaj, Mid'hat Frashëri, Odhise Paskali, Spiro Konda, Vasfi Samimi, Vedat Kokona etj.³⁰

Në vitet 1945-1946 emërohet përsëri nga Ministria e Arsimit si mësues në Shkodër në Gjmnazin e Shtetit. Më 1945-1947 gjendet përsëri në Shkodër në pozicionin e mësuesit dhe më 1.7.1945 në Liceun e Shtetit në po të njëjtin pozicion.³¹

Vitet 1947-1948 do ta gjenin në të njëjtin profesion në Gjmnazin e Shtetit në qytetin e tij të lindjes. Për të vijuar në këtë rrjedhë, më 1948 ai punon për pak kohë në Institutin e Studimeve në Tiranë, në pozicionin e folkloristit, si mbledhës e studiues. Në vitin 1948 emërohet në Tiranë pranë Institutit të Shkencave, institut ky që kishte trashëguar, përveç veprimtarisë, arkivin dhe bibliotekën e çmueshme

albanologjike të Institutit të Studimeve Shqiptare, themeluar nga profesor Ernest Koliqi. Në një procesverbal të Mbledhjes së Dytë të Asamblesë së Përgjithshme të Institutit të Studimeve, mbajtur në sallën e Bibliotekës Kombëtare në qershor 1948, mbledhja hapet me dr. Manol Konomin, ku fton anëtarët të bëhen pjesë e diskutimeve e propozimeve, pas referateve që do të paraqiten, ndër bashkëpunëtorët për seksionin e gjuhës dhe të literaturës veçohet edhe emri i Kolë Kamsit.³²

Në vitet 1950-1955 rikthehet profesor i gjuhës dhe i letërsisë në Gjmnazin (tashmë në vitet e regjimit komunist me emërtesën “28 Nëntori”) e Shkodrës dhe njëkohësisht profesor në shkollën pedagogjike “Shejnaze Juka”.³³ Për të respektuar këtë figurë të shquar të kulturës shqiptare, më 1955 do të zgjidhej Kandidat i Shkencave. Më 2 shtator 1957 themelohet Instituti i Lartë Pedagogjik 2-vjeçar në Shkodër dhe Kamsi emërohet pedagog i folklorit dhe i gjuhës shqipe në Fakultetin e Gjuhës dhe Historisë. Në këtë institucion si dhe paralelisht në Gjmnazin e Shtetit vazhdoi punën deri më 25 shkurt 1960, vit në të cilin ndahet nga jeta në moshën 74-vjeçare, pasi kontribuoi 53 vjet në vendosjen e themeleve të arsimit kombëtar shqiptar. Po në këtë vit ai do të mbante edhe një fjalim në varrezat e Shkodrës me rastin e sjelljes së eshtrave të Luigj Gurakuqit. Më 24 shkurt të vitit 1960, një ditë para se të mbyllte sytë përgjithmonë, teksa i dorëzonte i shtrirë në shtrat veprën e tij, Fjalorin Arbërisht-Shqip, prof. Mahir Domit, ai i

²⁹ Mirela Kamsi Gurakuqi, vep. cit.

³⁰ AQSH, fondi 803, fq. 50.

³¹ Po aty.

³² AQSH, d. 1230, v. 1957, fq. 18.

³³ AQSH, fondi 803, fq. 50.

thotë ngadalë: “Po vdes i qetë. Zotimin e marrë para Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë e mbajta.”³⁴

Për hartimin e Fjalorit Arbërisht-Shqip Kolë Kamsi ishte ngarkuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe Historisë në Tiranë, por duke qenë se gjendja e tij shëndetësore po përkeqësohej, ai punoi pa u lodhur ditë e natë dhe tashmë u ndie i qetë, pasi mundi ta dorëzonte punimin brenda afateve të përcaktuara nga Instituti. Por, edhe pse i përfunduar, fjalori i dorëzuar brenda afateve të caktuara nga ky institucion do të “flinte” për dyzet vjet me radhë në raftet e Institutit të Shkencave në Tiranë. Botimi i fjalorit u mundësua në vitin 2000, pas një redaktimi nga profesor Ferdinand Leka.

Ja se si do të pasqyrohej shkurtimisht rrugëtimi 53-vjeçar në fushën e arsimit i intelektualit të shquar Kolë Kamsit:

1907-1915 – mësues i gjuhës shqipe në qarkun e Vlorës;

1915-1916 – drejtor i shkollës së parë fillore për djem në prefekturën e Vlorës;

1916 – drejtor dhe mësues i një kursi afatshkurtër pedagogjik në Vlorë për arsimtarët;

1917-1920 – mësues në qarkun e Vlorës;

1907-1928 – anëtar dhe veprimtar i klubit “Labëria” dhe shquhet si veprimtar i lëvizjes arsimore e kulturore “Lidhja e arsimtarëve” në Vlorë;

1920 – mësues në Shkollën qytetase Françeskane, Shkodër;

22.07.1922-03.08.1922 – delegat në Kongresin II Arsimor, Tiranë;

1922-1924 – mësues i gjuhës shqipe dhe letërsisë në gjimnazin “28 Nëntori”, Shkodër;

1924 – drejtor i shkollës fillore “Teuta” në Shkodër;

1925 – drejtor dhe pedagog i kursit pedagogjik për mësuesit në qarkun e Korçës;

1926 – drejtor në Shkollën e Mesme Tregtare në qarkun e Vlorës dhe drejtor i konviktit në Ujin e Ftohtë (Vlorë);

1927 – emërohet drejtor i Institutit Tregtar në qytetin e Vlorës;

1928-1936 – mësues në Gjimnazin e Shtetit “28 Nëntori”, Shkodër;

1936 – drejtor i Institutit Femëror “Donika Kastrioti”, Shkodër;

1937-1939 – mësues në Gjimnazin e Shtetit, Shkodër;

1939 – drejtor i Institutit Femëror “Nënë e Skënderbeut”, Tiranë;

1940 – anëtar në Komisionin Teknik të hartimit të teksteve pranë Ministrisë së Arsimit;

1940-1942 – anëtar në Institutin e Studimeve Shqiptare, Tiranë;

1942 – drejtor i Gjimnazit të Shtetit “28 Nëntori”, Shkodër;

1944 – punon disa muaj pranë Institutit të Studimeve, Tiranë;

1946-1947 – mësues i gjuhës shqipe në shkollën unike të qytetit të Shkodrës;

1948 – emërohet në Tiranë, pranë Institutit të Shkencave;

³⁴ Mirela Kamsi Gurakuqi, vep. cit.

1950-1960 – rikthehet profesor i gjuhës dhe i letërsisë në gjimnazin “28 Nëntori”, Shkodër, dhe profesor në shkollën pedagogjike “Shejnaze Juka”.

1955 – zgjidhet Kandidat i Shkencave pranë Institutit të Shkencave, Tiranë;

1957-1960 – pedagog i folklorit dhe i gjuhës shqipe në Institutin 2-vjecar dhe njëkohësisht në gjimnazin “28 Nëntori”.

Duke parë gjithë këtë rrugëtim të personalitetit Kolë Kamsi, do të ishte e pakuptimtë të njihnim historinë e kulturës e të arsimit shqiptar pa emrin e Kolë Kamsit. Do të ishte e pakuptimtë apo e paplotë të njihnim historinë e folklorit e të kulturës pa atë i cili bëri emrin e kësaj historie.

Veprimtaria e Kolë Kamsit

Ndër kontributet e mëdha që la Kolë Kamsi ishin edhe veprat e tij. Sa u takon veprave të Kolë Kamsit, mund të listojmë një shumësi të tilla. Veprimtaria kërkimore-shkencore e Kamsit shtrihet në një hark kohor prej 50 vjetësh (1907-1960). Studimet e tij albanologjike vihen re në këto aspekte: të gjuhësisë, letërsisë, folkloristikës dhe historisë. Në fushën e gjuhësisë u dallua me veprën *Manual praktik i gjuhës shqipe* e shkruar në dy gjuhë, italisht dhe shqip, për strukturën gramatikore të gjuhës shqipe.³⁵ Pati tri botime, në Zarë të Dalmacisë më 1930 dhe në Shkodër më 1940 e 1941. Një tjetër kontribut i padiskutueshëm janë dhe monografitë *Jeta dhe vepra e Frang Bardhit* dhe *Disa vërejtje gjuhësore mbi veprën e Pashko Babit*.

³⁵ “Kolë Kamsi për arbëreshët”, revista *Phoenix*, 2018.

³⁶ Po aty.

³⁷ Po aty.

Tituj të tjerë veprash janë edhe ata të krijimtarisë letrare. Më konkretisht, Kamsi ishte autor i disa poezive për fëmijë, disa tregimeve edukative, të cilat në vetvete ishin përshtatje në shqip të shkrimtarëve të huaj. Ndër përkthimet mund të përmendim përkthimin që i bëri Andersenit, Lasingut, vëllezërve Grim, Hygoit, Bokaços, Tolstoit e shumë emrave të tjerë të letërsisë botërore, duke sjellë pranë lexuesit shqiptar kryeveprat e kësaj letërsie. Sa i takon fushës së historisë, Jup Kastrati veçon disa nga veprat e tij, të tilla si: *Udhëtim i Skënderbeut në Romë, Dita 28 Nëntori, Kryengritja e Malësisë së Madhe*, një tjetër artikull mban emrin *Fatosat e Traboinit që u vranë në kryengritjen shqiptare të vitit 1910-1911* dhe për të vijuar me *Një letër Abdyl Frashërit e Françesko Krispit* dhe shumë tituj të tjerë.³⁶

Kamsi botoi *Dokumenta të Agimit të Lirisë* me rastin e 25-vjetorit të pavarësisë. Ky botim përfshinte promemorie, protesta, peticione, memorandumet e kolonive shqiptare në Egjipt, Rumani e Turqi, si dhe artikuj të dërguar nga shoqëritë dhe klubet shqiptare që vepronin në emigrim.³⁷ Gjithashtu, ishin një pjesë e madhe e të gjitha dokumenteve letrare që u ishin dërguar Fuqive të Mëdha për njohjen e Shqipërisë. Ndërsa në lëmin e publicistikës botimet e tij gjenden tek *Albania* e Londrës e vitit 1907, te *Kalendari Kombiar* në Sofje i vitit 1912, te *Përparimi* në Shkodër më 1915. Shkrimet e tij do të zinin vend në artikujt e *Corriere della Puglie* me një numër të posaçëm mbi Shqipërinë më 1917, te *Kuvendi* në Romën i vitit 1919, *Edukata*

e re e vitit 1950 në Tiranë. Botimet e tij do të ishin prezente tek *Agimi* i Shkodrës i vitit 1920, te *Dituria* e Tiranës e vitit 1928 e shumë të tjera.³⁸ Kryevepra e tij është cilësuar Fjalori Arbëresh, që u botua pas 40 vjetësh. Fjalori ka rreth 8000 fjalë dhe fraza të nxjerra drejtpërsëdrejti nga veprat e shkrimtarëve arbëreshë dhe nga poezia popullore e arbëreshëve të Italisë. Karlo Kamsi shprehet se ky fjalor ka qëndruar për 40 vjet në Institutin e Gjuhësisë, në dorëshkrim: “E kam gjetur në një magazinë me ndihmën e Bahri Becit, i cili drejtonte atëherë këtë institucion.”³⁹

Duke filluar nga viti 1907 Kolë Kamsi punoi pare-shtur mbi fonetikën, morfologjinë dhe veçanërisht për leksikun e arbërishtes. Një ditë para se të vdiste ai i dorëzoi në shtrat në shtëpinë e vet në Shkodër prof. Mahir Domit veprën e tij jetësore dhe më të mirën e krijimtarisë së tij shkencore, Fjalorin e Dialektit Arbëresh, më 23 shkurt 1960, duke i thënë këto fjalë: “Po vdes i qetë. Zotimin e marrë para Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë e mbajta.”⁴⁰ Fjalori ka rreth 10.000 fjalë e fraza të nxjerra drejtpërsëdrejti nga veprat e shkrimtarëve arbëreshë dhe nga poezia popullore e shqiptarëve të Italisë, duke filluar nga Matranga e deri në ditët e sotme, pra më 1960.

Fjalori Arbërisht-Shqip u botua në vitin 2000. Kamsi u bë i njohur si studiues me monografinë *Shqiptarët e Italisë*. Çdo muaj për çdo vit rresht u botua në të përkohshmen *Leka* në Shkodër nga viti 1934 deri më 1944. Në fushën e gjuhësisë ai u

dallua me veprën *Manual praktik i gjuhës shqipe*, shkruar në italisht dhe në shqip, mbi strukturën gramatikore të gjuhës shqipe.⁴¹ Me rëndësi është edhe bashkëpunimi i tij për Fjalorin Italisht-Shqip të Fluvio Kordinjanos. Për Institutin e Studimeve, më 1948, Kamsi redaktoi veprën *Material leksikor* të mbledhur në rrethin e Gjakovës nga Murat Paci, ish-nxënës i Gjimnazit të Shtetit të Shkodrës që u vra nga fashistët në vitin 1943.

Për historinë e letërsisë shqiptare, përveç artikujve mbi shkrimtarët arbëreshë, Kolë Kamsi botoi punime me vlerë për Pashko Vasën, Filip Shirokën, Gjergj Fishtën, Luigj Gurakuqin, Fan Nolin, Justin Rrotën e shumë të tjerë. Gjithashtu, mjaft interesante janë edhe artikujt mbi figurën e Ismail Qemalit, Miss Edith Durhamit dhe shumë emra të tjerë. Folkloristika është një nga zhanret më të spikatura të Kamsit. Konkretisht, ai mbetet një nga studiuesit më të mirë të proverbave të shqipes me veprën e tij *Goja e popullit tonë*. Ky libër përmbledh thënie popullore të shkurtra. Në fushën e krijimtarisë së tij letrare janë për t'u vënë në dukje edhe disa vjersha apo tregime për fëmijë.

Shkurtimisht, disa nga titujt e veprave janë:

Kolë Kamsi, abetarja *Jeta e re*, shtypur në Bari të Italisë, shtypshkronja “La italiana”, ribotohet duke u përmirësuar botimi i parë tri herë në Bari në po të njëjtën shtypshkronjë, Vlorë, 1915, 72 faqe.

Kolë Kamsi, *Lulet e mendimit*, antologji me vjersha të mbledhura për shkollat filllore, botuar në Itali, Vlorë, 1917, 52 faqe.

³⁸ Gazeta *Shekulli*, nr. 2926, 2010, fq. 16-17.

³⁹ Gazeta 55, 2013.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Po aty.

Kolë Kamsi, *Mësime përmbi natyrën*, përshtatur sipas programit të diturisë së natyrës për shkollat filllore, botuar në Itali, Vlorë, 1919, 60 faqe.

Kolë Kamsi, *Manuale pratico della lingua albanese*, Zara, 1930, ribotuar më 1940, 1942, 224 faqe.

Kolë Kamsi, bashkautor me Ndue Palucën e Ernest Koliqin, *Shkollë e jetë*, vëllimi I, antologji për shkollat e mesme, tekste shtetërore, shtëpia botuese "Ora", Shkodër, 1935, 288 faqe.

Kolë Kamsi, bashkautor me Karl Gurakuqin, *Te praku i jetës*, libër leximi për klasën e parë dhe të dytë të shkollës së mesme, tekste shtetërore, Tiranë, 1940, ribotuar më 1942, 449 faqe.

Kolë Kamsi, bashkautor me Karl Gurakuqin, *Rreze drite*, për klasën e tretë dhe të katërt të shkollës së mesme, tekste shtetërore, Tiranë, 1941, 538 faqe.

Visaret e kombit, vëllimi IX, folklor, përmbledhje mbi zakonet dhe gjuhën popullore të botuara në revistën *Leka*, mbledhur nga Kolë Kamsi, botim i Ministrisë së Arsimit nr. 9, shtypur në shtypshkronjën "Zoja e papërlyeme", 1943, 192 faqe.

Bota shqiptare, antologji për kursin e naltë të shkollës së mesme, mbledhur nën kujdesin e Xhuvanit, Kamsit, Çabejt, Gurakuqit, Koliqit, botim i Ministrisë së Arsimit, antologji me 616 faqe, tekst shtetëror për shkollat e mesme, Tiranë, 1943.

Shqiptarët shqiptarë, pjesa II, Kamsi me Ernest Koliqin dhe Karl Gurakuqin, botim i Ministrisë së Arsimit, Tiranë, 1941.

Këto tekste u përdorën nga nxënësit për tri-dhjetë vjet (1915-1945) dhe u hoqën nga kurrikula

shkollore në vitin 1945, vit në të cilin po instalohesh diktatura komuniste. Krahas teksteve shkollore, Kamsi botoi sistematikisht artikuj metodikë për mësimdhënien me karakter shkencor-arsimor, për zbërthimin e temave mësimore sipas metodologjive të reja, në revistat dhe gazetat e periudhës 1907-1960, brenda dhe jashtë vendit. Mjafton të përmendim disa prej tyre, si: revista *Albania* duke përdorur pseudonimin Komneni (Londër, 1897-1907, 1909), revista *Corriere della Puglie* (numër i posaçëm mbi Shqipërinë, 1917), revista *Kuvendi* (Romë, 1919), revista *Hylli i dritës* (Shkodër, 1913-1914, 1921-1924, 1930-1944), revista *Kalendari Kombiar* (Sofje, 1912), revista *Përparimi* (Shkodër, 1914-1916), gazeta *Përlindja e Shqipënisë*, revista *Agimi* (Shkodër, 1919-1922), revista *Shkolla e re* (Shkodër, 1921), revista *Leka* (Shkodër, 1929-1940, 1943-1944), revista *Shejzat* (1957-1974, 1978), revista *Kalendari i veprës Pijore* (Shkodër, 1927), *Diturija* (Tiranë, 1928), *Edukata e re* (Tiranë, 1930), *Shkolla shqiptare* (Tiranë 1941), *Buletin për shkencat shoqërore* (Tiranë, 1956), *Buletin për shkëmbimin e eksperiencës* (Shkodër, 1954), *Nëndori* (Tiranë, 1955-1960), *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, seria shkencat shoqërore (Tiranë, 1957-1960).

Në bazë të kërkimeve arkivore kam mundur të studioj disa nga dorëshkrimet e Kolë Kasmit mbi arbëreshët e Italisë, por jo vetëm për të parë kështu më nga afër kontributin e tij. Një shkrim të posaçëm Kolë Kamsi i ka kushtuar figurës së Milo Duçit, i njohur ndryshe si Sulo Malësori. Në shkrimin e tij ai e quan atë si një famullitar të vjetër të Rilindjes Kombëtare, duke nxjerrë në pah kontributin e tij. Kolë Kamsi shkruan: "Ka qenë një puntuer i palodhur që me pendë ka ndezë e mbajtë gjallë në kolonin e

shqiptarëvet të Misirit, flakën e atdhedashurisë e i ka sjellë shërbime të mëdha ç'është shqiptare e gjuhës shqipe.⁴² Njëkohësisht, Milo Duçi është autor i një numri veprash, duke pasur meritime jo vetëm si gazetar, por dhe si shkrimtar i dialektit tosk.

Një tjetër shkrim i Kolë Kamsit është edhe ai mbi heroin tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeun. Në shkrimin e tij Kamsi shkruan për dhuratën që Ferdinanti I i bën Skënderbeut, qytetin e Tranit, për ndihmën që i dha kundër armiqve të tij. Kamsi bën me dije se: “Në Palatinë fisi i Kastriotëve qindroi deri në vjetin 1539 nën titullin marchesi.”⁴³ Më tej shkruan se si një pjesë e popullsisë shqiptare zhvendosen nga krahina e Leces në Kalabri. Kamsi i referohet edhe autorit Milan Shuflaj në librin e vet *Serbët dhe shqiptarët*, ku thotë se “farefisi i Gjon Kastriotit mbaroi në XVI qindvjetë”. Një moment interesant që zë vend në shkrimet e Kamsit është edhe Udhëtimi i Skënderbeut në Romë, më 1465, ku i kërkon Papës ndihmë në të holla dhe njerëz. Skënderbeu pritet me nderime të larta: “Nji mori njerzish kish rranë n'at qytet t'amshueshem për të pa me sij luftanin ma të madh të asaj kohe”.⁴⁴ Madje, kujtimi i heroit mbeti i gjallë në Romë, afër Quirinalit gjendet një rrugë “Rruga Skanderbeg”.

Një tjetër shkrim i Kolë Kamsit është edhe ai mbi Pashko Vasën dhe botimet e tij. Në shkrimet e tij ai e cilëson Pashko Vasën si një ndër pionierët e parë të Rilindjes Kombëtare. Më tej ai fokusohet te karriera e tij, duke përmendur këtu ndikimin që pati

te Vasa letërsia frënge e italiane, për të përmendur më tej kontributin që ai ka dhënë si pjesëmarrës në luftën për lirin e Venedikut. Ajo se çfarë është interesante në shkrimin e Kamsit janë fjalët që Pashko Vasa i transmeton sulltanit për propozimin si Vali i Kosovës: “Madhni, jam një nënpunës i Perandoris e mundohem me i shërbye me zell të sinqertë, por jam shqiptar e në më detyroftë Madhnija e Juej me shkue atje, më shtrëngon të baj një tradhti. Do të tradhtoj Perandorin, ose do të tradhtoj atdhen tim.”⁴⁵ E më tej Kamsi vjen me veprat dhe rëndësinë e përhapjes së gjuhës shqipe nga Pashko Vasa.

Një tjetër shkrim i Kamsit është edhe *Gjuha e malli i Atdheut*, është fjala pikërisht për shqiptarët e Italisë. Kamsi e vendos theksin në ruajtjen e traditave dhe rëndësinë e gjuhës si i vetmi element përbashkues. Sigurisht, të bashkëjetosh me një komunitet të huaj ka edhe ndikime që mund të synojnë zhdukjen e gjuhës, por që nuk kanë mundur të arrijnë plotësisht. “Katundet shqiptare të Kalabrijes së Veriut e të Basilikatës e riejten ma tepër karakterin e tyre etnik”⁴⁶ dhe kjo për shkak të pozicionit gjeografik. Sipas shkrimeve të Kamsit, gjuha shqipe nuk flitej vetëm brenda shtëpisë, por edhe jashtë. Sipas tij vihet re veçanërisht në shtresat e ulëta të popullsisë. Madje, ruajtja e dialektikës i ka sjellë mjaft dobi gjuhës kombëtare, për shkak se kanë mundur të nxjerrin fjalë të reja që kanë qenë të moçme. Faktori i martesave është edhe një element që ka ndikuar në humbjen

⁴² AQSH, fondi 823, dosja 2, fq. 1.

⁴³ AQSH, fondi 823, d. 1, fq. 15.

⁴⁴ Po aty, fq. 2.

⁴⁵ AQSH, fondi 823, d. 3, fq. 4.

⁴⁶ AQSH, fondi 823, d. 5, fq. 4.

e gjuhës. “Vërtetë një Katedër e vorfën për mësimin të gjuhës shqipe e të letërsisë shqipe u themelue mbas përpjekjeve të poetit të madh Jeronim de Radës, në vjetin 1822”.⁴⁷ Por nuk arriti të funksiononte. Vite më vonë ngrenë zërin edhe shkrimtarë italianë për rëndësinë e gjuhës dhe kjo për hir të studimit si shkencë. Arbëreshët respektojnë edhe kultin e të parëve, në çdo shtëpi shihen simbolet shqiptare. Një aspekt ku fokuson shkrimin e tij janë edhe doket e arbëreshëve. Kështu, në doket e morteve autori citon: “Porsa një pjestar familje ndahet kso jete, grat zhgrehen në vaj e thrasin me fjalët më të mallnghyme, i puthin duer e faqe tue derdhë mbi te lot. Burrat nuk qajnë for pse e kanë për marre. Gratë rrahin kryet me grushta e zhgulin prej kras flokë që i hjedhin përmbi kufomë.”⁴⁸ Rite të tjera që Kolë Kamsi na i bën të njohura ishin edhe ato tek Uji i Bekuem që ishte pagëzim i Jezu Krishtit, rite për Shën Lazarin etj. Kremtja e Rrëshajave ishte një tjetër rit që lidhej me pushtimin e tokave nga Turqit. Veç këtyre, kanë mundur të mbajnë gjallë ritet e martesës.

Një tjetër shkrim përbëjnë edhe *Bestytnit dhe Lojë të Kombtare*, të cilat janë ruajtur tek arbëreshët. Kështu, për shembull, besonin te shtrigat, thyerja e pasqyrës konsiderohej fatkeqësi. Interesante është mbajtja pastër e ambientit në rastin e lindjes së fëmijëve. Pakënaqësia e njerëzve mund të sillte fatin e zi te fëmija. Shkrime interesante të Kolë Kamsit janë edhe proverbat apo aforizmat. Të tilla janë për fenë: *Zoti e për gjithkënd* (Shkodër),

Zoti s’harron, por vonon (Shkodër), për gjendjen e jetës së njerëzve, si: *Mos ha çka të shohç, por ha çka të kesh, Mos më thuej si kje, por më kallxo si je* (Shkodër),⁴⁹ për gjumin e pushimin, si *Gjumi i tepërm, rroba të vjetra, Gjumi nuk ka besë* etj.⁵⁰

Shkrimin e radhës ia kushton listës së revistave shqiptare të botuara nga arbëreshët e Italisë, ndër to janë:⁵¹

L’Albanese d’Italia, në Napoli;

Fiamuri i Arbërit, numri i parë më 20 korrik 1883, në dy gjuhë;

Arbri i ri, ku Gustav Meyer bën një studim mbi shqiptarët;

Ylli i Arbreshvet;

La Nazione Albanese, daton më 15.12.1924, me karakter politik e letrar;

La Gazzetta Albanese, botohet në Romë, Itali, më 1904;

Albania, u botua më 24.12.1929 në shqip e italisht, dhe në anglisht në Nju-Jork, u bë e përmuajshme;

dhe shumë revista e gazeta të tjera.

Një studim tjetër Kamsi ia dedikon edhe Marko Boçarit, ku me anë të këngës popullore synon të ngrejë lart figurën e tij. Kontributi i shqiptarëve të Italisë për Rilindjen Shqiptare mbetet sërish në vëmendjen e Kamsit. Këtu ai u referohet kontribu-

⁴⁷ Po aty, fq. 6.

⁴⁸ AQSH, fondi 823, d. 7, fq. 5.

⁴⁹ AQSH, fondi 823, d. 8, fq. 4.

⁵⁰ Po aty, 2.

⁵¹ AQSH, fondi 823, d. 9, fq. 2, 3, 4.

uesve të huaj, si Meyer, apo autorëve të tjerë për mendimet rreth popullit shqiptar. Si më të vjetrin dokument italo-shqiptar që njihet deri më sot është *Doktrina e krishterë* e Lukë Matrangës, si vepër e parë, u botua më 1592. Te ky dokument vërehet rëndësia si vepër dialektit të arbëreshëve të Sicilisë. Kontribut dhanë De Rada, Dhimitër Kamarda, Zef Skiroi etj. Një moment historik përbëjnë absolutisht dy kongreset linguistike, ndër vendimet që ata marrin janë: themelimi i një Shoqërie Kombëtare, përdorimi i vetëm një alfabeti, botimi i një reviste italo-shqiptare. Arbëreshët kontribuuan edhe në çështje politike të Shqipërisë, duke lobuar për mbrojtjen e saj. Së fundmi, K. Kamsi flet edhe për momentet e vështira të arbëreshëve, madje shumë prej tyre u dënuan për kontributin që dhanë në çështjen shqiptare. Piemonte do të bëhej qendra e arbëreshëve. “Ndër 70 vetë, që u gjykuan prej një gjykatorje së *posaçme në Cosenza*, ma tepër se 40 qenë italo-shqiptarë”.⁵²

Kolë Kamsi gjatë regjimit komunist

Kolë Kamsi jetoi brenda një harku kohor prej 74 vjetësh. Një pjesë të jetës së tij ai e kaloi nën regjimin komunist, një ndër regjimet më të ashpra që përjetoi Shqipëria. Aq ashpër u instalua ky regjim, sa që një prej grupeve më të përndjekura të këtij regjimi diktatorial ishin edhe intelektualët. Shumë prej tyre u dënuan pa gjyqe, u persekutuan, pasi Partia këta persona i shikonte shumë më tepër të arsimuar sesa ajo vetë do të donte. Shumë prej tyre

u kthyen në kërcënim, por fatmirësisht Kolë Kamsi i mbijetoi persekutimit dhe përndjekjes duke qenë se u fokusua tërësisht në punën e tij akademike dhe arsimore.

Gjithsesi, brenda kësaj “lirietëndrydhur” që instaloi regjimi, shumë veta vazhduan të shkruanin të lirë, kjo në lëmin e letërsisë, historisë, folkloristikës, pra në aspektin e kontributit atdhetar. Megjithatë, edhe Kamsi nuk u shpëtoi dot procedurave hetimore dhe në një procesverbal të vitit 1950 nga organet lokale në Shkodër atij i drejtohen disa pyetje të karakterit biografik, për shembull, “pjesmarrja në *L.N.Ç.*”.⁵³ Arsimtari Kamsi nuk ka marrë pjesë as në Ushtrinë Nacionalçlirimtare, madje nuk ka kryer as shërbimin ushtarak. Në pyetjen e radhës që i bëhet se në cilën organizatë ke bërë pjesë para çlirimit ai përgjigjet në formë mohuese, pra nuk ka qenë pjesë e asnjë organizate. “Si arsimtar kam qenë antar i partisë fashiste dhe Bashkimit Profesional në organizatën e Frontit Demokratik në Kryqin e Kuq në Lidhjen Kulturore”.⁵⁴ Kamsi nuk ka qenë dënuar asnjëherë nga gjyqet. Duket se Kamsi ka qenë larg shembujve të internimit të intelektualëve të tij, ai bënte një jetë familjare. E shoqja Gjyzepeina Kamsi ishte shtëpiake, Paolin Kamsi ishte mësues në Rrëshen, djali tjetër Karlo Kamsi ushtronte profesionin e kursistit në Tiranë. Vajza e familjes, Terezina, ishte nxënëse në Shkodër dhe në vlerësimin final të procesverbalit Kamsi etiketohet si njeri i sinqertë.⁵⁵

Kështu, Kolë Kamsin më 19 tetor 1957, me dekret numër 2544, me propozimin e Ministrisë së

⁵² AQSH, fondi 823, d. 12, fq. 10.

⁵³ AQSH, fondi 803, d. II-134, fq. 51.

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Po aty, fq. 52.

Arsimit e Kulturës, presidiumi i Kuvendit Popullor e dekoron me “Urdhrin e Flamurit” me motivacion: “Për kontributin e vlefshëm në edukimin e brezave të rinj gjatë 50 vjetëve punë të rregullt e të pandërprerë në sektorin e arsimit.”⁵⁶ Ndërsa në demokraci Kamsi u dekorua më 1993 dhe iu dha titulli “Mësues i Popullit” me motivacion: “Mësues i fillimeve të arsimit kombëtar shqiptar, studiues i pasionuar i gjuhës dhe historisë, i kulturës dhe traditave kombëtare, botues veprash dhe artikujsh shkencorë, shembull qytetarie, shpirt demokratik e përparimtar.”⁵⁷ Këshilli i Bashkisë Shkodër, me vendim nr. 52, datë 29 qershor 2005, pasi mori në shqyrtim kërkesën e komisionit të vlerësimit të titujve dhe emërtesave dhe kërkesën e sindikatave të pavarura të arsimit, vendosi miratimin e titullit “Kolë Kamsi” për profesionin e mësuesit dhe “Mirënjohja e qytetit të Shkodrës”.

Më 25 shkurt 1960 personaliteti i shquar Kolë Kamsi ndahet nga jeta, duke lënë të përjetshme veprat e tij dhe kontributet në fushën e arsimit. Kamsi u përcoll për në banesën e fundit me një ceremoni madhështore organizuar nga intelektualë të fushave të ndryshme të vendit, përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Akademia e Shkencave Tiranë, intelektualë nga Instituti Pedagogjik dhe Gjymnazi i Shtetit, të cilët së bashku me nxënës shkollash dhe studentë shoqëruan kortezhin e për-motshëm me kurora në duar, nën tingujt e bandës së qytetit përgjatë bulevardit.

Pas vdekjes së tij shumë shkruan për figurën e tij. Ja se si do të kujtohej Kol Palokë Kamsi nga rrethi i ngushtë:

⁵⁶AQSH, d. 1230, v. 1957, fq. 69.

⁵⁷Gazeta 55, v. 2013.

“Unë po rënkoj fort Kolë Kamsin, mikun besnik, shkencëtarin e palodhur. Vdekja e tij është një humbje e madhe për shkencën, për kombin, për familjen, për miqtë, më dhimbset zemra”. (Prof. Maksimilian Lambetz, Leipzig, 1960.)

“Vdekja e ish-nxënësit tonë të dashur Kolë Kamsit është një humbje e madhe të një shkrimtari të dalluem e punëtori të palodhur”. (Prof. Aleksandër Xhuvani, 1960.)

“Figurë intelektuale për t’u vu në pah. Kolë Kamsi përfaqëson një ndër personalitetet më të spikatura të kulturës shqiptare në gjysmën e parë të këtij shekulli”. (Papa Zef Faraco, 1980.)

“Kolë Kamsi iu pat kushtu krejtësisht e më gjithë shpirt arsimit pa pritë shpërblime, pa kërkue lavdërime e çmime. Punonte në heshtje, punonte me sistem e pa u lodhë, prandaj puna e tij ka lanë gjurmë në historinë e arsimit kombëtar dhe të letërsisë shqiptare”. (Prof. Karl Gurakuqi.)

“Kolë Kamsi ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e shkollës shqipe e të arsimit kombëtar, duke dhënë kontributin e tij të çmuar në disa fusha me rëndësi jetike për periudhën në të cilën jetoi. Kamsi gjatë gjithë kohës që jetoi u dallua për kthjelltësinë e tij mendore, fuqinë e analizës dhe sintezës, për thellësinë e problemeve. Njëkohësisht, *gëzonte autoritet në rrethin shkollor dhe intelektual për karakterin e tij burrënor, vullnetin dhe seriozitetin e çështjeve që trajtonte. Ai gëzonte, përveç stimës dhe respektit, edhe dashurinë e të rinjve, si dhe kolegëve për esprin që e karakterizonte*”. (Jup Kastrati, 1960.)

Sipas *Intervistë me vetveten të Petro Markos*, Kamsi ishte “i heshtur, por punëtor i madh. Ai bënte gjuhësi, gramatikë, lexim dhe hartim. E them me plot gojën se na mësoi shqipen mirë: gramatikën, poetët tanë, historinë e shkrimit të shqipes dhe kulturës tonë”.⁵⁸

Përfundime

Edhe gjatë regjimit komunist Kolë Kamsi nuk e ndërpreu rrugëtimin e tij për kontribute të tjera në fushën e arsimit. Madje, në këto vite Kamsi emërohet në Institutin e Lartë të Studimeve, konkretisht më 1950. Ai nderohet me Urdhrin e Flamurit. Duket se Kolë Kamsi ishte një nga intelektualët e paktë i cili nuk u persekutua në kampet e egra të regjimit komunist, qoftë edhe nuk u dyshua për diçka të tillë. Kamsi nuk u kthye asnjëherë në rrezik apo kërcënim për ideologjinë e asaj kohe, ai mund të jetonte edhe nën këtë sistem, i lirë ose jo në të menduarin e tij. Synonte vetëm një gjë: çfarë mund të bënte ai më shumë për vendin e tij, si mund të kontribuonte? E kjo mund të vinte vetëm nëpërmjet studimeve të tij.

Një komb mund të përmirësojë të ardhmen e tij, fatin e tij dhe mund të jetë më shpresëdhënës vetëm me anë të arsimit. Një komb i arsimuar, rrjedhimisht, është dhe një komb i lirë në mendim dhe në shkrim. Ndoshta çdokush në komunizëm zgjodhi një formë të jetesës, një formë motivimi. Kamsi zgjodhi pikërisht dijen dhe studimet e mëtejshme duke i shërbyer popullit të tij.

BIBLIOGRAFIA

AQSH, f. 803, Ministria e Arsimit, D. II-134.

AQSH, f. 823, d. 5.

AQSH, f. 823, d. 5/1.

AQSH, f. 823, d. 1.

AQSH, f. 823, d. 2.

AQSH, f. 823, d. 3.

AQSH, f. 823, d. 7.

AQSH, f. 823, d. 8.

AQSH, f. 823, d. 9.

AQSH, f. 823, d. 12.

AQSH, f. 669, v. 1923, d. 8.

AQSH, d.1230, v. 1957.

Bisedimet Parlamentare 1922, Tiranë, 2012.

Gazeta *Ditë e re*, Tiranë, 23.07.1922.

“Kolë Kamsi, punëtor i palodhur në lëmin e arsimit e kulturës kombëtare”, gazeta 55, Tiranë, 2013.

“Familja Kamsi, intelektualët e djeshëm e të sotëm të Shkodrës”, gazeta *Shekulli*, nr. 2926, Tiranë, 2010.

Gazeta *Zëri i Korçës*, nr. 5, 1925.

[http://:Konica.al](http://Konica.al).

Petro Marko, *Intervistë me vetveten* (Tiranë: OMSCA).

Mirela Kamsi Gurakuqi, Manuskript mbi fjalën e mbajtur mbi Kolë Kamsin në përvjetorin e 95-të të Gjimnazit të Shtetit.

Kolë Kamsi për Arbëreshët, revista *Phoenix*.

⁵⁸ Petro Marko, *Intervistë me vetveten* (Tiranë: OMSCA), f. 57.

Joana Doda – Studente e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë
Prof. Ass. Dr. Albert P. Nikolla

Përndjekja e shkencëtarëve shqiptarë në vitet 1945-1955; lidhja ndërmjet shkencës dhe ideologjisë – rasti i përndjekjes së inxhinier Petraq Qafokut

Puna shkencore dhe zhvillimi i teknikës në vendin tonë ose, me fjalë të tjera, revolucioni tekniko-shkencor, përparon në rrugë të drejtë, për arsye se teknika dhe shkenca të ne është rezultati i revolucionit proletar të armatosur që rrëzoi pushtetin e vjetër shfrytëzues borgjez, kapitalist dhe vendosi diktaturën e proletariatit.

E. Hoxha

Metodologjia

Në pjesën fillestare analiza do të ketë një qasje filozofike për të sqaruar lidhjen ndërmjet ideologjisë dhe shkencës sipas modelit të filozofisë marksiste dhe nga ana tjetër, do të bëhet një qasje kritike ndaj kësaj rryme, bazuar kryesisht te vepra e filozofit francez Zh. Mariten. Do të shikohen në mënyrë kritike vizioni marksist i njeriut dhe reduktimi i këtij të fundit në një objekt, përkundër kritikës së Maritenit, i cili mbron përmasën njerëzore të personit. Në

këtë pikëpamje do të shohim se si trajtohet rasti i inxhinier P. Qafokut nga gjykata komuniste e nga Sigurimi i Shtetit dhe se si, nëpërmjet dhunës, dijet e tij përdoren për të “mirën socialiste”.

Si rast emblematic të keqpërdorimit të shkencës nga ideologjia marksiste do të shohim edhe atë të shkencëtarit sovjetik Lysenko i cili, me mbështetjen e Stalinit, organizon një dhunë të paprecedentë kundër shkencëtarëve sovjetikë nisur nga ideja se një gjenetist si Mendel duhet të ketë ide të gabuara shkencore, pasi ai ishte një prift.

10 vjet prive lirie

10 vjet prive lirie, me konfirmimin e pasurise, me heqjen e shprehur shtetesise per 10 vjet

Me lutem t'ju be falim per guximin qe uarr t'ju drejtohen juve...
 ...dokumenti Nr. 351 dt. 25.9.1948 te gjykatave te...
 ...Me vendimin Nr. 328 dt. 10.12.1948 te gjykatave te...
 ...Tirane, me 3.7.1979



Në pjesën tjetër, e cila është edhe pjesa kryesore e studimit, do të ndiqet metodologjia e antropologjisë historike, nëpërmjet së cilës analizohen dokumentet arkivore nën dritën e elementeve të pranishme kulturore që na japin mbështetjen e duhur për t'u thelluar në analizë. Në fund do të trajtohen disa elemente klasike të antropologjisë kulturore që konsistojnë në analizën e arkivit familjar të familjes Qafoku dhe atë të Autoritetit të Dosjeve mbi figurën e P. Qafokut. Përgjatë gjithë analizës studimore, rasti i inxhinier Qafokut do të analizohet duke dëshmuar nëpërmjet historisë së tij elementet e ngjashme ose të përbashkëta që pati regjimi komunist në dhunën që përdori ndaj intelektualëve dhe shkencëtarëve shqiptarë me modelin sovjetik që e pati si pikë referimi.

Të tria këto elemente të metodologjisë kanë për qëllim që të nxjerrin qartë në pah arsyet antropologjike të dhunës ndaj shkencëtarëve shqiptarë, duke analizuar rastin e inxhinier Qafokut.

Hyrje

Çështja e ndërtimit të socializmit, po të shihet me vëmendje historia e socializmit në vendet ish-socialiste, madje edhe të Kinës sot, ka qenë dhe është e lidhur ngushtë me shkencën dhe çështjen e progresit teknologjik e industrial. Marks, ati shpirtëror i komunizmit dhe i socializmit shkencor, bën një lidhje të drejtpërdrejtë midis zhvillimit të socializmit dhe lindjes së klasës politike të proletariatit, e cila nga ana e saj pasqyron drejtpërdrejt zhvillimin e një industrie në një shkallë të gjerë.¹ Sipas tij, kalimi nga manifaktura në industrinë në shkallë të gjerë

solli zhvillimin e tregut të punës dhe përqendrimin e një numri të madh punëtorësh në fabrika; pikërisht në këtë pikë kapitalizmi sjell jo vetëm shkatërrimin e vet, por edhe mundësinë e zëvendësimit të tij me një sistem tjetër.

Është e vërtetë që kapitalizmi përgjatë historisë së tij ka sjellë mjaft probleme të natyrës sociale, ekonomike, politike, shëndetësore, ekologjike, por dhe këtu qëndron paradoksi i idesë së zëvendësimit të tij me socializmin: që çdo tentativë për ta tejkaluar atë në planin politik me modelin socialist ka qenë akoma më e dhimbshme në të gjitha rrafshet që përmendëm më sipër. Pra, alternativa që shumëkush, në mirëbesim, mund të ketë pritur nga socializmi, ka rezultuar një dështim i plotë në planin politik dhe për më tepër, në atë moral. Theksoj aspektin moral, sepse regjimet komuniste i kanë dhënë një peshë të jashtëzakonshme lidhjes midis zhvillimit teknologjik e shkencor me moralin, në kuptimin që zhvillimi industrial “prodhon” një moral të caktuar. Duke qenë se ideologjia marksiste e bazon çdo superstrukturë kulturore te marrëdhëniet në prodhim dhe tek ekonomia, atëherë edhe morali që buron nga një model i caktuar ekonomiko-shoqëror do të jetë “i mirë” ose “i keq”, në varësi të modelit ekonomik. Pra, kapitalizmi prodhon moral “të keq”, ndërkohë që socializmi prodhon moral “të mirë” ose më saktë: moral komunist.

Në këtë pikëpamje, shteti socialist është e vetmja njësi absolute që përfshin të gjitha nënjësitë e tjera strukturore e superstrukturore dhe është vetë shteti krijuesi e rojtari i moralit komunist. Nga ky fakt rrjedh qëndrimi i dhunshëm ndaj kujtdo, qoftë intelektual, mësues, inxhinier, punëtor apo çdo

¹ K. Marks, *Capital A Critique of Political Economy*, V. 1, Chap. 15, Progress Publishers, Moscow, USSR, 1977, f. 271.

person tjetër që bie në kundërshtim me moralin komunist. Mirëpo ky fakt na çon doemos drejt një tjetër fenomeni interesant: meqenëse shkencë dhe zhvillimi industrial në një vend socialist që frymëzohet nga idealet komuniste janë drejtpërdrejt të lidhur me ideologjinë dhe moralin, atëherë çdo intelektual apo shkencëtar që ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë teknike në zhvillimin ekonomik, ka po kaq përgjegjësi në aspektin moral, që ka të bëjë me marrëdhëniet e tij me shtetin e shoqërinë. Lidhjen ndërmjet zhvillimit industrial dhe zhvillimit moral në një vend socialist e evidenton në mënyrë mjaft interesante filozofi H. Marcuse. Në studimin e tij mbi marksizmin sovjetik, ai vë në dukje impaktin që ka pasur zhvillimi industrial i Bashkimit Sovjetik në konkurrencë me kapitalizmin perëndimor dhe veçoritë etike të komunizmit sovjetik. Regjimi komunist mendon se është pikërisht zhvillimi i industrisë që do të sjellë lirinë e vërtetë të njerëzve.

Nëse ka një gjë të përbashkët në filozofinë marksiste të shekullit XIX, ajo qëndron në faktin se të gjitha rrymat marksiste theksojnë faktin se zhvillimi i industrisë dhe teknologjisë shikohet si premisë për progres ekonomik dhe moral.²

Nisur nga çka pohuam më lart, persekutimi ndaj intelektualëve në diktaturën komuniste shqiptare ishte i diktuar nga ideologjia komuniste. Për sa i përket çështjes ideologjike, intelektualët ishin një objekt persekutimi, pasi shumica dërmuese e tyre kishin studiuar në vendet perëndimore, jo në Bashkimin Sovjetik, për rrjedhojë ata nuk ishin “njerëz të rinj komunistë”³ të brumosur me moralin


²H. Marcuse, *Soviet Marxism. A critical analyses*, Columbia University Press, New York, 1958, f. 196.

³A. Nikolla, *Njeriu i ri shqiptar. Ndërmjet moralit komunist dhe krizës së tranzicionit*, (Tiranë: Onufri, 2012).



Petraç Qafoku me bashkëshorten / arkiva familjare

Petraç Qafoku, ashtu si anëtarët e tjerë të panumërt të klasave të edukimit, fillon të hasë vështirësi të mëdha nga Sigurimi i Shtetit



Letër dërguar Enver Hoxhës (1978)

Vendimi i gjykatës (1979), pafajësia e Qafokut



“Njeri me autoritet të lartë, përballë njerëzve autoritarë”, kujton një prej tyre, duke vënë në dukje autoritetin që i jepte dinjiteti, jo pushteti

dhe me idealet komuniste. Veç këtij fakti, shumë syresh ishin të edukuar me sensin e pavarësisë dhe lirisë individuale gjatë studimeve të tyre.

Në studimin e tij kritik, studiuesi V. Possenti, duke iu referuar kritikës filozofike që filozofi francez Zh. Mariteni ka bërë marksizmit në planin ideologjik dhe për sa i përket konceptit të lirisë, pohon:

Vetitë kryesore të personit janë pavarësia, njësimi ontologjik, liria, predispozicioni për marrëdhënie njerëzore nëpërmjet të cilave ai komunikon me të tjerët dhe me transhendentalen nën një dinamizëm njohjeje dhe dashurie. Nëse i mohojmë këto cilësi themelore të personit, jemi brenda kornizës së qëllimeve marksiste që e barazon personin me realitetin material.⁴

Këtë model dhe këtë mohim të personit, që del qartë në pjesën e fundit të citimit të mësipërm, komunizmi shqiptar e ushtron që në ditët e para të pushtetit. Intelektuali që ka studiuar, sidomos në Perëndim, është “njeri i vjetër” që duhet detyruar e nënshtruar me dhunë derisa të shndërrohet në “njeri të ri”. Mirëpo, qeveria komuniste, sidomos në dhjetë vitet e para të pushtetit, është në dilemë për sa i përket persekutimit të intelektualëve, sepse nga njëra anë, thirrja e përbrendshme ideologjike e shtyn regjimin drejt persekutimit të pamëshirshëm ndaj tyre, pasi ata përbëjnë rrezik ideologjik; nga ana tjetër, ajo ka nevojë për njohuritë e tyre, sidomos shkencore e profesionale, për të ringritur ekonominë e shkatërruar nga lufta dhe për t’i bërë ballë mjerimit.

Intelektualët dhe shkencëtarët shqiptarë të viteve të para të regjimit komunist ishin me mjaft

⁴V. Possenti, *MARITAIN E IL MARXISMO*, in “Aggiornamenti Sociali”, Novembre 1977, f. 607.

personalitet dhe edukim jo vetëm shkencor, por edhe filozofik e politik, pasi kishin përthithur pashmangshmërisht edhe frymën e përgjithshme kulturore e sociale prej vendeve ku kishin jetuar e studiuar. Kjo i bënte prë të një tjetër elementi persekutimi: ata nuk ishin “njerëz kolektivë”, ose më saktë njerëz të përputhshëm me mënyrën se si komunizmi e konceptonte njeriun.

Vetëm njeriu kolektiv, domethënë njeriu i përgjithshëm, është objekt i ekzaltimit të Marksit. Marksizmi është një humanizëm i ri, por me keqkuptim bazik mbi dinjitetin e personit, i cili e ka dinjitetin vetëm në masën që ia përkufizon kolektivi.⁵

Shkencëtarët shqiptarë të fillimviteve '40 nuk mund të reduktohen në “kolektiv”, ata janë, për vetë natyrën e tyre dhe studimet e kryera, të dalluar prej “turmës”, “kolektivit”. Janë pikërisht këto dy konceptet e fundit që do të jenë të keqpërdorura nga regjimi në dhunën sistematike ndaj shkencëtarëve dhe “armiqve të pushtetit popullor”.

Përvoja e Bashkimit Sovjetik, të cilën regjimi komunist shqiptar e ndjek me përpikëri në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore, ka dëshmuar se shkencëtarët dhunohen dhe përdoren prej regjimit në mënyrë brutale. Theksoj fjalën “përdoren” për vetë ngarkesën kuptimore antropologjike dhe kulturore që ka kjo fjalë nisur edhe nga arsytimi i Zh. Mariten. Pra, personi shndërrohet në send, në objekt dhe si i tillë përdoret, i cenohet krejt dinjiteti i tij. Këtë shembull ndjek me përpikëri udhëheqja komuniste shqiptare nisur edhe nga vija që përcakton diktatori komunist E. Hoxha, vijë e cila jo

vetëm i përjashton shkencëtarët që kanë studiuar në Perëndim që të përfshihen në organet drejtuese shkencore të vendit, por kërkon shfrytëzimin në terren të dijeve të tyre pa pasur qasje në organet drejtuese politikëbërëse. Në organet drejtuese mund të vihen vetëm ata që kanë studiuar në Bashkimin Sovjetik dhe vendet komuniste:

Instituti ynë i Shkencave është i ri, ashtu si çdo gjë në vendin tonë. Në të do të punojnë kuadrot tanë të rinj që kanë mësuar në Bashkimin Sovjetik e në vendet e demokracisë popullore, si dhe njerëzit tanë më të mirë të shkencës, të literaturës, të arteve etj. Atje duhet të punojnë shkencëtarë përparimtarë dhe të hiqen prej andej elementët e padëshiruar e që s'kanë asnjë lidhje me shkencën e re, e që bile mbajnë qëndrim armiqësor ndaj pushtetit tonë. Unë mendoj se dituria e tyre nuk na vlen për në institut, i cili ka qëllime të mëdha; atë dituri të tyre, në qoftë se ka mundësi, ta shfrytëzojmë akoma gjatë, por jo në një institut të tillë.⁶

Një vështrim ky që përcakton strategjinë e regjimit komunist shqiptar mbi shfrytëzimin dhe persekutimin e shkencëtarëve dhe intelektualëve. Shkencëtarët me frymë perëndimore të shfrytëzohen në maksimum, por të mos u jepet asnjë hapësirë pushteti e drejtimi. Modeli më i besueshëm për komunistët shqiptarë është ai sovjetik. Edhe atje përvoja e persekutimit është e madhe dhe tashmë ka krijuar një model. Rasti më emblemantik i persekutimit të shkencëtarëve të Bashkim Sovjetik është ai që lidhet me qasjen ndaj gjenetikës. Bëhet fjalë për rastin e gjenetistit Lysenko i cili, me mbështetjen e drejtpërdrejtë të Stalinit, organizon

⁵ Cfr. J. Maritain, *La filosofia morale*, f. 252

⁶ E. Hoxha, *Vepra*, vëll. 11, f. 243.

rrëmbimet, internimet dhe vrasjet e disa prej shkencëtarëve më të famshëm sovjetikë në fushën e gjenetikës, si: Vavilov, Ivanov, Dubinin, Jebrak, Sashiarov, vetëm se kishin mbështetur tezat e gjenetistit “borgjez” Mendel. Të gjitha zbulimet gjenetike të Gregor Mendelit hidheshin poshtë, sepse konsideroheshin si “shpikje të një prifti”, si zbulime “mistike” dhe antishkencore.⁷

Me të njëjtin paragjykim, të shprehur në forma nga më të ndryshmet, u duhej të përballeshin shkencëtarët shqiptarë që ishin diplomuar në vendet perëndimore.

Petraç Qafoku – inxhinieri me formim perëndimor dhe procesi i persekutimit të ushtruar ndaj tij

Në studimin tim për persekutimin e intelektualëve në dhjetë vitet e para të regjimit komunist kam marrë si rast historinë e inxhinier Petraç Qafokut. I lindur në qytetin e Beratit, më 17 korrik të vitit 1916, në një familje tregtarësh që kanë pasion shkollimin e fëmijëve, mbas mbarimit të shkollës së mesme me rezultate të shkëlqyera, të afërmit e tij, meqenëse Petraçi mbetet jetim që në moshë të njomë, e ndihmojnë të vazhdojë studimet e larta fillimisht në Bukuresht, më vonë në universitetin “La Sapienza” në Romë. Pas përfundimit të studimeve universitare dhe diplomimit në inxhinieri minierash me rezultate të shkëlqyera në vitin 1944, ai vendos të kthehet në Shqipëri, shkon në Berat dhe vihet në dispozicion për të punuar pranë Qeverisë Provizore të sapoformuar aty në prag të çlirimit të vendit.⁸

Ky vendim për t’u kthyer në Shqipëri përmban në vetvete elemente heroike, pasi inxhinier Qafoku ishte krejt i vetëdijshëm për pasojat e mundshme në një regjim diktatorial komunist. Në Itali ka pasur mundësi të njihet me literaturë që përshkruan tragjedinë e persekutimit në Bashkimin Sovjetik. Nga ana tjetër, ai, duke qenë jetim, nuk ka prona në Shqipëri. Ky fakt i jep përmasë të thellë shpirtërore vendimit të tij për t’u kthyer në atdhe, si shprehje e dashurisë së vërtetë për vendin e tij. Siç do ta shohim në vijim, ky fakt del në pah edhe më shumë në një letër që inxhinier Qafoku i drejton diktatorit Hoxha, në të cilën shprehet se gjëja që e lëndon më shumë sesa persekutimi në vetvete është “njolla e tradhtisë”.⁹

Pas çlirimit të vendit inxhinier Qafoku punon në Dikasteret Qendrore që merreshin me ndërtimet dhe me çështjet ekonomike. Vendimi i tij për kthimin në Shqipëri është mjaft fisnik dhe i përgjigjet një klime shpirtërore të shumë intelektualëve shqiptarë të shkolluar kryesisht në Perëndim dhe që e kishin mjaft për zemër fatin e Shqipërisë. Ky interes dhe pasion i tyre i madh për të ardhmen e vendit i bënte ata edhe më të dyshimtë përballë përfaqësuesve të regjimit komunist, pasi këta të fundit ishin kryesisht njerëz të pashkolluar mirë, por me nuhatje politike e të gatshëm për çdo kompromis për të marrë pushtetin. Dyshimi ngrihej natyrshëm kundrejt këtyre intelektualëve të shkolluar.

Nisur nga nevoja e madhe e regjimit për të ardhura në valutë dhe ekzistenca e pak ndërmarrjeve që prodhojnë për eksport, inxhinier Qafoku

⁷ J. Huxley, *La genetica sovietica e la scienza*, Ed. Longanesi, 1977, f. 38-45.

⁸ “Për një kujtim të paharruar”, punim i autorëve: prof. Stavri Buri, prof. Minella Hido, prof. Sotir Guxha, Arkivi familjar i familjes Qafoku.

⁹ Arkivi familjar i familjes Qafoku.

dërgohet në Minierën e Selenicës në fund të vitit 1945 për ta ngritur atë në kushte prodhimi, pasi ishte në gjendje të shkatërruar si pasojë e luftës. Shikojmë në këtë vendim rastin e nevojës ekstreme të regjimit për profesionistë të aftë të cilët të mund t'i japin një frymë ringjalljeje ekonomisë së rrënuar.

Pa kaluar dy vjet nga puna e tij tejet e përkushtuar, ai arrestohet më 18 shtator të vitit 1947 në Tiranë. Ky fakt futet në kontekstin e fazës së parë të dhunës që regjimi kryen ndaj intelektualëve. Elitat komuniste janë thujse inekzistente dhe çdo sukses i intelektualëve e i shkencëtarëve në vitet e para të regjimit shihet me mjaft dyshim dhe frikë. Nga njëra anë ka një nevojë të madhe për intelektualët, nga ana tjetër regjimi i druhet suksesit të tyre dhe përdor metodën e “kulaçit e kërbacit”. Në fillim regjimi u jep mundësi të diplomuarve të vënë në praktikë njohuritë e tyre në sektorët e rëndësishëm ekonomikë të vendit dhe më vonë, sapo ata janë të suksesshëm, fillon paranoja e regjimit me burgosjet e vrasjet masive nën pretextin e sabotimit. Teoria e sabotimit ka qenë një ndër më famëkeqet, pasi është përdorur si pretext për të dhunuar të ashtuquajturit “armiqtë e klasës” thujse në të gjithë sektorët e ekonomisë, shkollës e politikës.

Dhuna ndaj inxhinier Qafokut nje skaje të tmerrshme, sidomos në hetuesi. I mbajtur për një vit në hetuesi për ta nënshtruar që të bënte deponime të rreme kundër kolegëve të tij, për t'i paraqitur ata si agjentë të shërbimeve të huaja, ai dëshmon një dinjitet dhe qëndresë të pashoqe. Për 24 ditë me radhë është lënë pa ushqim dhe vetëm me një sasi

të vogël ditore uji. Pritshmëria e hetuesisë mbetet duarthatë: asnjë dëshmi e rreme nuk del nga goja e tij dhe asnjë dokument nuk firmoset nga inxhinier Qafoku kundër kolegëve të tij.

Akuza ndaj inxhinier Qafokut, si në shumicën e rasteve ndaj intelektualëve dhe shkencëtarëve, lidhet me absurdin e “sabotimit”. Si në rastin e inxhinierëve të Kënetës së Maliqit, ashtu edhe për inxhinier Qafokun shfaqet fantazma e sabotimit. Në dosjen e dënimit të tij, e cila na u vu në dispozicion nga AIDSSH, vërejmë një koordinim të pamagjueshëm të dashakeqësisë, injorancës, intrigës dhe tinëzarisë së hetuesve, prokurorëve dhe gjykatësve. Sigurisht, këto dinamika antropologjike janë të ushqyera nga dogmatizmi politik që e impononte pushteti. Ajo çka e bën groteske formulimin e aktakuzës është fakti se dallohet qartë që regjimi e ka marrë vendimin për ta dënuar inxhinier Qafokun, me hir apo me pahir. Kjo situatë, në të cilën të gjitha figurat e një grupi të caktuar social kanë të njëjtën mënyrë veprimi me bazë dhunën dhe të njëjtin qëllim për ta dënuar të akuzuarin, përkufizohet nga antropologu francez M. Mauss si “fakt social i përgjithshëm”.¹⁰

Gjatë gjyqit të Gjykatës Ushtarake në proces-verbalin e mbajtur hidhet akuza e bashkëpunimit me fashizmin dhe e sabotazhit.

Prokurorija ushtarake e këtushme, me komunikatën e saja, nr. 242, i ka sjellë kësaj gjykate proces verbalin e mbajtur nga ana e Seksjonit të Sigurimit të Shtetit Tiranë, kundra të pandehurit Petraq Qafoku, i reshtuar dhe i akuzuar si dhe i pajisur me një edukatë fashiste gjat okupacionit

¹⁰ M. Mauss, *Saggio sul dono*, Ed- Einaudi, Torino, 2002.

është treguar Anëtar Aktiv i Partisë Fashiste. Në lidhje me Ing. Taraskinon, Zyberin e të tjerë ka rënë në lidhje me ta dhe në çdo mënyrë është përpjekur të sabotojë punën ekonomike si mbas direktivave të organizatës së agjento sabotatorëve.¹¹

Çdo detaj i akuzës së Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit ka rezultuar i rremë dhe është vetëm në funksion të vendimit të Partisë për ta dënua me çdo kusht inxhinier Qafokun. Sipas paranojës së regjimit, inxhinier Qafoku është një “njeri i vjetër”, është modeli i kundërt i “njeriut të ri”. Formimi i “njeriut të ri komunist” ka qenë një ndër qëllimet më të rëndësishme ideologjike dhe antropologjike të komunizmit shqiptar. Sipas vizionit të ideologëve shqiptarë, një intelektual e ka të vështirë të bëhet një “njeri i ri” i vërtetë dhe për këtë arsye shkencëtarët dhe intelektualët duhet të jenë në frontin më të vështirë të punës (në praktikë!), pasi janë “infektuar” nga teoria që kanë marrë në shkollat perëndimore. Pra, kjo lidhje e ngushtë mes teorisë dhe praktikës, e shpallur dhe e aktualizuar në vendet komuniste (përfshirë Shqipërinë), na ndihmon të kuptojmë më mirë lidhjen antropologjike shumë të ngushtë mes zgjedhjeve praktike dhe moralit marksist. “Njeriu i ri” nuk është një njeri intelektual (ai që di), por një njeri që karakterizohet nga sjellje të përcaktuara nga morali komunist (ai që bën). Kjo na bën të kuptojmë se shkencëtari me përvojë studimore perëndimore është një “njeri i vjetër”, është e kundërta e “njeriut të ri”, është një rrezik për komunizmin. Udhëzimi që diktatori E. Hoxha jep për “njeriun e vjetër” është bazë e punës së institucionit famëkeq të Sigurimit:

Ai (njeriu i vjetër, shënimi im) vepron ilegalisht, duke qenë legal, ai hedh gurin dhe fsheh dorën, ai bie gjoksit, bën be e rrufe se është me këtë rregjim, të cilin e urren, ai ka mësuar të maskohet dhe të ruhet nga furtunat... Ai shfrytëzon, fryn, përhap të gjitha çështjet që i vijnë në dorë dhe që i bien në vesh, ai nxit dobësitë e njerëzve, shfrytëzon autokritikat në interesin e tij, ai mbjell konfuzionin, anarkinë, indisiplinën, nxit dëshirat e ekzagjeruara, nxit vjedhjen, rrugaçërinë, dhe këto nuk i bën hapur, sepse ruhet, i lë t'i bëjnë të tjerët, shumë herë mundësisht njerëzit e mirë, që të kompromentohen dhe ata, të shtojë kështu radhët e tij...¹²

Nevoja e regjimit për profesionalizmin e inxhinier Qafokut bën që ky i fundit të përfshihet në mjaft aktivitete profesionale ku kërkohej ekspertiza e tij, duke filluar prej Kuçovës e deri në Minierën e Selenicës, por natyrisht duhej pasur “kujdes” i madh ndaj tij, pasi ai konsiderohej si një “njeri i vjetër”. Për shumë arsye, por sidomos nisur nga motive ideologjike të ndërtimit të socializmit “me forcat tona” dhe të industrializimit të vendit, regjimi e fut vendin në një aventurë zhvillimi industrial që është krejt e panatyrshme për kushtet e mjera në të cilat ndodhej vendi. Në këtë aventurë, ndonëse me premisa krejt specifike, u fut edhe Shqipëria pas fundit të Luftës së Dytë Botërore. Paradoksi i një modeli zhvillimi teknologjik socialist që do ta nxirrte vendin nga prapambetja iu prezantua shqiptarëve si rruga e së vërtetës dhe e ndërtimit të socializmit.

Menjëherë pas luftës, qeveria komuniste e diktatorit Hoxha, duke ndjekur modelin sovjetik, përqendrohet në zhvillimin industrial, duke e parë

¹¹ Dosja Petraq Qafoku, Arkivi i AIDSSH, f. 3.

¹² *Rruga e Partisë*, n. 7, F. Çami, “Ta kuptojmë dhe ta zhvillojmë drejt luftën e klasave”, 1973, f. 20.

këtë të fundit si shpresë madhore për ndërtimin e socializmit:

Domosdoshmëria e industrializimit diktohej nga nevoja për të krijuar një bazë materialo-tek-nike krejt të re në ekonominë popullore, për të zgjeruar prodhimin e mallrave në vend, për të përgatitur kushtet e riorganizimit të bujqësisë mbi baza socialiste, për të rritur klasën punëtore në mënyrë që kjo të forconte pozitat e saj drejtuese. Industrializimi socialist do t'i shërbente drejtpërdrejt ruajtjes së fitoreve dhe zhvillimit të revolucionit, ndërtimit të shoqërisë socialiste.¹³

Pra, regjimi e shikonte industrializimin si mjet për mbrojtjen dhe zhvillimin e shoqërisë shqiptare bazuar në parimin e barazisë. Në fazat e para, të cilave u referohet edhe studimi ynë, ky lloj komunizmi, sipas një forme “të përshtatur shqiptare”, ecën me modele që nuk i referohen aq shumë teorisë marksiste, por kryesisht modeleve jugosllave apo sovjetike. Një ndër fazat më të dhunshme të këtij procesi është edhe ajo e futjes së Shqipërisë në fushatën e kolektivizimit të bujqësisë, që krijon një tragjedi të vërtetë në popull. Dhuna ishte mjeti i pazëvendësueshëm i kolektivizimit dhe në emër të “barazisë” dhunohej sistematikisht pasuria private e personave dhe e familjeve. Në emër të barazisë shumica ndëshkohet në favor të “klasës udhëheqëse”, që nuk bën gjë tjetër veçse hedh bazat e një falimentimi të pashmangshëm të vetë kolektivizimit dhe sistemit në tërësi. Ja si e përkufizon J. Ratzinger dështimin e zhvillimit që bazohet vetëm te teknologjia si e tillë:

¹³E. Hoxha, *Historia e PPSH*, 1985, f. 241-242.

¹⁴J. Ratzinger, *Caritas in Veritate*, p. 14.

...zhvillimi i popujve degjeneron nëse shoqëria njerëzore mendon se mund të “rikrijohë” vetveten duke u besuar “mrekullive” të teknologjisë. Në të njëjtën mënyrë zhvillimi ekonomik bëhet i rremë dhe i dëmshëm nëse u beson vetëm “mrekullive” të financës për të mbështetur një zhvillim jo të natyrshëm dhe konsumist.¹⁴

Në këtë kontekst absurd të zhvillimit industrial të vendit futet edhe dashakeqësia që regjimi bën kur ndërton aktakuzën për inxhinier P. Qafokun: ky inxhinier nuk i ka premisat morale për të dhënë një kontribut me vlerë ideologjike në ndërtimin e socializmit. Thelbi i moralit komunist kërkon që çdo person duhet të dëshmojë një dashuri të pakufishme për Partinë dhe pushtetin popullor dhe të punojë me vetëmohim për socializmin. Inxhinier Qafoku pohon edhe vetë, me një sinqeritet tipik të një intelektualit të nivelit të lartë, se ai është i edukuar me kulturë dhe edukatë fashiste gjatë studimeve në Romë. Sigurisht, për një mendje të kthjellët e normale kjo nuk do të thotë automatikisht se është agjent i fashizmit. Por për një hetues komunist kjo është premisa kryesore e hetimit.

Ja një pjesë dialogu ndërmjet hetuesit dhe inxhinier Qafokut që nxjerr në pah lartësinë e tij morale, ku sinqeriteti është arma e tij më e fuqishme, që do ta ndihmojë më vonë edhe në reduktimin e dënimit:

Pyetje: Si element dhe kuadro i fashizmit Italtan, çfarë aktiviteti ke kërryhur dhe si e ke ndihmuar regjimin Fashist Italtan?

Përgjigje: *S'kam treguar ndonjë aktivitet pro fashizmit Italian. Megjithëse kam patur një edukatë dhe kulturë fashiste.*¹⁵

Dialogët mes inxhinier Qafokut dhe hetuesit janë një burim mjaft interesant antropologjik për të kuptuar dramën e të akuzuarit dhe anën groteske të regjimit. Këmbëngulja e hetuesit për të nxjerrë në pah mungesën e moralit komunist tek inxhinier Qafoku e detyron këtë të fundit të fillojë ironinë me hetuesin. Tashmë inxhinier Qafoku e ka kuptuar se dënimi është i pashmangshëm dhe përdor një ironi therëse, duke e çarmatosur hetuesin, i cili me pohimet e Qafokut e ndien veten në lartësinë e detyrës si hetues i regjimit komunist:

Pyetje: *Cila ka qënë detyra jote si Shqiptar, të qëndronje e të luftonje fashizmin që okupoi atdheun; apo të ri-ktheheshe në Romë në shkolla dhe në vatrën e fashizmit siç je kthyer?*

Përgjigje: *Detyra ime ishte të qëndronja në Shqipëri si shokët dhe të mirrja pjesë në Lëvizjen N.Ç.L., por unë veprova në të kundërtën, u ktheva në universitetin e Romës Fashiste; qëndrimi im në këtë rast ishte i keq dhe jo i mirë.*¹⁶

Inxhinier Qafoku e pranoi se nuk ishte “njeri i ri”, nuk ishte i përshtatshëm për moralin komunist të Shqipërisë së re. Veç anës morale, të përrputhshme me moralin komunist, mësimet e diktatorit Hoxha të vëna në jetë nga hetuesi në këtë rast nxjerrin në pah edhe faktin se inxhinier Qafoku nuk ka as shpirtin e heroizmit, i cili është i domosdoshëm për “njeriun e ri” komunist.

*...Tipari heroik është një anë e figurës së pasur morale të njeriut të ri dhe nuk mund të përfytyrohet i veçuar nga tërësia e vetive që përcaktojnë personalitetin e tij.*¹⁷

Nga dialogu i sapocituar del në pah mungesa e “heroizmit komunist” të Qafokut. Ai, duke qenë një intelektual i rafinuar, e ka mjaft të qartë anën groteske të heroizmit komunist dhe keqpërdorimin që regjimi u bën njerëzve duke i përdorur si “mish për top”, për këtë arsye zgjedh të luajë me ironinë dhe të pranojë disa të vërteta që mund ta dënojnë, por që nuk e çojnë drejt dënimit me vdekje.

“Njeriu i vjetër” nuk është vetëm moralisht i keq dhe pasiv. Ai, sipas mendësisë së regjimit, vepron kurdoherë kundër pushtetit popullor dhe saboton zhvillimin shkencor e teknologjik të komunizmit. Vetë diktatori E. Hoxha jep direktiva se si duhet pasur kujdes ndaj sabotatorëve dhe ngre “vigjilencën” duke pohuar se intelektualët janë të rrezikshëm, ndërkohë që “njerëzit tanë të rinj” janë ata që do ta ndërtojnë socializmin:

Që në muajt e parë pas Çlirimit na u desh të luftonim dhe të lanim hesapet me sabotuesit italianë, me në krye ish-drejtnesin e shoqërisë italiane, dhe të ndesheshim me punën armiqësore të disa inxhinierëve reaksionarë shqiptarë.

Por si atëherë, kur pothuajse na mungonin fare mjetet dhe kuadrot, ashtu edhe më pas, kur kuadrot tanë për nga dituria dhe eksperiencia ishin, si të thuash, nxënësit e specialistëve sabotatorë

¹⁵ Dosja Petraq Qafoku, Arkivi i AIDSSH, f. 12.

¹⁶ Po aty, f. 13.

¹⁷ “Probleme aktuale të traditës dhe të novatorizmit në letërsinë shqiptare të realizmit socialist”, Akademia e Shkencave të RPSH, IGJL (Tiranë: N. Frashëri, 1975), f. 199-200.

sovjetikë, ne nuk mbetëm pa naftë, për arsye të zotësisë e të vendosmërisë së njerëzve tanë.¹⁸

Pika e parë e aktakuzës fillon me akuzën se i pandehuri P. Qafoku gjatë studimeve në Itali ka përvetësuar kulturën fashiste e për rrjedhojë, ai ka propaganduar fashizmin. Kjo akuzë është mjaft e rëndë përgjatë gjithë kohës së diktaturës, por mund të konsiderohet veçanërisht e rëndë menjëherë pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, kur propaganda komuniste mbi luftën e bënte akoma më të rëndë një akuzë të tillë ku flitej për bashkëpunim me armiqtë fashistë. Pra, inxhinier P. Qafoku ishte një rrezik potencial për komunizmin dhe si i tillë duhej burgosur.¹⁹ Gjithë dialogu midis Qafokut dhe hetuesit ka një peshë të madhe antropologjike dhe nxjerr në pah një hipotezë të ngritur prej vitesh nga filozofi H. Marcuse, i cili pohonte se marksizmi sovjetik është kthyer në një “shkencë të mënyrës së sjelljes”.²⁰ Hetuesi kërkon me ngulm çdo element të “sjelljes” së inxhinier Qafokut. Jemi në një panoramë krejt të ngjashme me atë sovjetike, ku hetuesia dhe mjetet e tjera të dhunës veprojnë ndaj intelektualëve sipas një metode “të trajtimit si fëmijë”.²¹

Rasti i burgosjes, dënimit dhe lirimit të parakohshëm prej burgut të P. Qafokut është mjaft interesant për të evidentuar disa veçori të regjimit që ndodhej përballë dy shtysave të forta në ushtrimin e diktaturës: nga njëra anë ishte nevoja për dhunë dhe terror, e cila ishte thirrja e përbrendshme e

një regjimi diktatorial; nga ana tjetër regjimi është i vetëdijshëm se ka nevojë edhe për lëshime në interes të pushtetit. Antropologu gjerman H. Popitz e shtjellon mjaft qartë këtë veti antropologjike të përdorimit të dhunës nga regjimet diktatoriale në librin e tij *Phänomene der Macht*, ku nënvizon faktin se hapi i parë i ushtrimit të pushtetit është pikërisht përdorimi i dhunës,²² ndërkohë që në një hap të mëtejshëm regjimi përdor instrumentalizimin: kërcënon dhe njëherazi bën lëshime sipas nevojës për të mbajtur pushtetin. Inxhinier Qafoku dhe mjaft profesionistë të tjerë që janë të domosdoshëm për arsye teknike për regjimin, për shkak të përgatitjes së tyre profesionale, i nënshtrohen dhunës pasi ata duhet të kuptojnë se nuk janë të lirë dhe nuk duhet të kenë asnjë pretendim për pushtet. Vetë natyra e personave të përgatitur profesionalisht i bën ata të rrezikshëm për pushtetet diktatoriale, sidomos kur këto të fundit udhëhiqen nga persona mediokër dhe në të shumtën e rasteve nga injorantë. Dëshmitë nga familjarë e të afërm të inxhinier Qafokut na sjellin mjaft rrëfime se si ai është kërcënuar disa herë me vdekje, sidomos përgjatë periudhës së hetuesisë. Antropologjikisht, kërcënimi me vdekje është më i rëndi e më ekstremi dhe nëpërmjet tij, regjimi kërkon bindjen e verbër dhe absolute nga ana e të persekutuarit. Kërcënimi me aktin e vrasjes luan rolin e simbolit antropologjik të fitores absolute të regjimit mbi të persekutuarin e tronditur.²³

Aktakuza vazhdon me hipotezën e bashkëpunimit me inxhinierë të huaj që ndodheshin në

¹⁸ E. Hoxha, *Vepra, vëll.* 33, f. 186.

¹⁹ Dosja Petraq Qafoku, Arkivi i AIDSSH, f. 10.

²⁰ H. Marcuse, *Soviet marxism. A critical analyses*, Columbia University Press, NY, 1969, f. 34.

²¹ Në literaturën e antropologjisë politike mbi komunizmin njihet me termin e gjuhës angleze: “infantilisation”.

²² Heinrich Popitz, *Phänomene der Macht*, II ED, Tübingen, 1992, f. 18.

²³ E. V. Walter, *Terror and Resistance; a Study of Political Violence*, Oxford University Press, NY, 1969.

Shqipëri për shkak të rrethanave të punës për rimëkëmbjen e ekonomisë së shkatërruar nga lufta dhe për shkak të trashëgimisë së një prapambetjeje të theksuar kundrejt ekonomive europiane të asaj kohe. Pra, “armiqtë e huaj” u bashkohet edhe “armiku i brendshëm” e sabotatori inxhinier Qafoku i cili:

Ka patur lidhje me elementa reaksionar të arratisur politik jashtë shtetit, n'Itali i kanë dhënë letra dhe lidhje për elementa reaksionar të vendit t'onë.

Ka patur lidhje me Ing. Taraskonin (Italian) dhe me Prof. Zyber Stanislav, i cili është nxitur nga këta dhe ka sjellur pengesa dhe çrregullime në punimet e kantierit të Kuçovës.

Ka patur dijeni të plotë mbi organizatën agjento-sabotatore (Tekniko-Intelektuale) ku është konsultuar me Ing. Zyber Stanislav dhe Ing. Riza Alizoti.

Ka bërë mbledhje me karakter politik me elementa të ndryshëm kundërshtar që punojnë në këtë minjerë dhe ka sabotuar në prodhimin e katjerit të Selenicës.²⁴

Në kantierin e Kuçovës, me gjithë përkushtimin e jashtëzakonshëm profesional, ai gjatë punës has vështirësi të mëdha nga elementë të Sigurimit të Shtetit të cilët e ndjekin dhe më pas, gjatë seancave gjyqësore, i ngrenë akuzat e bashkëpunimit me të ashtuquajturit “armiqtë e sabotatorë”, si inxhinier Zyber Stanislav dhe inxhinier Riza Alizoti. Përballë këtyre akuzave, inxhinier Qafoku dëshmon një urtësi dhe qetësi të pashoqe. Megjithëse është i vetëdijshëm se këto akuza janë të rreme, ai e di fort mirë se për të tilla akuza të pret dënimi me vdekje.

²⁴ Dosja Petraq Qafoku, Arkivi i AIDSSH, f. 10.

²⁵ Dosja Petraq Qafoku, Arkivi i AIDSSH, f. 15.

As torturat dhe as presioni i tmerrshëm psikologjik nuk e thyejnë që të pohojë dëshmi të paqena. Përballë akuzës se ka marrë pjesë në grupin armik të Kuçovës, ai përgjigjet:

Përgjigje: Nuk është e vërtetë se unë, ingj. Petraqi, të kem marrë udhëzime nga prof. Zyber Stanislava dhe ingj. Riza Alizoti, të kem organizuar rethe kundërshtarë, të kem bërë mbledhje me karakter politik kundra Pushtetit Popullor dhe të kem sabotuar në punën (prodhimet) në kantierin e Selenicës, por kam punuar sa kam mundur për të mirën e pushtetit popullor, deri në ditën e arrestimit tim më 18 shtator 1947.²⁵

Me gjithë pasionin djallëzor të prokurorëve e gjykatësve dhe dënimin absurd me 10 vjet burg të pambështetur mbi prova, regjimi ka nevojë për njohuritë e pashoqe teknike të inxhinier Qafokut. Është momenti i qëndrimit antropologjik instrumentalizues të pushtetit komunist. Përveç dhunës, pushteti përdor edhe mjete të tjera që kanë të bëjnë me liri të përkohshme dhe të kufizuar për shkencëtarët shqiptarë. Të njëjtën strategji regjimi përdor edhe me inxhinier Qafokun. Pas dënimit me 10 vjet burgim dhe me mohimin e vazhdueshëm të akuzave nga Qafoku, organizohet një seancë tjetër gjyqësore në dhjetor të vitit 1948, ku i dënuari shpallet i pafajshëm.

Mirëpo aventurat e persekutimit nuk mbarojnë me këtë akt pafajësie. Ai mbahet vazhdimisht nën mbikëqyrje gjatë punës nëpër kantiere dhe qëndrimi i kuadrove partiakë ndaj tij është tejet mosbesues. Dënimi i tij, edhe pse më vonë doli i pafajshëm,

ishte si një “njollë biografike” e pashlyeshme. Kalvari i vuajtjeve të tij mjerisht ka ndjekur edhe familjen, bashkëshorten dhe dy djemtë. Ata kanë qenë gjatë gjithë kohës së regjimit komunist të vrojtuar nga Sigurimi i Shtetit dhe u janë krijuar shpesh probleme me të drejtën e studimeve për në shkollën e lartë, edhe pse kishin kaluar tashmë rreth 30 vjet nga marrja e pafajësisë.

Një element i rëndësishëm që shpreh praninë e vazhdueshme të dhunës ndaj inxhinier Qafokut është edhe ushtrimi i ofendimit nga ana e regjimit përgjatë kohës kur ai nuk ishte në burg. Sjell në këtë studim edhe dëshmitë e shumta ta familjarëve të Qafokut ku kujtohen raste të shumta të ofendimit para kolektivit apo dhënia e medaljes si “Punëtor i dalluar” për inxhinier Qafokun. Ndonëse ekzistonte edhe medalja “Inxhinier i dalluar”, ai trajtohej si punëtor kantieri dhe jo si inxhinier. Emblematiche mbetet, gjatë studimit tim, një dëshmi e një bashkëkohësi të inxhinier Qafokut: “Ai ishte i jashtëzakonshëm. Njeri me autoritet të lartë, përballë njerëzve autoritarë.” Në këtë perspektivë, për ta kuptuar këtë dëshmi, shpjegimi i filozofes H. Arendt është i përkryer. Në studimin e saj *What is Authority* ajo shpjegon ndryshimin ndërmjet *potestas* dhe *auctoritas*. Pikërisht në këtë ndryshim qëndron edhe fakti që dikush (inxhinier Qafoku në rastin tonë) mund të mos ketë pushtet, por përmasa e tij e lartë morale i jep autoritet, gjë e cila mungon te regjimi megjithëse ai e kërkon autoritetin me çdo kusht.²⁶

Në vitin 1978, kur i biri i tij Lluca Qafoku kërkon të përgatisë dosjen për punësim, ndodh ngjarja tjetër e pabesueshme: inxhinier Qafoku rezulton akoma në regjistrat e gjykatës si person i dënuar. Ky

fakt dëshmon hipokrizinë e shtetit dhe të gjykatave mbi dënimin dhe mosrespektimin e procedurave të regjistrimit të pafajësisë, pasi interesi i regjimit në atë kohë ishte vetëm lirimi i tij me qëllim që të shfrytëzohej në kantierin e Selenicës dhe jo respektimi i së drejtës së tij si person. Duke u ndodhur përballë kësaj situatë sa absurde, aq edhe ofenduese, inxhinier Qafoku vendos t'i drejtohet drejtpërsëdrejti diktatorit Hoxha, pasi e sheh si të vetmen rrugë që mund t'i japë zgjidhje kalvarit të pafund. Letra drejtuar diktatorit është me një vlerë të veçantë antropologjike dhe më kujton letrën e filozofit italian N. Bobbio drejtuar Musolinit në vitin 1935 mbi një arrestim të kryer nga policia politike fashiste kundër filozofit. Kur intelektual humbet shpresën përballë makinës së dhunshme e të shumëfishtë të regjimit, kërkon si shpresën e vetme të drejtuarit drejtpërsëdrejti diktatorit, pasi në këtë rast të paktën ke të bësh me një person dhe jo me një turmë të dhunshme e të shurdhër përballë zërit të të pafajshmit.

Shoku Enver. Ju lutem të më falni për guximin që marr t'ju drejtohem Juve personalisht, por e bëj këtë sepse problemi që shtrij ka rëndësi shumë të madhe për punën e jetën time.

Im bir më dt. 28.3.1978 kërkoi pranë Gjykatës së Lartë një dokument për gjendjen time gjyqësore, duke ditur se kam marrë pafajësinë për një dënim të dhënë nga Gjykata Ushtarake e Tiranës në drejtimin tim. ... Iu lëshua një dokument që vërtetonte se unë figuroja akoma në Regjistrin e Gjendjes Gjyqësore të Gjykatës së Lartë si i dënuar...

U shtyva t'ju shkruaj këtë letër, sepse unë dhe fëmijët e mi do të mbanim për gjithë jetën pa të drejtë njollën e tradhtarit.²⁷

²⁶ H. Arendt, *What is Authority?*, in *Between Past and Future*, Viking Press, NY, 1961.

²⁷ Arkivi familjar i familjes Qafoku.

Letra shpreh gjithë dramën e inxhinier Qafokut për pasojat që ka pasur ndër vite njolla e të dënuarit pa faj, por edhe dhimbja për të ardhmen e fëmijëve. Përcjellja e pasojave të dënimit të prindërve te fëmijët ka qenë një tipar dallues i regjimit komunist shqiptar dhe ky rast e nxjerr në pah mjaft qartë.

Letra ka rëndësi antropologjike edhe në përshfaqjen e karakterit tribal të komunizmit shqiptar. Qeveria shqiptare është formalisht e organizuar në formë burokratike, por sidoqoftë i pari i vendit, diktatori, është mbi ligjin, si i tillë ai mund t'u japë zgjidhje problemeve duke tejkaluar ligjin, qoftë ky i drejtë apo i gabuar. Këtu duket edhe nuhatja kulturore e Qafokut për t'iu drejtuar diktatorit. Ky element tribal i komunizmit shqiptar ka shkaktuar mjaft përplasje klanesh brenda Partisë së Punës, duke shkaktuar viktima të shumta. Preteksti i kësaj dhune ndërmjet klaneve ka qenë përherë ideologjik, por motivet e vërteta kanë të bëjnë me natyrën tribale të komunizmit shqiptar.

Në fakt, përgjigjja e diktatorit vjen jo drejtpërdrejt, por nëpërmjet detyrimit të gjykatës që të japë dëshminë e penaltetit të korrigjuar. Kjo ndodh një vit pas dërgimit të letrës, saktësisht më datë 3 korrik të vitit 1979. Dëshmisë së mëparshme të penaltetit i shtohet edhe një rresht mjaft i rëndësishëm: “Me vendimin nr. 328, dt. 10.12.1948, të Gjykatës së Lartë ka marrë pafajësinë.”

Falë kësaj fjalie në fund të dëshmisë së penaltetit fëmijët e inxhinier Qafokut, Lluka dhe Niko, mundën të vazhdonin studimet e larta duke njohur arritje shkencore të jashtëzakonshme: Lluka duke punuar në Rrjetin Informatik të Akademisë së Shkencave në Tiranë dhe Nikoja duke arritur majat

më të larta në nivel botëror në shkencat e studimit të tokës, si pjesë e Bordit Shkencor të Agjencisë Federale të SHBA-së për Studimin e Tokave.

Përfundime

Në regjimet komuniste në përgjithësi dhe tek ai shqiptar në veçanti, duke qenë se ky i fundit ndjek me përpikëri modelin e Bashkimit Sovjetik, në fazën e parë të ndërtimit të socializmit, shkencës dhe industrisë u jepet rëndësi e jashtëzakonshme për zhvillimin e socializmit, pasi shkenca dhe industria sigurojnë të ardhmen jo vetëm ekonomike, por, sipas perspektivës komuniste, edhe morale. Ky fakt përbën edhe motivin thelbësor të persekutimit të shkencëtarëve shqiptarë përgjatë komunizmit.

Në Shqipëri, për fat të keq, sikurse u lejua ndërhyrja pa mëshirë e mediokritetit masiv të masave punonjëse në hierarkinë e domosdoshme të vendimeve në fushën e drejtësisë dhe të dijeve shoqërore e shpirtërore, ashtu u veprua për interpretimin e revolucionit tekniko-shkencor si pronë e klasës punëtore dhe e masave punonjëse, pra: një praktikë të vlerësoheshin vetëm idetë praktike, detyrimisht të pazhvilluara dhe mediokre, primitive, të dala nga njerëzit e pashkolluar dhe të mos lejohej formimi i elitave shkencore dhe teknologjike, pasi këto ishin të papërgatitura moralisht për ndërtimin e komunizmit dhe mund ta sabotonin atë. Kjo do të sillte moslejimin faktik të punës shkencore në grup që realisht përbën një kusht *sine qua non* për një kërkim shkencor të vërtetë. Kështu, në fakt, iu pre koka zhvillimit real shkencor dhe teknologjik të vendit dhe institucioneve që e përfaqësonin atë, sepse këto duhet të kontrolloheshin si në nivelin e

personelit që zgjidhnin, ashtu edhe nga tematikat e kërkimit nga struktura dhe njerëz krejtësisht të paaftë për të dhënë mendim në fushat përkatëse. Kjo çoi, në fakt, në sabotimin e zhvillimit shkencor real në vend. Gjë që nuk ndodhi në këto përmasa në vendet e tjera komuniste, ku efekti frenues i ideologjizimit të shoqërisë u kufizua nga shteti me krijimin e strukturave të mbrojtura të shkencëtarëve dhe teknologëve që u lejoi atyre zhvillime interesante e hera-herës të suksesshme në fushat ku shteti kishte interes.

Veç këtyre fakteve, një peshë specifike të rëndësishme në interpretimin e persekutimit ndaj shkencëtarëve zë përdorimi i dhunës si fenomen antropologjik. Mendoj se dhuna e ushtruar gjatë regjimit mund të klasifikohet si “fakt social i përgjithshëm” (koncept i antropologut francez M. Mauss), pasi ajo ka pasur ndikim në çdo sektor të jetës përgjatë komunizmit dhe ka ndikuar shumë edhe tek ata që e kanë pësuar dhunën e që më pas janë bërë viktime të një mendësie dhune. Një shembull i këtij supozimi është dhuna verbale e politikanëve të periudhës paskomuniste.

Në këtë kontest politiko-ideologjik, shembulli i qëndresës së jashtëzakonshme të inxhinier Qafokut përbën jo vetëm një rast mjaft interesant studimor për të hedhur dritë mbi atë kohë të zymtë, por sidomos paraqet një shembull udhërrëfyes të ruajtjes së integritetit moral e njerëzor përballë njëjës prej diktaturave më mizore të shekullit XX.

BIBLIOGRAFIA

H. Arendt, *What is Authority?, in Between Past and Future*, Viking Press, NY, 1961.

“Për një kujtim të paharruar”, punim i autorëve: prof. Stavri Buri, prof. Minella Hido, prof. Sotir Guxha, Arkivi familjar i familjes Qafoku.

J. Ratzinger, *Caritas in veritate*, Enciklikë.

Dosja familjare Petraq Qafoku.

Dosja Petraq Qafoku, Arkivi i AIDSSH.

E. Hoxha, *Historia e PPSH*, 1985.

E. Hoxha, *Vepra*, vëll. 1.

J. Huxley, *La genetica sovietica e la scienza*, Ed. Longanesi, 1977.

Marcuse, *Soviet Marxism. A critical analyses*, Columbia University Press, New York, 1958.

Maritain, *La persona e il bene comune*, Morcelliana, Brescia, 1973.

Maritain, *La filosofia morale. Esame storico e critico dei grandi sistemi*, Morcelliana, Brescia, 1973.

Marks, *Kapitali*, vëll. 1.

Mauss, *Saggio sul dono*, Ed- Einaudi, Torino, 2002.

Nikolla, *Njeriu i ri shqiptar. Ndërmjet moralit komunist dhe krizës së tranzicionit* (Tiranë: Onufri, 2012).

Heinrich Popitz, *Phänomene der Macht*, II ED, Tübingen, 1992.

V. Possenti, *MARITAIN E IL MARXISMO*, in “Aggiornamenti Sociali”, Novembre 1977.

“Probleme aktuale të traditës dhe të novatorizmit në letërsinë shqiptare të realizmit socialist”, Akademia e Shkencave të RPSH, IGJL (Tiranë: N. Frashëri, 1975), f. 199-200.

Rruga e Partisë, n. 7, F. Çami, “Ta kuptojmë dhe ta zhvillojmë drejt luftën e klasave”, 1973.

Sheshunova, “Idea dell’uomo nuovo nel comunismo sovietico”, në *Annali di Storia dell’educazione e delle istituzioni scolastiche*, Ed. La Scuola, Brescia, 2002.

E. V. Walter, *Terror and Resistance; a Study of Political Violence*, Oxford University Press, NY, 1969.

Prof. As. Dr. Sonila Boçi
Kristi Kolçe

Petraq Peppo: intelektual dhe historiani përballë indoktriminit komunist

Mihai Botez, një intelektual rumun që kërkoi strehim politik në SHBA më 1988, duke folur për jetën e një intelektual në një sistem diktatorial pohonte: “Thuhet ndonjëherë se një intelektual që jeton nën një regjim komunist, duhet patjetër të zgjedhë midis të qenit “njeriu i oborrit” ose disident. Ky është një thjeshtëzim i tejskajshëm. Të pranosh kontratën sociale (të regjimit komunist), nuk nënkupton automatikisht se u bërë “njeri i oborrit”. Sepse, nën diktaturën komuniste ekziston një koncept i trishtë, por i vërtetë që quhet “arti i të mbijetuarit”, madje në një mënyrë dinjitoze, i cili përfshin kombinimin e nënshtrimit të kalkulluar, kritikën e vetëkontrolluar,

mbajtjen taktike të një profili të ulët dhe përdorimin me inteligjencë të mundësive. Sigurisht për shumë intelektualë perëndimorë, këto strategji duken të çuditshme, madje edhe të neveritshme. Në princip, jam gati të bie dakord me ta, duke shprehur urimin tim që atyre të mos iu duhet asnjëherë ta mësojnë këtë art”¹.

Bazuar në vlerat morale dhe akademike të një njeriu të rritur dhe të edukuar në një sistem politik të demokracisë liberale, portreti i çdo intelektual që punoi gjatë regjimit komunist në Shqipëri, mund të ngrinte pikëpyetje të natyrës sa shkencore, aq edhe morale. Teza që ngremë në këtë ministudim është se si do të mundte një intelektual i edukuar

¹Andrei Plesu, “Intellectual life under dictatorship”, in: *Representation*, No. 49 Special Issue: identifying histories: Eastern Europe before and after 1989 (Winter, 1995), p. 64.



I dachin...

Historia...
to...
pa...
kita...
ku...
te...
din...
kista...
ku...
ya...
nista...
gith...
din...
ber...

P... B...
ne...

të Arkivit të Shtetit, nga Arkivi i Ministrisë së Jashtme, si dhe nga dosjet formulare të kolegëve të Petraq Peppos, që gjenden pranë Autoriteti për Informim mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit. Është përdorur edhe literatura historike relevante, si për personazhin në studim, ashtu edhe shtypi i kohës. Intervista me familjarët e prof. Peppos, si dhe me kolegë të tij, na kanë bërë të kuptojmë më shumë njeriun që qëndron prapa historianit.

Kush ishte Petraq Peppo?

Në qytetin juglindor të Shqipërisë, në Korçë, mbiemri Peppo është nga më të njohurit. Shtëpia e tyre në pjesën historike të qytetit, afër shtëpisë së Themistokli Gërmenjit, ishte një vend referimi për banorët. Në këto rrugë të shtruara me kalldrëm, në një familje mjeshtërish korçarë, lindi më 30 qershor 1903 Petraq Peppo. Petraqi ishte më i madhi nga tetë fëmijët e familjes dhe, koha e tregoi, se ai u bë shembull, të cilin e ndoqën vëllezërit dhe motrat e tij më të vegjël. Sipas djalit të tij, Leonidhës, ishte ai që i nxiti vëllezërit dhe motrat e tij t'i kushtoheshin arsimimit të tyre dhe të ndiqnin shkollat e larta². Prindërit e Peppos nuk ishin të pasur, por ishin ata që edukuan te secili prej fëmijëve të tyre patriotizmin, dashurinë për punën dhe dijen³.

Më 1917, Petraqi 14-vjeçar, ishte një nga 36 nxënësit e parë që u regjistruan në Liceun e hapur nga francezët në Korçë, një nga shkollat elitare që funksiononin në Shqipërinë e Luftës së Parë

Botërore e në vijim⁴. Ai dhe 9 studentë të tjerë ishin të parët që morën diplomën e Liceut Kombëtar të Korçës më 1925⁵. Që në vitet e shkollës spikati pasioni i tij për historinë dhe letërsinë. Më 1922, ai u bë një prej iniciatorëve të themelimit të një shoqate liceistësh, e cila nxori një revistë me karakter letrar të quajtur “Shpresa”, redaktor përgjegjës i së cilës, dhe më pas drejtor i saj, ishte Petraq Peppo. Kur u zgjodh drejtor i saj, Peppoja ishte në klasën e gjashtë të Liceut dhe ishte vetëm njëzet vjeç. Revista botonte kryesisht përkthime nga filozofët dhe shkrimtarët francezë të të gjitha rrymave. U botuan në numrat e saj pjesë nga iluministët francezë, si: Rousseau, Voltaire, por edhe nga letërsia klasiciste, si p.sh. fragmente nga *Dorështrënguari (Kopraci)* i Molierit.

Ndonëse në thelb nuk ishte i pirrë ndaj politikës, në fund të majit 1924, Peppoja iu bashkua 60 studentëve të Liceut Kombëtar të Korçës, të cilët u nisën në mbështetje të Lëvizjes së Qershorit të drejtuar nga imzot Fan S. Noli, një moment, të cilin Peppoja e ka konsideruar vazhdimisht si një ndër pikat kulmore në veprimtarinë e tij atdhetare.

Në reportazhin që shkroi për numrin 10-11 të revistës letrare “Shpresa”, shprehet se ishte ideali që i kishte bindur liceistët të linin mësimin dhe të rrëmbejnë armët. “I shenjtë qëllimi, më i shenjtë, kur shpëton njeriu popullin nga feudalët, kur s’e lë bujkun të jetë rob dhe, në fund, kur shpëton shtetin⁶”. Kontributi i liceistëve në lëvizje ishte

² Intervistë e autorëve të këtij punimi me djalin e Petraq Peppos, Leonidha Pepon, intervistuar më 12 nëntor 2018.

³ Arkivi i Familjes Pepo, *Kujtimet e Petraq Peppos* (dorëshkrim).

⁴ Koli Xoxi, *Liceu Kombëtar i Korçës (1917-1939)* (Tiranë: Lumo Skëndo, 1997), f. 49.

⁵ Lefter Pepo, “Enveri, si na bënte moral në Liceun Francez”, në: <http://telegraf.al/dossier/lefter-pepo-enveri-si-na-bente-moral-ne-liceun-francez/>, vizituar më 18 nëntor 2018.

⁶ Petraq Peppo, “Njëzet e një ditë me studentët vullnetarë”, në: *Shpresa*, nr. 10-11, maj-qershor 1924, f. 117.

veçse propagandistik, pasi ngjarjet u rrokullisën me shpejtësi dhe në kohën kur liceistët hynë në Tiranë, Zogu dhe qeveria e tij ishte larguar dhe Noli kishte zënë kolltukun e kryeministrit. Pavarësisht kësaj, reportazhi i shkruar nga Peppoja flet shumë për pasionet e vërteta të të riut Peppo. Përshkrimet e vendeve ku kishin kaluar liceistët revolucionarë, theksimi i zakoneve dhe traditave të krahinave të ndryshme, ku kishin qëndruar, njohja e trashëgimisë materiale historike, tregon qartazi talentin e hershëm të Peppos për fjalën dhe historinë.

Në kërkim të identitetit si historian: Petraq Peppo gjatë viteve '30

Përfundim i studimeve në Liceun Kombëtar të Korçës, koïncidoi dhe rikthimin në pushtet të Ahmet Zogut, tanimë si president i Republikës Shqiptare. I riu Peppo kërkoi mbështetje financiare për të vijuar studimet e larta jashtë vendit. Më 1925 ai përfitoi një bursë studimi nga qeveria shqiptare dhe nisët për të studiuar në Ecolé Normale Superieure në Paris të Francës. Në vitin 1929 ai diplomohet për *Licences-Lettres (Histoire et Geographie)*, merr certifikatën *Ancien Elève de l'Ecole Normale supérieure de Paris*, po ashtu edhe certifikatën *Diplome de l'Ecole Nationale des Languages Orientales Vivantes de Paris*. Në jetëshkrimin e tij, Peppoja kujton se, në vitin 1928, balkanologu Mario Roques, i kërkoi ndihmë për të ngritur për herë të dytë një kurs për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare në katedrën ku Roques ishte titullar. Kështu, për gati një vit, studenti shqiptar shërbeu si lektor për gjuhën shqipe, historinë dhe gjeografinë e Shqipërisë⁷. I

⁷ Arkiva e Familjes Pepo, *Kujtimet e Petraq Peppos (dorëshkrim)*.

⁸ Intervistë e Kristi Kolçes me djalin e Petraq Peppos, Leonidhën, intervistuar në korrik 2018.

biri i tij, Leonidha Pepo pohon se gjatë kërkimeve të tij personale mbi jetën e babait të tij si student në Francë, kishte zbuluar se Peppoja kishte dhënë



mësim për gjuhën e letërsinë shqipe edhe në Universitetin e Lionit⁸.

Përfundimi i studimeve e rikthen sërish në qytetin e lindjes, në Liceun Kombëtar të Korçës, tanimë në cilësinë e profesorit të historisë, gjeografisë dhe të greqishtes së vjetër. Në jetëshkrimin e Peppos nuk thuhet shumë për veprimtarinë e tij gjatë viteve '30. E vetmja ngjarje që ai e ka konsideruar të vlefshme për ta përmendur, janë përpjekjet e tij për të futur si pjesë të kurrikulave shkollore të Liceut edhe lëndën e historisë së Shqipërisë, e cila nuk zhvillohej deri atëherë.

Kërkimet në Arkivin Qendror të Shtetit, na tregojnë se profesori i ri ambicioz dhe i pasionuar për kërkimet historike ka një veprimtari jo të vogël intelektuale dhe pedagogjike gjatë viteve '30. Nuk

janë të pakta rastet ku Petraqi ka kërkuar leje nga Ministria e Arsimit për të shkuar në Austri, Francë dhe Itali për të marrë pjesë në konferenca shkencore, apo për të kryer kërkime në arkivat e huaja për historinë e Shqipërisë. Në korrik 1931 ai arriti të sigurojë lejen e Ministrisë së Arsimit për të marrë pjesë në një Kongres të Arsimitarëve që zhvillohej në Paris⁹. Gjatë viteve 1935-1939, ai disa herë ka bërë kërkesë pranë Ministrisë së Arsimit për të vizituar arkiva të Vjenës dhe të Vatikanit, për të mbledhur dokumente për të shkruar një libër mbi historinë e Shqipërisë¹⁰. Duket qartazi se interesi i tij kanë qenë studimet e natyrës historike dhe antropologjike, pasi në disa raste ka kërkuar të bëjë ekspedita kërkimore te kolonitë arbëreshe të Italisë. Në vitin 1935, ai së bashku me Eqrem Çabejin kanë kërkuar leje nga Ministria e Arsimit për të vizituar Piana dei Grecci në Itali¹¹, por nuk ka arritur të sigurojë lejen e autoriteteve për këtë udhëtim studimor.

Gjithashtu, Peppoja ka korrespondencë të dendur me një sërë personalitetesh të kulturës shqiptare të viteve '30, si: Lef Nosit, Ilo Mitkë Qafzezin, Mehdi Frashërin etj. Në bazë të këtyre dokumenteve dhe letërkëmbimeve lexohet qartë interesi i Peppos për studimet mbi lashtësinë e shqiptarëve. Interesante është veçanërisht korrespondenca e Peppos me albanologun Lef Nosi, të cilin duket se e ka takuar për herë të parë në vitin 1924, kur Nosi, si kryetar i Bashkisë së Elbasanit, priti ngrohtësisht liceistët revolucionarë. Në një letër, që Peppoja i dërgon Nosit nga Athina, kuptohet se

qëllimi i udhëtimit të tij është i karakterit studimor. Ai shkruan se kishte vizituar Bibliotekën Kombëtare të Athinës dhe se në të kishte gjetur të dhëna për historinë e Shqipërisë, që nuk mund t'i gjeje në bibliotekat e Parisit apo të Vatikanit. Peppoja i shkruan Nosit me shumë pasion për studime të natyrës historike, etnografike dhe gjuhësore, që mund të zhvilloheshin rreth arvanitasve të Greqisë. "Arvanitët e Greqisë më kanë hequr vërejtjen [vëmendjen] me gjuhën e tyre plot figura, ku gjen fjalë shqip që ne nuk i kemi. Shumë fjalë që janë krejt shqip nuku ngjasin me fjalet t'ona, për shembull në një fshat afër Athinës klyçit i thonë "rahederës", fjalë plot kuptim"¹². Në një letër tjetër që mban datën 12 korrik 1937 duket se marrëdhëniet mes Peppos dhe Nosit janë bërë më miqësore. Peppoja, tanimë në profilin e një intelektual të ri, i tregon Nosit për dëshirën që ka që të krijojë në qytetin e Korçës rrethe intelektualësh. Ai gjithashtu e fton Nosit të ndër marrin së bashku me Mehdi Frashërin një tur studimor në fshatrat e Korçës për të gjetur të dhëna mbi kodikët. "Dëgjo, i dashur Lef, – shkruan Peppo, – Korça, Voskopoja, Vithkuqi, Shpaska etj.... veç dokumentave arkeologjike – guri, kishëra, kanë dhe kodikë (codic) ku shënohen kronikat shqiptare nga shekulli i 6. Unë pak a shumë i di mirë këto vise dhe kam mjaft miq të sinqertë, për të patur kodikët në dispozitën tonë; për këtë arsye, në vend të vish në Pogradec, sipas fjalës, po të ftoj, mik në shtëpinë time, të vish në Korçë dhe kështu tinë, Mehdiu dhe unë të vemë në vendet ku te dobitim si nga shëndeti, ashtu dhe nga dokumentat. Me

⁹AQSH, F. 335/Drejtoria e Liceut të Korçës, V. 1931, D. 1, fl. 83. Njoftim i Ministrisë së Arsimit mbi pjesëmarrjen e prof. Peppos në Kongresin e Mësimi që do të mbahet në Paris më 14. 7. 1931.

¹⁰AQSH, F. 195/Ministria e Arsimit, V. 1939, D. 28, fl. 267. Korrespondencë ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkollës Normale të Elbasanit për lejimin e Petraq Peppos për të shkuar jashtë shtetit për mbledhje dokumentacioni për Historinë e Shqipërisë.

¹¹AQSH, F. 195/Ministria e Arsimit, V. 1935, D. 24, fl. 528. Lutje e Eqrem Çabejt dhe e Petraq Peppos për të vizituar Piana dei Grecci.

¹²AQSH, F. Lef Nosi, V. 1907-1944, D. 55/1. Letër e Petraq Peppos për Lef Nosit, 10 tetor 1930.

duket se do jemi një trini që do merremi vesh për bukuri, mbasi unë si i rrëmbyer që jam në bisedim, do kapem me Mehdi benë dhe tinë me urtësinë tënde do na zbutësh”¹³.

Për fat të keq, nuk kemi mundësi të gjykojmë nëse këto projekte të Peppos kanë pasur ndonjë vijimësi apo jo, dhe nëse ekspedita për të cilat ai flet në letrën e tij të jetë kryer apo jo. As në arkivat shtetërore, as në arkivin personal të familjes nuk gjenden përgjigjet e Lef Nosit për Petraq Peppon. Ai vetë, pas Luftës së Dytë Botërore, nuk ka folur kurrë mbi njohjen dhe bashkëpunimin e tij me Nosin, madje as në biseda intime me familjen. Shpallja e Lef Nosit si “armik i popullit” dhe dënimi i tij me vdekje nga Gjyqi Special Ushtarak më 1945, vinte në rrezik çdo njeri që kishte pasur afërsi me të. Kjo e ka detyruar, mesa duket Peppon, t’i hedhë mikut të vjetër tisin e harresës.

Sfidat e një profesori dhe patrioti në vitet e Luftës së Dytë Botërore

Historia e Petraq Peppos për vitet e pushtimit është sa konfuzë, aq edhe interesante, për të kuptuar marrëdhënien e njeriut me të vërtetën në kushtet e një sistemi totalitar. Në jetëshkrimin e tij, të shkruar në vitet ’60, ku Petraq Peppoja përpiket t’u argumentojë autoriteteve më të larta të PPSH-së se, si profesionalisht, ashtu edhe politikisht, e meritonte të merrte titullin Profesor. Ai thekson vetëm një anë të veprimtarisë së tij gjatë Luftës së Dytë Botërore, qëndrimin e tij antifashist, duke mos përmendur asgjë sa i takon veprimtarisë së tij shkencore.

Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia e Musolinit, indiferenca politike që e kishte karakterizuar jetën e tij gjatë viteve ’30, nuk mund të vazhdonte më gjatë. Pas demonstratave të studentëve të Liceut të Korçës në nëntor 1939, Peppoja transferohet në Shkollën Normale të Elbasanit¹⁴. Zyrtarët fashistë e konsideronin Peppon si një antiitalian dhe antifashist “nxitës për rebelimin e studentëve, të cilëve u ka folur me ekzaltim për Francën”¹⁵. Ai ka qenë ndër të paktët profesorë të asaj kohe, të cilët refuzuan të nënshkruanin deklaratat për t’u anëtarësuar në Partinë Kombëtare Fashiste. Temperamenti i tij impulsiv dhe i rrëmbyer kishte bërë që disa herë të kundërshtonte hapur propagandën që bëhej nga pushtuesit, sipas së cilës Italia e kishte çliruar Shqipërinë nga “regjimi i satrapit Zog” dhe se ajo mund të sillte përparimin dhe zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare. Sipas dëshmive të kolegëve të tij, kundërshtimi i këtyre tezave në mënyrë të hapur i shkaktoi dy herë burgosjen dhe internimin e tij, respektivisht në kampin Colfiorito afër Firences (Itali) në 1941 dhe në atë të Porto-Romanos (Durrës) në 1943.

Për fat të keq, burimet primare për internimin e prof. Peppos në Itali nuk kemi mundur t’i gjejmë me kohën që kishim në dispozicion për kryerjen e këtij studimi. Në këtë rast na vijnë në ndihmë dëshmitë e bashkëvuajtësve të tjerë në kampin e internimit. Sipas kujtimeve Ferrik Ferras, djalin të Xhemal Ferras, në kampin burg të Kolflorit ku ky i fundit kishte qenë i internuar “ndodheshin të internuar si kundërshtarë politikë të regjimit fashist dhe shumë intelektualë të njohur shqiptar,

¹³AQSH, F. Lef Nosi, V. 1907-1944, D. 55/1. Letër e Petraq Peppos për Lef Nosin, 12 korrik 1937.

¹⁴AQSH, F. 164/Partia Kombëtare Fashiste, V. 1940, D. 20, fl. 44. Karakteristikë e Prof. Petraq Peppo.

¹⁵AQSH, F. 164/Partia Kombëtare Fashiste, V. 1940, D. 20, fl. 44. Karakteristikë e Prof. Petraq Peppo.

si profesorët: Zijaudin Kodra e Petraq Peppo, Tahir Dizdari, Faik Bregu, Tefik Gjyli, Skënder Frashëri, Haki Luzati, Seit Bilali etj.". Ferrik Ferra kujton fjalët e babait tij: "Aty në Kolflorito në ditët e para të internimit, u kujtova se shkollën e kisha lënë pa bërë dhe gjithë kohën që kisha në dispozicion, e kaloja midis intelektualëve të njohur, si profesorët Zijaudin Kodra e Petraq Peppo, të cilët diskutonin e debatonin në atë kamp ku ndodheshin shumë nga ajka e inteligjencies shqiptare të asaj kohe, të cilët i dëgjoja me kujdes"¹⁶. Sipas të birit, Leonidhës, internimi i tij kishte ardhur pas një takimi të intelektualëve të kohës me Mëkëmbësin e Përgjithshëm të perandorit Victor Emanuele III, Francesco Jacomoni. Qëllimi i këtij takimi ishte një tentativë për të kaluar këta intelektualë në krah të fashizmit. Në sallë mbizotëronte qetësia dhe fjalën e merr Peppoja *"Kujt i tregoni ju se çfarë është fashizmi! Kujt i thoni ju se fashizmi çliroi Shqipërinë? Trupat tuaja ushtarake në vendin tonë thonë vetëm pushim, fashizmi nuk sjell ndërtim por robëri. I biri shton me tej, "Sipas Misto Treskës pas ndërhyrjes së babit e gjithë salla ngriu. Ngelëm të gjithë si hunj. Nuk e kuptuam ku e gjeti atë guxim."* - do të ishin fjalët e Aleks Budës¹⁷. Edhe për burgosjen e dytë të prof. Peppos shkak do të bëhej kundërshtimi i tij ndaj dogmave të hierarkëve fashistë. Mësuesja e mirënjohur korçare, Helidhona Falli, në një deklaratë të 9 tetorit të vitit 1951, do të kujtonte se gjatë një takimi në Liceun e Korçës me ministrin e

Arsimit, Xhevat Korça, ky i fundit kishte deklaruar se "pavarësia e Shqipërisë është e siguar (pasi) Shqipërinë e mbron Musolini"¹⁸. Prof. Peppo kishte pasur sërish guximin të ngrihej dhe të thoshte "Shqipëria është e robëruar nën fashizmin dhe duhet të përpiqemi për lirinë e Shqipërisë"¹⁹.

Po ndërsa qëndrimet e tij patriotike dhe antifashiste gjatë Luftës së Dytë Botërore janë të mirëdokumentuara si nga ai vetë, ashtu dhe nga fjalët e familjarëve të tij, të cilët qartazi i kanë dëgjuar shumë herë këto kujtime, për veprimtarinë e tij si studiues dhe mësimdhënës në këto vite ai nuk ka folur aspak. Dokumentacioni arkivor tregon qartazi se Peppoja nuk e braktisi pasionin e tij për historinë edhe gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore.

Petraq Peppoja ishte një nga pjesëmarrësit në Kuvendin I të Studimeve Shqiptare, të mbajtur nga 9-12 prilli 1940, i cili shërbeu si aktiviteti themelues për Institutin e Studimeve Shqiptare. Gjatë zhvillimeve të këtij aktiviteti, Peppoja replikoi në disa raste me arkeologun italian prof. Mustillin, i cili u referohet vetëm zbulimeve arkeologjike të bëra në Shqipëri nga arkeologë italianë, si: Baldacci, Ugolini etj. Peppoja i kujtoi se "afër Trenit, Pittard ka gjetë sheje neolytike. Në Klisyrë janë gjetë sheje të periudhës së shpis lakustre. Filovi e Vulici kanë gjetë gjana illyrike në Trebnisht, të cillat e pshtesin thezin e lidhjes me artin miqenë"²⁰. Përmendja e tezave të arkeologëve jo italianë, duhet të mos jetë

¹⁶ "Babai im biznesmen i njohur në Itali, ndihmonte shtetin shqiptar për të gjetur tregje"/ Historia e panjohur e Kontit Ferra nga Kruja që ndërtoi Pallatin e Brigadave...më pas internimi", në: (<https://dosja.al/dosja-xhemal-ferra/>), vizituar më 12 maj 2021.

¹⁷ Internet: Peppo, Historiani që bllokoi grekët në Konferencën e Paqes, dt. 4 nëntor 2009, site i përdorshëm: ikub.al http://www.ikub.al/Lajme/911040979/Article_Peppo-historiani-qe-bllokoi-greket-ne-Konferencen-e-Paqes-.aspx?cookiesEnabled=false

¹⁸ Arkivi personal i Familjes Pepo, Deklaratë e Helidhona Fallit, dhënë më 9 tetor 1951.

¹⁹ Arkivi personal i Familjes Pepo, Deklaratë e Helidhona Fallit, dhënë më 9 tetor 1951.

²⁰ AQSH, F. 200/Instituti i Studimeve Shqiptare, V. 1940, D. 11, fl. 4. Informacion mbi Kuvendin I të Studimeve Shqiptare në Tiranë, 12 prill 1940 në mëngjes.

mirëpritur nga drejtuesit e Institutit dhe personalitetet italiane. Më 8 tetor 1940, Peppoja i drejton një letër Mustafa Krujës, kryetarit të Institutit të Studimeve Shqiptare, ku njofton se kishte përgatitur një konferencë me temë “Shqipëria dhe banorët e saj gjatë periodës proto-ilire”, të cilën ai dëshironte ta mbante në emër të Institutit të Studimeve Shqiptare. Ai vë në dukje se materiali që kishte përgatitur për këtë konferencë ishte hartuar në mënyrë të tillë, që të kuptohet si nga “intelektualët që kanë kulturë të gjerë, por edhe prej nxënësve të shkollave të mesme”²¹. Në përgjigjen që M. Kruja i kthen dy javë më vonë, shprehet se “këshilli {i Institutit} vendosi me të kumtue se e pëlqen mendimin tënd dhe se ka për ta rreshtue konferencën t’ande në vargun e konferencave që do t’organizojë ky Institut në një kohë ma të volitshme, mbasi në gjendjen e sotme nuk na duket qi konferenca të këtilla ta tërheqin shumë publikun”²².

Edhe pas kthimit nga internimi në Itali, profesori vijoi t’i përkushtohej sa mësimdhënies në Gjymnazin e Tiranës, aq edhe shkrimeve në shtypin e kohës. Ai ishte një nga bashkëpunëtorët e ngushtë të revistës “Drini”, e cila kishte synim të promovonte turizmin shqiptar. Në disa raste, ai bashkëpunoi dhe me revistën “Albania/Shqipni”, një revistë mujore e politikës, ekonomisë, shkencës dhe letërsisë, që drejtohej nga Ferdinando Guido di Bagno. Në këtë revistë në mars 1942, Peppoja botoi artikullin “Shqipëria në prehistori”²³. Një artikull me tematikë të ngjashme e botoi një vit më vonë edhe në revistën *Shkëndija*, e cila drejtohej nga Ernest Koliqi. Prof. Peppo nuk do t’i përmendte më vonë këto

bashkëpunime dhe veprimtarinë shkencore që kishte zhvilluar gjatë Luftës. Ai do të heshte për këto, ashtu siç nuk përmendi njohjen me Lef Nosin.

Petraq Peppo dhe sfida për t’iu përshtatur trajtimit marksist të historisë

Është e vështirë të flasësh për pozicionimin e Petraq Peppos me vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri. Përveç ndjenjave të forta patriotike, Peppoja nuk kishte shfaqur asnjëherë më parë ndonjë preferencë politike, qoftë të majtë, qoftë të djathtë. Petraq Peppos i duhej të përballej me dy situata njëra më sfiduese se tjetra. Si një njeri në thelb apolitik, atij do t’i duhej të përshtatej në një sistem qeverisjeje i cili mobilizimin e masave dhe “edukimin komunist” të tyre e konsideronte si themel të mbijetesës. Si historian i edukuar në një shkollë perëndimore, atij do t’i duhej të përshtatej ta shkruante historinë sipas shkollës marksiste të mendimit historik, me të cilën ai nuk ishte familjar.

Në përshtatjen e tij me regjimin komunist, duket se Peppon e kanë ndihmuar disa rrethana. Së *pari*, njohja me Enver Hoxhës, të cilin e kishte pasur edhe student, edhe koleg. Të dy kishin një ndjenjë të përbashkët dashurie për Revolucionin Francez, pavarësisht se Hoxha adhuronte Komunën e Parisit dhe jakobinët, ndërsa Peppoja, nga sa duket në shkrimet e tij, kishte idhuj iluministët. Së *dyti*, antifashizmi dhe burgosja e internimi i tij gjatë Luftës së Dytë Botërore, i kishte siguruar një lloj dashamirësie të krerëve të regjimit. Së *treti*, ai asnjëherë nuk shprehu ndonjë opozicion kundrejt

²¹ AQSH, F. 200/Institutit i Studimeve Shqiptare, V. 1940, D. 20, fl. 1-2. Letër e Petraq Peppos për Mustafa Krujës, 5 tetor 1940.

²² AQSH, F. 200/Institutit i Studimeve Shqiptare, V. 1940, D. 20, fl. 3. Letër e Mustafa Krujës për Petraq Peppon, nr. 19.10. 1940-XVIII.

²³ Petraq Peppo, “L’Albania nella preistoria”, in: Albania/Shqipni, anno 3/nr. 3, Roma, marzo 1941-XX, pp. 85-86.

regjimit. Së *katërti*, fushat e tij të studimeve, veçanërisht njohja e marrëdhënieve të hershme të Greqisë me Shqipërinë, e bënin të domosdoshëm për regjimin, në kushtet kur atij i duhej të përballëj me pretendimet greke dhe të rikonfirmonte pavarësinë, kufijtë dhe sistemin politik. Me fjalë të tjera, Petraq Peppoja ishte nga të paktët intelektualë të shkolluar në Perëndim, të cilëve regjimi do të duhej t'i besonte.

Në korrik të vitit 1946, emri i prof. Peppos do të ishte ndër dy historianët që do të bënë pjesë në delegacionin që do të dërgohej në Konferencën e Paqes në Paris, për të mbrojtur Shqipërinë përballë pretendimeve territoriale të ngritura nga qeveria greke²⁴. Leonidha Pepo pohon se ishte pikërisht Enver Hoxha që do ta përzgjidhte Petraq Pepon. Në Arkivin e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme ka shumë materiale të karakterit historik, të cilat nuk kanë emrat e përgatitësve, por, duke qenë se Aleks Buda dhe Petraq Peppo ishin të vetmit historianë të delegacionit, këto materiale duhet të jenë fryt i punës së tyre²⁵.

Kur Konferenca e Paqes filloi punimet në Paris më 29 korrik 1946, qeveria greke kishte marrë tashmë premtimin nga britanikët dhe amerikanët se pretendimet e saj ndaj Shqipërisë së Jugut do të dëgjoheshin. Kjo sigurisht e kishte shqetësuar qeverinë shqiptare, edhe pse ajo kishte marrë njoftime që Konferenca në parim do të diskutonte vetëm traktatet me shtetet e mundur²⁶. Më 3 gusht 1946, kryeministri grek, Caldarisi (Konstantinos Tsaldaris), i cili kryesonte delegacionin, paraqiti para Konferencës së Paqes çështjen e “Epirit të Veriut”. Në fjalën e kryeministrit grek ishin përmbledhur të njëjtat akuza, të cilat qeveria greke kishte kohë që i kishte artikuluar në kancelaritë e ndryshme. Ai fliste për karakterin historik helen të “Vorio-Epirit”, për popullsinë helene të tij që, edhe pasi i ishte nënshtruar një procesi de-helenizimi, përsëri e kishte ruajtur karakterin dhe ndërgjegjen e saj helene. Ndër të tjera, kryeministri grek theksoi se “gjendja e luftës, që ekziston midis Shqipërisë dhe nesh, duhet të shkojë drejt një përfundimi natyral dhe të drejtë duke i kaluar Greqisë, Vorio-Epirin”²⁷.

²⁴ AMPJ, V. 1946, D. 147, fl. 3 dhe 4. Dokumenti përmban Notën Verbale të qeverisë shqiptare të datës 26 korrik 1946, drejtuar Ambasadës Franceze në Tiranë, me anë të së cilës i kërkon viza hyrëse për delegacionin zyrtar të Konferencës së Paqes, i cili përbëhej nga Hysni Kapo, ministër i Shqipërisë në Beograd, Dr. Manol Konomi, ministër i Drejtësisë, Kahreman Ylli, ministër i Shqipërisë në Francë, Behar Shtylla, sekretar i përgjithshëm i MPJ, Pullumb Dishnica, deputet i Kuvendit Popullor, prof. Aleks Buda dhe prof. Petraq Peppo, ing. Salih Angoni, Misto Treska, drejtor i shtypit. Më 2 gusht 1946 mbërriti në MPJ përgjigjja e Notës Verbale, sipas së cilës ambasada kishte marrë autorizimin t'u jepte vizën personave që përmbaheshin në listës e qeverisë shqiptare.

²⁵ Puna e këtyre historianëve duhet të ketë filluar prej prillit të vitit 1945 (AMPJ, V. 1945, D. 128/5, fl. 21, Radiogram i Hysni Kapos nga Beogradi për MPJ, pa numër, datë 22 prill 1945). Sipas një radiogrami të Hysni Kapos nga Beogradi, çështjen shqiptare në Këshillin e Ministrave të Jashtëm të shteteve aleate, por edhe në Konferencën e Paqes (nëse delegacioni shqiptar nuk do të lejohej të merrte pjesë), do t'i besohej delegacionit jugosllav. Ata do të vinin në dispozicioni për këtë qëllim historianët e tyre, midis të cilëve edhe një shqiptar nga Kosova. Gjithsesi u kërkua nga qeveria shqiptare që të mblidhej material për një sërë problematikash që lidheshin me Greqinë, si: njoftime historike sa më të vjetra, që kur Shqipëria e Jugut ishte ndarë në krahina dhe principata dhe masat që janë marrë për një ndarje të tillë si principata e Janinës dhe të tjera; statistika të sakta mbi minoritetin grek në Shqipëri dhe atë çam në Greqi; statistika të përgjithshme të popullatës shqiptare dhe statistika fetare, përgjendja e popullit të krishterë që flet greqisht; argumente historike dhe etimologjike pse thirren me emra grekë një pjesë e katundeve minoritare; pretendimet greke mbi Vorio-Epirin, ku bazohen, si është zhvilluar procesi i kërkesave të tyre, shkaqet; qëndrimi i kolonive shqiptare jashtë, i pjesës ortodokse ndaj pretendimeve greke dhe vepra të tyre ku tregojnë ndjenjat atdhetare; një studim i gjerë mbi popullin shqiptar të Çamërisë dhe vendin; dokumente mbi trajtimin që i është bërë minoritetit çam qysh në ditët e para të sundimit grek deri më 1945 etj. Siç është treguar më sipër, Petraq Peppoja kishte treguar interes dhe kishte studiuar qysh gjatë viteve '30 për shume prej këtyre tematikave.

²⁶ AMPJ, V. 1946, D. 146, fl. 36, Telegram shifër e ministrit shqiptar në Paris, Karreman Ylli për MPJ, 2 gusht 1946.

²⁷ AMPJ, V. 1946, D. 151, fl. 1-3, Fjala e kryeministrit grek, Caldarisi në mbledhjen e gjashtë plenare të Konferencës së Paqes, 3 gusht 1946.

Më 21 gusht 1946, u lejua të paraqeste qëndrimin e qeverisë shqiptare para Konferencës së Paqes dhe përfaqësuesi i saj²⁸. Enver Hoxha, me cilësinë e kryetarit të delegacionit, shpjegoi arsytet përse Shqipërisë i takonte të pranohej për të thënë fjalën e saj në traktatet e paqes. Një pjesë e madhe e fjalimit të Enver Hoxhës u përqendrua në hedhjen poshtë të akuzave të parashtruara disa ditë më parë nga kryeministri grek, sipas të cilave midis Shqipërisë dhe Greqisë ekzistonte gjendja e luftës²⁹.

Teksa politikanët komunistë zhvillonin bisedime me fuqitë fituese të luftës duke u treguar që Shqipëria ishte viktimë e Italisë së Musolinit dhe nuk kishte rrezikuar asnjëherë shtetet fqinje, historianët e delegacionit ishin të angazhuar në debate publike me historianët grekë dhe konferenca për shtyp duke hedhur poshtë tezat për të ashtuquajturin "Vorio Epir". Leonidha tregon me detaje historinë e atyre ditëve dhe debatin që ishte zhvilluar në atë sallë: *"Është tokë greke - ishte pretendimi më këmbëngulës i grekëve. Të gjitha gërmimet arkeologjike në Apoloni apo edhe në vende të tjera e vërtetojnë këtë. Aty janë gjetur me shumicë shkrime të vjetra në greqisht, monedha të vjetra greke...". "Atëherë në bazë të kësaj logjike, - u ishte përgjigjur historiani shqiptar me një frëngjishte të përkryer, - ju, grekëve, edhe francezët duhet t'ju japin edhe Parisin, duhet t'ju japin edhe këtë sallë ku ne po flasim, pasi në disa kisha të vjetra, jo shumë larg nga këtu, ka pllaka me mbishkrime në greqisht, por edhe monedha*

*të vjetra greke..."*³⁰. Ndërsa mosmarrja parasysh e pretendimeve greke nga Konferenca e Paqes, ishte një çështje që i takonte vendimmarrjes së të Mëdhenjve, dy historianët shqiptarë Petraq Peppo dhe Aleks Buda, dhanë një kontribut të vlefshëm për të treguar mungesën e argumenteve reale të Athinës zyrtare për këtë çështje. Në përfundim të Konferencës Shqipëria u njoh si "fuqi shoqe", duke e vendosur kështu në krah të shteteve fituese të Luftës së Dytë Botërore, të cilat nënshkruan Traktatin e Paqes me Italianë. Njohja e këtij statusi i bëri të pavlefshme kërkesat e Athinës zyrtare dhe, ashtu siç tregoi koha, ato nuk u shqyrtuan më në asnjë forum ndërkombëtar.

Prezantimi dinjitoz në Konferencën e Paqes në Paris, duhet të këtë ndikuar mjaft në karrierën e mëvonshme të Petraq Peppos. Në vitin 1947, kur u hap Instituti Pedagogjik, i pari institucion i arsimit të lartë në vend, Peppoja emërohet aty si pedagog. Sipas jetëshkrimit të tij, Peppos i ishte dashur të bëjë një punë të jashtëzakonshme si mësimdhënës në Institutin Pedagogjik. Ai u mësonte studentëve kurset e Historisë së Vjetër, Historinë e Mesjetës, Historinë e Bashkimit Sovjetik³¹. të cilat në mungesë të teksteve duhej t'i përgatiste vetë. Njëkohësisht ai është një prej themeluesve të Institutit të Shkencave (janar 1947), duke qenë një nga anëtarët e Asamblesë së saj³². Në nxitimin e qeverisë komuniste për të ngritur institucionet e veta të shkencës dhe të arsimit të lartë, në kushtet e mungesës së njerëzve të shkolluar, nuk ishte një

²⁸ AMPJ, V. 1946, D. 150, fl. 65, Telegram shifër i Enver Hoxhës nga Parisi për gjeneral Koçi Xoxen, 23 gusht 1946.

²⁹ Enver Hoxha, *Dy popuj miq ...*, f. 38; si dhe, *Bashkimi*, 22 gusht 1946.

³⁰ Intervistë e Kristi Kolçes me Leonidha Pepon, marrë në korrik 2018

³¹ Arkiva personale e Familjes Pepo.

³² "Vendimi i Këshillit Ministerial, nr. 16, dt. 28.1.1947" mbi nevojën e krijimit të një Instituti studimesh, në: *Buletini i Institutit të Studimeve*, nr. 1, qershor 1947.

situatë e pazakonshme që një person të punonte njëkohësisht në të dyja institucionet.

Instituti i Shkencave, si çdo institucion tjetër në shtetin shqiptar, të drejtuar nga PKSH/PPSH, ishte nën kontrollin e rreptë politik. Çdo vit veprimtaria e Institutit të Shkencës shqyrtohej me kujdes dhe në detaje në forumet e larta partiake, në Byronë Politike ose në Sekretariatit e KQ të PPSH-së. Në krye të institucionit u vendos Ministri i Drejtësisë, Manol Konomi, i cili në të vërtetë ishte një ndërmjetës midis organeve drejtuese të institucionit shkencor dhe lidheshit më të lartë partiak. Disa numra të revistës shkencore, Buletinit të Institutit të Shkencave, kishin në frontespicin e tyre foton e Stalinit³³; të gjitha këto detaje tregojnë qartazi për kontrollin dhe ideologjizimin e shkencës shqiptare.

Përtej kontrollit politik, studiuesit duhet të përballëshin edhe me detyrimin për ta mbështetur shkencën shqiptare mbi bazat e teorisë marksiste-leniniste. Në analizën që Sekretariati i KQ të PPSH-së bëri për veprimtarinë e Institutit të Shkencave gjatë viteve 1948-1949, dy ishin çështjet që i theksoi më së tepër: së pari, u theksua se “Studimet shkencore të bëra mbi vendin tonë nga të huajt, nuk kanë qenë të drejtuara dhe nuk i përgjigjen qëllimeve dhe nevojave tonë, për të njohur sistematikisht vendin nga ana e mundësive dhe zhvillimit ekonomik e kulturor të tij. Ato mund të vlejnë vetëm për të lehtësuar nga ndonjë anë studimet tona”³⁴. Për këtë arsye, parimi që duhet të ndiqte “Institutit i Shkencave në udhën e tij është të vejë rezultatet

e aktivitetit të tij shkencor në shërbim të popullit, për të ngritur sa më parë nivelin e mirëqenies së tij materiale dhe të zhvillimit të tij kulturor”³⁵. Së dyti u vu në dukje se “Institutit i Shkencave ka neglizhuar problemin e rëndësishëm të edukimit dhe riedukimit të kuadrove të tij dhe të njerëzve të tjerë të shkencës me ideologjinë e shkencës marksiste-leniniste-staliniste dhe nuk qe përpjekur që të ngrejë në fushën ideologjike problemet e ndryshme shkencore, në mënyrë që të luftoheshin me efikasitetin e duhur në njerëzit e shkencës mbeturinat e ideologjisë reaksionare e borgjeze dhe të bëhej si platformë e çdo dege të shkencës materializmi dialektik dhe historik”³⁶. Detyra që iu theksua Institutit të Shkencave nga drejtuesit e lartë të PPSH-së komunistë ishte t’i kushtoheshin me të gjitha forcat edukimit komunist të tyre.

Deri në vitin 1952, kohë kur studentët e parë të diplomuar në Bashkimin Sovjetik dhe në disa shtete të tjera të Lindjes Komuniste, u kthyen në atdhe, regjimi nuk kishte zgjidhje tjetër veçse t’ia besonte punën për ngritjen e institucioneve shkencore njerëzve që ishin shkolluar në Perëndim edhe pse, një pjesë prej tyre, nuk besonin në ideologjinë marksiste. Petraq Peppo ishte një nga këta duke përbërë një rast shumë interesant studimi.

Siç e kemi përmendur më herët, Peppoja ishte njëri apolitik. Ai nuk bëri përpjekje të zinte pozicione shtetërore, as të tregonte devotshmëri të theksuar ndaj regjimit. Ndërsa nuk ngurronte të thoshte gjithmonë mendimin e vet, Peppoja bëri të gjitha

³³ *Shih* frontespicin e Buletinit të Institutit të Shkencave, nr. 1, Tiranë: 1951.

³⁴ AQSH, F. 14/AP org. udh, V. 1950, D. 48, fl. 1, Relacion mbi veprimtarinë e Institutit të Shkencave gjatë vitit 1948-1949.

³⁵ AQSH, F. 14/AP org. udh, V. 1950, D. 48, fl. 1, Relacion mbi veprimtarinë e Institutit të Shkencave gjatë vitit 1948-1949.

³⁶ AQSH, F. 14/AP org. udh, V. 1950, D. 48, fl. 16, Projekt-vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH mbi veprimtarinë e Institutit të Shkencave.

përpjekjet të përvetësonte ideologjinë marksiste. Në vitin 1955, ai u regjistrua në kurset e edukimit marksist-leninist, të cilat zhvilloheshin në Shkollën e Partisë “Vladimir Iliç Lenin” dhe e përfundoi atë me rezultate shumë të larta.

Arsyet se përse P. Peppo në moshën 52 vjeçare mori vendimin për të ndjekur kurset e edukimit marksist-leninist është e vështirë të dokumen-tohen. Por ne mund të bëjmë një analizë në bazë të të dhënave që kemi mbi veprimtarinë e tij si anëtar i Institutit të Shkencave. Për një studiues të historisë nën regjimin komunist, njohja e teorisë marksiste ishte një nga kushtet thelbësore për të vijuar punën, pavarësisht për cilat periudha të historisë ishin përqendruar studimet. Në vitin 1948, kishte filluar puna për hartimin e një teksti zyrtar për Historinë e Shqipërisë, në të cilën Petraq Peppoja ishte caktuar si një nga bashkautorët. Ai do ta kishte shumë të vështirë të ishte i suksesshëm në diskutimin e këtij teksti nëse nuk e mbështeste atë në teorinë e materializmit dialektik dhe historik. Fakti, që ai u regjistrua në kurset e marksizëm-leninizmit, pikërisht në kohën kur pjesa e parë e tekstit, ku Peppoja ishte autor, ishte në proces diskutimi, është një argument plus në këtë analizë. Edhe më vonë, kur Peppoja tashmë në pension do të mësonte studiuesit e rinj sesi duhet të ecnin në rrugën e kërkimeve shkencore, krahas skrupolozitetit me të cilin duhet të shihnin dokumentin dhe saktësinë e përkthimit, ai nuk do të harronte t’i porosiste “*spërkateni pak më pluhurin e markzizëm-leninizëm*”, në mënyrë që studimet të botoheshin³⁷.

Një tjetër arsye për të kërkuar integrimin në regjimin e ri, mund të jetë nevoja për t’u dëgjuar më shumë. Në vitet e para të themelimit të Institutit të Shkencave, Petraq Peppoja ishte një nga njerëzit që nuk kishte frikë të thoshte mendimin e vet. Në analizën vjetore të vitit 1948, kritikoi drejtuesit për mungesën e transparencës³⁸. Ai nuk kishte asnjë ngurrim të propozonte studime mbi tema të cilat konsideroheshin të vështira dhe problematike, si: studimet mbi pellazgët apo mbi lashtësinë shqiptare. Nuk janë të pakta rastet që ka ngritur problematika të rëndësishme për marrëdhëniet e shkencës me mësimdhënien, siç ishte rasti në mbledhjen e Institutit të Shkencave në vitin 1952, ku “shoku Peppo shtroi çështjen e bashkëpunimit dhe ndihmës që duhet t’i japë instituti, Ministrisë së Arsimit përse i takon përpilimit të teksteve shkollore dhe organizimit të ekspeditave me qëllim që të ndihmohen kuadrot studionjëse të Ministrisë në punimet e tyre origjinale”³⁹. Të gjitha propozimet e tij binin në vesh të shurdhët, si të drejtuesve të Institutit, ashtu dhe të drejtuesve të lartë partiakë. Kjo mund ta ketë detyruar studiuesin ambicioz që të kërkonte një mënyrë a për të gjetur një rrugë për t’u ndier disi më i përfshirë në vendimarrjen e regjimit të ri.

Vitet 1947-1954, mund të konsiderohen si vite përshtatjeje të historianit të edukuar në Francë me një ideologji që ai nuk e ndiente plotësisht të tijën. Gjatë veprimtarisë së tij shkencore prof. Peppo na ka lanë vepra shumë të rëndësishme për historinë e Shqipërisë⁴⁰. Përkthimi i dokumenteve nga greqishtja e vjetër, ndihmesa për të sjellë në shqip

³⁷ Intervistë e Kristi Kolçes me prof. Ferit Dukën, marrë në nëntor 2018.

³⁸ AQSH, F. 490/Këshilli i Ministrave, V. 1948, D. 802, fl. 20. Nga procesverbalet e mbledhjes së Institutit të Shkencave, 21 qershor 1948.

³⁹ “Procesverbalet e mbledhjes vjetore të Institutit të Shkencave”, në: *Buletini i Institutit të Shkencave*, nr. 2, Tiranë: 1952, f. 183-184.

⁴⁰ Gjatë veprimtarisë së tij shkencore Peppo ka lënë vepra të rëndësishme për historinë e Shqipërisë. Në veprimtarinë e tij botuese renditen: *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëllimi II* : Shek. VII-XV. [A. Buda, I. Zamputi, K. Frashëri, P. Peppo] (1962); *Historia e*

testamentet e Iljaz Bej Mirahorit dhe të tjerëve, japin të dhëna të rëndësishme për Korçën nën sundimin osman, por edhe për organizimin e jetës ekonomike dhe sociale në atë periudhë. Veçanërisht qëmtimi i dokumenteve, kodikëve të Korçës dhe të Selasforit dhe e kodikëve të fshatrave të Korçës, një pasion i hershëm i tij, janë një kontribut shumë i vyer për historinë e Shqipërisë. Ashtu siç thoshte vetë prof. Peppoja, historia e Shqipërisë ishte shkruar duke u bazuar në arkiva të huaja, dokumentet që qëmtoi ai gjithë jetën e tij, jepnin atë që mungonte, dokumentin vendas dhe një këndvështrim tjetër për historinë e Shqipërisë. Të gjitha këto studime janë fryt i një pune të jashtëzakonshme, me shumë pasion dhe përkushtim. Duke i cilësuar arkivat si “laboratore të shkencës”, Peppoja edhe në moshë të thyer nuk rreshti së frekuentuari ato. Madje, duke e çmuar “pasurimin e arkivave pune patriotike” pasi “ato [arkivat] ndihmojnë shumë në ngritjen e punës shkencore” ka bërë kujdes të veçantë në grumbullimin e shumë dokumentave historike duke shkruar vetë kudo që ato ndodheshin: bakaj, depo të ish-tregëtarëve, rrugë, pazare të vegjël (ku mblidhte shkresa, akte, deftere tregëtarësh të hedhura plot lagështi që mykeshin apo kalbeshin) etj., çfarë e konsideronte si një “shërbim të vogël qytetar” që ai kryente në cilësinë e “një punëtori të thjeshtë dhe të vogël të shkencës historike”⁴¹. Leonidha i kujton mjaft mirë orët e gjata të prof. Peppos në tryezën

e punës. “*Babai ishte kampion i shfrytëzimit të arkivave, - thekson ai, - qëndronte me orë të gjata duke punuar, gati 8 orë në ditë dhe sigurisht kur kthehej nga puna ai sërish do ishte duke punuar. Nuk e konceptonte dot që të qëndronte një ditë pa studiuar, ... në dhomën tonë të pritjes nuk futej askush, babai sa kthehej nga puna rifillonte studimin duke u ulur këmbëkryq, e gjithë dhoma ishte e mbuluar me materialet që ai studionte edhe shkruante*”⁴² shprehet ai duke qeshur.

Përkthimet e tij profesionale dhe të sakta, vuajtën, për fat të keq, nga ideologjizimi marksist që u imponohej historianëve. Sipas studiuesit të Mesjetës, Andi Rëmbecit përkthimeve u janë hequr pjesë, të cilat binin ndesh me ideologjinë e kohës⁴³. Duket se prof. Peppo bëri disa kompromise në mënyrë që të mund të vijonte pasionin e tij për historinë. Për kontributin i tij, ai u vlerësua nga pushteti i kohës. Kështu më 1950 iu akordua *Medalja e Kujtimit*. Në vitin 1958 nderohet me *Urdhrin e Punës të Klasit II*, ndërsa më 1962 mori edhe *Urdhrin e Punës të Klasit I*. Në vitin 1981 nderohet nga Këshilli Popullor i Fshatit Vithkuq (1981) me titullin “Fshatarë Nderi i Vithkuqit” [së toku me bashkëshorten e tij znj. Marika Peppo] me motivacion “Për punën këmbëngulëse në ngritjen, pasurimin e muzeut, në përgatitjen e sesionit shkencor *Mbi historinë e Vithkuqit*, si dhe zhvillimin

Shqipërisë : pjesa e parë (Bashkëautor) ; Lufta për çlirimin kombëtar në vitet 1878-1912: kujtime veteranësh (1962); Kujtime nga lëvizja për çlirimin kombëtar [Goni Katundi] (1962); Kujtime nga lëvizja për çlirimin kombëtar [Koço Grameno] (1962); Kujtime nga lëvizja për çlirimin kombëtar [Nepsi Kerenxhi] (1962); Kujtime të grave veterane nga lëvizja për çlirimin kombëtar (1962); Materiale dokumentare për Shqipërinë juglindore në shek. XVIII-XX: Kodiku i Korçës dhe Selasforit: I, II (1981), Kanunore të shoqërisë shqiptare: 1870-1936 (2007), Themistokli Gërmenji : kujtime (2014), Kodiku i Korçës dhe Selasforit: Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore në shek. XVIII-XX (2020) etj. Ka lënë në dorëshkrim punime shkencore ende të pabotuara.

⁴¹ Shumë prej dokumenteve historike të grumbulluara si pasojë e kësaj pune të përkushtuar, Peppoja ia ka dhuruar Arkivit Qendror të Shtetit (1960), por edhe Ministrisë së Arsimit (1960) për arkivat lokale (Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Delvinë, Përmet).

⁴² “Procesverbalet e mbledhjes vjetore të Institutit të Shkencave”, në: *Buletini i Institutit të Shkencave*, nr. 2, Tiranë: 1952, f. 183-184.

⁴³ Intervistë e Sonila Boçit dhe Kristi Kolçes me Andi Rëmbecin, marrë në dt. 20 tetor 2018.

e bisedave e takimeve me karakter shkencor me popullin e rininë”.

Ai nuk e ndali punën e tij kërkimore edhe pasi doli në pension në vitin 1968, duke kërkuar me ngulm që kontributi i tij të njihej dhe vlerësohej nga shtetit. Nga kërkimet në Arkivin Qendror të Shtetit janë gjetur disa letër-këmbime të tij me Enver Hoxhën, me anë të të cilave i kërkonte ta ndihmonte për t’iu akorduar Çmimi i Republikës (1974) apo të merrte titullin Profesor (1972). *“Kam forca të gjalla, - do t’i shkruante Peppoja Enver Hoxhës, - kam vullnet për punë, koha nuk më ka mposhtur akoma prandaj kam kërkuar nga Instituti i Historisë të më marrin në punë profesor pensionist”*⁴⁴. Në një letër drejtuar Enver Hoxhës shtator 1971 ai do t’i shkruante *“...i kërkoj Drejtorisë së Institutit të më propozojë në Komisioni i Lartë i Atestimit për të më akorduar titullin profesor duke më vënë në radhën e profesionistëve”*⁴⁵. Ndërsa disa vite më vonë, konkretisht në vitin 1974, do i shkruante përsëri Enver Hoxhës *“Për dijeni kam nderin t’ju dërgoj kopjen e lutjes drejtuar Institutit të Historisë më anën e së cilës në bazë të veprimtarisë sime entuziaste në dobi t’arsimit e të kulturës në popull të nderohem më Çmimin e Republikës”*⁴⁶. Vetë këto letra dhe përgjigjet që vijnë nga aparatçikët e KQ të PPSH-së janë një tjetër dëshmi e kontrollit të fortë shtetëror mbi shkencën. Ata nuk dëshironin ta merrnin në konsideratë kërkesën e Petraq Peppos, por kërkojnë që atij t’i kthehej një përgjigje e kujdesshme duke respektuar moshën e tij të shtyrë. Si për të kompensuar mosnjohjen

e meritave në fushën e studimeve, Peppoja mori vlerësime për veprimtarinë e tij pedagogjike. Me rastin e 70-vjetorit të lindjes, Presidiumi i Kuvendit Popullor i akordon *Urdhrin e Naim Frashëri të Klasit të I-rë*. Një vit më vonë, atij më në fund i jepet titulli shkencor “Bashkëpunëtor i vjetër shkencor”, ekuivalenti i sotëm i Profesorit të Asociuar. Në vitin 1984 ai nderohet me titullin “Mësues i Popullit”.

Peppoja u nda nga jeta më 14 dhjetor 1989. Pas vdekjes ai është nderuar me titullin “Qytetar nderi i qarkut Korçë”⁴⁷ me motivacionin “Figurë e shquar e arsimit kombëtar, patriot, historian me kontribut të gjerë të çmuar për zhvillimin e kulturës korçare dhe asaj kombëtare” nga Këshilli i Qarkut Korçë (2003), si dhe me titullin “Emblema e Artë e Qytetit” me motivacion “Intelektual i shquar, pjesë e Liceut të Korçës, që me aktivitetin e tij shkencor dhe shoqëror dha kontribute të mëdha në kulturën shqiptare” nga Bashkia e Korçës, me vendim të Këshillit Bashkiak në kuadër të festimeve të 100-vjetorit të çeljes së Liceut Kombëtar të Korçës (2017).

⁴⁴ AQSH, F. 14/AP str., V. 1972, D. 681, fl. 7

⁴⁵ AQSH, F. 14/AP str., V. 1971, D. 623, fl. 2

⁴⁶ AQSH, F. 14/AP str., V. 1974, D. 1090, fl.1

⁴⁷ Arkivi Personal i Familjes Pepo, e përmendur.

Dr. Enriketa Pandelejmoni (Papa)

Gjergj Kokoshi dhe kontributi i tij politik në një atmosferë atipike politike në Shqipërinë e pasluftës¹

Në këtë punim do të trajtohet figura e Gjergj Kokoshit, në kuadër të kontributit të tij politik në vitin e parë të pas Luftës së Dytë Botërore, duke u bazuar në burime kryesisht arkivore nga Arkivi Qendror i Shtetit dhe nga Arkivi i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Synimi është shkrimi i një studimi duke u bazuar në burimet arkivore dhe në analizën diskursive në hedhjen dritë mbi një nga figurat më interesante dhe më

pak të zbardhura në vitin e parë të konsolidimit të pushtetit nga Partia Komuniste, siç është Gjergj Kokoshi.¹

Gjergj Kokoshi lindi në Shkodër më 1904 nga Jaçim e Viktorë Kokoshi, u diplomua në Itali dhe Francë për filozofi dhe u doktorua në Paris për letërsi. Gjatë viteve '30 Kokoshi ishte profesor në Gjimnazin Shtetëror në Shkodër dhe në Tiranë, i njohur si antizogist.² Në vitin 1940 u ftua të bënte pjesë në Konferencën e Parë të Studimeve

¹ Shkrimi i këtij artikulli u mundësua edhe nëpërmjet ndihmës së disa personave, pa të cilët do të ishte e vështirë përsheptimi i kërkimit shkencor. Ndaj, një falënderim shkon për Sonila Boçin, e cila më ka ndihmuar me këshilla dhe materiale arkivore të rëndësishme për këtë punim. Një tjetër falënderim shkon për studenten time Enxhi Beka, që ka punuar intensivisht në arkiv. Po ashtu, gjej rastin të falënderoj edhe Ornela Arapin, pa të cilën puna ime tek AIDSSH do të ishte më e ngadaltë. Falënderimi i fundit, por jo i parëndësishëm, është për platformën PERFORM dhe AIDSSH që më mundësuan thellimin shkencor në një figurë aq interesante për periudhën e hershme të komunizmit në Shqipëri, siç është Gjergj Kokoshi.

² Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSH), dosja nr. 3, N 1081-A, fleta 11.



Indermar

Kam pyegatë në konferencë:

Shqipëria dhe banorët e saj gjatë
periodes proto-istorike

Pikat kryesore të periodes proto-istorike

A. Perioda proto-istorike shqiptare

B. Si ishte bota shqiptare gjatë periodes proto-istorike si në pikëpamje arkeologjike dhe në pikëpamje gjuhësore

C. Lidhshme të periodes proto-istorike shqiptare me botën e ashpër të periodes proto-istorike shqiptare

1. Perioda proto-istorike shqiptare

1940 - 1941

Shqiptare, ngjarje kjo që shërbeu si themeluese e Institutit Mbretënor të Studimeve Shqiptare. Ai refuzoi të merrte pjesë në këtë konferencë për arsye shëndetësore.³

Në thelb antifashist, Gjergj Kokoshi gjatë Luftës së Dytë Botërore dëshmoi afilicion me Lëvizjen Nacionalçlirimtare të drejtuar nga PKSH. Më 1943 ai aderoi në Frontin Nacionalçlirimtar⁴ dhe ishte ndër intelektualët antifashistë që u mor edhe me propagandimin e ideve antifashiste dhe përhapjen e tyre te rinia shkollore. Ai mori pjesë në rezistencën e armatosur kundër pushtuesit në zonën e Dibrës, madje pas Kongresit të Përmetit u gradua kolonel.⁵

Emri i Gjergj Kokoshit, profesorit, filloi të dëgjohet mjaft pas Kongresit të Përmetit, kongres që vuri bazat e regjimit komunist në Shqipëri. Në këtë kongres ai u zgjodh një prej anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar, struktura legjislative e qeverisjes së shtetit shqiptar.⁶ Ai duhet të jetë propozuar si i ngarkuar me punë për arsimin që gjatë ditëve të Kongresit, pasi emri i tij gjendet në një dokument pa firmë.⁷ Zyrtarisht, Kokoshi u emërua si i ngarkuar me arsimin më 20 qershor 1944 gjatë mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të mbajtur në Odrichan. Enver Hoxha e prezantoi Kokoshin me elozhe të mëdha. Ai vuri në dukje veprimtarinë e Kokoshit si pjesë-

marrës i Lëvizjes Nacionalçlirimtare, “si njeri që nuk ka bërë kompromise dhe si kompetent dhe me eksperiencë në fushën e arsimit”.⁸

Në mbledhjen e dytë të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar, të mbajtur në Berat më 20-23 tetor 1944, Kokoshi emërohet ministër i Arsimit në qeverinë provizore të drejtuar nga Enver Hoxha, post nga i cili dha dorëheqjen më 13 janar 1945. Në postin e ministrit të Arsimit, organizoi Kongresin e Arsimitarëve Antifashistë, i cili përpiloi platformën për organizimin e arsimit në Shqipëri. Në këtë kongres pikëpamja e Kokoshit për zhvillimin cilësor të arsimit në Shqipëri u përplas me pikëpamjen e Sejfulla Malëshovës për masivizimin e arsimit.⁹ Po ashtu debate Kokoshi kishte me Malëshovën edhe mbi kompetencat e Ministrisë së Kulturës Popullore, si në rastin e Institutit të Studimeve që ishte nën këtë ministri dhe jo në atë të Arsimit, si dhe mbi zërin e ulët që arsimit i ishte kushtuar në buxhetin e vitit 1945, kur më parë sipas Kokoshit arsimit i ishte rezervuar 13% e buxhetit.¹⁰

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, Kokoshi vazhdoi të ishte anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili pas gushtit të vitit 1945 mori emrin Fronti Demokratik. Në shtator dhe në fillim të dhjetorit të po këtij

³AQSH, f. 200, v. 1940, d. 2, fl. 26, Letër e Gjergj Kokoshit drejtuar Ministrisë së Arsimit, 9 prill 1940.

⁴Po aty, fleta 25.

⁵AQSH, f. 40/APL, v. 1944, d. 13, fl. 66. Procesverbal i Kongresit të Përmetit, 26 maj 1944.

⁶Po aty.

⁷AQSH, f. 40/APL, v. 1944, d. 19, fl. 6. Vendim i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar për emërimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar, pa datë, pa firmë.

⁸AQSH, f. 40/APL, v. 1944, d. 31, fl. 1. Fjala e Enver Hoxhës në mbledhjen e parë të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të mbajtur në Odrichan, 20 qershor 1944.

⁹E. Kambo, *Arsimi në Shqipëri*, Tiranë, 2005, Botim i Akademisë së Shkencave, “Mësonjëtorja”, fq. 14-16.

¹⁰AQSH, f. 489, d. 88, v. 1945, fleta 27.

viti, edhe pse ishte anëtar i Frontit Demokratik, e shprehu hapur kundërshtimin e tij ndaj ligjit të ri zgjedhor, që nuk lejonte pjesëmarrjen në zgjedhje të partive të tjera.¹¹

Zgjedhjet e para politike të 2 dhjetorit 1945

Qeveria provizore shqiptare pas çlirimit të Shqipërisë nuk ishte njohur ndërkombëtarisht dhe një ndër objektivat kryesorë mbetej konsolidimi i pushtetit politik dhe njohja ndërkombëtare e saj. Kjo e fundit ishte refuzuar të bëhej nga Aleatët Perëndimorë, ku sidomos SHBA dhe Britania e Madhe kishin vënë si kusht zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Ndaj Partisë Komuniste (PKSH) i duhej fillimisht të organizonte zgjedhjet lokale dhe më pas ato kombëtare, me synimin e fitimit të tyre nëpërmjet paraqitjes në zgjedhje të anëtarëve vetëm të FNÇ, pas të cilit qëndronte PKSH. Zgjedhjet e organeve lokale u zhvilluan gjatë pranverës 1945 dhe në to PKSH arriti të zgjidhte njerëzit e vet, që i konsideronte “të sprovuar në luftë, të vendosur dhe besnikë ndaj interesave të popullit”, dhe të organizonte “ndërtimin e aparatit të ri shtetëror, si nga forma dhe nga përmbajtja marksiste-komuniste, mbi baza të reja institucionale, administrative, e u ngritën gjykatat popullore, Policia Popullore dhe Drejtoria e Mbrojtjes Popullore,¹² që më pas u shndërrua në organet e Sigurimit të Shtetit”, që do t’i shërbenin

konsolidimit të pushtetit të PKSH dhe mori në duart e veta drejtimin e shtetit, duke eliminuar më parë “përfaqësuesit e reaksionit”. Gjergj Kokoshi kandidoi në këto zgjedhje në Lagjen e Re në Tiranë, por nuk mundi të zgjidhej dhe kishte marrë vetëm 17 vota.¹³

Pas zgjedhjeve lokale të majit 1945 PKSH duhej të konsolidonte pushtetin qendror dhe kjo u realizua përmes shndërrimit të FNÇ në një organizatë politike, e cila do të dilte si e vetmja alternativë politike në zgjedhjet qendrore. Para zgjedhjeve FNÇ zhvilloi kongresin e tij, më 3 gusht 1945, ku edhe u shndërrua në Frontin Demokratik dhe Fronti kontrollohej totalisht nga PKSH, por kishte edhe elementë jokomunistë, që ishin të paktë. Pas Kongresit u vendos që zgjedhjet qendrore të mbaheshin më 2 dhjetor 1945. Por përpara tyre, më 27-29 shtator 1945, u mbajt mbledhja e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar (KANÇ), në të cilën u diskutua kryesisht për zgjedhjet e ardhshme dhe u miratua një paketë ligjore për to. U miratua ligji elektoral, ligji mbi Asamblenë Kushtetuese dhe ligji mbi listat e votuesve.¹⁴ Të tria këto ligje në njëfarë mënyre kufizonin zhvillimin e zgjedhjeve të lira, megjithëse ligji elektoral nuk vinte kufizime për paraqitjen e kandidatëve nga grupime të ndryshme politike.¹⁵ Kështu ekzistenca e një force të vetme politike si Fronti Demokratik që drejtohej nga PK, që nuk lejonte krijimin e grupeve të tjera politike, rrjedhimisht e kthente Shqipërinë në një shtet monist.

¹¹ Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist IV (Tiranë: ISKK, 2015), fq. 264.

¹² Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, *Historia e Partisë Punës së Shqipërisë*, botimi i dytë (Tiranë: 8 Nëntori, 1968), fq. 186.

¹³ AIDS, dosja nr. 3, N 1081-A, fleta 25.

¹⁴ Sonila Boçi, *The December 2nd, 1945 Albanian Elections: Legitimization, or Mere Formalization for Communist Power?* Porta Balkanica (7), 2005, fq. 16, ç11-24]

¹⁵ Kandidati si i pavarur mund të konkurronte në zgjedhje nëse kishte 20 firma dhe grupimi politik regjistrohej nëse mblidhte 70 firma. Për më shumë shih ligjin nr. 124 (28.09.1945) botuar te *Gazeta zyrtare*, nr. 54.

I gjithë procesi i administrimit të votimit, sipas historianes Sonila Boçi, ishte në duart e FANÇ, pasi procesi zgjedhor administrohej nga Fronti dhe komisionet elektorale kryesoheshin dhe në shumicën absolute të tyre ishin me anëtarë të FANÇ, si dhe votimi do të mbikëqyrej nga anëtarë të këshillave të Frontit, gjë që minonte transparencën e të gjithë procesit elektorale.¹⁶ Zgjedhjet do të fillonin në orën 7 të mëngjesit deri në orën 19, në krye të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të ishte Andrea Saatçi dhe të gjithë anëtarët e komisionit vinin nga Fronti (Andrea Nathanailli, Faik Dishnica, Xhavid Gjata, Vasil Avrami, Halim Budo, Spiro Stringa). Madje, edhe zëvendësuesit e tyre ishin anëtarë të Frontit Demokratik (Salim Luniku, Irakli Noçka, Neki Delvina, Sotir Kuneshka, Vasil Sidoshi, Karaman Ylli dhe Eqrem Çabej).¹⁷

Këto dhe disa ambiguitete të tjera të ligjit elektorale shkaktuan pakënaqësi të përgjithshme për ata individë që kishin qëllim të konkurronin si të pavarur në zgjedhjet e 2 dhjetorit, por edhe brenda vetë FANÇ. Që në diskutimet mbi hartimin e ligjit Gjergj Kokoshi, në atë kohë ministër i Arsimit, por edhe anëtar i Këshillit të FANÇ, diskutoi mbi problematikat e ligjit të menduar, i cili nuk ishte i përshtatshëm me parimet demokratike, madje doli kundër miratimit të këtij ligji që cenonte vendosjen e një regjimi demokratik dhe pluralist. Në kushtet e pasluftës ky ligj nuk u mundësonte njerëzve të arsimuar dhe të kualifikuar për të kontribuar për vendin e tyre. Lufta kishte marrë fund dhe tani ishte

koha për të zhvilluar Shqipërinë sipas standardeve demokratike e u duhej dhënë mundësia atyre njerëzve, të cilët për arsytet e besimit të tyre politik nuk ishin anëtarë të FANÇ, të mund të vinin kandidaturat për zgjedhjet e përgjithshme.¹⁸ Sipas Kokoshit, ligji nuk u jepte kohën e mjaftueshme njerëzve dhe grupimeve jashtë Frontit për t'u organizuar e për të paraqitur listat dhe kandidaturat e tyre. Ligji favorizonte thjesht FANÇ, madje zgjedhjet ishin nën kontrollin e Frontit. Ndaj kushdo që do të konkurronte në këto zgjedhje do ta bënte kundër jo vetëm Frontit, një organizate politike, por përkundrejt makinerisë shtetërore.¹⁹ Kjo binte ndesh me parimet e demokracisë liberale. Kështu, dukej se Fronti Demokratik dominohej komplet nga PKSH dhe ky fakt ishte i ditur edhe për qeveritë e aleatëve, për të cilët nuk kishte iluzione mbi regjimin e ri dhe që qeveria shqiptare për ta ishte thjesht “një grup individësh të sinqertë, patriotë, me të cilët do të kishte vështirësi në bashkëpunim”, pasi, sipas përfaqësuesit amerikan në Tiranë, Jacobs, “zyrtarët ishin injorantë për sa i përket shkencës së qeverisjes, dinin shumë pak mbi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe ishin tepër të ndjeshëm ndaj faktit se, megjithëse kishin luftuar kundër të njëjtit armik, ende qeveria e tyre nuk ishte njohur nga aleatët, përveç Jugosllavisë”.²⁰

Duket se para zgjedhjeve të 2 dhjetorit edhe brenda vetë Frontit Demokratik kishte pakënaqësi dhe hezitime mbi mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve dhe “lirisë” për të kandiduar jashtë Frontit. Qeveria

¹⁶ Sonila Boçi, vep. cit., fq. 17.

¹⁷ AQSH, f. 489, d. 88, v. 1945, fleta 2.

¹⁸ Sonila Boçi, vep. cit., fq. 17.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Elidor Mëhilli, *From Stalin to Mao. Albania and the Socialist World*, Cornell University Press, Ithaka, London, 2017, fq. 21.

shqiptare ende nuk ishte njohur nga Aleatët, ndaj njerëz jashtë Frontit filluan të organizoheshin me shpresën e konkurrimit në këto zgjedhje, madje kontaktuan edhe me njerëz brenda Frontit apo Këshillit Nacionalçlirimtar, siç ishte Gjergj Kokoshi i cili, pavarësisht se kishte qenë ministër i Arsimit pas luftës, kishte filluar të mbante një qëndrim më kritik ndaj politikave qeverisëse dhe ishte tërhequr nga posti i ministrit. Në mbledhjet e KFNÇ Kokoshi disa herë ishte shprehur kundër politikave të ashpra ekonomike, të cilat mund të justifikoheshin për kriminelët e luftës, por nuk mund të vazhdonin të merreshin masa të rrepta dhe rekuizim pasurie edhe ndaj anëtarëve të familjes së tyre, sidomos në rastet kur personi në fjalë kishte vdekur,²¹ apo edhe në rastin e tatimit të jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës të kihej kujdes me aplikimin e këtij ligji, pasi kështu siç ishte zhvilluar si procedurë ligji ishte kthyer në një makth për tregtarët.²²

Kjo klimë e nderë politike e bëri Gjergj Kokoshin që të rimendonte pozicionin e tij brenda Frontit dhe mundësinë e largimit të tij, pasi e shikonte që të gjithë punën e Frontit po e drejtonin vetëm komunistët dhe qeveria drejtohej vetëm nga Partia Komuniste.²³ Ndaj rruga e ndjekur prej tij për të marrë pjesë në këto zgjedhje duket se ka qenë ajo e daljes nga listat e Frontit Demokratik. Sipas tij, në publik flitej kundër Frontit, se s'kishte liri dhe se vendi ishte në diktaturë.²⁴

Në këtë frymë pakënaqësie ndaj politikës elektorale të Frontit Demokratik dhe synimit të

fitores së zgjedhjeve prej tij, Gjergj Kokoshi filloi të përpiquej për t'u organizuar politikisht. Ishte takuar disa herë me njerëz që po mundoheshin të organizoheshin për zgjedhjet e 2 dhjetorit, si Shefqet Beja, Selahudin Toto, Riza Dani, Kosta Boshnjaku, Kol Kuqali, Irfan Majuni e Musine e Salim Kokalari, të cilët duke shpresuar edhe në mbështetjen amerikane dëshironin të formonin një parti klandestine me parimet e demokracive perëndimore dhe donin të shtrinin ndikimin te shtresat e pakënaqura sociale, si të prekurit nga regjimi i ri, tregtarët, pronarët, çifligarët dhe intelektualët me parime të kundërta me pushtetin popullor.²⁵ Por, sipas deponimit të Shefqet Bejës pas arrestimit të tij, duket se, megjithëse Kokoshi ishte kundra dhe e kishte kundërshtuar në Front ligjin elektorale, ai propozoi themelimin e një opozite dhe daljen si parti më vete në zgjedhjet e 2 dhjetorit. Ky propozim nuk u ndoq nga anëtarët e tjerë dhe sipas Shefqet Bejës, ky ishte dallimi mes tyre, grupit opozitar që kërkonte mbështetjen e amerikanëve të cilët u kishin rekomanduar Bejës dhe të tjerëve që më mirë të rrinin brenda radhëve të Frontit sesa të dilnin më vete, dhe Kokoshit që, siç dukej, anonte më shumë nga influenca britanike, u shkëput nga grupi i Shefqet Bejës dhe Riza Danit.²⁶

Po ashtu, Kokoshi ishte edhe mik i Mirash Ivanajt dhe i kushëririt të tij Nikolla Ivanaj. Ai shpeshherë ishte takuar në Tiranë me Mirash Ivanajn, i riadhesuar rishtazi në Shqipëri me ftesë të vetë Kokoshit si ministër i Arsimit, mbi mundësinë

²¹ AQSH, f. 489, d. 108, v. 1945, fleta 6.

²² AQSH, f. 489, d. 108, v. 1945, fleta 13.

²³ AIDSH, dosja nr. 3, N 1081-A, fleta 25.

²⁴ AIDSH, dosja nr. 3, N 1081-A, fleta 6.

²⁵ AIDSH, dosja nr. 3, N 1081-A, fleta 19.

²⁶ Po aty.

e organizimit dhe daljes si kandidatura në zgjedhjet e 2 dhjetorit. Nikolla Ivanaj mendonte të vinte kandidaturën në Shkodër dhe përkrahej nga Kokoshi dhe Mirashi, madje ky i fundit në shënimet e Ministrisë së Brendshme gjatë marrjes në pyetje konsiderohej që bashkë me Kokoshin “ishin me Frontin dhe pushtetin, por më të rezervuar, gjoja për t’i dhënë një pamje më demokratike Frontit”. Sipas shënimeve në dosjen e hetuesisë së Kokoshit, Mirash Ivanaj shënohej se “i ka thënë se Aleatët kanë deklaruar që anëtarë të KANÇ janë të emëruar dhe jo të zgjedhur”.²⁷

Në opozitën politike anti-PKSH

Gjithsesi, nga dosja e tij hetimore-gjyqësore, tërhequr tek AIDSSH, Kokoshi duket se krijimin e një partie opozitare e ka pasur qëllim të qenësishëm dhe ka biseduar e është takuar edhe me persona të ndryshëm të interesuar në formimin e saj. Kështu, gjatë hetuesisë depononte se “aktivitetin e tij politik për formimin e një Partije, e cila do të kishte funksionin e një opozite demokratike konstruktive”, e kishte filluar rreth 15 tetorit 1945.²⁸ Gjatë Luftës së Dytë Botërore madje, siç mësohet nga dosja formulare e Selahudin Totos, Kokoshi ishte i pakënaqur nga elementët ekstremë të majtë që ishin në pushtet. Për Kokoshin, LNÇ nuk ka qenë lëvizje njëqind për qind e së majtës ekstreme. Në të ka pasur edhe të moderuar (fakti që ekstremistet morën pushtetin nuk i pëlqente dhe kishte shkaktuar shumë dëshpërim në shumë elementë të lëvizjes).²⁹

²⁷ Po aty, f. 25.

²⁸ AIDSH, dosja nr. 3, N 1081-A, fleta 3.

²⁹ AIDSSH, dosja 11 formulare e Selahudin Totos, fq. 29.

³⁰ Boçi, vep. cit, fq. 14.

Meqenëse nuk arriti të kishte firmat e nevojshme për të krijuar grupimin politik, ra në kontakt me njerëz të tjerë antikomunistë e anti-Front, që ishin në këtë kohë duke u organizuar për zgjedhjet. Ai u takua në Tiranë me intelektualë të ndryshëm, si Sami Qeribashi, Shaban Balla, Profi Çeko, Tut Mëniku për të diskutuar mbi krijimin e një grupi i cili do të konkurronte në zgjedhjet e 2 dhjetorit. Kësaj nisme politike të të sipërpërmendurve iu bashkuan edhe njerëz të tjerë, të cilët ishin të interesuar të dilnin veçmas Frontit e që ligji elektorale nuk ua lehtësonte kandidimin, si Musine Kokalari, që ishte iniciatorja e grupimit social-demokrat, apo Qenan Dibra, simpatizant i monarkistëve.

Duhet pasur parasysh se në kushtet e një terrori politik të iniciuar me gjyqet speciale apo “gjyqet e popullit” të marsit 1945, fillimisht ndaj “kriminelëve të luftës”, duke vijuar më tej me antikomunistët, kryesisht në Veri të Shqipërisë, klima në vend nuk ishte edhe aq në favor të organizimeve politike jashtë Frontit. Por, gjithsesi, presioni ndaj qeverisë shqiptare për t’u njohur përfundimisht nga të gjithë Aleatët (BS e njohu qeverinë shqiptare më 10 nëntor 1945), i kushtëzuar prej SHBA dhe Britanisë së Madhe me kryerjen e zgjedhjeve të lira dhe demokratike, dhe lejimi i gazetarëve të huaj gjatë fushatës elektorale dhe në ditën e zgjedhjeve,³⁰ ishin faktorë nxitës për elementët jokomunistë për t’u organizuar dhe për të dalë me lista konkrete në zgjedhje. Megjithatë, presioni ishte i jashtëzakonshëm, duke pasur parasysh edhe kohën e shkurtër: prej 1 tetorit kur ligji u

shpall në Fletoren Zyrtare dhe deri në zgjedhje mbeteshin vetëm 2 muaj. Presioni duket aq i madh, sa në takimet e fshehta doli në pah edhe vështirësia në sigurimin e firmave të mjaftueshme për të shpallur kandidaturat apo grupin politik. U arrit të mblidheshin 25-30 firma, të cilat ishin të pamjaftueshme për të kandiduar si subjekt politik.³¹ Në mbledhjen e parë që u zhvillua në shtëpinë e Shaban Ballës, ku morën pjesë përfaqësues të tri grupimeve, më 17 nëntor 1945, grupi vendosi të dilte me një emër konkret, Bashkimi Demokratik, si bashkim i rrymave politike me qëllim formimin e një opozite.³² Qëndrimi politik antifashist dhe i kahut të majtë të Kokoshit duket edhe kur ai propozon që për të realizuar këtë ishte e nevojshme hartimi i një programi dhe i një lutjeje që do të nënshkruheshin prej disa “njerëzve të ndershëm me qëndrim politik korrekt”, që do t’i dërgoheshin Ministrisë së Brendshme për ta vënë në dijeni. Programi i kësaj partie, për habinë e të gjithëve të mbledhur në takim, do të ishte pak a shumë i ngjashëm me atë të Frontit, meqenëse edhe ky grupim politik do të ishte në kahun e Bllokut antifashist. Kjo parti, sipas bindjes së Kokoshit, do të kryente “po ato reforma ekonomike që do të bënte Fronti, por në një masë më të vogël”.³³

Duket se në bindjet e tij të majta Kokoshi, si një antifashist, por edhe si një patriot, ndahej me Frontin në çështjen e politikës së jashtme. Ai ishte kundër politikës së qeverisë shqiptare, e cila sipas tij “don me bashkue Shqipërinë me Jugosllavinë”.

Për të, ky bashkim ishte kundër vullnetit të popullit shqiptar, “populli shqiptar don që Shqipëria të mbetet shtet independent dhe sovran, na duhet ta rujm një shtet të tillë, por pa Gjirokastër e pa Korçë nuk ka shtet shqiptar”. Ndaj Shqipëria duhet të ruhet nga Veriu dhe Jugu. Ndërsa për sa i përket çështjes së Kosovës Kokoshi duket se kishte një mendim tjetër nga të pranishmit në mbledhje, kur sugjeron që për momentin kjo çështje duhej lënë mënjanë, “pasi Jugosllavia na ndihmon për me rujt integritetin tokësor”.³⁴ Ndaj Kokoshi propozoi që para se të hartohej programi duheshin mbledhur firmat të cilat ishin të nevojshme për të dalë si opozitë në zgjedhje dhe secili duhet të mendonte personat për firmë. Gjergj Kokoshi, përpos përpjekjeve për të dalë me një parti më vete në zgjedhje, kishte edhe besim te misionet britanike dhe amerikane në Shqipëri dhe tek influenca e tyre mbi qeverinë shqiptare për t’i bërë presion mbi mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve, sidomos për shtyrjen e tyre. Me naivitete dhe për habinë e pjesëmarrësve në mbledhje, u bën me dije se programi dhe lutja duhej t’i dërgoheshin qeverisë shqiptare, konkretisht Ministrisë së Brendshme, pasi kishte biseduar me gjeneralin britanik Hodgson dhe ai i kishte sugjeruar që për këtë duhet t’i drejtohej Ministrisë së Brendshme të qeverisë shqiptare.³⁵ Ky propozim i tij u prit me skepticizëm nga shumica e pjesëmarrësve në mbledhje, pasi po të bënin me dije qeverinë mbi krijimin e kësaj partie rrezikonin të arrestoheshin. Por Kokoshi insistoi në mendimin

³¹ AIDS, dosja nr. 5, N 1081-A, fleta 50.

³² AIDS, dosja nr. 3, N 1081-A, fleta 3.

³³ Po aty.

³⁴ Po aty.

³⁵ Po aty, fleta 4.

e tij mbi bërjen me dije të qeverisë mbi organizatën politike dhe duhej marrë parasysh edhe arrestimi në momentin që ndërmarrin nismën për të krijuar një parti opozitare.³⁶

Për këtë u rimblodhën edhe në një mbledhje tjetër në të cilën, përveç firmave, do të diskutohej edhe çështja e Kosovës, programi dhe do të dakordësoheshin në notën apo memorandumun që do t'u dërgonin misioneve britanike dhe amerikane me shpresën për të influencuar në shtyrjen e zgjedhjeve dhe në krye u vunë Gjergj Kokoshi dhe avokat Fuad Asllani;³⁷ secili prej anëtarëve ideatorë të grupit do të merrte përsipër sigurimin e firmave të nevojshme për t'u legalizuar pastaj si grupim elektorale.

Vështirësia e mbledhjes së firmave vuri në mëdyshje organizatorët për të marrë në konsideratë mundësinë reale të Bashkimit Demokrat të tri grupeve (grupi i rezistencës, monarkistët, social-demokratët) për të marrë pjesë në zgjedhjet e 2 dhjetorit. Ndaj përfaqësues të tyre u takuan me përfaqësues të misionit britanik, për t'u paraqitur programin dhe një memorandum me 10 pika, ku ndër to kërkohesh edhe ndërmjetësimi i misionit britanik pranë qeverisë shqiptare për të shtyrë zgjedhjet. Si pikë kontakti me britanikët shërbyen anëtarë të Bashkimit Demokrat, të cilët punonin si përkthyes pranë britanikëve dhe amerikanëve, si Kiço Xhonga, Avdulla Muça, Shaban Balla, Niko Beço, Hivzi Golja, Larry Posti (Llazar Papapostoli).³⁸

Vetë Gjergj Kokoshi, së bashku me avokat Sami Qeribashin, ideatori kryesor i Bashkimit Demokrat, dhe Shaban Ballën, vunë në dijeni Aleatët Perëndimorë nëpërmjet kolonelit Palmer, të cilin e kishin takuar disa herë për të diskutuar mbi hapat e marrë. Ideja që iu paraqit Palmer-it ishte ajo e formimit të një grupi opozitar, në të cilin do të bashkoheshin përfaqësues të disa tendencave politike me një program dhe degë në disa qytete kryesore të Shqipërisë ku kishin përkrahës, si në Shkodër, Korçë, Tiranë, Vlorë. Bashkimi Demokrat do të dilte më vete në zgjedhjet e 2 dhjetorit me një program të vetin. Kokoshi u bëri me dije anglezëve se në rast se zgjedhjet do të ishin të lira opozita do të fitonte 20-30%, ndaj u duhej mbështetja angleze. Prej misionit atyre iu komunikua që të hartonin programin e kërkesën për shtyrjen e zgjedhjeve, pasi të kishin siguruar firmat.³⁹

Më 20 nëntor 1945 përfaqësues të ndryshëm të grupimeve politike u mbledhën sërish në shtëpinë e Shaban Ballës, ku në këtë mbledhje Gjergj Kokoshi, si përfaqësues edhe i Frontit Nacionalçlirimtar, vuri në dukje nevojën e bashkimit të grupeve për të bashkëpunuar dhe për të formuar një opozitë. Pati edhe debate mbi përfshirjen ose jo të çështjes së Kosovës në program, ku Kokoshi ishte në fillim kundër, për shkak se “duhet ta mbanin mirë me mareshalin Tito”,⁴⁰ por u tërhoq më vonë për shkak të imponimit të pjesëmarrësve të tjerë se, nëse nuk përfshihej Kosova në program, nuk do të kishin dallim nga Partia Komuniste. Po ashtu, Kokoshi

³⁶ Po aty.

³⁷ Instituti i Historisë, “Historia e popullit shqiptar”, vëll. 4, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj* (Tiranë: Toena, 2008), fq. 193.

³⁸ *Koçi, Dorian, Musine Kokalari and the Anticommunist Resistance in 1945-1946*, *Anglisticum Journal (IJLLIS)*, Volume: 6| Issue: 7, fq. 46.

³⁹ AIDS, dosja nr. 5, N 1081-A, fleta 53.

⁴⁰ AIDS, dosja nr. 3, N 1081-A, fleta 80.

u propozoi anëtarëve të mbledhjes që programi i opozitës t'u çohet anglezëve, konkretisht gjeneralit Hudgson, por edhe qeverisë shqiptare. Për këtë të fundit të tjerët ishin kundra, duke parashikuar rrezikshmërinë e lartë për ta nëse qeveria shqiptare vihej në dijeni.⁴¹ Si përfundim, u la vetëm që programi dhe një notë mbi shtyrjen e zgjedhjeve të dhjetorit, formën demokratike të regjimit pas zgjedhjeve dhe për mundësinë e kthimit të mbretit Zog në Shqipëri nëse pas zgjedhjeve vendosej për një formë monarkike të regjimit, t'u dërgohej vetëm misioneve aleate në Tiranë.⁴²

Kështu u hartua një memorandum në një mbledhje tjetër për shtyrjen e zgjedhjeve, që u dërgua misionit anglez dhe atij amerikan në Tiranë.⁴³ Sipas dëshmisë së Qenan Dibrës, prezent në mbledhje, u ra dakord për bashkimin e tri grupeve dhe hartimin e një programi, një memorandum, ku synimi i Bashkimit Demokratik ishte që:

1. Nuk ishte e mundur që zgjedhjet të zhvilloheshin lirisht në konditat e sotme, sepse populli kishte për të votuar për Frontin (Nacionalçlirimtar) nga frika.
2. Premtimet e dhëna nga qeveria nuk i përshatëshin së vërtetës, sepse në atë kohë qeveria kishte caktuar një afat të shkurtër për paraqitjen e ndonjë opozite ose kandidatëve të veçantë.
3. Nuk mjafton ardhja e korrespondentëve të huaj për vëzhgimin e zgjedhjeve.

4. Vëzhgimi i zgjedhjeve mund të bëhet vetëm me dërgimin e observatorëve anglo-amerikanë.
5. Kërkohej një ndërhyrje nga ana e Aleatëve në bazë të parimit të shpallur shpesh prej burrave të shteteve aleate.⁴⁴

Te misioni anglez grupi opozitar dërgoi edhe një notë, në të cilën kërkonte shtyrjen e zgjedhjeve dhe dërgimin e disa vëzhguesve për zgjedhjet. Po ashtu, koalicioni i tri partive me tendencë të ndryshme demokratike kërkonte edhe sigurimin e independencës dhe integritetit tokësor të Shqipërisë etnike (Kosovë e Çamëri); zbatimin e Reformës Agrare; dënimin e Kriminelëve të Luftës; marrëdhënie miqësore me fqinjët; zgjidhjen e çështjes së Kosovës në bazë të Kartës së Atlantikut; deklarimin e neutralitetit të shtetit shqiptar dhe garantimi i këtij neutraliteti nga ana e Fuqive të Mëdha.⁴⁵

Por, kur ua dorëzuan dy ushtarakëve anglezë, Palmer dhe Arnott, në misionin e tyre në Tiranë, morën përgjigje se tashmë këto ishin dorëzuar shumë vonë dhe pak shpresë kishte për shtyrjen e zgjedhjeve, por, sidoqoftë, do t'ia dorëzonin gjeneralit Hodgson.⁴⁶ Në fakt, anglezët kishin pasur gjatë gjithë vitit 1945, para se të njihej qeveria shqiptare, disa takime me përfaqësues të ndryshëm të opozitës, kontakte të cilat u zhvilluan nga koloneli Palmer dhe majori Arnott. Vetë Palmer-i dhe Arnott-i në letrat që i kanë dërguar Ministrisë së Jashtme britanike me rastin e akuzave ndaj britanikëve në

⁴¹ AIDSH, dosja nr. 3, N 1081-A, fleta 81.

⁴² Po aty.

⁴³ AIDSH, dosja nr. 5, N 1081-A, fleta 54.

⁴⁴ AIDSH, dosja nr. 3, N 1081-A, fleta 73.

⁴⁵ AIDSH, dosja nr. 3, N-1081-A, fleta 74.

⁴⁶ AIDSH, dosja nr. 5, N 1081-A, fleta 47.

gjyqin e grupit për ndihmë, kanë sqaruar pozicionin e tyre, duke mohuar që t'u kenë bërë njerëzve të opozitës premtime konkrete. Palmer-i pranon që iu dorëzua një program dhe memorandum, që për qëllim primar kishte marrjen e pushtetit në rrugë demokratike dhe paqësore, duke nënkuptuar zgjedhje të lira. Në mungesë të këtyre zgjedhjeve, atëherë mund të përdorej forca. Ndërsa nga memorandum i kërkohej se, ndër të tjera, në qoftë se një numër i madh prej tyre do të arrestoheshin, atëherë britanikët duhet t'i mbështesnin.⁴⁷ Ndërsa majori Arnott, edhe ai pranon takimet e shpeshta me përfaqësues të grupeve opozitare në mision. Atij planet e tyre i ishin dukur të dobëta dhe shpeshherë me natyrë dhune. Madje për të këto grupe ishin joefektive dhe kundërshtonin njëri-tjetrin në mjaft çështje bazike, duke mos pasur bashki me njëri-tjetrin. Ai pranon se ndër emrat që ka pasur kontakte ishin edhe Gjergj Kokoshi, Sami Qeribashi, Qenan Dibra, Xhavid Koka, Fuad Asllani, Shaban Balla, Musine Kokalari, Larry Post (Llazar Papapostoli), të cilët i ishin dukur të përgarë dhe se nuk e inspironin se do të mund të ruanin konfidencialitetin e bisedave me të.⁴⁸

Megjithatë, siç u përmend më lart, të gjithë ranë dakord për bashkimin e grupeve në një parti opozitare jashtë Frontit me Gjergj Kokoshin si kryetar të saj,⁴⁹ i cili ishte profesor që njihte mirë rininë në shkollat e gjimnazet dhe do të mund ta organizonte atë. Musine Kokalari duket se ka qenë

skeptike ndaj aderimit në këtë koalicion dhe ka pasur po ashtu dyshime se pse në krye të opozitës duhet të ishte Gjergj Kokoshi. Ajo në një bisedë me Suad Asllanin e pyet se përse duhet të ishte Kokoshi në krye dhe pse ishte aq i domosdoshëm. Ai iu përgjigj se ishte personi më i përshtatshëm, pasi kishte qenë në Front, kishte luftuar, kishte qenë ministër, deputet dhe ishte një personalitet i njohur për aleatët.⁵⁰ Më pas ajo u tërhoq dhe pranoi që Bashkimi Demokrat të kryesohej nga Gjergj Kokoshi, madje ishte po ajo që në mbledhjen e tretë në shtëpinë e Ali Kavajës shkroi memorandum për shtyrjen e zgjedhjeve bashkë me Qenan Dibrën.⁵¹

Në memorandum⁵² shkruhej si më poshtë:

Gjatë pushtimit italian dhe gjerman në Shqipëri komunistët luftuan kundër forcave pushtuese nën zërin e "Frontit Nacionalçlirimtar", programi politik i të cilit bazohej tërësisht në një sistem demokratik. Një thirrje kaq gjeniale u dha mundësinë të zgjerojnë në mënyrë të konsiderueshme radhët e tyre, duke regjistruar një pjesë të madhe të djemve, të cilët luftonin me gëzim për çlirimin e atdheut. Arsyeja që një pjesë e madhe e djalërisë u bashkua me komunistët qëndron në faktin që dy grupet e tjera nacionaliste (Balli Kombëtar dhe pasuesit e Zogut), duke pasur frikë nga komunizmi dhe duke qenë nën influencë të një pjese të shtypit Aleat, nuk vazhduan luftën kundër forcave pushtuese. Djallërisë dhe nacionalistëve të tjerë që morën pjesë në Lëvizjen

⁴⁷ Erald Kapri, *Sekretet e Luftës. Shqipëria tjetër në dokumentet britanike* (Tiranë: Lumo Skëndo, 2017), fq. 412-413.

⁴⁸ Po aty, fq. 413-415.

⁴⁹ AIDS, dosja nr. 3, N-1081-A, fleta 151.

⁵⁰ Po aty, fleta 170.

⁵¹ Leka Ndoja, *Bashkimi Demokratik Shqiptar 1946. Akte gjyqësore politike gjatë komunizmit në Shqipëri I* (Tiranë: ISSK, 2015), fq. 14-15.

⁵² Alina Wagner, *Musine Kokalari dhe Social-Demokracia në Shqipëri* (Tiranë: Fridrich Ebert Stiftung, 2016), fq. 26-29.

Nacionalçlirimtare nuk u shkoi ndër mend kurrë se po binin në grackë dhe të mendonin ngritjen me forcë të një regjimi komunist në Shqipëri.

Në këtë mënyrë Fronti Nacionalçlirimtar u bë i vetmi grupim politik i autorizuar nën direktivat dhe kontrollin komunist. Nacionalistët, që përbënin shumicën, nuk lejohen të formojnë një parti të veçuar nga komunistët; ata nuk lejohen, gjithashtu, të shkëputen prej frontit duke krijuar një parti jashtë tij. Në të dyja rastet akuzohen si sabotatorë, fashistë dhe reaksionarë “rasti i prof. Gjergj Kokoshit, më parë ministër i Arsimit në qeverinë e Enver Hoxhës e tregon qartë këtë gjë”.

2. Pasqyra e përgjithshme e gjendjes së tanishme

(a) Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, qeveria, këshillat e prefekturave dhe të nënprefekturave, si dhe të lokaliteteve më të vogla, ndodhen të gjitha nën drejtimin dhe kontrollin komunist.

(b) Të tria fuqitë, d.m.th. pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, ndarja e të cilave garanton një regjim me liri politike, në fakt janë një përzierje. Shumëzimi i zyrave bëhet për këtë qëllim. Shembull është që kryetari i policisë, në të njëjtën kohë, gjendet edhe anëtar i trupit gjykues (nënpresident), anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, kryetar i Gjyqit të Lartë, kryetar i Komisarëve Politikë në ushtri etj.

(c) Të katër liritë (liria e fjalës, e fesë, e nevojës dhe e frikës) janë shkelur nën këmbë.

(d) I tërë legjislacioni është marrë prej atij të Jugosllavisë; ligjet më të rëndësishme janë një për-kthim besnik i ligjeve jugosllave.

(e) Në të gjitha problemet shtypi ynë dhe radioja paraqesin tërësisht pikëpamjet ruse.

(f) Puna e Policisë bëhet prej Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit, programi dhe aktiviteti i së cilës përbën një GPU të dytë. Kryetari i saj, gjenerali Koçi Xoxe, është një nga të dy sekretarët e përgjithshëm të Partisë Komuniste Shqiptare, tjetri është vetë Enver Hoxha.

(g) Numri i atyre që janë vrarë egërsisht gjatë ditëve të para të regjimit (150 pa u gjykuar fare në Tiranë e në rrethe), si dhe ata që janë gjykuar, dënuar me vdekje dhe pastaj ekzekutuar, i kapërcen të 1.000-jën në të gjithë vendin. Në qoftë se merr si shembull Francën, popullata e së cilës është 45 herë më e madhe se jona, që në të njëjtën kohë numëron 2.321 dënime me vdekje, atëherë mund të kuptonit tragjedinë e popullit shqiptar. Shumë prej këtyre janë ekzekutuar për shkak se po të qenë të gjallë do të kanosnin unitetin e regjimit të tanishëm.

Ka rëndësi këtu të përmendet që ca muaj më parë në Durrës disa njerëz i bënë qeverisë një telegram, me anën e të cilit kërkonin mëshirë për ca persona që u dënuan me vdekje nga gjyqi lokal. Për këtë ata u arrestuan menjëherë, u nxorën në gjyq dhe u dënuan me burgim, pasi me qëndrimin e tyre kishin shkuar kundër mendimit gjyqësor, i cili konsiderohet si shprehje më e lartë e vullnetit të popullit! Aktiviteti i Mbrojtjes së Popullit dhe mënyra me të cilën u zhvillua drejtësia kanë krijuar një atmosferë frike dhe terrori në të gjithë vendin. Natyrisht, kjo gjë e ka shtuar më tepër numrin e të pakënaqurve, por frika dhe vetëm frika i ka ndaluar ata të organizohen në një opozitë.

Po të mos dish këtë gjë të nëndheshme, është e pamundur të marrësh vesh pse populli do të shkojë në votime më 2 dhjetor, si mund të bëhej ndryshe, kurse Shqipëria ndodhej për 13 muaj nën diktaturën më të tmerrshme që ka parë historia e saj. Shko në katunde dhe bisedo me popullin fshehtësisht dhe atëherë do të konstatosh se një presion është ushtruar në favor të listës unike të Frontit Nacionalçlirimtar.

(h) Shqipëria nuk ka pasur kurrë një ushtri kaq të madhe sa kjo e tanishmja; numri i saj është dyfishuar qysh prej çlirimit të vendit dhe tani përbëhet prej rreth 60.000. Mbajtja e një ushtrie kaq të madhe i kushtohet kryesisht faktit se autoritetet kanë frikë që numri i vazhduar i të pakënaqurve mund të përbëjë rrezik për regjimin. Kjo masë politike ka pasur një efekt katastrofal jo vetëm për financat tona, që përmbledhin më tepër së gjysmën e buxhetit për ushtrinë, po gjithashtu edhe për bujqësinë dhe blegtorinë, në të cilat ndihet seriozisht mungesa e krahut të punës.

(i) Në administratat tona gjenden gati katër herë më shumë funksionarë se përpara. Kjo i përgjigjet faktit se qeveria mund t'iu gjejë punë të gjithë punonjësve besnikë pa marrë parasysh kapacitetin e tyre. Me gjithë atë, për të pasur një administratë të kënaqshme, ata janë të detyruar të mbajnë disa nga teknikët më të mirë dhe, në fakt, janë këta që bëjnë gjithë punën. Por kjo situatë ka krijuar njëfarë kaosi dhe, për këtë, kjo është arsyeja që nëpër krahina punët zgjaten tepër.

(j) Ligji i bujqësisë është nga reformat më me rëndësi, për të cilën regjimi fryhet së lëvduari. Kjo është bërë dhe aplikuar në mënyrë ekstreme: 1. Toka, që u është lënë pronarëve të mëparshëm

(15 hektarë), është e pamjaftueshme t'u sigurojë atyre jetën, megjithëse kanë mjaft tokë për të gjithë. 2. Ligji bujqësor, kështu siç ekziston, është vetëm e vetëm një konfiskim, pasi e tërë toka është shpronësuar, duke mos u shpërblyer aspak.

(k) Qeveria e ka humbur besimin e tregtarëve për shkak të masave që kanë ndër degët e ndryshme të aktivitetit ekonomik. Iniciativa private është zhdukur pothuajse krejtësisht.

(l) Për sa i përket politikës së jashtme, qeveria e tanishme i qëndron besnike aksit Beograd-Moskë. Parulla "Enver-Tito" është bërë e zakonshme.

3. Kush jemi ne?

Është nevoja të theksojmë që ne nuk jemi armiq të komunizmit. Edhe sikur të mos ekzistonte komunizmi, do të qe e dobishme ta krijonim si një fuqi shtytëse drejt përparimit social. Por, nga ana tjetër, ne jemi kundërshtarët e tij politikë derisa ai shkel liritë politike dhe ngre një qeveri despotike në vend të asaj demokratike.

4. A është e mundur demokracia në Shqipëri?

Është e parakohshme të flitet në Shqipëri për një demokraci të tipit perëndimor. Po, nga ana tjetër, kjo nuk do të thotë se është nevoja për një qeveri totalitare në vendin tonë. Ne besojmë se një demokraci relative me të paktën 2 parti është plotësisht e mundshme në Shqipëri. Kjo gjë do t'i jepte rast shumicës së popullit, të cilët nuk janë komunistë, të bashkohen me një organizatë, me anën e së cilës të jenë në gjendje të shprehin idetë politike.

5. Cili është programi ynë?

(a) Politika e brendshme

Vendosja e menjëhershme e lirisë së plotë politike. Liri e fesë, liri e shtypit, liri e personave

dhe mbrojtja përpara ligjit dhe përpara gjyqit me gjykatës të zgjedhur.

(b) Politika e jashtme

Pjesëmarrja në të gjitha kombet e bashkuara në themelimin e një rregulli internacionalist të bazuar mbi principin e sigurimit kolektiv. Mbajtja e marrëdhënieve miqësore me të gjithë aleatët tanë të mëdhenj dhe me të gjithë fqinjët tanë. Ne do të përpiqemi me të gjitha forcat tona për të dhënë kontributin tonë për një të ardhme paqësore dhe më të mirë në Ballkan dhe të sigurojmë integritetin tonë tokësor, konform shpirtit dhe Kartës së Atlantikut.

(c) Politika sociale

Përmirësimi material dhe moral i kushteve të jetës së klasës punëtore. Pjesëmarrja e plotë e punëtorëve dhe e fshatarëve në jetën politike. Lënia e lirë e organizatave të punëtorëve dhe pjesëmarrja e tyre në vendosjen e kushteve të punës. Demokratizimi i institucioneve. Rivendosja e identitetit familjar.

(d) Politika ekonomike

Respektimi i plotë i pasurive private brenda kufijve të funksioneve shoqërore. Kontrolli i shtetit mbi industrinë vitale dhe inkurajimi i iniciativës dhe i ndërmarrjeve private.

(e) Reforma agrare

Ngritja e shtëpive moderne për fshatarësinë dhe krijimi i kooperativave bujqësore.

6. Dëshira jonë e zjarrtë

Duke konsideruar që misioni juaj në Shqipëri është i shenjtë, pasi e keni për detyrë t'i thoni

botës situatën e vërtetë të vendit tonë, shpresojmë se do të konstatooni që në situatën e tanishme të flasësh për zgjedhje të lira do të thotë të errësosh të vërtetën. Me këtë frymë, ne shpresojmë që ju do të bëheni interpret jo vetëm i opozitës, por pothuaj i dëshirës së gjithë kombit për shtyrjen e zgjedhjeve, në mënyrë që t'i jepet rast popullit të shprehë lirisht vullnetin e tij dhe në këtë mënyrë të ngrejë një qeveri demokratike përfaqësuese.

Do të shihni një numër të madh realizimesh që do t'ju tregohen për llogari të qeverisë të tanishme. Ne nuk e vëmë në dyshim vullnetin e mirë të qeverisë, por, në të njëjtën kohë, e quajmë të nevojshme të nënvizojmë që shumica e këtyre realizimeve kanë ekzistuar përpara nëntorit të 1944-ës. Për sa u përket urave dhe punimeve të tjera të këtij lloji, çdo shqiptar e di mirë që këto janë ndërtuar prej shoqërive italiane, nën mbikëqyrjen shqiptare, me materiale të sjella nga Italia.

Përveç memorandumit, në takimet e bëra nga grupet e Bashkimit Demokratik secili paraqiti programet respektive. Musine Kokalari u paraqiti atë të social-demokratëve të cilët përfaqësonte dhe Sami Qeribari atë të Grupit të Rezistencës ku, ndër të tjera, kishte si qëllim të krijonte lidhje me të arratisurit politikë jashtë Shqipërisë, me njerëzit brenda, për të organizuar një kryengritje kundër regjimit komunist. Si kryetar i këtij grupi,⁵³ hartoi një thirrje për të arratisurit jashtë dhe ato nëpër qytetet kryesore, ku u bënte me dije formimin e Komitetit Nacional që ftonë të gjithë kundërshtarët e regjimit t'i bashkoheshin në përpjekjen e tyre. Madje, Sami Qeribari i bëri me dije grupit se ishte menduar që

⁵³ AIDSH, dosja nr. 3, N 1081-A, fleta 81.

para zgjedhjeve, më datë 28 nëntor, me rastin e Festës së Pavarësisë të organizohej edhe një demonstratë dhe të kërkohesh shtyrja e zgjedhjeve. Prandaj dhe ishte përgatitur dhe një thirrje për popullin:

28 nëntor 1945

Vllazër shqiptarë!

Sot në këtë ditë të shenjtë ka ardh koha që të gjithë të bashkohemi dhe t'iu heqim maskën armiqve të kombit, që na kanë pushtue votrat tona dhe po na çojnë në greminë.

Partija Komuniste që është sot në fuqi me terror siç e dini të gjithë nuk është gjë tjetër përveç një vegël e verbër e Imperializmit sllav. Kjo parti që mbretëron sot në Shqipëri, sikundër e shiti Kosovën, ka me ja dorëzue Titos shumë shpejt dhe krejt Shqipninë.

Na përket ne popullit dhe patriotëve të vërtetë që e dashurojnë këtë vend me sinqeritet të duhur, që ta shpëtojmë Atdheun nga këjo fatkeqësi e madhe që ka qenë sot.

Me qenë se këtu po trumbetohet se gjoja ka shumë liri, fjalë propagande, ju njoftojmë që të gjithë sëbashku të drejtohem në misionet Aleate dhe të kërkojmë prej tyre ndërhyrjen për shtyrjen e zgjedhjeve, për me i tregue botës mbarë, se këtu ka një Opozitë të fortë që është në gjendje të përmbledhë rreth saj shumicën dërmuese të popullit shqiptar dhe ka formue për këtë qëllim Koalicionin e partive me tendenca demokratike

(Partia Monarkiste, Social-Demokrate dhe ajo e Rezistencës).⁵⁴

Demonstrata nuk u mbajt prej frikës së survejimit dhe u hodhën vetëm trakte kundër pushtetit. Të gjitha iu dërguan misioneve britanike dhe amerikane, por asnjë prej tyre nuk ndërhyri pranë qeverisë shqiptare për të shtyrë zgjedhjet. Zhgënjimi dhe hidhërimi i mosndërhyrjes së tyre duket edhe në fjalët e Musine Kokalarit rrëfyer në fshehtësi tek i nipi i saj më 1972, kur shprehet: “Aleatët nuk i ndërhyjnë qeverisë dhe heshtën mbi një çështje e cila, logjikisht, rezultoi më pas si e pashmangshme për dënimin e firmosësve. Një nga një firmëtarët u arrestuan me akuzën për rrëzim të qeverisë. Pasojat për të gjithë këta njerëz janë thjeshtësisht të imagjinueshme.”⁵⁵

Heshtja e përfaqësuesve britanikë dhe amerikanë, të cilët tashmë ishin në dijeni të ekzistencës së opozitës dhe përpjekjes për të dalë në zgjedhje, ishte fatale për Bashkimin Demokratik që ndërkohë ishte edhe i survejuar nga strukturat e Seksionit të Mbrojtjes Popullore (Sigurimi), i cili kishte katër informatorë dhe bashkëpunëtorë brenda opozitës. Goditja ishte e afërt. Që në dhjetëditëshin e parë të vitit 1946 filluan arrestimet e para (10-23 janar). Fillimisht u arrestuan Sami Qeribari, Qenan Dibra, Gjergj Kokoshi, Musine Kokalari dhe Shaban Balla, që ishin drejtuesit kryesorë, si dhe pjesëtarë të tjerë, gjithsej 37 persona.⁵⁶

Gjyqi ndaj 37 anëtarëve të Bashkimit Demokratik filloi në Tiranë më 17 qershor 1946 në kinema

⁵⁴ AIDS, dosja nr. 3, N-1081-A, fleta 263.

⁵⁵ Wagner, vep. cit., fq. 13.

⁵⁶ Ndoja, vep. cit., fq. 17-18.

Nacional (kinema 17 Nëntori) në prani të një pulli “të zgjedhur” dhe gazetarëve vendas.⁵⁷ Gjyqi që zgjati 15 ditë u transmetua edhe në radio, si formë presioni dhe si një mjet propagandistik i pushtetit popullor, që ta dëgjonin njerëzit në çdo skaj të Shqipërisë. Grupi u gjykua nga Gjykata e Lartë Ushtarake e kryesuar nga major Frederik Nosi, Kapitenët e Parë Veledin Zeneli e Nexhat Hyseni, ndërsa akuza u mbrojt nga prokurori ushtarak, Kapiteni i Parë Nevzat Haznedari.⁵⁸ Të gjithë akuzoheshin se ishin mbledhur disa herë me qëllim që, në bashkëpunim me kriminelët e luftës të arratisur brenda e jashtë vendit dhe me reaksionin e jashtëm, të aktivizoheshin për të rrëzuar me dhunë pushtetin popullor, për të shkaktuar një ndërhyrje të imperialistëve të jashtëm, që për pasojë të kishte një vetëvrasje, do të bënin atentate kundër udhëheqësve të pushtetit popullor dhe ishin të lidhur ngushtë edhe me reaksionin e grupit të klerit katolik, Bashkimi Shqiptar.⁵⁹ Të lidhur me gjithë këto grupe e individë reaksionarë, këto rrethe kundërshtarë, në fillim me propagandën kundër masave të gjera dhe reformave shoqërore, filluan të veprojnë në grupe të vogla klandestine për të krijuar më vonë komitete e nënkomitete, të cilat u lidhën dhe bashkërisht me grupet fashiste terroriste të Shkodrës formuan një komitet qendror të përkohshëm, të ashtuquajtur Komiteti Nacional. Programi i tyre kryesisht synonte të rrëzonte pushtetin popullor me violencë dhe me terror, përmes atentateve, aksioneve të ndryshme me kriminelët

e arratisur, goditje deponsh ushtarake dhe grabitje armësh e municionesh, sulme me armë nga kriminelët e arratisur jashtë.⁶⁰

Në aktakuzën e prokurorit të çështjes kundër Kokoshit, Nevzat Haznedari e akuzonte atë që, në bashkëpunim me Suat Asllanin, Qenan Dibrën, Sami Qeribarin dhe elementë të tjerë të Ballit, Legalitetit e të tjerë, kishte udhëzuar dhe frymëzuar në mënyrën e veprimit për të tërhequr sa më shumë elementë dhe iu kishte treguar mënyrën e organizimit të grupeve për t'u lidhur me njëri-tjetrin, si grupin e Rezistencës, monarkistëve e të tjerë, të lidheshin edhe me të arratisurit, të ashtuquajtur kriminelë të luftës brenda e jashtë Shqipërisë. I kishte mësuar të përpilonin nota për misionin e huaj dhe me anë e tyre të kërkonin ndërhyrjen dhe ndihmën e tyre. Ka shfrytëzuar vendin, emrin dhe kredinë që i kishte dhënë Fronti duke e përdorur për të sabotuar e për të përmbysur pushtetin. Gjithë aktiviteti dhe propaganda e tij ka qenë për të përmbysur me forcë pushtetin popullor në lidhje me të sipërpërmendurit e me reaksionin grek e ndërkombëtar. Prandaj prokurori kërkonte dënimin e tij nga Gjykata e Lartë Ushtarake.⁶¹

Kokoshi gjatë gjyqit mbajti edhe një fjalë në mbrojtje të vetes, e cila mungon në aktet gjyqësore,⁶² por pranonte se “qeveria komuniste nuk përfaqësonte vullnetin e popullit. Ajo po ia falte gjithë pasurinë Jugosllavisë”, ndaj ai i ishte bashkuar grupit të opozitës. I vënë para një fakti të qartë të

⁵⁷ Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës* (Tiranë: ISSK), fq. 89.

⁵⁸ AIDSH, dosja nr. 5, N-1081-A, fleta 35.

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ Po aty, f. 36-37.

⁶¹ Po aty.

⁶² Pepa, vep. cit., fq. 95.

një gjyqi politik e farsë në akuza, në fund edhe ai si të tjerët (Sami Qeribari e Musine Kokalari) vendos të mos flasë më. Thjesht kërkoi të dinte se “çka ishte në kundërshtim me ligjet shtetërore në fuqi?”

Në përfundim të Gjyqit të Bashkimit Demokrat, më 2 korrik 1946 u dhanë dënime për 37 personat e gjykuar, prej të cilëve 8 u pushkatuan dhe të tjerët u dënuan me dënime nga 30-2 vjet. Ndërsa informatorët e Sigurimit u dënuan minimalisht ose u liruan si të pafajshëm.⁶³

Përfundime

Gjergj Kokoshi ishte një ndër ideatorët kryesorë të koalicionit opozitar Bashkimi Demokrat, që përfshinte bashkimin e tre përfaqësuesve të tri rrymave politike në Shqipërinë e pas Luftës së Dytë Botërore, monarkistëve, social-demokratëve dhe atyre të ashtuquajtur grupi i rezistencës, përfaqësues kryesisht të pronarëve të mëdhenj, të arratisurve politikë e intelektualëve antikomunistë. Kokoshi, që kishte një veprimtari politike në FANÇ, u ftua të mernte pjesë në Bashkimin Demokratik dhe ta kryesonte atë, pasi njihej si një intelektual, politikan me përvojë dhe popullor ndër njerëz. Ky pragmatizëm në zgjedhjen e tij në krye të opozitës vinte edhe ngase përfaqësonte të pakënaqurit brenda Frontit dhe ishte në dijeni të politikave shtetërore të kohës, por njihej edhe si një njeri i afërt me misionin britanik në Shqipëri. Ndaj pakënaqësia e tij dhe vullneti për të marrë pjesë në aktivitet politik dhe të sakrifikoje veten, pavarësisht se shëndeti i tij ishte i prekur nga TBC,⁶⁴ ishin arsye të

qenësishme në vënien e tij në krye të opozitës. Po ashtu emrin e tij nuk e kundërshtuan as britanikët, madje këta edhe e kërkuan Kokoshin në krye të opozitës.

Bashkimi Demokratik nuk arriti të dilte në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 si parti opozitare, për shkak edhe të vonesës së miratimit të këtij koalicioni rrymash politike prej misioneve aleate, të cilat, megjithëse ishin në dijeni të çdo hapi dhe initiative politike të grupit, si vënia e kontakteve me të arratisurit politikë jashtë Shqipërisë, Muharem Bajraktari, Fiqiri Dine e Shefqet Vërlaci, apo me ata që fshiheshin brenda, si Alush Leshanaku, nuk e mbështetën këtë parti. Mungesa e kësaj mbështetjeje ishte fatale, pasi, pavarësisht mosarritjes së mbledhjes së 75 firmave të domosdoshme për të dalë si subjekt politik, ndërhyrja e aleatëve pranë qeverisë shqiptare për të shtyrë zgjedhjet, si dhe dekonspirimi i Bashkimit Demokratik nga brenda, bënë që edhe kjo nismë politike për vendosjen e një demokracie liberale në Shqipërinë e post-1945 të dështonte.

Bashkimi Demokratik u zbulua dhe të gjithë ideatorët dhe organizatorët e tij nëpër qytetet kryesore të vendit u arrestuan dhe u dënuan me dënime kapitale dhe me burgim të rëndë. Goditja e Bashkimit Demokratik vinte në një klimë tepër të nderë politike, ku në harkun kohor të një viti ishin vënë para gjyqeve speciale dhe popullore dhe ishin dënuar me dhjetëra njerëz, të cilët kërkonin një Shqipëri jo të orientuar drejt Lindjes Komuniste.

⁶³ Ndoja, vep. cit., fq. 15.

⁶⁴ AIDSH, dosja nr. 3, N-1081-A, fleta 20.

Në fakt, fati i Shqipërisë ishte vendosur si konsekuencë edhe e vendimeve Jaltës, por më 1945, kur ende nuk ishin zhvilluar zgjedhjet e lira dhe kur njohja ndërkombëtare e Shqipërisë kondicionohej nga këto zgjedhje, goditja e grupimeve politike jocomuniste në Shqipëri u dhanë *knock out*-in atyre që shpresonin ende për vendosjen e një shteti demokratik-liberal.

Gjergj Kokoshi u dënua me 30 vjet burg dhe humbjen e të drejtave qytetare dhe politike, si dhe konfiskimin e pasurisë. Dënimi 30-vjeçar i tij do të mbaronte më 23 janar 1976, por ai ndërroi jetë në burgun e Burrelit në vitin 1961.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

AIDSSH

Sigurimi dhe shkenca: mbi rolin e shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954): (studimet e plota) / Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; përgat. për bot. Ornela Arapi; red. Kadia Dedja. – Tiranë: Onufri, 2021

159 f.: me foto; 22 cm.

ISBN 978-9928-354-04-4

1.Sundimi komunist, 1945-1991 2.Shenca dhe shteti

3.Shkencëtarë 4.Persekutimi politik 5.Shqipëri

323.212(496.5) "1945/1954"

ISBN: 978-9928-354-04-4